

Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri

# PËRMBLEDHJE E RASTEVE MBI AFTËSINË E KUFIZUAR NË JURISPRUDENCËN E GJYKATËS SË STRASBURGUT

Mars 2016



**PËRMBLEDHJE E RASTEVE  
MBI AFTËSINË E KUFIZUAR  
NË JURISPRUDENCËN E  
GJYKATËS SË STRASBURGUT**

Mars 2016

Programi i Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri

## Përmbledhje Rastesh mbi Aftësinë e Kufizuar në Jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut

Mars 2016

## FALENDERIME

Autorja e këtij punimi falënderon ekipin e programit të PNUD-it, “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri”, që udhëhoqi dhe koordinoi gjithë punën për hartimin e këtij botimi. Gjithashtu, ajo falënderon në veçanti Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që, në cilësinë e institucionit drejtues për çështjet e aftësisë së kufizuar, vlerësoi nevojën për këtë studim dhe nxiti kryerjen e tij në kuadër të programit të bashkëpunimit me PNUD-in. Ajo falënderon gjithashtu edhe zonjën Ina Xhepa për mbështetjen e saj gjatë të gjitha fazave të realizimit të këtij botimi.

Kjo përmbledhje është realizuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri, në kuadër të projektit “Mbështetja e Kombeve të Bashkuara për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (UNSSIA), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim e Bashkëpunim.

Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë përmbledhje nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), apo të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Tiranë, mars 2016

**Përgatitur nga:** Dajena Kumbaro

**Recensuese:** Prof. Dr. Arta Mandro  
Agustela Nini-Pavli, MA  
Sidita Fortuzi, MA

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE	9	Zarzycki k. Polonisë, 12.03.2013, Nr. 15351/03	44
2. METODOLOGJIA	10	<i>Nëse kushtet e vuajtjes së dënimit të kërkuesit përbënin trajtim poshtërues, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.</i>	
3. STANDARDE TË GJEDNJ-SË PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	11	Dordević k. Kroacisë, 24.7.2012, Nr. 41526/10	45
3.1. E drejta e jetës	11	<i>Nëse, ngacmimet dhe shqetësimet e vazhdueshme, që u bëheshin kërkuesve nga persona privatë dhe mosmarrja e masave nga autoritetet shtetërore për t'i mbrojtur kërkuesit, përbënin shkelje të së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese, të drejtës së jetës private e familjare dhe parimit të mosdiskriminimit.</i>	
3.2. E drejta për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtërues	13	Arutyunyan k. Rosisë, 10.01.2012, Nr. 48977/09	49
3.3. Heqja e lirisë për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor	15	<i>Nëse, kushtet në të cilat kërkuesi vuante dënimin me heqje lirie, ishin në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe nëse kishte shkelje të nenit 3 të Konventës.</i>	
3.4. Jeta private dhe familjare: Heqja e të drejtave prindërore	18	Zoti H. k. Hungarisë, 08.11.2012, Nr. 28973/11	52
3.5. Heqja e zotësisë për të vepruar dhe garancitë e procesit të rregullt	19	<i>Nëse ndalimi i kërkuesit dhe kushtet e vuajtjes së dënimit shkelnin garancitë, sipas nenit 3 dhe nenit 5 të Konventës.</i>	
3.6. E drejta e votës	20	Groni k. Shqipërisë, nr. 25336/0, 7 korrik 2009	54
3.7. Pagesa e aftësisë së kufizuar dhe e drejta e pronës	21	<i>Nëse, mosdhënia e kujdesit të duhur mjekësor për kërkuesin, ka cenuar të drejtën e tij për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor e degradues.</i>	
3.8. Mbrojtja nga diskriminimi	21	Dybeku k. Shqipërisë, 18.12.2007, Nr. 41153/06	57
3.9. Referimi te KPDAK-ja	22	<i>Nëse, mungesa e kujdesit të përshtatshëm shëndetësor gjatë vuajtjes së dënimit nga kërkuesi, i cili vuante nga aftësi të kufizuara mendore, shkelte të drejtën e tij për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor e poshtërues.</i>	
PJESA E DYTË - VENDIMET E GJEDNJ-SË	23	Vincent k. Francës, 24.10.2006, Nr. 6253/03	58
I. E DREJTA E JETËS	23	<i>Nëse, heqja e lirisë së kërkuesit me aftësi të kufizuara fizike në një institucion të vuajtjes së dënimit, ku ai nuk mund të qarkullonte lirisht, përbënte trajtim poshtërues dhediskriminues.</i>	
Lambert dhe të Tjerët k. Francës [DHOMA E MADHE], 5.6.2015, Nr. 46043/14	23	Price k. Mbretërisë së Bashkuar, 10.07.2001, Nr. 33394/96	60
<i>Nëse ekzekutimi i vendimit gjyqësor për ndërprerjen e ushqyerjes dhe hidratimit, që mbanin pacientin në jetë në mënyrë artificiale, shkelte nenin 2 të Konventës.</i>		<i>Nëse kushtet e heqjes së lirisë në komisaratin e policisë dhe burgun e grave përbënin trajtim çnjerëzor e poshtërues sipas nenit 3.</i>	
Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar, 29.04.2002, Nr. 2346/02	26	Aswat k. Mbretërisë së Bashkuar, 14.04.2013, Nr. 17299/12	61
<i>Nëse refuzimi i autoriteteve të lejonin vdekjen e asistuar të kërkueses shkelte të drejtën e jetës dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues.</i>		<i>Nëse ekstradimi në SHBA i kërkuesit, i cili vuante nga probleme të rënda të shëndetit mendor dhe akuzohej për kryerjen e veprave terroriste, shkelte nenin 3 të Konventës.</i>	
Qendra e Burimeve Juridike në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë, 17.07.2014, Nr. 47848/08	29	S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar, 29.01.2013, Nr. 60367/10	63
<i>Nëse vdekja e kërkuesit në një spital psikiatrik përbënte shkelje të nenit 2 dhe nëse kishte pasur një mjet ankimi efektiv, sipas nenit 13.</i>		<i>Nëse kthimi i kërkuesit në vendin e origjinës, pas refuzimit të kërkesës për azil, shkelte të drejtën e tij për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtërues.</i>	
Nencheva dhe të Tjerët k. Bullgarisë, 18.06.2013, Nr. 48609/06	33	Hukić k. Suedisë, 27.09.2005, Nr. 17416/05	65
<i>Nëse vdekja e pesëmbëdhjetë fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, që ishin nën përkujdesjen e shtetit, përbënte shkelje të së drejtës së jetës nga shteti i paditur.</i>		<i>Nëse kthimi i një prej kërkuesve që vuante nga sindroma 'down' në vendin e origjinës, shkelte nenin 3 të Konventës.</i>	
Jasinskis k. Letonisë, 21.12.2010, Nr. 45744/08	36	III. LIRIA DHE SIGURIA	67
<i>Nëse humbja e jetës së djalit të kërkuesit dhe mosndërmarrja nga ana e autoriteteve e një hetimi efektiv për këtë ngjarje, cenonte nenin 2, par. 1, të Konventës për të drejtën e jetës.</i>		Mihailovs v. Latvia, 22.01.2013, nr. 35939/10	67
II. NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMIT ÇNJERËZOR DHE DEGRADUES	40	<i>Nëse vendosja dhe mbajtja e kërkuesit, i cili vuante nga epilepsia, në një institucion shtetëror të përkujdesjes sociale kundër vullnetit të tij, por me lejen e kujdestares ligjore, shkelte të drejtën e tij për liri, sipas nenit 5 të Konventës.</i>	
Helhal k. Francës, 19.02.2015, Nr. 10401/12	40	Lashin k. Rosisë, 22.01.2013, Nr. 33117/02	71
<i>Nëse mbajtja në burg e kërkuesit në kushte të papërshtatshme përbën trajtim poshtërues dhe çnjerëzor, sipas nenit 3 të Konventës.</i>		<i>Nëse, heqja e zotësisë së kërkuesit për të vepruar dhe shtrimi i tij në një spital psikiatrik, përbënin shkelje të të drejtës për jetë private dhe të së drejtës për moskufizim të paligjshëm të lirisë.</i>	
Grimailovs k. Letonisë, 25.06.2013, Nr. 6087/03	42		
<i>Nëse trajtimi i kërkuesit nga policia dhe gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit përbënte shkelje të së drejtës së tij për t'u mbrojtur nga tortura e trajtimi çnjerëzor e poshtërues.</i>			

Stanev kundër Bullgarisë (Dhoma e Madhe), 17.01.2012, Nr. 48977/09	75	Spyra dhe Kranczkowski k. Polonisë, 25.09.2012, Nr. 19764/07	109
<i>Nëse heqja e zotësisë së kërkesit për të vepruar, vendosja e tij në një qendër sociale pa vendim gjyqësor dhe mohimi i të drejtës së tij për të kërkuar rivendosjen e zotësisë për të vepruar, përbënin shkelje të lirisë dhe sigurisë, shkelje të së drejtës për mjet efektiv dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor.</i>		<i>Nëse pakujdesia nga personeli mjekësor, e pretenduar se kishte shkaktuar aftësinë e kufizuar të një prej kërkuësve gjatë lindjes, shkelte nenet 2 dhe 8 të Konventës.</i>	
Shtukurov k. Rosisë, 27.03.2008, Nr. 44009/05	81	Glass k. Mbretërisë së Bashkuar, 09.03.2004, Nr. 61827/00	111
<i>Nëse heqja e zotësisë së kërkesit për të vepruar, pa e përfshirë atë në procesin gjyqësor, dhe vendosja e tij në një spital psikiatrik shkelnin të drejtën për liri, për proces të rregullt ligjor dhe të drejtën për jetë private.</i>		<i>Nëse mosmarrëveshja ndërmjet nënës së kërkesit dhe personelit mjekësor, rreth trajtimit mjekësor të kërkesit, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës private të kërkesit, veçanërisht të së drejtës së tij për integritet fizik.</i>	
IV. PROCESI I RREGULLT	86	Botta k. Italisë, 24.02.1998, Nr. 153/1996/772/973	112
D.D. k. Lituanië, 14.2.2012, Nr. 13469/06	86	<i>Nëse mosveprimi i organeve shtetërore për garantimin e qasjes së kërkesit në ambjentet e një hoteli privat, shkelte të drejtën e jetës private dhe të drejtën për mosdiskriminim.</i>	
<i>Nëse proceset gjyqësore për emërimin e kujdestarit dhe vendosjen e kërkuës në një qendër sociale shkelenin procesin e rregullt ligjor sipas nenit 6 dhe të drejtën e kërkuës për liri sipas nenit 5.</i>		X dhe Y k. Holandës, 26.03.1985, Nr. 8978/80	114
Salontaji-drobnjak k. Serbisë, 30.01.2010, nr. 36500/05	89	<i>Nëse vendimi i prokurorisë për të mos nisur ndjekjen penale, për shkak se kërkuësja nuk kishte bërë kallëzim si viktimë e një abuzimi seksual, shkel të drejtën për jetë private, sipas nenit 8.</i>	
<i>Nëse kërkesit i ishte shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor gjatë procesit të vlerësimit të zotësisë së tij për të vepruar, dhe nëse atij i ishte mohuar e drejta e qasjes në gjykatë për sa i përket kërkesës për rikthimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas nenit 6 të Konventës.</i>	148	VI. E DREJTA E PRONËS	115
Dauti k. Shqipërisë, nr. 19206/05, 3 shkurt 2009	91	Katai k. Hungarisë, 18.03.2014, Nr. 939/12	115
<i>Nëse vendimi gjyqësor i gjykatave të brendshme, se vendimi i Komisionit të Ankimeve ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor, shkelte qasjen në gjykatë, sipas nenit 6 të Konventës.</i>		<i>Nëse pensioni i invaliditetit të kërkesit, dhënë me një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili si pasojë e ndryshimeve ligjore nuk do të vazhdonte t'i jepej më kërkesit, shkelte të drejtën e pronës, të drejtën për proces të rregullt dhe të drejtën për mjet efektiv.</i>	
V. E DREJTA PËR JETË PRIVATE DHE FAMILJARE	94	Kjartan Ásmundsson k. Islandës, 12.10.2004, Nr. 60669/00	116
Ivinović k. Kroacisë, 18.09.2014, Nr. 13006/13	94	<i>Nëse ndërprerja e pagesës së aftësisë së kufizuar së kërkesit nga Fondi i Pensioneve, shkelte nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së për të drejtën e pronës, së bashku me nenin 14 të KEDNJ-së për mosdiskriminim</i>	
<i>Nëse kufizimi i zotësisë së kërkuës për të vepruar shkelte të drejtën për një jetë të qetë private, sipas nenit 8, dhe të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, sipas nenit 6.</i>		Koua Poirrez k. Francës, 30.09.2003, Nr. 40892/98	118
Dmitriy Ryabov k. Rosisë, 01.08.2013, Nr. 33774/08	96	<i>Nëse trajtimi i ndryshëm për sa u përket përfitimeve sociale mes shtetasve francezë, ose shtetasve me vendbanim të përhershëm në Francë, shkelte të drejtën e pronësisë, sipas nenit 1 të Protokollit 1, dhe parimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 14 të Konventës.</i>	
<i>Nëse heqja e kujdestarisë së kërkesit mbi të birin shkelte të drejtën për jetë private e familjare dhe parimin e mosdiskriminimit.</i>		VII. E DREJTA PËR TË VOTUAR	120
A.K. dhe L. K. Kroacisë, 08.01.2013, Nr. 37956/11	98	Alajos Kiss k. Hungarisë, 20.05.2010, Nr. 38832/06	120
<i>Nëse heqja e të drejtave prindërore të kërkuës dhe birësimi i fëmijës së saj shkelte të drejtën për jetë familjare.</i>		<i>Nëse kufizimi me vendim gjyqësor i zotësisë së kërkesit për të vepruar, si pasojë e të cilit ai nuk kishte të drejtë për të votuar, shkelte Konventën.</i>	
R.P. dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, 09.10.2012, Nr. 38245/08	100	Molka k. Polonisë, 11.04.2006, Nr. 56550/00	122
<i>Nëse caktimi i një kujdestari ligjor për kërkuësen, për ta përfaqësuar në procedurat gjyqësore për heqjen e të drejtës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së saj, shkelte të drejtën e qasjes në gjykatë.</i>		<i>Nëse pretendimi i kërkesit, për cenim të së drejtës për të votuar, shkelte nenin 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).</i>	
A.M.M. k. Rumanisë, 14.02.2012, Nr. 2151/10	102	VIII. MOSDISKRIMINIMI	123
<i>Nëse, procesi gjyqësor ku kërkuësi kërkonte njohje atësie, shkelte të drejtën e saj për jetë private e familjare dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor.</i>		Glor k. Zvicrës, 30.04.2009, Nr. 13444/04	123
Saviny k. Ukrainës, 18.12.2008, Nr. 39948/06	104	<i>Nëse vendimi administrativ ndaj kërkesit për pagimin e një gjobe, për moskryerjen e shërbimit ushtarak përbënte diskriminim, për shkak të aftësisë së kufizuar të kërkesit.</i>	
<i>Nëse heqja e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të kërkuësve ndaj fëmijëve të tyre dhe vendosja e fëmijëve të kërkuësve nën pakujdesje shoqërore, shkelte të drejtën e kërkuësve për jetë private e familjare, procesin e rregullt ligjor dhe parimin e mosdiskriminimit.</i>		INDEKSI ALFABETIK I ÇËSHTJEVE SIPAS NENEVE TË KONVENTËS	127
Kutzner k. Gjermanisë, 26.02.2002, Nr. 46544/99	106	BURIME NË INTERNET PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA	128
<i>Nëse vendimi gjyqësor, që u hoqi kërkuësve të drejtat prindërore ndaj të dy vajzave të tyre, shkelte të drejtën e tyre për respektimin e jetës së qetë familjare, garantuar nga neni 8 i Konventës.</i>			

## 1. HYRJE

Ky botim paraqet një përmbledhje të standardeve të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) për personat me aftësi të kufizuara. Botimi vjen si material referues për profesionistët e fushës së drejtësisë e të shërbimeve sociale dhe shërben si burim mbështetës e shpjegues, përmes rasteve nga praktika, për të qartësuar përmbajtjen e detyrimeve që Shqipëria ka ndërmarrë për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Këto detyrime rrjedhin nga Kushtetuta e Shqipërisë, nga e drejta ndërkombëtare dhe, ndër të tjera, nga Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDDAK)<sup>1</sup> dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si edhe nga legjislacioni i brendshëm.

Ndër traktatet për të drejtat e njeriut, KEDNJ-ja gëzon një vend të veçantë në sistemin ligjor<sup>2</sup> shqiptar dhe, për rrjedhojë, standardet e vendosura dhe interpretimet e bëra nga GJEDNJ-ja kanë mjaft rëndësi për të gjithë aktorët e sistemit të mbrojtjes të së drejtave të personave me aftësi të kufizuara sipas fushës së tyre të kompetencave. Vendimet e GJEDNJ-së janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe atyre u referohen vazhdimisht Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe gjykatat e shkallëve të tjera të sistemit gjyqësor shqiptar. Për shkak të nenit 17/2 të Kushtetutës, **jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut krijon një standard minimal ose një bazë krahasuese për standardet ligjore** të cilat Shqipëria duhet t'i garantojë në ligj dhe në praktikë në fushën e të drejtave dhe lirive themelore për të gjithë individët nën juridiksionin e saj.

KDDAK-ja është një instrument ndërkombëtar universal dhe *lex specialis*<sup>3</sup> për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ajo synon që ata të mos konsiderohen thjesht si objekte të trajtimeve mjekësore dhe përkujdesjes sociale, por si mbajtës të drejtash dhe lirish themelore<sup>4</sup>. Vihet re se, që prej hyrjes në fuqi të KDDAK-së, në maj të vitit

2008, GJEDNJ-ja i referohet, në disa raste (shih më poshtë) drejtpërsëdrejti, normave të saj në çështje që përfshijnë persona me aftësi të kufizuara, duke qartësuar kështu se standardet e saj në këtë fushë do të zhvillohen paralelisht dhe do të mbajnë parasysht tendencat më të fundit për mbrojtjen e të drejtave të këtyre njerëzve. Në të njëjtën frymë, sugjerohet që edhe profesionistët e fushës së personave me aftësi të kufizuara, të përditësohen dhe mbajnë parasysht normat e KDDAK-së dhe interpretimet e këtyre normave nga Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>5</sup>.

Deri më sot, GJEDNJ-ja ka vendosur në lidhje me disa çështje që kanë të bëjnë me Shqipërinë (*çështjet Dybeku, Gromi dhe Dauti*),<sup>6</sup> për persona me aftësi të kufizuara, kryesisht në kuadër të ndalimit të trajtimit çnjerëzor e poshtëruar të personave me aftësi të kufizuara, që vuajnë një dënim penal; dhe në kuadër të procesit të rregullt ligjor<sup>7</sup>, por jo në fusha të tjera. Pavarësisht këtij fakti, ka të ngjarë që Gjykata të zbatojë standardet e saj të zhvilluara deri më sot në mënyrë të njëjtë për çështje të ngjashme. Për këtë arsye, mbështetja dhe fuqizimi i ekspertizës profesionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, veçanërisht duke mbajtur parasysht se zhvillimet e jurisprudencës janë mjaft dinamike, është një domosdoshmëri për përmbushjen e detyrimeve përkatëse ndërkombëtare<sup>8</sup>. Në përgjithësi, profesionistët e drejtësisë, përfshi gjyqtarët, juristët, avokatët, si edhe punonjësit socialë, nuk marrin njohuri specifike e të thelluara për përmbajtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si pjesë e kurrikulumit të tyre universitar. Ndërsa njohuria për standardet e GJEDNJ-së në këtë fushë jepet kryesisht në mënyrë sporadike dhe në vartësi të ndërhyrjeve specifike, siç është rasti i disa programeve të trajnimit vazhduar që jepen në Shkollën e Magjistraturës.

1 Konventa u ratifikua nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 108, datë 15.11.2012.

2 Nenet 5, 17 dhe 122 t/ Kushtetutës së Shqipërisë.

3 Interpretim ligjor.

4 Për më shumë informacion për KDDAK, shih <http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=17>

5 Komiteti përbëhet nga ekspertë të pavarur dhe ka për detyrë të mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve të KDDAK-ut nga Shtetet Palë dhe njëkohësisht të bëjë interpretimin e dispozitave të saj përmes Komenteve të Përgjithshme. Për më tepër shih <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/CRPDIndex.aspx>

6 Përmbledhje e çështjeve të GJEDNJ-së për Shqipërinë, botim i QPZ-së, 2010. Gjetet tek <http://www.qbz.gov.al/botime/permbledhese/Permbledhje%20e%20vendimeve%20te%20Gjykatës%20Europiane%20per%20te%20Drejtat%20e%20Njeriut.pdf>

7 Shih më poshtë, çështjet Gromi, Dybeku dhe Dauti.

8 Shih nenin 13 të KDDAK-ut.

## 2. METODOLOGJIA

Ky botim përfshin pjesën më të madhe të çështjeve<sup>9</sup> të GJEDNJ-së për personat me aftësi të kufizuara, për të cilat ajo ka marrë vendim që nga viti 1985 deri në qershor 2015. Rastet paraqiten të grupuara sipas të drejtave kryesore të pretenduara se janë shkelur dhe brenda secilit seksion, rastet pasqyrohen në mënyrë kronologjike, duke renditur në krye rastet më të reja. Pavarësisht kësaj strukture, duhet theksuar se në pjesën më të madhe të çështjeve, Gjykata vlerëson pretendimet e kërkuarve bazuar në disa nene të Konventës. Ndaj fakti se një çështje mund të jetë përfshirë në seksionin e “Lirisë dhe sigurisë” sipas nenit 5 të Konventës, nuk e pengon atë të përmbajë edhe vlerësimin e shkeljeve në bazë të nenit 8 (e drejta për jetë private e familjare), apo të nenit 6 (e drejta për proces të rregullt gjyqësor), etj.

Për përgatitjen e kësaj përmbledhjeje standardesh, është kryer një kërkim i detajuar, i cili është përqendruar në të gjitha indekset e buletineve të GJEDNJ-së (*case law information notes*). Për të garantuar që asnjë çështje të mos mbetet pa u trajtuar, janë bërë verifikime edhe me referencat që Gjykata jep në vendimet e saj. Më tej, janë studiuar dhe analizuar përmbledhjet ligjore (*Legal Summaries*) për secilën çështje të përzgjedhur në HUDOC (data baza e çështjeve të GJEDNJ-së), me qëllim për të nxjerrë faktet dhe problemet kryesore ligjore. Së fundmi, jemi këshilluar me raportet e Gjykatës për personat me aftësi të kufizuara, të cilat ndihmuan në hartimin e një liste tërësore e gjithëpërfshirëse. Pas kësaj pune përgatitore, çdo vendim gjyqësor është analizuar dhe më pas janë identifikuar par. përkatës, të cilët vendosin standarde e parime. Në fund, është pasqyruar zbatimi i këtyre standardeve në rrethanat e një çështjeje konkrete, objekt gjykimi.

### Ekstraktet e vendimeve pasqyrohen sipas kësaj strukture:

- ▶ Palët/data e vendimit/Nr. i kërkesës;
- ▶ Fjalë kyçe e objektit të mosmarrëveshjes;
- ▶ Faktet kryesore;
- ▶ Vlerësimi i Gjykatës.

“Vlerësimi i Gjykatës” është pjesa më e rëndësishme e punimit, e cila përfshin par. e përzgjedhur, duke treguar numrin e saktë të paragrafëve të vendimit origjinal të Gjykatës, për të lehtësuar përdorimin e tij nga lexuesi si material referues.

Në vijim, paraqiten disa nga elementët më të rëndësishëm të standardeve, të grupuar sipas të drejtave të pretenduara nga kërkuarët.

<sup>9</sup> Në këtë botim nuk përfshihen 11 çështje të cilat ishin botuar më parë. Shih *Raste të GJEDNJ-së në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara*, botuar nga FSHDPAK- Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Helsinki Suedez për të Drejtat e Njeriut [Swedish Helsinki for Human Rights].

## 3. STANDARDET E GJEDNJ-SË PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, që trajtohen në këtë përmbledhje, përfshijnë ndër të tjera të drejtën për jetën, ndalimin e torturës e trajtimit çnjerëzor e poshtëruar; të drejtën për sigurinë personale dhe lirinë; të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor dhe përdorimin e gjykatës, të drejtën për jetë private e familjare; ndalimin e diskriminimit; të drejtën e votës; të

drejtën e pronës, etj.

Siç u përmend më lart, KEDNJ-ja nuk parashikon mbrojtje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara. Këto standarde janë zhvilluar nga Gjykata, në bazë të kërkesave të paraqitura për shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura nga Konventa.

### 3.1 E DREJTA E JETËS

Një nga çështjet më interesante, ku GJEDNJ-ja hedh dritë mbi përgjegjësinë shtetërore për mbrojtjen e jetës së personave me aftësi të kufizuara, të vendosur nën përkujdesjen shtetërore është *Nencheva dhe të Tjerët k. Bullgarisë*.<sup>10</sup> Pesëmbëdhjetë fëmijë dhe të rinj nën moshën 22 vjeçare humbën jetën gjatë dimrit të viteve 1996/97 në një shtëpi përkujdesje shtetërore për fëmijë me probleme të rënda të shëndetit mendor<sup>11</sup> në Dzhurkovo të Bullgarisë.

Gjykata e konsideroi këtë çështje si të jashtëzakonshme dhe tragjike dhe nuk pranoi se rruga e vetme në dispozicion të kërkuarve – procesi civil – ishte e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve shtetërore, në bazë të nenit 2 të Konventës, për respektimin e të drejtës së jetës. Gjykata vlerësoi se shteti nuk kish arritur të përmbushte detyrimin e tij për mbrojtjen e jetës së fëmijëve të cenueshëm, nën përgjegjësinë e tij dhe se nuk kishte përmbushur detyrimin e tij për të hedhur dritë mbi faktet, përmes një mekanizmi të përshtatshëm procedural.

Standardet themelore të Gjykatës për të drejtën e jetës sipas nenit 2 (përfshi jetën e personave me aftësi të kufizuara) janë:

- ◆ Neni 2 u vendos Shteteve detyrimin që jo vetëm të abstenojnë nga shkaktimi i vdekjes me «qëllim», por edhe të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së personave

nën juridiksionin e tyre<sup>12</sup>.

- ◆ Detyrimi i Shtetit për të mbrojtur jetën përfshin edhe detyrimin për të garantuar shërbimin e ndihmës së shpejtë, kur autoritetet informohen se jeta apo shëndeti i një personi është në rrezik për shkak të një aksidenti<sup>13</sup>. Detyrimi për mbrojtjen e jetës duhet të interpretohet si i vlefshëm në kontekstin e të gjitha veprimtarive, publike ose private që kanë të ngjarë të venë në rrezik të drejtën e jetës. Ai zbatohet edhe ndaj autoriteteve, në fushën e mësimdhënies shkollore, të cilët marrin përsipër detyrimin për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve, më saktë, të fëmijëve të vegjël, të cilët janë veçanërisht të brishtë dhe nën kontrollin ekskluziv të autoriteteve<sup>14</sup>.
- ◆ Shteti ka detyrimin pozitiv për marrjen e masave parandaluese praktike për të mbrojtur një individ ndaj një tjetri, ose në disa rrethana të veçanta, nga vetvetja. Duke qenë se ky është një detyrim pozitiv, duhet të provohet se autoritetet kanë pasur dijeni ose duhej të kishin pasur dijeni në momentin që individi ishte kërcënuar në mënyrë reale dhe të menjëhershme për jetën e tij dhe se, në kuadër të kompetencave të tyre, ata nuk kanë marrë masat, që nga një pikëpamje racionale, do ta

<sup>10</sup> *Nencheva dhe të Tjerët k. Bullgarisë*, 18.06.2013, Nr. 48609/06.

<sup>11</sup> Në këtë punim do të përdoren termat “persona me probleme ose çrregullime të shëndetit mendor”, ose “aftësi e kufizuar mendore”. Vetë GJEDNJ-ja nuk ka përdorur një terminologji të unifikuar. Ndërkohë, terminologjia e përdorur në versionin shqip të KPDPAK-ut është “aftësi e kufizuar mendore”. Ligji për shëndetin mendor, Nr. 44/2012, në nenin 3/2 “përkufizimet”, përdor termin çrregullime të shëndetit mendor.

<sup>12</sup> *McCann dhe të Tjerët*, par. 147, L.C.B. k. *Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, par. 36, *Përmbledhjet 1998III, Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 48, GJEDNJ, 2002I, Vo k. *Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 53924/00, par. 88, GJEDNJ, 2004VIII, dhe *Dodov k. Bullgarisë*, nr. 59548/00, par. 79, 17 janar 2008.

<sup>13</sup> *Furdik k. Sllovakisë*, nr. 42994/05, 2 dhjetor 2008.

<sup>14</sup> *Ilbeyi Kemaloğlu dhe Meriye Kemaloğlu k. Turqisë*, nr. 19986/06, par. 35, 10 prill 2012.

kishin shmangur pa dyshim këtë rrezik<sup>15</sup>.

- ◆ Në rastin e humbjes së jetëve njerëzore në rrethana në të cilat autoritetet shtetërore mbajnë përgjegjësi, shteti ka detyrimin që të garantojë, përmes të gjitha mjeteve që ka në dispozicion, gjyqësore e të tjera, duke bërë të mundur që kuadri legjislativ e administrativ i hartuar për të mbrojtur të drejtën e jetës, të zbatohet siç duhet dhe duke garantuar dhënien fund dhe ndëshkimin e të gjitha shkeljeve të kësaj të drejte<sup>16</sup>.
- ◆ Një sistem gjyqësor efikas, si ai që kërkon neni 2, mund të përfshijë dhe, në disa rrethana, duhet të përfshijë, një mekanizëm penal.
- ◆ Nëse cenimi i të drejtës së jetës ose të integritetit fizik nuk është i qëllimshëm, detyrimi pozitiv për vendosjen e një sistemi gjyqësor efikas, sipas nenit 2, nuk kërkon domosdoshmërisht në të gjithë rastet një mjet të natyrës penale. Në kontekstin specifik të neglizhencës mjekësore « një detyrim i tillë mund të përmbushet edhe kur sistemi gjyqësor u ofron të interesuarve një mjet para gjykatave civile, më vete, ose bashkërisht me një mjet përpara gjykatave penale, me synimin që të përcaktohet përgjegjësia e mjekëve për çështjen dhe, nëse është rasti, të sigurohet zbatimi i të gjitha sanksioneve civile të përshtatshme, si dëmshpërblimi dhe botimi i vendimit. Mund të parashikohen edhe masa disiplinore.<sup>17</sup>
- ◆ Në fushën e shëndetit publik, Shteti duhet të vendosë një kuadër rregullues për spitalet, qoftë publike apo private, që të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e jetës së të sëmurëve.
- ◆ Shtetet duhet të vendosin njëkohësisht një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur, i cili të jetë në gjendje të përcaktojë shkaqet e vdekjes së një individi, që ndodhet nën përgjegjësinë e personelit mjekësor.
- ◆ Neni 2 përmban detyrimin e kryerjes së një hetimi zyrtar nga autoritetet në lëmin e veprimtarive të rrezikshme, nëse vdekja ka ndodhur pas ngjarjeve që kanë qenë nën përgjegjësinë e pushtetit publik<sup>18</sup>.

Shtetet nuk duhet, në asnjë rast, të lënë pa dënuar sulmet e pajustificuara ndaj të drejtës së jetës për të gjithë individët nën juridiksionin e tyre, përfshi personat me aftësi të kufizuara. Kjo është e

15 Nancheva, par. 108.

16 Nancheva, par. 109.

17 Nancheva, 110; Calvelli dhe Ciglio, par. 51.

18 Nancheva par. 112.

nevojshme për të ruajtur besimin e publikut, për të siguruar respektimin e shtetit të së drejtës, si dhe për të parandaluar shfaqjen e tolerancës ndaj akteve të paligjshme apo bashkëpunimin në kryerjen e tyre.

### 3.1.1 Eutanazia dhe administrimi apo ndërprerja e trajtimit të mbajtjes në jetë artificialisht

E drejta e jetës dhe e drejta për jetë private janë vlerësuar shpesh nga Gjykata në rastin e personave me aftësi të kufizuara, të cilët ose kishin kërkuar të drejtën e tyre për të vdekur, për t'u dhënë fund vuajtjeve të mëdha, ose mjekët kishin vendosur t'u jepnin fund trajtimeve artificiale të mbajtjes së tyre në jetë, për shkak se nuk kishte më asnjë shpresë që ata të mund të jetonin. Në fakt, eutanazia dhe ndërprerja e trajtimit artificial janë konsideruar nga Gjykata si çështje jashtëzakonisht të vështira e komplekse nga pikëpamja shkencore dhe etike.

Vendimi i Dhomës së Madhe i qershorit të vitit 2015, në çështjen *Lambert*, jo vetëm që përmbledh jurisprudencën e mëparshme dhe nuancat e saj, por edhe qartëson përfundimisht hapësirën e vlerësimit të shteteve për këto çështje dhe rolin që mund të luajë Gjykata në ushtrim të funksioneve të saj si rojtare e të drejtave të mbrojtura nga Konventa.

Gjykata shprehet se thelbi i Konventës është respektimi i dinjitetit dhe lirisë së njeriut. Pa mohuar në asnjë mënyrë parimin e shenjtëritetit të jetës, të mbrojtur nga Konventa, Gjykata vlerëson se edhe nocioni i cilësisë së jetës, merr kuptim në kuadër të nenit 8. Në epokën e rritjes së perfeksionimit të mjekësisë, kombinuar me rritjen e moshës së vdekshmërisë, shumë njerëz kanë filluar të shqetësohen se mund të jenë të detyruar të lëngojnë në një moshë të shtyrë, ose mund të jenë në gjendje të rënduar fizike dhe mendore, e cila bie në kundërshtim me idetë e konsoliduara të identitetit personal<sup>19</sup>.

Kur vlerëson nëse Shteti ka vepruar në përputhje me detyrimet pozitive që rrjedhin nga neni 2, në lidhje me administrimin ose ndërprerjen e trajtimit mjekësor, Gjykata merr parasysh faktorët e mëposhtëm<sup>20</sup>:

- ekzistencën në legjislationin dhe praktikën e brendshme të një kuadri rregullator në përputhje me kërkesat e nenit 2;
- nëse janë marrë parasysh dëshirat e shprehura më parë të kërkuarit dhe të personave të afërm

19 Shih *Lambert*, par. 142; dhe *Pretty*, par. 65.

20 Shih *Lambert*, par. 143.

të tij, si edhe mendimet e personelit tjetër mjekësor;

- mundësie për t'iu drejtuar gjykatave në rast dyshimesh për sa i përket interesit më të lartë të pacientit;
- kriteret e parashtruara në "Udhërrëfyesin e procesit vendimmarrës për trajtimin mjekësor në rastet e përfundimit të jetës" të Këshillit të Evropës.

Nuk ka konsensus ndërmjet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës për sa i përket lejimit të ndërprerjes së trajtimit të mbajtjes në jetë në mënyrë artificiale, edhe pse shumica e Shteteve duket se e lejojnë një gjë të tillë. Ndonëse mënyrat që rregullojnë ndërprerjen e trajtimit ndryshojnë

## 3.2 E DREJTA PËR TË MOS IU NËNSHTRUAR TORTURËS, TRAJTIMIT ÇNJERËZOR E POSHTËRUES

### 3.2.1 Keqtrajtimet nga persona privatë

A mban përgjegjësi shteti, nëse një person me aftësi të kufizuara keqtrajtohet nga persona privatë, qofshin këta edhe fëmijë? Gjykata e ka trajtuar këtë pyetje në çështjen *Dordević k. Kroacisë* dhe është shprehur se, në kuadër të nenit 3, shteti duhet të mbajë përgjegjësi për keqtrajtimin e individëve nga subjektet jo shtetërore. Ky detyrim rrjedh nga neni 1 i Konventës, sipas të cilit Shtetet kanë për detyrë që t'i garantojnë çdo individi brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Kështu p.sh., neni 3, i lexuar së bashku me nenin 1, e detyron shtetin të marrë masa të posaçme për të garantuar, që individët brenda juridiksionit të tij, të mos i nënshtrohen torturës, ose trajtimit çnjerëzor, poshtëruar, apo ndëshkimit, duke përfshirë këtu edhe keqtrajtimet e kryera nga individë privatë<sup>22</sup>. Këto masa duhet të garantojnë mbrojtjen efektive, veçanërisht të fëmijëve dhe individëve të tjerë të cenueshëm, duke përfshirë ndërmarrjen e veprimeve të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimin, për të cilin autoritetet kanë pasur ose duhet të kishin pasur dijeni që po ndodhte<sup>23</sup>. Pra, është e dukshme se, që ky detyrim pozitiv të lindë, duhet që autoritetet të dine ose të kenë ditur në kohën kur ngjarja ndodh ekzistencën e një rreziku real të keqtrajtimet ose

22 Shih *mutatis mutandis*, H.L.R. k. Francës, 29 prill 1997, par. 40, *Raportet* 1997-III.

23 Shih *Dordević k. Kroacisë*, Nr. 41526/10, 24.7.2012; par. 138 dhe *mutatis mutandis*, *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, par. 116, *Raportet* 1998-VIII, dhe *E., dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33218/96, par. 88, 26 nëntor 2002).

nga një vend në tjetrin, megjithatë ka një konsensus për sa i takon rëndësisë parësore të dëshirave të pacientit në procesin vendimmarrës, pavarësisht sesi shprehen këto dëshira<sup>21</sup>. Prandaj, Gjykata ka çmuar se në fushën e dhënies fund të jetës, si edhe në atë të fillimit të jetës, Shtetet kanë një hapësirë vlerësimi, jo vetëm për sa i përket lejimit ose ndalimit të trajtimit të mbajtjes në jete artificialisht, por edhe për sa i takon mjeteve për të vendosur një balancë të drejtë ndërmjet mbrojtjes së të drejtës së jetës së pacientit dhe mbrojtjes së të drejtës së tij për respektimin e jetës private dhe autonomisë personale. Megjithatë, kjo hapësirë vlerësimi nuk është e pakufizuar dhe Gjykata i rezervon vetes rolin kontrollues, për të parë nëse Shteti ka vepruar ose jo në përputhje me detyrimet sipas nenit 2.

21 Shih *Lambert*, par. 147-148.

kryerjen e keqtrajtimet nga persona të tretë ndaj një individi të caktuar dhe të mos kenë marrë asnjë masë efektive, e cila në mënyrë të arsyeshme do ta kishte shmangur rrezikun në fjalë<sup>24</sup>. Nëse incidentet e dhunës zgjasin për një periudhë kohe dhe, nëse autoritetet nuk kanë marrë masa të mjaftueshme për të zgjidhur problemin dhe për të parandaluar përsëritjen e tij, ka të ngjarë që Gjykata të gjejë shkelje të nenit 3 të Konventës<sup>25</sup>.

### 3.2.2 Heqja e lirisë së personave me aftësi të kufizuara që vuajnë dënime penale

Ndalimi i torturës dhe i trajtimeve çnjerëzore e poshtëruese ndaj individëve është një nga vlerat themelore të një shoqërie demokratike. Në kuadrin e mbrojtjes që neni 3 i Konventës, siguron për personat me aftësi të kufizuara, të cilëve i kufizohet liria për shkak të ekzekutimit të një dënimi penal, merren në shqyrtim: a) kushtet e heqjes së lirisë; dhe b) sigurimi dhe ofrimi i kujdesit të përshtatshëm shëndetësor.

Standardet themelore të Gjykatës në këtë fushë janë:

- ◆ Ky nen vendos një detyrim pozitiv për shtetin,

24 Shih *Dordević k. Kroacisë*, Nr. 41526/10, 24.7.2012; par. 139.

25 E njëjta gjë thuhet edhe për detyrimet e autoriteteve shtetërore, në bazë të nenit 8, për mbrojtjen e jetës private dhe marrjen e masave parandaluese për t'i mbrojtur personat me aftësi të kufizuara nga ndërhyrjet e personave privatë në jetën e tyre personale.



i cili duhet të garantojë mbajtjen e personit në kushte të cilat respektojnë dinjitetin e tij njerëzor; përfshi edhe garantimin e ndihmës së duhur mjekësore.<sup>26</sup>

- ◆ Mungesa e kujdesit mjekësor të përshtatshëm dhe burgosja e një personi të sëmurë në kushte të papërshtatshme mundet që, në parim, të bjerë ndesh me nenin 3<sup>27</sup>. Kujdesi dhe shpeshësia e ofrimit të shërbimeve mjekësore një personi janë dy elemente që merren parasysh për matjen e përputhshmërisë së trajtimit të tij me kërkesat e nenit 3.
- ◆ Edhe pse nuk mund të arrihet në përfundim se ekziston një detyrim i përgjithshëm për të liruar një të burgosur apo për ta transferuar në një spital civil, edhe nëse ky vuan nga një sëmundje veçanërisht e vështirë, ka pasur raste kur Gjykata ka vendosur se nuk përjashtohet që në kushte veçanërisht të rënda, mund të ndodhemi në prani të situatave për trajtimin e të cilave, administrimi i mirë i drejtësisë penale, kërkon marrjen e masave humanitare. Prandaj, në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të burgosurit është absolutisht në mospërputhje me kushtet e vuajtjes së dënimit të tij me heqje lirie, respektimi i nenit 3 mund të kërkojë lirinë e personit sipas disa kushteve të përcaktuara.
- ◆ Gjykata kërkon që ambienti i burgut t'u përshtatet, nëse është e nevojshme, nevojave të veçanta të të burgosurit, në mënyrë që ai të vuajë dënimin në kushte që nuk venë në rrezik integritetin e tij moral<sup>28</sup>.
- ◆ Heqja e lirisë së një personi me aftësi të kufizuara në një vend ku ai nuk mund të lëvizë vetë, veçanërisht kur nuk mund të dalë jashtë qelisë për një kohë të gjatë, përbën një trajtim poshtëruar që ndalohet nga neni 3 i Konventës.
- ◆ Varësia nga ndihma e të burgosurve të tjerë për të shkuar në tualet, për t'u larë, veshur apo zhveshur, mund të konsiderohet poshtëruar<sup>29</sup>. Mungesa e provave që të vërtetojnë se autoritetet kanë vepruar me qëllim për ta poshtëruar kërkuesin, nuk e ndryshon këtë përfundim<sup>30</sup>.
- ◆ Në çështjen *Groni k. Shqipërisë*, GJEDNJ-

ja bëri disa konstatime të rëndësishme për pretendimin, sipas nenit 3, për kujdes mjekësor të papërshtatshëm. Kërkuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, sklerozë multiple, e cila mund të shkaktojë aftësi të kufizuara ose vdekje. Gjykata e konsideroi si alarmant faktin që vendimin nëse kërkuesi ka nevojë për kontrolle mjekësore shtesë, e merr prokurori dhe jo mjekët. Po ashtu, Gjykata nuk pranoi argumentin që trajtimi mjekësor për personat të cilëve u është hequr liria i kushton shumë buxhetit të shtetit. Mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, së bashku me refuzimin e autoriteteve për t'i dhënë kërkuesit barna mjekësore sipas recetës, shoqëruar me vuajtjet fizike të tij, përbëjnë trajtim poshtëruar sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës.

### 3.2.3 Dëbimi i të huajve me aftësi të kufizuara dhe neni 3

Në një sërë çështjesh<sup>31</sup> të gjykuara nga GJEDNJ-ja, kërkues të ndryshëm me aftësi të kufizuara, të cilët kanë qenë subjekt i një urdhër dëbimi nga territori i një shteti anëtar në vendin e tyre të origjinës, kanë paraqitur argumentin se kthimi i tyre do të përbente keqtrajtim sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Në një grup çështjesh,<sup>32</sup> Gjykata ka shqyrtuar pretendimet për kthim të personit për shkak të refuzimit të kërkesës për azil. Ndërsa në raste të tjera, është shqyrtuar ekstradimi dhe përputhshmëria e tij me nenin 3<sup>33</sup>.

**Në rastin e kthimeve për shkak të refuzimit të kërkesës për azil**, Gjykata i është referuar të drejtës ndërkombëtare të konsoliduar dhe të zbatueshme, duke përfshirë këtu edhe Konventën, sipas së cilës Shtetet Palë kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve në territorin e tyre. Megjithatë, dëbimi i të huajve nga territori i një shteti palë mund të ngrejë çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës dhe të përfshijë përgjegjësinë e shtetit në kuadër të Konventës, kur ekzistojnë rrethana të mjaftueshme që tregojnë se personi në fjalë mund të ndihet i rrezikuar dhe të trajtohet në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, në rast kthimi në vendin e tij të origjinës. Në këto rrethana, neni 3 nënkupton detyrimin e shteteve për të mos e dëbuar personin në fjalë<sup>34</sup>.

Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se, në kuadër të nenit 3, ekstradimi, dëbimi ose largimi i individëve në shtete të treta ndalon në mënyrë absolute torturën, ose trajtimin çnjerëzor ose poshtëruar dhe se garancitë e këtij neni zbatohen pavarësisht nga natyra e dënueshme e sjelljes së personit në fjalë<sup>35</sup>. Në kuadër të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, të huajt që kthehen apo dëbohen, në parim, nuk mund të pretendojnë të qëndrojnë në territorin e një Shteti Palë për të vazhduar një trajtim mjekësor, të garantuar nga shteti që ka urdhëruar kthimin ose dëbimin. Megjithatë, në raste përjashtimore, vendimi për të dëbuar një kërkues, në kuadër të parimeve humanitare, mund të sjellë shkelje të nenit 3 të Konventës<sup>36</sup>. Gjykata nuk mbështet pretendime sipas nenit 3, të cilat

35 *Ahmed k. Austrisë*, 17 dhjetor 1996, *Raportet e Vendimeve dhe Gjykimeve* 1996-VI, f. 2206, par. 38, dhe *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, *Raportet* 1996-V, f. 1853, par. 73-74

36 *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 maj 1997, *Raportet* 1997-II, par. 54

## 3.3 HEQJA E LIRISË PËR SHKAK TË ÇRREGULLIMEVE TË SHËNDETIT MENDOR

Personave me aftësi të kufizuara mund t'u hiqet liria përmes vendosjes në spitale psikiatrike, apo në qendra të përkujdesjes shoqërore. Në këto raste, Gjykata vlerëson dy aspekte themelore: 1) nëse vendosja në një institucion përkujdesjeje ose spital psikiatrik është heqje lirie sipas kuptimit të nenit 5, par. 1; dhe b) nëse kjo heqje lirie është në përputhje me kërkesat e nenit 5 të Konventës.

Fjalja e parë e nenit 5, par. 1 parashikon se çdokush ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë personale dhe kjo fjali duhet të interpretohet se krijon një detyrim pozitiv për shtetin për të mbrojtur lirinë e të gjithë individëve brenda juridiksionit të tij. Pra, shteti është i detyruar të marrë masa, për të siguruar një mbrojtje efektive për personat e cenueshëm, për të parandaluar cenimin e lirisë nga autoritetet që kanë, ose duhet të kishin, dijeni për brishtësinë e këtyre individëve<sup>39</sup>. Një nga çështjet më të rëndësishme që konsiderohet se ka hedhur themelet për interpretimin e nenit 5 (1) (e) të Konventës dhe të shprehjes "persona me probleme të shëndetit mendor" është *Winterwerp k. Holandës* (1979). Gjithashtu, kjo është një nga çështjet e para që trajton rëndësinë e zbatimit të nenit 6 në rastin e kufizimit të lirisë për personat me probleme të shëndetit mendor.

39 *Stanev k. Bullgarisë* (Dhoma e Madhe), 17.01.2012, Nr. 48977/09, par. 119-120

bazohen në argumentin se një person me aftësi të kufizuara, nëse kthehet në vendin e origjinës, do të marrë trajtime më pak të përshtatshme aty, se sa në vendin nga ku do të kthehet<sup>37</sup>.

**Në rastet e ekstradimeve**, Gjykata ka zbatuar dhe i referohet të njëjtit test vlerësimi për kushtet e heqjes së lirisë në shtetin pritës, si në rastin e personave që vuajnë dënimin me heqje lirie në burg apo paraburgim. Sipas saj, ka tre elemente të veçantë që duhet të merren në konsideratë në lidhje me përputhshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit prej kërkuesit: (a) gjendja shëndetësore e tij, (b) përshtatshmëria e ndihmës dhe kujdesit shëndetësor, dhe (c) përshtatshmëria e mbajtjes së kërkuesit në burg, në raport me gjendjen e tij shëndetësore<sup>38</sup>.

37 *Hukic k. Suedisë*, par. 2

38 *Aswat* par.50; *Slawomir Musial k. Polonisë*, nr. 28300/06, par. 87, 20 janar; *Dybeku k. Shqipërisë*, nr. 41153/06, par. 41, 18 dhjetor 2007.

**Në cilat rrethana konsiderohet se një personi me aftësi të kufizuara, të vendosur në një institucion të përkujdesjes sociale ose spital psikiatrik, i është hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës?**

Për të vlerësuar nëse dikujt i është "hequr liria" sipas kuptimit të nenit 5 të Konventës, Gjykata merr parasysh disa kritere që përfshijnë natyrën, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zbatimit të masës së vendosur<sup>40</sup>. Nacioni i heqjes së lirisë sipas nenit 5, par. 1, nuk përfshin vetëm elementin objektiv të mbylljes së një personi në një hapësirë të kufizuar për një periudhë kohore, e cila mund të jetë e papërfillshme. Vlerësohet se një personi i hiqet liria, nëse nuk ekziston elementi subjektiv, që do të thotë se ai nuk ka pranuar në një mënyrë të vlefshme heqjen e lirisë së tij<sup>41</sup>.

Në kontekstin e heqjes së lirisë për arsye të problemeve të shëndetit mendor, Gjykata ka konstatuar heqje të lirisë në rrethanat e mëposhtme:

- a. kur kërkuesi, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe që është pranuar në një spital psikiatrik me kërkesë të përfaqësuesit të tij ligjor, është përpjekur, por pa sukses, që të largohet nga spitali<sup>42</sup>;

40 *Stanev*, par. 115; *Mihailovs k. Letonisë*, nr. 35939/10, 22.01. 2013, par. 128

41 *Mihailovs k. Letonisë*, par. 128; *Storck k. Gjermanisë*, nr. 61603/00, par. 74

42 *Shtukurov*, par. 108

- b. kur kërkuesi, fillimisht e ka dhënë pëlqimin për shkrimin në një klinikë, por më pas është përpjekur të largohet prej saj<sup>43</sup>;
- c. kur kërkuesi është një person madhor, i cili e ka të pamundur të japë pëlqimin e vet për pranimin në një institucion psikiatrik, prej të cilit ai nuk është përpjekur asnjëherë të largohet<sup>44</sup>; dhe
- d. kur kërkuesi, një person me probleme të shëndetit mendor, është vendosur në një qendër të përkujdesjes sociale, ku ai mbikëqyret në mënyrë të vazhdueshme dhe prej së cilës ai nuk mund të largohet pa leje sa herë që dëshiron<sup>45</sup>.

Për sa i përket faktit nëse një institucion apo qendër është një **institucion i hapur ose i mbyllur**, Gjykata ka theksuar se kjo rrethanë nuk është përcaktuese për çështjen. Një personi konsiderohet se i është hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, edhe gjatë një periudhe kur ai ose ajo vendoset në një seksion (institucion) të hapur, me hyrje dalje të rregullta, të pashoqëruara në ambientet e spitalit dhe ka mundësi të largohet i pashoqëruar nga spitali<sup>46</sup>. Faktori kyç, që përcakton zbatimin e nenit 5 në një çështje konkrete, është nëse autoritetet drejtuese të qendrës **ushtrojnë kontroll tërësor dhe efektiv** për trajtimin, kujdesin, qëndrimin dhe lëvizjen e një personi me aftësi të kufizuara<sup>47</sup>.

Standardet e mësipërme janë krijuar nga interpretimi i nenit 5(1)(e) të KEDNJ-së, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të ligjshëm të lirisë së personave me probleme të shëndetit mendor.

### 3.3.1 Garanci procedurale për kufizimin e lirisë

Gjykata ka vërejtur se ekzistojnë *disa situata* në të cilat dëshirat e një individi me probleme të shëndetit mendor mund të zëvendësohen në mënyrë të ligjshme, me dëshirat e një individi tjetër, i cili vepron në emër të tij, apo i ofron atij mbrojtje. Ndonjëherë, është e vështirë të konstatohet se cila mund të jetë dëshira e individit në fjalë. Por, fakti që një individ nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, nuk nënkupton detyrimisht se ai është i paaftë për të kuptuar situatën në të cilën ndodhet<sup>48</sup>.

Fakti që kujdestari ligjor i një personi kërkon

43 Storck, cituar më lart, par. 76

44 H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 45508/99, par. 89-94, GJEDNJ, 2004IX

45 Stanev, par. 124-130

46 shih H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar, par. 92

47 D.D. k. Lituanië, nr. 13469/06, par. 146, 14 shkurt 2012; dhe Kedzior v. Polonisë, nr. 45026/07, par. 57, 16 tetor 2012.

48 Shih Shtaturuv, par.108).

vendosjen e tij në një institucion, ndonëse në vetvete përbën një bazë ligjore për këtë veprim, nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur nocionin e ligjshmërisë sipas nenit 5, par. 1, të Konventës<sup>49</sup>. Gjykata ka vlerësuar se nocioni i "ligjshmërisë" në kontekstin e nenit 5, par. 1, ka një kuptim më të gjerë. Kuptimi i termit "procedurë e parashikuar me ligj" është ai i një procesi të rregullt, që do të thotë se çdo masë, e cila i heq lirinë një personi, duhet të merret dhe ekzekutohet nga autoritetet kompetente dhe nuk duhet të jetë arbitrare. Me fjalë të tjera, heqja e lirisë nuk mund të konsiderohet "e ligjshme" sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, nëse procedura e brendshme nuk përmban garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit<sup>50</sup>.

Në vendimin *Winterwerp*<sup>51</sup>, Gjykata parashtroi tre standarde minimale, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të plotësohet kushti i "heqjes së ligjshme të lirisë së personave me probleme të shëndetit mendor", sipas kuptimit të nenit 5, par. 1 (e):

- me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, duhet të provohet në mënyrë të besueshme se një individ ka probleme të shëndetit mendor. Kjo do të thotë se ekzistenca e një çrregullimi të vërtetë mendor, duhet të përcaktohet nga një autoritet kompetent, në bazë të një mendimi mjekësor objektiv;
- çrregullimi mendor duhet të jetë i një shkalle dhe natyre që të bëjnë të detyrueshme kufizimin e detyrueshëm të lirisë; dhe që
- vlefshmëria e heqjes së lirisë të varet nga vijimësia e çrregullimit, i cili duhet të vlerësohet në mënyrë të herëpashershme e të rregullt.

Detyra e Gjykatës është që të kontrollojë sipas Konventës vendimet e autoriteteve shtetërore<sup>52</sup>. Ajo nuk rivlerëson mendimet e ndryshme/ekspertizat mjekësore, të cilat kryesisht hyjnë në fushën e kompetencës së Gjykatave të brendshme; por ajo vlerëson **nëse gjykatat e brendshme, kur marrin vendime, objekt gjykimi, kanë në dispozicion të tyre prova të mjaftueshme për të justifikuar heqjen e lirisë**<sup>53</sup>.

Gjykata ka vërejtur se, në disa rrethana, mirëqenia e një personi me probleme të shëndetit mendor mund të jetë një faktor tjetër që merret parasysh, së bashku me provat mjekësore, për të vlerësuar nëse është e nevojshme që një person të vendoset

49 Mihailovs k. Letonisë, par. 142.

50 Mihailovs k. Letoisë, par. 143.

51 Winterwerp, par. 39; Mihailovs k. Letonisë, par. 144

52 Stanev, par. 155

53 Mihailovs k. Latvia par. 144; Shih Herz k. Gjermanisë, nr. 44672/98, par. 51, 12 qershor 2003, Plesó k. Hungarisë, nr. 41242/08, par. 61, 2 tetor 2012

në një institucion. Gjykata konsideron se çdo masë mbrojtëse duhet të pasqyrojë, sa më shumë të jetë e mundur, dëshirat e individëve që janë të aftë të shprehin vullnetin e tyre. Mosmarrja e këtij mendimi mund të shpjerë në situata abuzimi dhe të pengojë ushtrimin e të drejtave nga personat e cenueshëm. Prandaj, çdo masë e marrë pa u këshilluar paraprakisht me personin e interesuar, si rregull, kërkon një vlerësim të kujdesshëm<sup>54</sup>.

Ndër parimet/standardet që kanë dalë në pah nga jurisprudenca e Gjykatës<sup>55</sup> në kuadër të nenit 5, par. 4, për personat që kanë "probleme të shëndetit mendor" janë:

- në rastet kur nuk bëhet një kontroll gjyqësor automatik e periodik i heqjes së lirisë, individi, të cilit i është hequr liria për një periudhë të pa përcaktuar apo të gjatë, është, në parim, i legjitimuar për të kërkuar ligjshmërinë e ndalimit të tij duke nisur procedura në intervale kohe "të arsyeshme" përpara një gjykate të brendshme;
- neni 5 par. 4, kërkon që procedura e ndjekur të ketë karakter gjyqësor dhe t'i sigurojë individit garanci të përshtatshme me llojin e kufizimit të lirisë në fjalë. Në mënyrë që të përcaktohet nëse procesi ka siguruar garanci të përshtatshme, duhet të mbahen në vëmendje edhe rrethanat e veçanta të rastit që shqyrtohet;
- procesi gjyqësor, sipas nenit 5 par. 4, nuk duhet të përmbajë gjithmonë të njëjtat garanci që kërkohen në kuadër të nenit 6 par. 1,<sup>56</sup> të Konventës për mosmarrëveshjet civile ose penale. *Megjithatë, është thelbësore që subjekti i interesuar të ketë mundësi t'i drejtohet gjykatës dhe të dëgjohet personalisht, ose përmes një përfaqësuesi.*

Tre parimet më lart janë të zbatueshme si në rastet kur heqja fillestare e lirisë ishte autorizuar nga një gjykatë<sup>57</sup>, ashtu edhe kur vendosja e një personi në një qendër sociale është iniciuar nga një individ privat, konkretisht nga kujdestari ligjor i tij dhe vendimi merret nga autoritetet administrative, qofshin ato bashkiake, apo të institucionit të përkujdesjes sociale, pa përfshirjen e gjykatave.<sup>58</sup>

54 Stanev, par. 153; Mihailovs k. Letonisë, par. 145

55 Stanev, par. 171.

56 E drejta për një proces të rregullt.

57 Shih X k. Mbretërisë së Bashkuar, 5 nëntor 1981, par. 52

58 Mihailovs k. Letonisë, par. 155; D.D. k. Lituanië, par. 164, dhe Kedzior, par. 76

**Garanci të tjera** që lidhen me heqjen e lirisë për personat me probleme të shëndetit mendor janë:

- e drejta e tyre për t'u dëgjuar, për të shprehur mendim, ose për të konfirmuar shprehimisht vendosjen e tyre në një qendër sociale;<sup>59</sup>
- e drejta për t'u njoftuar për arsyet ose kohëzgjatjen e kësaj mase, e cila mund të jetë marrë nga kujdestari ligjor;
- shtetet duhet të sigurojnë një mjet ankimi, i cili t'i japë mundësi të drejtpërdrejt personit të kundërshtojë ligjshmërinë e pranimin të tij në një qendër sociale, si dhe kontrollin e zbatimit të kësaj mase në mënyrë të vazhdueshme<sup>60</sup>. Një individi, të aftë për të shprehur një pikëpamje të vetën, pavarësisht se i është kufizuar zotësia për të vepruar dhe i është cenuar liria, si pasojë e kërkesës së kujdestarit ligjor, i duhet dhënë mundësia për ta kundërshtuar këtë vendim përpara një gjykate, duke u përfaqësuar nga një person i tretë<sup>61</sup>. Veçanërisht në rastet që kanë të bëjnë me persona me aftësi të kufizuara mendore, autoritetet shtetërore kanë detyrimin të sigurojnë që këta persona të mbështeten nga një përfaqësues i pavarur, duke bërë të mundur që ankesat e tyre të trajtohen në mënyrë të duhur.<sup>62</sup>
- nëse kufizimi i lirisë ka qenë i paligjshëm, personi duhet të ketë një mjet për kërkimin e dëmshpërblimit, në kompensim të shkëlqes të drejtave të tij.<sup>63</sup>

Autoritetet shtetërore duhet të marrin "masa të arsyeshme" – një nocion kyç mjaft i ngjashëm me "përshtatjen e arsyeshme", të përmendur në nenin 2, 13 dhe 14 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Këto masa përfshijnë veçanërisht sigurimin e ndihmës juridike nga një avokat, ose një person tjetër i përshtatshëm. Kur nuk është i mundur asnjë lloj komunikimi domethënës me një person me aftësi të kufizuara, kërkimi i ndihmës nga prindi, kujdestari, apo avokati është i domosdoshëm dhe personi nuk duhet në asnjë rast të detyrohet të nënshkruajë procesverbalin e marrjes në pyetje.<sup>64</sup>

59 Stanev, par. 130.

60 Stanev, par. 172.

61 D.D. k. Lituanië, nr. 13469/06, 14.2.2012, par. 166.

62 Ivinovic k. Kroacisë, nr. 13006/13, 18.09.2014, par. 45; Qendra e Burimeve Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë [DHOMA E MADHE], nr. 47848/08, par. 161, 17 korrik 2014.

63 Stanev, par. 182.

64 Z.H. k. Hungarisë, Nr. 28973/11, 8.11.2012, par. 42-43.

### 3.4 JETA PRIVATE DHE FAMILJARE: HEQJA E TË DREJTAVE PRINDËRORE

Në shumë çështje që lidhen me të drejtën për jetë private dhe familjare të personave me aftësi të kufizuara, problemi themelor juridik ka qenë heqja e të drejtave të tyre prindërore. Nuk ka dyshim se revokimi i të drejtës së prindërimit të një prindi dhe vendosja e fëmijës për birësim janë që të dyja masa shumë ekstreme. Madje, masa e fundit sjell shkatërrimin e plotë të marrëdhënies mes prindit dhe fëmijës<sup>65</sup>.

Hapësira e vlerësimit të nevojës për ndërhyrjen e autoriteteve kombëtare varet nga natyra e çështjes dhe serioziteti i interesit të rrezikuar, të tilla si rëndësia e mbrojtjes së një fëmije që gjendet në një situatë në të cilën rrezikohet seriozisht shëndeti ose zhvillimi i tij, si edhe objektivi për të bashkuar sërish familjen sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjykata zakonisht vlerëson se autoritetet kanë shumë liri veprimi për të vlerësuar, nëse një fëmijë ka nevojë për t'u marrë në mbrojtje ose jo. Megjithatë, ajo kryen një shqyrtim të rreptë të çdo kufizimi të të drejtave dhe pranisë së prindërve në jetën e fëmijëve të tyre, si edhe të çdo garancie ligjore të parashikuar, për të siguruar një mbrojtje efektive të së drejtës së prindërve dhe fëmijëve në respektim të jetës së tyre familjare. Standardet e Gjykatës në këtë fushë janë si më poshtë:

- ◆ Vendosja e një fëmije nën mbrojtje, në një ambient më të përshtatshëm për mirëqenien e tij, nuk mund të justifikojë një masë detyruese, e cila urdhëron heqjen e fëmijëve nga kujdesi i prindërve biologjikë. Duhet të ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat të provojnë "nevojën" e një ndërhyrje të tillë.<sup>66</sup>

- ◆ Kjo masë nuk mund të justifikohet as nga fakti që prindërit e fëmijës gjenden në një situatë jo të mirë, e cila mund të përmirësohet, për shembull, përmes ndihmës financiare dhe konsulencës sociale, pa qenë e nevojshme ndërmarrja e masave aq radikale, siç është ndarja e familjes<sup>67</sup>.
- ◆ Para se të merret një masë e tillë, autoritetet administrative dhe gjyqësore duhet të marrin masa alternative shtesë për të mbështetur fëmijët apo familjen, përpara se të ndërmarrin hapin ekstrem të ndarjes së tyre nga prindërit.
- ◆ Mendimi i fëmijëve duhet dëgjuar nga gjyqtarët.<sup>68</sup>
- ◆ Gjykata zbaton testin e arsyeve relevante dhe të mjaftueshme dhe pavarësisht, hapësirës së vlerësimit të autoriteteve vendase, kjo ndërhyrje duhet të jetë proporcionale me qëllimin e ligjshëm që ajo synon të realizojë.
- ◆ Shkelje të nenit 8 rezultojnë në situata kur një person nuk është njoftuar për procedurat e birësimit dhe nuk është dëgjuar në asnjë moment në lidhje me këtë çështje, pasi nuk ka qenë palë në këto procedura dhe nuk ka pasur asnjë të drejtë për të përdorur një mjet ankimi në kontekst të këtyre procedurave.<sup>69</sup>
- ◆ Së fundmi, është e domosdoshme që një prindi t'i jepet një mundësi për të kërkuar revokimin e vendimit për heqjen e të drejtave prindërore, para se fëmija e tij të jepet për birësim.<sup>70</sup>

67 Saviny k. Ukrainës, nr. 39948/06, 18.12.2008, par. 50.

68 Po aty, par. 75

69 Po aty, par. 77.

70 Po aty, par. 78.

65 A.K. dhe L. k. Kroacisë, 08.01.2013, Nr. 37956/11, par. 60.

66 Po aty, par. 67; 69

### 3.5 HEQJA E ZOTËSISË PËR TË VEPRUAR DHE GARANCITË E PROCESIT TË RREGULLT

Heqja ose kufizimi i zotësisë së personave me aftësi të kufizuara për të vepruar është një nga çështjet më delikate që lidhet me realizimin e të drejtave të tyre. Heqja e zotësisë për të vepruar mund të shkelë në parim të drejtën e një personi për jetë private, por edhe të drejtën për përdorimin e gjykatës. Gjykata ka çmuar se hapësira e vlerësimit që kanë autoritetet në këtë rast varet nga dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, kur masa në shqyrtim ka një efekt vendimtar në autonominë personale të kërkuarit, siç është kufizimi i lirisë përmes vendosjes së tij në një qendër përkujdesje<sup>71</sup>, shqyrtohet arsytimi i autoriteteve shtetërore për ta përligjur këtë masë të rreptë. Së dyti, Gjykata i kushton vëmendje të veçantë *cilësisë* së procedurave të brendshme<sup>72</sup>.

Ekzistenca e një çrregullimi të shëndetit mendor, madje edhe një çrregullim i rëndë, nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të justifikuar heqjen e zotësisë për të vepruar.<sup>73</sup> Në shumicën dërrmuese të rasteve, kur aftësitë e një individi për të vepruar dhe arsyetuar varen nga probleme të shëndetit mendor, gjendja e tij mund të ndryshojë. Për këtë arsye, personave që u është hequr zotësia për të vepruar duhet t'u bëhet një rivlerësim i herë pas herësh. Në mbështetje të këtij standardi, GJEDNJ-ja i referohet kërkesave të nenit 12 (4) të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

#### 3.5.1. Elemente të procesit të rregullt gjyqësor për heqjen e zotësisë për të vepruar: Mundësia për t'iu drejtuar gjykatës, e drejta për t'iu dëgjuar dhe paanësia e ekspertit

E drejta për të pasur mundësi t'i drejtohesh gjykatës është një aspekt shumë i rëndësishëm i autonomisë së personave me aftësi të kufizuara. Në çështjen *Stanev k. Bullgarisë*, Gjykata ka vërejtur se ekziston tashmë një tendencë në nivel evropian për t'u dhënë personave që u është hequr zotësia për të vepruar mundësi të menjëhershme për t'iu drejtuar gjykatës për të kërkuar rikthimin e zotësisë së tyre.<sup>74</sup>

Një aspekt i procedurave të brendshme, i lidhur ngushtë me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, ka të bëjë me kërkesën për rishikimin e vendimeve gjyqësore për heqjen e zotësisë për të vepruar.

71 Lashin k. Rusisë, 22.01.2013, Nr. 33117/02, par. 81.

72 Shtukaturov k. Rusisë, cituar më lart, par. 91.

73 Shtukaturov, cituar më lart, par. 94.

74 Lashin, par. 97.

Gjykata ka shqyrtuar raste kur gjykatat e brendshme kanë refuzuar kryerjen një ekzaminimi të ri psikiatrik të kërkuarve. Në këtë këndvështrim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se në lidhje me mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në kuadër të nenit 6, par. 1, "e drejta për t'i kërkuar një gjykatë të rishikojë heqjen e zotësisë për të vepruar, është një nga të drejtat më të rëndësishme të individit në fjalë".<sup>75</sup> Kërkuarja ka të drejtë t'i nënshtrohet një rishikimi tërësor të statusit të tij, procedurë e cila në parim duhet të përfshijë një vlerësim të gjendjes së tij nga një mjek tjetër. Në rastet kur vlerësimi i një eksperti pritët të luajë një rol shumë të rëndësishëm në procesin gjyqësor, paanësia e një eksperti të tillë bëhet një nga kriteret më të rëndësishme që duhet marrë në konsideratë. Mungesa e paanësisë mund të sjellë cenim të parimit të barazisë së armëve, garantuar nga neni 6 i Konventës<sup>76</sup>.

E drejta e personit me aftësi të kufizuara për t'iu dëgjuar në seancë në proceset që lidhen me zotësinë e tij për të vepruar, është një tjetër element i procesit të rregullt ligjor. Fakti që një individ nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, nuk nënkupton detyrimisht se ai është i paaftë për të kuptuar situatën në të cilën ndodhet.<sup>77</sup> Gjykata thekson se në raste të tilla, individi nuk është vetëm një palë e interesuar, por është edhe objekt i vetë shqyrtimit nga gjykata<sup>78</sup>. Ka disa rrethana përjashtimore nga rregulli i përgjithshëm i pjesëmarrjes së individit në këto seanca,<sup>79</sup> me kusht që gjykatat e brendshme t'i kenë vlerësuar me shumë kujdes këto rrethana. Për ilustrim, në çështjen *Lashin k. Rusisë*, gjykata e brendshme ishte shprehur se pjesëmarrja e kërkuarit në seancë do të "dëmtonte shëndetin e tij", por nuk ishte paraqitur asnjë provë që kjo gjykatë të kishte kërkuar mendimin e një mjeku specialist për këtë çështje, apo të ndonjë faktori tjetër që pengonte paraqitjen e ankuesit personalisht në gjykatë. GJEDNJ-ja vlerësoi se supozimi sipas të cilit, për shkak se një person vuan nga skizofrenia, duhet të përjashtohet nga procedurat gjyqësore, nuk është i mjaftueshëm. Duke iu referuar konkretisht KPDAK-së<sup>80</sup>, Gjykata u kërkon shteteve që të ndërmarrin masat e duhura dhe rregullimet e nevojshme për të lehtësuar rolin konkret të personave me aftësi të kufizuara në proceset gjyqësore<sup>81</sup>. Garancitë për heqjen e zotësisë për të vepruar zbatohen njësoj edhe kur bëhet fjalë për kufizimin e kësaj zotësie.

75 Stanev k. Bullgarisë [DHOMA E MADHE] nr. 36760/06, par. 241, GJEDNJ, 2012)

76 Lashin k. Rusisë, par. 87.

77 Stanev, par. 130

78 X. dhe Y. k. Kroacisë, par. 83.

79 Berková k. Sllovakisë, nr. 67149/01, par. 138 e në vijim, 24 mars 2009.

80 Shih më poshtë, seksionin për referimin te KPDAK-u.

81 R.P. dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, 09.10.2012, Nr. 38245/08, par. 65-67

### 3.6 E DREJTA E VOTËS

Heqja ose kufizimi i të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara është në përgjithësi e lidhur dhe rrjedh nga heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, sikurse është rasti në çështjen *Alajos Kiss k. Hungarisë*, e cila është baza e standardeve të këtij seksioni.

Në analizimin e kufizimeve të së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, gjykata zakonisht vlerëson:

**qëllimin dhe proporcionalitetin e kufizimeve të vendosura.** Neni 3 i Protokollit 1 të KEDNJ-së nuk përcakton në mënyrë të shprehur kufizimet që mund t'i vendosen të drejtës që garanton ky nen, kështu që një gamë e gjerë qëllimesh të ligjshme mund të jenë në përputhje me nenin 3.<sup>82</sup> Gjykata ka pranuar se në këtë fushë, pushtetit legjislativ kombëtar i lihet një hapësirë e gjerë vlerësimi për të përcaktuar se cilat kufizime të së drejtës së votës mund të justifikohen në kohët moderne dhe nëse kjo ndodh, sa e drejtë është shkalla e kufizimeve. I takon pushtetit legjislativ të vendosë se cila procedurë duhet të hartohet për ta përshtatur të drejtën e votës për personat me aftësi të kufizuara mendore.<sup>83</sup> Gjykata nga ana e saj kontrollon nëse ka prova që vërtetojnë se pushteti legjislativ i ka marrë ndonjëherë parasysh interesat konkurruese, ose e ka vlerësuar ndonjëherë shkallën e kufizimit në fjalë.

**pengimi absolut për të votuar** i personave me zotësi të pjesshme për të vepruar, pa vlerësuar aftësitë e tyre aktuale, nuk pranohet nga Gjykata se është brenda hapësirës së vlerësimit që gëzon shteti në kufizimin e kësaj të drejte.<sup>84</sup> Për më tepër, nëse një kufizim i të drejtave themelore zbatohet për një grup shoqëror që ka qenë subjekt diskriminimi në të shkuarën, siç janë konkretisht personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, shteti do të ketë një hapësirë më të ngushtë vlerësimi për të kufizuar këtë të drejtë dhe duhet të ketë arsye shumë serioze për këtë kufizim. Arsyeja e kësaj qasjeje është se këto grupe të shoqërisë historikisht u janë nënshtruar paragjyqimeve që kanë pasur gjithmonë pasoja negative për ta, duke sjellë përjashtimin social të tyre. Paragjyqime të tilla mund të rezultojnë në stereotipi legjislativ, të cilat pengojnë vlerësimin individual të kapaciteteve dhe nevojave të këtyre individëve.<sup>85</sup>

82 *Alajos Kiss k. Hungarisë*, 20.05.2010, Nr. 38832/06, par. 38.

83 *Po aty*, par. 41.

84 *Po aty*, par. 42.

85 *Po aty*.

Heqja e të drejtës së votës, pa bërë një vlerësim individual juridik dhe bazuar vetëm në ekzistencën e kujdestarisë së pjesshme të një individi, nuk konsiderohet nga Gjykata se është në përputhje me kufizimet legjitime të së drejtës së votës, duke shkaktuar kështu shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.<sup>86</sup> E thënë ndryshe, trajtimi në mënyrë të njëjtë i personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose mendore, sikur të ishin të gjithë pjesë e të njëjtës kategori, do të ishte një klasifikim i diskutueshëm, prandaj kufizimi i të drejtave të tyre, duhet të shqyrtohet me rreptësi.

Në një çështje të ngjashme me *Alajos Kiss*, Komiteti për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në 30 Shtator 2013<sup>87</sup>, në çështjen *Zsolt Bujdosó dhe të Tjerët k. Hungarisë*<sup>88</sup>, shkon përtej vendimit të GJEDNJ-së, vendim i cili lejon vlerësimin individual të çdo personi nga autoritetet shtetërore në lidhje me aftësinë e tij për të votuar. Këtë lejim, të cilin shteti hungarez e bazon duke iu referuar rastit të sipërpërmendur të GJEDNJ-së, Komiteti e konsideron si diskriminues në natyrën e vet. Komiteti shkon më tej, duke thënë se vetëm përmes sigurimit të procedurave të përshtatshme, të mundshme për t'u përdorur dhe të lehta për t'u kuptuar, si dhe duke siguruar asistencën e nevojshme gjatë votimit, shteti do të sigurojë që personat me aftësi të kufizuara mendore të hedhin votën e tyre në mënyrë kompetente.

Pra, komiteti shkon përtej GJEDNJ-së, duke thënë se nuk mund të ketë procedura të cilat të vlerësojnë aftësinë për të votuar ose jo të një personi me, ose pa, aftësi të kufizuara.

86 *Po aty*, par. 44.

87 Komunikimi nr. CRPD/C/10/D/4/2011.

88 Rasti kishte të bënte pikërisht me një grup personash me aftësi të kufizuara intelektuale, të cilët ishin fshirë në mënyrë automatike nga regjistrat zgjedhorë, bazuar në nenin 70 të Kushtetutës së Republikës së Hungarisë, e cila i përjashton nga votimi personat që nuk kanë zotësi për të vepruar.

### 3.7 PAGESA E AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE E DREJTA E PRONËS

Një aspekt interesant i çështjeve të GJEDNJ-së lidhet me pagesat për aftësinë e kufizuar dhe nëse ato krijojnë të drejta pronësie sipas Konventës. Kështu, Gjykata ka vërejtur se derdhja e kontributeve në një fond pensioni, në rrethana të caktuara, mund të krijojë të drejta pronësie, të cilat mund të preken nga mënyra se si shpërndahet fondi.<sup>89</sup> GJEDNJ-ja ka pranuar se të drejtat që rrjedhin nga pagesa e kontributeve të sistemeve të sigurimeve shoqërore janë të drejta materiale për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1.<sup>90</sup> Megjithatë, edhe duke supozuar se neni 1 i Protokollit 1 u garanton përfitime personave që kanë kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore, kjo e drejtë nuk mund të interpretohet se u krijon individëve të drejtën për pension në një shumë të caktuar.

Një pikë e rëndësishme në vlerësimin e pretendimeve në kuadër të kësaj dispozite është të përcaktohet nëse e drejta e një personi me aftësi të kufizuara, për të nxjerrë përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, është shkelur në një mënyrë të tillë që dëmton thelbin e së drejtës së tij të pensionit. Konkretisht, do të çmohen pritshmëritë e ligjshme të personit lidhur me përfitimin e një pensioni për aftësinë e kufizuar.

Në fushën e legjislationit social, shteti ka një hapësirë të gjerë vlerësimi. Nga çështja *Kjartan Ásmundsson k. Islandës*, mund të arrihet në përfundimin se Gjykata nuk do të kishte gjetur shkelje, në rast se kërkuesi do t'i ishte nënshtruar një rivlerësimi dhe do të kishte pasur një reduktim të pensionit të tij dhe jo një ndërprerje tërësore të këtij përfitimi.

89 *Kjartan Ásmundsson k. Islandës*, 12.10.2004, Nr. 60669/00, par. 39.

90 *Gaygusuz k. Austrisë*, 16 shtator 1996, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1996-IV, f. 1142, par. 39-41.

### 3.8 MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI

Mbrojtja nga diskriminimi parashikohet në nenin 14 të KEDNJ-së dhe në Protokollin 12 të saj.<sup>91</sup> Për nenin 14, Gjykata është shprehur se luan një rol shumë të rëndësishëm sepse plotëson parashikimet e tjera të Konventës dhe Protokolleve të saj, duke mbrojtur individët, të cilët ndodhen në situata të njëjta, nga çdo formë diskriminimi në gëzimin e të drejtave të vendosura nga Konventa. Një trajtim i ndryshëm është diskriminues sipas kuptimit të nenit 14, nëse ai nuk është ndërmarrë në bazë të një objektivit dhe justifikimi të arsyeshëm. Ekzistenca e një justifikimi duhet të shqyrtohet në lidhje me qëllimin dhe pasojat e masës së ndërmarrë dhe me parimet që mbizotërojnë normalisht në një shoqëri demokratike. Një trajtim i ndryshëm në lidhje me një të drejtë të garantuar nga Konventa, nuk duhet të ndiqet vetëm nga një qëllim legjitim: neni 14 shkelet edhe kur është qartësisht e dukshme se nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masës së ndërmarrë dhe qëllimit që është kërkuar të realizohet.<sup>92</sup>

Neni 14 nuk e ndalon trajtimin e ndryshëm, i cili bazohet në rrethana tërësisht të ndryshme dhe që janë të bazuara në interesin publik, duke përfshirë një balancë të drejtë mes mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa. Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të përligjur një trajtim të ndryshëm të situatave të ngjashme dhe fusha e veprimit të kësaj hapësire vlerësimi varet nga rrethanat e çështjeve që shqyrtohen.<sup>93</sup>

91 Protokollin 12 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj, përfshi ligjet e brendshme, duke pasur kështu një fushë më të gjerë veprimi se neni 14, i cili u referohet vetëm të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja. Shih "*Raporti Shpjegues i Protokollit 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*", paragrafi 1.

92 *Glor k. Zvicrës*, nr. 13444/04, 30.4.2009, par. 71-72.

93 *Glor*, par. 73-74.

### 3.9 REFERIMI TE KPDAK-JA

Rasti i të drejtës për të votuar i personave me aftësi të kufizuara tregon se standardet e GJEDNJ-së dhe ato të Komitetit për të Drejtat e Personave me aftësi të Kufizuara nuk përputhen plotësisht. Raste të tilla mund të përsëriten, duke i vënë autoritetet e brendshme në mëdyshje për zbatueshmërinë e secilit standard. Pa u ndalur në faktin se në cilin rang autoriteti qëndrojnë vendimet e GJEDNJ-së, përkundëjt atyre të Komitetit nga pikëpamja formale juridike, tendenca e jurisprudencës së Gjykatës është e qartë. GJEDNJ-ja u referohet në shumë çështje normave të KPDAK-së. Për shembull, në çështjen *Lashin k. Rusicë*, Gjykata thekson se, në kuadër të rëndësisë gjithmonë e më në rritje të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e personave që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, këtyre individëve po u jepet më shumë autonomi ligjore si nga KPDAK-ja, ashtu edhe nga Rekomandimi nr. R (99) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në bazë të parimeve që lidhen me mbrojtjen ligjore të të rriturve që nuk kanë zotësi për të vepruar<sup>94</sup>. Në çështjen *S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata shprehet se Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara duhet të lexohet së bashku me qëllimin e nenit 3. Gjykata është e mendimit se parimet e Konventës (KEDNJ) nuk zbatohen në vakum, por duhet të interpretohen në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare<sup>95</sup>. Ndërsa në çështjen *Zoti H. k. Hungarisë*,<sup>96</sup> Gjykata shqyrton konceptin e "masave të arsyeshme", që autoritetet shtetërore duhet ta marrin, si një nocion mjaft të ngjashëm me nocionin e "përshtatjes së arsyeshme", përmendur në nenet 2, 13 dhe 14 të KPDAK-së, për të adresuar në mënyrën e duhur kushtet e kërkuarit, veçanërisht, për t'i siguruar atij ndihmë juridike nga një avokat ose një person tjetër i përshtatshëm.

94 *Lashin k. Rusicë*, par. 97.

95 *S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 29.01.2013, Nr. 60367/10, par. 94.

96 *Z.H. k. Hungarisë*, 08.11.2012, Nr. 28973/11, par. 43

Gjykata i referohet shprehimisht KPDAK-së edhe në çështjen *R.P. dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*.<sup>97</sup> Gjykata, duke u njohur gjykatave të brendshme një hapësirë të caktuar vlerësimi për të bërë rregullimet përkatëse procedurale, për sigurimin e administrimit të mirë të drejtësisë dhe mbrojtjen e shëndetit të individit, e mbështet argumentimin e saj edhe tek KPDAK-ja. Gjykata u kërkon Shteteve që të bëjnë rregullimet e duhura për të lehtësuar rolin e personave me aftësi të kufizuara në procedurat ligjore,<sup>98</sup> duke ia nënshtruar shprehimisht këto masa nenit 6, par. 1, të Konventës, pasi këto masa nuk duhet të ndikojnë në thelbin e të drejtës së një personi për një gjykim të rregullt.<sup>99</sup>

Zhvillimet e mësipërme të jurisprudencës janë dëshmi e faktit që standardet dhe interpretimet e KPDAK-së nuk do të kalojnë pa u vënë re nga GJEDNJ-ja. Siç u përmend më lart, në fund të fundit, standardet e GJEDNJ-së janë standardet bazë, ose standardet minimale nën të cilat shtetet nuk mund të bien. Është detyrim i tyre ndërkombëtar që të zbatojnë edhe standardet e vendosura nga KPDAK-ja, si standarde specifike për personat me aftësi të kufizuara.

97 *R.P. dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 09.10.2012, Nr. 38245/08, par. 65-67

98 Shih nenin 13 të KPDAK-ut mbi qasjen në drejtësi.

99 Shih edhe *Shtukaturov k. Rusicë*, cituar më lart, par. 68.

## PJESA E DYTË - VENDIMET E GJEDNJ-së

### 1. E DREJTA E JETËS

“ Lambert dhe të Tjerët k. Francës [DHOMA E MADHE], 5.6.2015, Nr. 46043/14

*Nëse ekzekutimi i vendimit gjyqësor për ndërprerjen e ushqyerjes dhe hidratimit, që mbanin pacientin në jetë në mënyrë artificiale, shkelte nenin 2 të Konventës.*

**Faktet** – Kërkuarit janë disa nga të të afërmit e Vincent Lambert-it, i cili kishte pësuar dëmtime në kokë, si pasojë e një aksidenti rrugor në shtator të vitit 2008. Si rrjedhojë, ai u bë tetraplegjik dhe në gjendje varësie tërësore. Ai merrte ushqim dhe hidratim artificial në një spital. Në shtator të vitit 2013, mjeku i ngarkuar me trajtimin e zotit Lambert filloi procedurën e këshillimit, sipas Aktit "Leonetti", për të drejtat e pacientëve dhe çështjet e përfundimit të jetës. Ai u këshillua me gjashtë mjekë, njëri prej të cilëve ishte përzgjedhur nga kërkuarit, organizoi një takim me ekipin e kujdesit mjekësor dhe dy takime me të afërmit e Vincent Lambert-it. Pas këtyre takimeve, një pjesë e të afërmeve të zotit Lambert u shprehën në favor të ndërprerjes së trajtimit, ndërsa kërkuarit e kundërshtuan këtë veprim. Në 11 janar 2014, mjeku i ngarkuar me kujdesin mjekësor të Vincent Lambert-it vendosi të ndërpriste ushqyerjen dhe hidratimin artificial të pacientit.

Këshilli i Shtetit, i cili mori në shqyrtim rastin në bazë të një kërkesë urgjente, vërejti se vlerësimi më i fundit i pacientit ishte bërë dy vjet e gjysmë më parë dhe e quajti të nevojshme të merrte informacionin më të plotë të mundshëm për gjendjen shëndetësore të Vincent Lambert-it. Për këtë arsye, urdhëroi hartimin e një raporti mjekësor, të cilin ua besoi tre specialistëve të njohur në neurologji. Më tej, duke pasur parasysh shkallën dhe vështirësinë e rastit, ai u kërkoi Akademisë Kombëtare Mjekësore, Komitetit Këshillimor Kombëtar për Etikën, Këshillit Mjekësor Kombëtar dhe zotit Jean Leonetti-t të bënin parashtrime të përgjithshme, si amici curiae, për të qartësuar, në veçanti, konceptet e "këmbënguljes së paarsyeshme"<sup>100</sup> dhe "mbështetjes së jetës në mënyrë artificiale". Ekspertët e ekzaminuan Vincent Lambertin në nëntë raste, kryen një sërë analizash dhe u njohën me dosjen mjekësore në tërësi, si edhe me elementët e dosjes gjyqësore. Ata u takuan edhe me të gjitha palët e interesuara. Në 24 qershor 2014, Këshilli i Shtetit vendosi se vendimi i marrë nga mjeku i Vincent Lambert-it më 11 janar 2014, për ndërprerjen e ushqimit dhe hidratimit artificial kishte qenë i ligjshëm.

Kërkuarit pretenduan para GJEDNJ-së se, nëse do të ekzekutohej vendimi i Këshillit të Shtetit, e drejta e jetës së Vincent Lambert-it do të cenohet dhe se atyre gjithashtu do t'u shkeleshin të drejtat për jetë private dhe familjare.

100 Sipas Aktit francez "Leonetti", trajtimi konsiderohet si "këmbëngulje e paarsyeshme" nëse është i kotë ose shpërpjesëtimor, ose nuk ka ndonjë efekt tjetër, përveç atij të mbajtjes në jetë artificialisht të një personi. Shih hollësisht paragrafët 156-160 të Vendimit Lambert.

#### Vlerësimi i Gjykatës

##### Konsiderata të përgjithshme

###### a) Jurisprudenca e deritanishme

1. Gjykata nuk ka vendosur kurrë më parë për një çështje që lidhet me këtë kërkesë, por ka shqyrtuar një numër rastesh që kanë të bëjnë me çështje të ngjashme.

2. Në grupin e parë të çështjeve, kërkuarit ose të afërmit e tyre kërkuan të drejtën për të vdekur, bazuar në nene të ndryshme të Konventës.

Në çështjen *Sanles Sanles k. Spanjës* (*Sanles Sanles k. Spain* (vendim), nr. 48335/99, GJEDNJ, 2000XI), kërkuarit vlerësuan në emër të kunatit të tyre, i cili ishte tetraplegjik dhe dëshironte t'i jepte fund jetës së tij me ndihmën e palëve të treta, [...] të drejtën

për të vdekur me dinjitet bazuar në nenet 2, 3, 5, 6, 8, 9 dhe 14 të Konventës. Gjykata e rrëzoi kërkesën si në mospërputhje *ratione personae* me dispozitat e Konventës, pasi personi në fjalë kishte vdekur përpara se çështja t'i drejtohej Gjykatës.

Në çështjen *Pretty*<sup>101</sup> (*Pretty v. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, GJEDNJ, 2002III) kërkesja gjendej në fazën terminale të një sëmundje të pashërueshme neuro-degjenerative dhe u ankua se, në bazë të neneve 2, 3, 8, 9 dhe 14 të Konventës, bashkëshorti i saj nuk mund ta ndihmonte të kryente vetëvrasje, pa u ndjekur penalisht në Mbretërinë e Bashkuar. Gjykata nuk gjeti shkelje të dispozitave në fjalë.

Në çështjet *Haas* (*Haas k. Zvicrës*, nr. 31322/07, par. 51, GJEDNJ, 2011) dhe *Koch* (*Koch k. Gjermanisë*, nr. 497/09, 19 korrik 2012), për vetëvrasjen e asistuar, kërkesit u mbështetën në nenin 8 të Konventës. Në çështjen *Haas*, kërkesi, i cili kishte vuajtur për një kohë të gjatë nga një çrregullim serioz bipolar, dëshironte t'i jepte fund jetës dhe u ankua se e kishte të pamundur që të merrte substancën vdekjeprurëse pa recetë mjekësore; Gjykata arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 8. Në çështjen *Koch*, kërkesi pretendoi se refuzimi që i ishte bërë gruas së tij (e cila ishte e paralizuar dhe kishte nevojë për ventilim artificial), për të siguruar një dozë të një bari vdekjeprurëse, në mënyrë që t'i jepte fund jetës, cenonte të drejtën e saj dhe të tij për respektim të jetës private dhe familjare. Ai u ankua edhe për refuzimin nga ana e gjykatave të brendshme të shqyrtimit themelin e kërkesës së tij. Në këtë rast, Gjykata gjeti shkelje të nenit 8 vetëm për këtë pikë.

3. Një grup i dytë çështjesh lidhet me pretendimet e kërkesve për administrimin ose ndërprerjen e trajtimit.

Në çështjen *Glass* (*Glass k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61827/00, 18 mars 2003), kërkesit u ankuan se mjekët e spitalit i kishin dhënë diamorfinë djalit të tyre të sëmurë, pa pëlqimin e tyre, dhe se në dosjen mjekësore të tij, kishin përfshirë urdhrin "të mos ringjallet". Në vendimin e saj [...], Gjykata konstatoi se kërkesa e tyre sipas nenit 2, ishte haptazi e pabazuar; ndërsa në vendimin e saj të 9 marsit 2004 (*Glass k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61827/00, 9 mars 2004), Gjykata konstatoi se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës.

Në çështjen *Burke k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 19807/06, 11 korrik 2006), kërkesi vuante nga një sëmundje degjenerative e pashërueshme e trurit dhe kishte frikë se praktika që përdorej në

Mbretërinë e Bashkuar mund të shkonte drejt ndërprerjes së ushqimit dhe hidratimit të tij. Gjykata e deklaroi kërkesën e tij, të bazuar te nenet 2, 3 dhe 8 të Konventës, të papranueshme, për shkak se ishte haptazi e pabazuar.

Së fundmi, në vendimin *Ada Rossi dhe të Tjerët* (*Ada Rossi dhe të Tjerët k. Italisë*, nr. 55185/08, 16 dhjetor 2008), Gjykata deklaroi si të papranueshme *ratione personae* një kërkesë të paraqitur nga individë dhe shoqata të cilët, bazuar në nenet 2 dhe 3 të Konventës, ankoheshin për pasojat e ekzekutimit të një vendimi të Gjykatës Italiane të Kasacionit, e cila autorizonte ndërprerjen e ushqimit dhe hidratimit artificial të një vajze të re në gjendje vegjetative.

[...]

#### (b) Konteksti

4. Neni 2 u kërkon shteteve që të marrin masat e duhura për mbrojtjen e jetës së individëve nën juridiksionin e tyre [...]; në sferën e shëndetit publik. Këto detyrime **pozitive kërkojnë që shtetet të miratojnë rregullore të cilat i detyrojnë spitalet, qofshin publike apo private, të marrin masat e duhura për mbrojtjen e jetës së pacientëve** (shih *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 49, GJEDNJ, 2002I; *Glass*, cituar më lart; *Vo. k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 53924/00, par. 89, GJEDNJ, 2004VIII; dhe *Qendra për Burime Ligjore, në emër të Valentin Câmpeanu*, shih më poshtë, par. 130).

5. Gjykata thekson se rasti konkret nuk është eutanazia, por ndërprerja e trajtimit të mbajtjes gjallë [...].

6. Në çështjen *Haas*, cituar më lart, Gjykata vlerësoi se Konventa duhet të lexohet në tërësi [...]. Gjykata ishte e mendimit se ishte me vend që, në kontekstin e shqyrtimit të një shkelje të mundshme të nenit 8, t'i referohej nenit 2 të Konventës. Gjykata mendon se edhe e kundërta mund të zbatohet: në një çështje si çështja në shqyrtim, për të vlerësuar një shkelje të mundshme të nenit 2, Gjykata i referohet nenit 8 të Konventës, të drejtës për respektim të jetës private dhe nocionit të autonomisë personale [...]. Tek çështja *Pretty* (par. 67), Gjykata nuk ishte e gatshme të përjashtonte se moslejimi i kërkesës që, në mënyrë të ligjshme, të ushtronte zgjedhjen e saj, për të shmangur atë që ajo e konsideronte një fund të padenjë dhe të dhimbshëm të jetës së saj, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e saj për respektim të jetës private, garantuar nga neni 8 par. 1, i Konventës. Në çështjen *Haas* (par. 51), ajo vlerësoi se e drejta e një individit për të vendosur se në ç' mënyrë dhe në cilin moment duhet t'i jepte

fund jetës së vet, ishte një nga aspektet e të drejtës për respektim të jetës private.

Gjykata i referohet në veçanti paragrafëve 63 dhe 65 të vendimit *Pretty*, ku deklaroi si më poshtë:

"... Në sferën e trajtimeve mjekësore, refuzimi për të pranuar një trajtim të caktuar, mund të çojë në mënyrë të pashmangshme drejt një fundi fatal, por kryerja e një trajtimi mjekësor, pa pranimin e një pacienti të aftë mendërisht, ndërhyr me integritetin fizik të atij personi në një mënyrë e cila ngre çështje që lidhen me të drejtat e mbrojtura në nenin 8 par. 1, i Konventës..."

"Thelbi i Konventës është respektimi i dinjitetit dhe lirisë njerëzore. Pa mohuar në asnjë mënyrë parimin e shenjtërit të jetës së mbrojtur nga Konventa, Gjykata vlerëson se nocionet e cilësisë së jetës mund të marrin kuptim në kuadër të nenit 8.. Në epokën e rritjes së perfeksionimit të mjekësisë, kombinuar me rritjen e moshës së vdekshmërisë, shumë njerëz kanë filluar të shqetësohen se mund të jenë të detyruar të lëngojnë në një moshë të shtyrë, ose mund të jenë në gjendje të rënduar fizike dhe mendore, e cila bie në kundërshtim me idetë e konsoliduara të identitetit personal..."

7. Gjykata do t'i marrë parasysh këto konsiderata për të vlerësuar nëse Shteti ka vepruar në përputhje me detyrimet e tij pozitive, që rrjedhin nga neni 2. Më tej, ajo vëren nëse në administrimin, ose ndërprerjen e trajtimit mjekësor [...], janë marrë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- **ekzistenca në legjislacionin dhe praktikën e brendshme** e një kuadri rregullator në përputhje me kërkesat e nenit 2 (*Glass*);
- nëse janë **marrë parasysh dëshirat e shprehura më parë të kërkesit** dhe të personave të afërm të tij, si edhe **mendimet e personelit tjetër mjekësor** (*Burke*);
- **mundësia për t'iu drejtuar gjykatave** në rast të dyshimeve për sa i përket interesit më të mirë të pacientit (po aty).

Gjykata do t'i marrë parasysh këta faktorë në vlerësimin e çështjes që është objekt shqyrtimi. Ajo do të marrë parasysh edhe kriteret e parashtruara në "*Udhërrëfyesin e procesit vendimmarrës për trajtimin mjekësor në rastet e dhënies fund të jetës*" të Këshillit të Evropës.

#### c) Hapësira e vlerësimit

8. Gjykata rithekson se neni 2 renditet si një ndër dispozitat më themelore të Konventës e cila,

në kohë paqeje nuk lejohet asnjë derogim, sipas nenit 15 të Konventës, dhe se përjashtimet e përmendura aty duhet të interpretohen në mënyrë të kufizuar (Shih *Giuliani dhe Gaggio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 23458/02, par. 174-77, GJEDNJ 2011 (ekstrakte)). Megjithatë, në kontekstin e detyrimeve pozitive shtetërore, kur shqyrton çështje komplekse shkencore, ligjore dhe etike, të cilat lidhen në veçanti me fillimin dhe mbarimin e jetës dhe në mungesë të një konsensusi ndërmjet Shteteve Anëtare, Gjykata ka pranuar se shtetet kanë një hapësirë të caktuar vlerësimi.

Së pari, Gjykata vëren se në çështjen *Vo*, (që lidhet me shfaqësimin për akuzën ndaj një mjeku përgjegjës për vrasjen e paqëllimshme të fëmijës së pa lindur të kërkuarit), në vlerësimin e pikës së fillimit të jetës, nën këndvështrimin e nenit 2 të Konventës, Gjykata arriti në përfundimin se kjo çështje futej në sferën e hapësirës së vlerësimit të Shtetit. Ajo mori në konsideratë mungesën e një qasjeje të përbashkët midis Shteteve Kontraktuese dhe të një konsensusi Evropian për përkufizimin shkencor dhe ligjor të fillimit të jetës (par. 82).

[...]

9. Lidhur me çështjen e vetëvrasjes së asistuar, Gjykata vërejtë se, në kontekstin e nenit 8 të Konventës, nuk kishte konsensus ndërmjet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës për të drejtën e një individit për të vendosur se në cilën mënyrë dhe në cilin moment kohor duhet të mbaronte jeta e tij dhe për këtë arsye, arriti në përfundimin se hapësira e vlerësimit të Shteteve në këtë fushë ishte e "konsiderueshme" (shih *Haas*, cituar më lart, par. 55, dhe *Koch*, cituar më lart, par. 70).

[...]

10. Gjykata vëren se nuk ka konsensus ndërmjet Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës në favor të lejimit të ndërprerjes së trajtimit të mbajtjes në jetë në mënyrë artificiale, edhe pse shumica e Shteteve duket se e lejojnë një gjë të tillë. Ndërsa mënyrat që rregullojnë ndërprerjen e trajtimit ndryshojnë nga një vend në tjetrin, megjithatë ekziston konsensusi në lidhje me rëndësinë parësore të dëshirave të pacientit në procesin vendimmarrës, pavarësisht mënyrës sesi shprehen këto dëshira.

11. Prandaj, Gjykata mendon se **në fushën e mbarimit, si edhe në atë të fillimit të jetës, Shtetet kanë një hapësirë vlerësimi jo vetëm për sa i përket lejimit ose ndalimit të trajtimit të mbajtjes së jetës artificialisht, por edhe për sa u përket mjeteve për të vendosur një balancë ndërmjet mbrojtjes të së drejtës së jetës**

<sup>101</sup> Shih çështjen *Pretty*, trajtuar më poshtë.

së pacientit dhe të drejtës së tij për respektim të jetës private dhe autonomisë personale [...]. Megjithatë, kjo **hapësirë vlerësimi nuk është e pakufizuar** dhe Gjykata i rezervon vetes funksionin për të kontrolluar nëse Shteti ka vepruar ose jo në përputhje me detyrimet e tij sipas nenit 2.

#### d) Zbatimi i parimeve për çështjen objekt shqyrtimi

[...]

**12.** Gjykata është mjaft e ndërgjegjshme për rëndësinë e çështjeve të ngritura në këtë rast, të cilat kanë të bëjnë me aspekte jashtëzakonisht komplekse mjekësore, ligjore dhe etike. Bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata rithekson se fillimisht u takonte autoriteteve të brendshme që të verifikonin nëse vendimi për ndërprerjen e trajtimit ishte në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe Konventën dhe të përcaktonte dëshirat e pacientit, në përputhje me të drejtën e brendshme. Roli i Gjykatës ishte të vlerësonte nëse Shteti i kishte përmbushur detyrimet e tij pozitive, sipas nenit 2 të Konventës.

Bazuar në këtë qasje, Gjykata konstatoi se kuadri ligjor i brendshëm dhe interpretimi i tij nga Këshilli i Shtetit, si edhe procesi vendimmarrës, i kryer në një mënyrë të kujdesshme në rastin në shqyrtim, ishin në përputhje me nenin 2. Për sa i përket mjeteve gjyqësore në dispozicion të kërkuesve, Gjykata arriti në përfundimin se çështja ishte shqyrtuar në thellësi; se ishin shprehur të gjitha këndvështrimet dhe se të gjitha aspektet ishin shqyrtuar me kujdes si nga raporti mjekësor i detajuar, ashtu edhe nga vëzhgimet e përgjithshme të organizmave më të larta mjekësore dhe etike.

Për rrjedhojë, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet e brendshme kishin vepruar në përputhje me detyrimet pozitive që rrjedhin nga neni 2 i Konventës [...].

[...]

**13.** Për rrjedhojë, nuk do të ketë shkelje të nenit 2 të Konventës, nëse zbatohet vendimi i Këshillit të Shtetit i datës 24 qershor 2014.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetën

**37.** Jurisprudenca e Gjykatës i jep epërsi nenit 2 të Konventës, si garantues i një prej të drejtave më themelore të parashikuara në Konventë (shih *McCann dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, Seria A, nr. 324, par. 146-47). Neni 2 mbron të drejtën e jetës, pa garantimin e së cilës nuk mund të gëzohet asnjë e drejtë dhe liri tjetër, duke i bërë parashikimet e tjera të Konventës të pavlefshme. Ai përcakton rrethanat e kufizuara kur privimi i jetës mund të justifikohet dhe Gjykata zbaton një shqyrtim të rreptë, në rastet kur shtetet e painformuara e mbështesin cenimin e të drejtës së jetës në këto përjashtime (po aty, par. 149-50).

**38.** Teksti i nenit 2 të Konventës parandalon në mënyrë të drejtpërdrejtë përdorimin e forcës nga agjentët shtetërorë. Megjithatë, ky nen është interpretuar se zbatohet jo vetëm për vrasjet e qëllimshme, por edhe për ato situata, në të cilat është lejuar përdorimi i forcës, duke sjellë si pasojë cenimin e jetës së individit (po aty, par. 148). Për më tepër, Gjykata është shprehur se neni 2, par. 1, i detyron Shtetet Palë që jo vetëm të mos ndër marrim veprime të qëllimshme dhe të paligjshme, të cilat cenojnë jetën e qytetarëve, por edhe të marrin masat e duhura për të mbrojtur jetën e individëve që jetojnë brenda juridiksionit të këtyre shteteve (shih *L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve 1998-III, par. 36). Ky detyrim nuk siguron të drejtën e jetës vetëm përmes ekzistencës së një makinerie të tërë ligjore, e cila parandalon shkeljen e kësaj të drejte, por përfshin edhe një detyrim pozitiv të autoriteteve në disa situata të tjera, për të marrë masa vepruese për ruajtjen e jetës së individëve, të cilët rrezikohen nga veprimet kriminale të personave të tretë (shih *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, Raportet 1998-VIII, par. 115, dhe *Kılıç k. Turqisë*, nr. 22492/93, par. 62 dhe 76, GJEDNJ, 2000-III). [...].

**39.** Në të gjitha çështjet e gjykuara prej saj, Gjykata ka theksuar në mënyrë të veçantë detyrimin e shteteve për të mbrojtur jetën e qytetarëve të tyre. Gjykata nuk është e bindur se “e drejta e jetës”, e garantuar nga neni 2 i Konventës, mund të interpretohet se përmban edhe aspektin negativ [...]. **Neni 2 i Konventës nuk mund të interpretohet se garanton edhe një të drejtë diametralisht të kundërt me të, siç është e drejta për të vdekur, ashtu sikurse ai nuk krijon një hapësirë për vetëvlerësim (vetëpërcaktim) në kuptimin që një individ ka të drejtë të zgjedhë vdekjen dhe jo jetën.**

**40.** Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se neni 2 i Konventës nuk garanton të drejtën për të vdekur, qoftë kjo me ndihmën e një personi të tretë, apo me ndihmën e autoriteteve publike. Ky qëndrim është konfirmuar edhe nga Rekomandimi 1418 (1999) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

**41.** [...] Në rastet kur shtetet lejojnë që individët t’i japin fund jetës së tyre vetë, ose përmes ndihmës nga persona të tretë, mund të lindë një konflikt mes konsideratave të lirive vetjake dhe interesit publik, konflikt i cili mund të zgjidhet vetëm duke shqyrtuar rrethanat konkrete të çështjes (shih *mutatis mutandis, Laskey, Jaggard dhe Brown k. Mbretërisë së Bashkuar*, 19 shkurt 1997, Raportet 1997-I).

[...] Mbretëria e Bashkuar, duke mos e lejuar vetëvrasjen e asistuar, nuk shkel parashikimin e nenit 2 të Konventës.

**42.** Gjykata vlerëson se në këtë rast nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës.

### Në lidhje me trajtimin poshtëruar

**49.** Neni 3 dhe neni 2 i Konventës duhet të konsiderohen ndër parashikimet më thelbësore të saj, të cilat krijojnë vlerat bazë të shoqërive demokratike, anëtare të Këshillit të Evropës (shih *Soering k. Mbretërisë së Bashkuar*, 7 korrik 1989, Seria A, nr. 161, par. 88). Në ndryshim nga parashikimet e tjera të Konventës, këta dy nene kanë karakter absolut e nuk lejojnë përjashtime, ose shmangie në bazë të nenit 15 të Konventës.

**50.** Në jurisprudencën e Gjykatës vërehet se neni 3 është zbatuar në rastin e individëve të cilët kanë qenë të rrezikuar nga ndonjë formë e qëllimshme keqtrajtimi [...] (shih ndër të tjera *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, gjykim i 18 janarit 1978, Seria A, nr. 25). Në terma të përgjithshëm, ky parashikim duhet shpjeguar si një detyrim negativ për shtetet, për të shmangur keqtrajtimin e individëve brenda juridiksionit të tyre. Megjithatë, nën dritën e rëndësisë thelbësore që mbart neni 3, Gjykata i rezervon vetes një fleksibilitet dhe liri vendimi të mjaftueshme për ta vlerësuar zbatimin e këtij neni në situata të ndryshme, të cilat mund të sjellin shkelje (shih *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, gjykim i 2 majit 1997, Raportet 1997-III, par. 49).

**51.** Veçanërisht, Gjykata është shprehur se neni 1 i Konventës i detyron Palët e Larta Kontraktuese që t’u garantojnë të gjithë individëve brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e parashikuara në Konventë. Ky nen i marrë së bashku

“

**Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar, 29.04.2002, Nr. 2346/02**

*Nëse refuzimi i autoriteteve për vdekjen e asistuar të kërkueses shkelte të drejtën e jetës dhe të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës dhe trajtimit çnjerëzor e degradues.*

”

**Faktet** – Kërkuesja, D. Pretty, vuante nga një sëmundje e neuroneve motorike, sëmundje kjo e pashërueshme, e cila prek indet muskulore. Sëmundja ishte në një fazë të avancuar dhe kërkuesja ishte paralizuar nga qafa e poshtë. Gjithsesi, aftësia e saj intelektuale për të marrë vendime nuk ishte dëmtuar. Duke marrë parasysh se gjatë fazës së fundit, sëmundja do t’i prekte neuronet, ajo dëshironte të ishte në gjendje të përcaktonte vetë mënyrën dhe kohën e vdekjes për të shpëtuar nga vuajtjet dhe degradimi. Megjithëse, sipas ligjeve angleze, vetëvrasja nuk është vepër penale, kërkueses i ndalohej ta ndërmerre këtë hap nëpërmjet ndihmës së asistuar, pasi kjo ndihmë parashikohej si vepër penale. Zonja Pretty dëshironte që bashkëshorti i saj ta asistonte gjatë kryerjes së vetëvrasjes, por prokurori e refuzoi kërkesën e saj, me argumentin se bashkëshorti do të ndiqej penalisht në rast se e kryente këtë veprim.

Kërkuesja iu drejtua GJEDNJ-së me një sërë pretendimesh për shkelje të Konventës. Ndër të tjera, ajo pretendoi se i ishte shkelur e drejta për jetën, pasi neni 2 i Konventës garanton të drejtën e çdo individi për të jetuar ose jo, dhe se vuajtjet e shkaktuara nga sëmundja do t’i sillnin asaj një trajtim poshtëruar, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Kërkuesja pretendonte edhe se autoritetet i cenonin të drejtën për një jetë të qetë private, duke mos e lejuar të bënte çfarë të donte me trupin e saj.

me nenin 3, i detyron shtetet që të ndërmarin masa të përshtatshme për të siguruar që individët brenda juridiksionit të tyre të mos i nënshtrohen torturës, trajtimit apo ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtëruës, duke përfshirë këtu edhe rastet kur ky trajtim kryhet nga persona të tjerë dhe jo nga autoritetet shtetërore (shih *A. k. Mbretërisë së Bashkuar*, gjykim i 23 shtatorit 1998, Raportet 1998-VI, par. 22). Detyrimi pozitiv i shtetit për të garantuar mbrojtje kundër trajtimit çnjerëzor ose poshtëruës është theksuar në një sërë çështjesh të shqyrtuara nga Gjykata, ndër të tjera, *A. k. Mbretërisë së Bashkuar* (cituar më lart), dhe *Z. dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* ([DHOMA E MADHE], nr. 29392/95, GJEDNJ, 2001-V). Gjithashtu, neni 3 u vendos autoriteteve shtetërore detyrimin për të mbrojtur shëndetin e personave, të cilëve u është kufizuar liria (shih *Keenan*, cituar më lart, dhe *Kudla k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 94, GJEDNJ, 2000-XI).

**52.** Për sa i përket llojit të "trajtimit", sipas qëllimit të nenit 3 të Konventës, jurisprudenca e Gjykatës i referohet "keqtrajtimit", i cili përmban një nivel minimal ashpërsie dhe cenon individin fizikisht ose psikologjikisht (shih *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 167; *V. k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 24888/94, par. 71, GJEDNJ 1999-IX). Kur trajtimi e përul, ose diskrediton një individ, duke treguar mungesë respekti për të, ose duke i cenuar dinjitetin njerëzor, ose duke i shkaktuar ndjenjë frike, akthi ose inferioriteti, të tilla që mund të cenojnë moralin ose qëndrueshmërinë fizike të tij, ky trajtim mund të karakterizohet si poshtëruës dhe të përfshihet brenda kuadrit të ndalimeve të nenit 3 (shih vendimet *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 24-30, GJEDNJ, 2001-VII, dhe *Valašinas k. Lituanisë*, nr. 44558/98, par. 117, GJEDNJ, 2001-VIII). Vuajtjet e shkaktuara nga sëmundje natyrore, fizike ose çrregullime të shëndetit mendor, mund të përfshihen në parashikimin e nenit 3, kur gjendja e personit përkeqësohet ose rrezikon të përkeqësohet për shkak të situatave të ndryshme, siç janë për shembull, kushtet e vuajtjes së dënimit në një burg [...] (shih *D. k. Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Keenan*, të dyja cituar më lart, dhe *Bensaid k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44599/98, GJEDNJ, 2000-I).

**53.** Në çështjen konkrete, shteti i paditur nuk ka shkaktuar ndonjë keqtrajtim ndaj kërkueses. Gjithashtu, as kërkuesja nuk është ankuar se nuk ka marrë trajtimin e duhur nga autoritetet mjekësore shtetërore [...].

**55.** Gjykata shpreh mirëkuptimin e saj për vlerësimin e kërkueses se pa pasur mundësi që t'i japë fund jetës së saj, ajo përballat me

perspektivën e një vdekjeje të vështirë. Është e vërtetë se ajo e ka të pamundur të kryejë vetëvrasjen për shkak të paaftësisë fizike dhe se ligji është i tillë që bashkëshorti i saj mund të ndiqet penalisht, nëse i jep asaj ndihmë [...].

**56.** [...] Gjykata arrin në përfundimin se, në kuadër të **nenit 3 të Konventës, nuk ekziston një detyrim pozitiv i cili ta detyrojë shtetin e paditur të mos e ndjekë penalisht bashkëshortin e kërkueses, në rast se ai e asiston atë në vetëvrasjen e saj.** Rrjedhimisht, në këtë rast, nuk ka shkelje të nenit 3 të Konventës.

**Në lidhje me respektimin e jetës së qetë private**

**Përputhja me nenin 8, par. 1.**

**61.** Sikur është shprehur edhe më parë, Gjykata rithekson se koncepti i "jetës private" është shumë i gjerë dhe nuk mund të përcaktohet në mënyrë shteruese. Ai përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të njerëzve (shih *X dhe Y k. Holandës*, 26 mars 1985, Seria A, nr. 91, par. 22). Në disa raste, ky koncept mund të përfshijë aspekte të identitetit fizik dhe social të individit (shih *Mikulic k. Kroacisë*, nr. 53176/99, par. 53, GJEDNJ 2002-I). Elementë të tillë si, për shembull, identifikimi gjinor, emri dhe orientimi seksual dhe jeta seksuale përfshihen në sferën personale, të mbrojtur nga neni 8 (shih *B. k. Francës*, gjykim i 25 marsit 1992, Seria A, nr. 232-C, par. 63; *Burghartz k. Zvicrës*, gjykim i 22 shkurtit 1994, Seria A, nr. 280-B, par. 24; *Dudgeon k. Mbretërisë së Bashkuar*, gjykim i 22 tetorit 1981, Seria A, nr. 45, par. 41; dhe *Laskey, Jaggard dhe Brown*, cituar më lart, par. 36). Neni 8 mbron gjithashtu të drejtën e zhvillimit personal, dhe të drejtën për të vendosur dhe pasur marrëdhënie me persona të tjerë [...] (shih *Burghartz*, cituar më lartë, opinion i Komisionit, par. 47, dhe *Friedl k. Austrisë*, gjykim i 31 janarit 1995, Seria A, nr. 305-B, opinion i Komisionit, par. 45) [...].

**62.** [...] Gjykata vëren se mundësia e një individi për ta jetuar jetën e vet sipas zgjedhjeve të tij, mund të përfshijë edhe veprime që mund të jenë të dëmshme fizikisht, ose moralisht. Shtrirja e pushtetit shtetëror dhe legjislacionit penal, për të mbrojtur individët nga pasojat e stilit të jetës që ata zgjedhin, ka qenë për një kohë të gjatë temë e diskutimeve morale dhe të jurisprudencës, veçanërisht për shkak se kjo ndërhyrje konsiderohet si ndërhyrje në sferën e jetës private. Megjithatë, edhe në rastet kur sjellja e një individi vendos në rrezik shëndetin ose jetën e tij, jurisprudenca e institucioneve të Konventës e ka trajtuar vendosjen e masave shtrënguese shtetërore ose zbatimin e legjislacionit penal si cenim të jetës private të kërkuesve sipas nenit 8 par. 1, duke u

kërkuar Shteteve që të paraqesin justifikime sipas kuptimit të par. të dytë, të nenit 8 (shih *Laskey, Jaggard dhe Brown*, cituar më lart, *Acmanne dhe të Tjerët k. Belgjikës*, nr. 10435/83, vendim i Komisionit i 10 dhjetorit 1984, Vendime dhe Raporte (DR) 40, f. 251).

**65.** Thelbi i Konventës është respektimi i dinjitetit dhe lirisë njerëzore. Pa mohuar në asnjë mënyrë parimin e shenjtëritit të jetës, të mbrojtur nga Konventa, Gjykata vlerëson se nocionet e cilësisë së jetës mund të marrin kuptim në kuadër të nenit 8 [...].

**67.** Kërkuesja në çështjen, objekt gjykimi, e kishte të ndaluar me ligj ushtrimin e zgjedhjes së saj, për të shmangur atë që ajo e konsideron si një fund të padenjë dhe stresues të jetës së saj. Gjykata nuk është e gatshme të përjashtojë se kjo përbën një shkelje të së drejtës së saj për respektim të jetës private, garantuar nga neni 8, par. 1, i Konventës. Për këtë arsye, pretendimet e zonjës Pretty do të shqyrtohen në dritën e par. 2, të nenit 8.

**Përputhja me nenin 8, par. 2, të Konventës**

**68.** Një kufizim i të drejtës së garantuar nga neni 8 nuk mund të legjitimohet, përveç rasteve kur "parashikohet me ligj" dhe ka ose ndjek një qëllim të ligjshëm, "të nevojshëm në një shoqëri demokratike" (shih *Dudgeon*, cituar më lart, par. 43).

**70.** Në bazë të jurisprudencës së konsoliduar të gjykatës, nocioni i "nevojës", i korrespondon një nevojë të ngutshme sociale, por një ndërhyrje

e tillë duhet të jetë sidomos në proporcion me qëllimin për të cilin bëhet; dhe për të përcaktuar nëse ndërhyrja është "e nevojshme në një shoqëri demokratike", Gjykata merr në konsideratë hapësirën e vlerësimit që kanë autoritetet kombëtare, vendimet e të cilëve janë objekt i shqyrtimit nga Gjykata në kuadër të parashikimeve të Konventës. Hapësira e vlerësimit që u jepet autoriteteve kompetente shtetërore varet nga natyra e çështjes dhe interesat e përfshira në të.

**71.** Gjykata kujton se hapësira e vlerësimit në jetën intime dhe seksuale të individëve (shih *Dudgeon*, cituar më lartë, f. 21, par. 52, dhe *A.D.T. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35765/97, par. 37, GJEDNJ, 2000-IX). Megjithëse kërkuesja ka argumentuar se ka disa arsye po aq të forta për ndërhyrje në jetën e saj, Gjykata nuk është e mendimit se situata e saj ka bazë krahasuese të njëjtë, ose përfshin të njëjtin arsyetim me këtë çështje.

[...]

**76.** Gjykata vlerëson se sanksioni ligjor për ndalimin e vetëvrasjes së asistuar nuk është në shpërpjesëtim me nevojën për këtë ndërhyrje [...].

[...]

**78.** Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në këtë rast mund të justifikohet si "e nevojshme në një shoqëri demokratike", për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve dhe se, rrjedhimisht, nuk ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

“

**Qendra e Burimeve Juridike në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë, 17.07.2014, Nr. 47848/08**

*Nëse vdekja e kërkuesit në një spital psikiatrik përbënte shkelje të nenit 2 dhe nëse kishte pasur një mjet ankimi efektiv sipas nenit 13.*

”

**Faktet** – Organizata jofitimprurëse, Qendra e Burimeve Juridike (QBJ), e paraqiti kërkesën përpara GJEDNJ-së në emër të një të riu rom, zotit Câmpeanu, i cili ndërroi jetë në vitin 2004 në moshën 18 vjeçare. Zoti Câmpeanu, pasi ishte braktisur nga nëna e tij, kishte jetuar në një jetimore. Në moshë të hershme, ai u diagnostikua si bartës i virusit HIV-pozitiv dhe vuante nga çrregullime të shëndetit mendor. Pasi arriti moshën madhore, ai u largua nga qendra për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe iu nënshtrua një sërë vlerësimesh shëndetësore, për t'u vendosur në një institucion të specializuar. Pas një sërë refuzimesh nga institucione të ndryshme, zoti Câmpeanu u pranua të qëndronte në një qendër të kujdesit shëndetësor dhe social, e cila vlerësoi se ai kishte një gjendje të degraduar të shëndetit mendor



dhe fizik, se nuk mernte mjekim të përshtatshëm dhe se ishte i keq ushqyer. Disa ditë më pas, zoti Câmpeanu u shtrua në një spital psikiatrik, pasi kishte shfaqur sjellje agresive. Ndërkohë, spitali në të cilin u shtrua kishte deklaruar se nuk i kishte mjetet e nevojshme për pacientët e sëmurë me HIV. Gjatë qëndrimit në spital, ai u vizitua nga një ekip monitorues i QBJ-së, i cili raportoi se zoti Câmpeanu u gjet i vetëm në një dhomë pa ngrohje, pa kushte të përshtatshme fjetjeje dhe me veshje të pamjaftueshme për të përballuar të ftohtin. Megjithatë ai nuk mund të përdorte tualetin i vetëm, personeli i spitalit refuzonte ta ndihmonte, nga frika se mos u transmetonte virusin HIV. Gjatë qëndrimit në spital, ai nuk pranonte të merrte ushqim dhe ilaçe, duke u trajtuar kështu vetëm me glukozë përmes serumeve. Zoti Câmpeanu ndërroi jetë.

Ekipi monitorues i QBJ-së arriti në përfundimin se personeli mjekësor i spitalit nuk kishte mundur t'i ofronte zotit Câmpeanu trajtimin dhe kujdesin bazë. Në bazë të raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) gjatë dimrit të viteve 2003 dhe 2004, në të njëjtin spital psikiatrik, ndërroan jetë në rrethana të dyshimta rreth 109 pacientë nga shkaqe të tilla si arrest kardiak, infarkt i miokarditis dhe bronkopneumoni. Ndërkohë, moshë mesatare e pacientëve që ndërroan jetë ishte më e ulët se 56 vjeç. KPT-ja vlerësoi se pacientët nuk kishin marrë trajtim të kujdesëshëm mjekësor; spitali kishte mungesa në burime njerëzore dhe materiale, si dhe mangësi në cilësinë dhe sasinë e ushqimit dhe të ngrohjes së nevojshme. Pas rrëzimit të padive të paraqitura prej saj në emër të zotit Câmpeanu në gjykatat e brendshme, QBJ-ja iu drejtua GJEDNJ-së për shkelje të neneve 2, 3 dhe 13 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

**130.** Gjykata thekson se fjalia e parë e nenit 2, par. 1, të Konventës i detyron shtetet anëtare që jo vetëm të mos marrin jetën e individëve në mënyrë "të qëllimshme", por edhe të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e njerëzve që ndodhen nën juridiksionin e tyre (shih *L.C.B k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, par. 36, GJEDNJ, 1998-III).

Detyrimet pozitive, të cilat rrjedhin nga neni 2, duhet të interpretohen si të vlefshme në kontekstin e çdo lloj veprimtarie, publike ose jo, e cila mund të vërë në rrezik të drejtën e jetës. Kjo vlen edhe për fushën e shëndetësisë, për sa u përket veprimeve ose mosveprimeve të profesionistëve të shëndetësisë (shih *Dodov*, cituar më lart, par. 70, 79-83 e 87, dhe *Vo. k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 53924/00, par. 89-90, GJEDNJ, 2004VII, bashkë me referenca të tjera), ku **shtetet duhet të hartojnë një kornizë ligjore që u dikton spitaleve, qofshin këto publike ose private, marrjen e masave të posaçme për të siguruar mbrojtjen e jetës së të sëmurëve të tyre** (shih *Calvelli e Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 49, GJEDNJ, 2002I). Ky detyrim zbatohet veçanërisht në rastet e mëposhtme: kur aftësia e të sëmurëve për t'u kujdesur për vetveten është e kufizuar (shih *Dodov*, i cituar më lart, par. 81); në kontekstin e administrimit të veprimtarive të rrezikshme (shih *Öneryıldız k. Turqisë* [DhM], nr. 48939/99, par. 71, GJEDNJ, 2004XII); ndaj autoriteteve shkollore, të cilat e kanë për detyrë mbrojtjen e shëndetit e të mirëqenies së nxënësve që ndodhen nën kontrollin e tyre ekskluziv dhe, sidomos të fëmijëve në moshë të vogël, të cilët janë

veçanërisht të brishtë (shih *İlbeyi Kemaloğlu e Meriye Kemaloğlu k. Turqisë*, nr. 19986/06, par. 35, 10 prill 2012); dhe po ashtu, në kuadrin e ndihmës dhe të kujdesit mjekësor për fëmijët në moshë të njomë, të vendosur në institucione publike (shih *Nencheva e të tjerë*, i cituar më lart, par. 105-116).

Në mënyrë që të ekzistojë një detyrim i tillë pozitiv, duhet të vërtetohet se autoritetet kanë pasur ose duhej të kishin pasur dijeni, në bazë të rrethanave, që viktimat ndodhej nën kërcënim real dhe të pashmangshëm nga veprimet kriminale të një pale të tretë (shih *Nencheva dhe të tjerë*, cituar më lart, par. 108) dhe se autoritetet nuk i kishin marrë masat, të cilat siç mund të çmohet në mënyrë të arsyeshme, do ta kishin shmangur pa dyshim atë rrezik (shih *A. dhe të tjerë k. Turqisë*, nr. 30015/96, par. 44-45, 27 korrik 2004).

**131.** Duke pasur parasysh rëndësinë e mbrojtjes që ofron neni 2 i Konventës, Gjykata duhet t'i shqyrtojë në mënyrë tejet të vëmendshme rastet e vdekjeve, duke analizuar jo vetëm veprimet e nëpunësve të shtetit, por edhe të gjitha rrethanat e tjera të çështjes. Personat të cilëve u është hequr liria ndodhen në një situatë të brishtë dhe autoritetet kanë detyrimin që t'i mbrojnë. Kur autoritetet vendosin t'i heqin lirinë një personi me aftësi të kufizuara, duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë, që kushtet e heqjes së lirisë t'u përgjigjen nevojave specifike të tij, që rrjedhin nga aftësia e kufizuar (shih *Jasinskis k. Letonisë*, nr. 45744/08, par. 59, 21 dhjetor 2010, bashkë me referenca të tjera). [...] **Kur një individ, në momentin e heqjes së lirisë, ndodhet në gjendje të mirë shëndetësore dhe më pas vdes, shteti ka detyrimin që të japë një**

**shpjegim të mjaftueshëm e bindës për rrethanat që kanë çuar në vdekjen e personit** (shih *Carabulea k. Rumanisë*, nr. 45661/99, par. 108, 13 korrik 2010) dhe të paraqesë prova të tilla që vërtetojnë kujdesin e treguar, veçanërisht kur pretendimet mbështeten me raporte mjekësore (shih *Selmouni k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 25803/94, par. 87, GJEDNJ, 1999V, dhe *Abdülismet Yaman k. Turqisë*, nr. 32446/96, par. 43, 2 nëntor 2004). Për të vlerësuar provueshmërinë, Gjykata i përmbahet standardit të provës "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Një provë e tillë mund të rezultojë gjithsesi nga një sërë treguesish ose prezumimesh që nuk janë hedhur poshtë e që kanë peshë, qartësi e bashkëpërkim të mjaftueshëm (shih *Orhan k. Turqisë*, nr. 25656/94, par. 264, 18 qershor 2002, dhe *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 161).

**132.** Në lidhje me detyrimin për të mbrojtur të drejtën e jetës, shteti duhet që jo vetëm të marrë masa të arsyeshme, të cilat garantojnë sigurinë e individëve në vende publike, por edhe të sigurojë se kanë një sistem gjyqësor efikas e të pavarur, që ofron rrugë ligjore, të cilat mundësojnë që brenda një afati të shkurtër, në raste plagosje të rëndë ose vdekjeje, të vërtetojë faktet, të vërë përpara përgjegjësisë personat përgjegjës dhe t'u japë viktimave një zhdëmtim të përshtatshëm (shih *Dodov*, cituar më lart, par. 83). [...]

**133.** Gjithashtu, juridiksionet kombëtare duhet të kujdesen që të mos lënë pa ndëshkuar cenimet e jetës së individëve. Kjo është e domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut dhe për të siguruar përkrahjen e tij për shtetin e së drejtës, si edhe për të parandaluar çdo hije tolerance ndaj veprimeve të paligjshme (shih *mutatis mutandis, Nikolova dhe Velitchkova k. Bullgarisë*, nr. 7888/03, par. 57, 20 dhjetor 2007). Pra, detyra e Gjykatës është që të verifikojë nëse dhe në çfarë mase juridiksionet e brendshme e kanë bërë shqyrtimin e përpiktë që kërkon neni 2 i Konventës (Öneryıldız, cituar më lart, par. 96).

**135.** Gjykata vëren se zotit Câmpeanu nuk iu caktua asnjëherë ndonjë përfaqësues apo kujdestar i përkohshëm. Sipas autoriteteve, ai kishte zotësi të plotë për të vepruar, pavarësisht se sa serioze ishte aftësia e kufizuar mendore e tij [...]. Gjykata thekson se mënyra se si autoritetet mjekësore e kanë administruar rastin e zotit Câmpeanu, ka shpërfillur kërkesat e Ligjit për Shëndetin Mendor [...]; në fakt, të riut nuk i është marrë pëlqimi, pasi kishte mbushur moshën 18 vjeç, për transferimet e tij të njëpasnjëshme nga një strukturë mjekësore në tjetrën; pacienti as ishte informuar, as ishte

pyetur lidhur me mjekimet që i jepeshin dhe, po ashtu, atij nuk i është bërë e ditur mundësia për t'i kundërshtuar masat e sipërpërmendura.

**137.** është transferuar nga një strukturë te tjetra, pa diagnozën e pa ndjekjen e duhur dhe në shpërfillje të plotë të gjendjes së tij shëndetësore dhe të nevojave të tij mjekësore [...].

139. Gjykata u referohet përfundimeve të raportit mjekësor të hartuar prej ekspertit të ngarkuar nga QBJ-ja. Kjo ekspertizë kishte konstatuar dokumente mjekësore "sipërfaqësore dhe jo cilësore" për gjendjen shëndetësore të zotit Câmpeanu [...], duke arritur në përfundimin se vdekja e zotit Câmpeanu në institucionin mjekësor ishte rezultati i një "gabimi të rëndë mjekësor".

**141.** Duke e përgjithësuar situatën personale të zotit Câmpeanu në një kontekst më të gjerë, Gjykata vëren se në kohën kur ka ndodhur ngjarja, ishin sinjalizuar ndërkohë disa dhjetëra vdekje të ndodhura në të njëjtin institucion, siç e vinte në dukje raporti i KPT-së i vitit 2004.

**143.** Gjykata është e mendimit se autoritetet shtetërore kanë reaguar në mënyrë të papërshtatshme ndaj situatës së vështirë që mbizotëronte në atë kohë në spitalin psikiatrik, megjithatë ishin të vetëdijshme për mungesën e kushteve materiale, si edhe mungesën e personelit dhe pajisjeve mjekësore, sidomos të barnave. Në këto kushte, GJEDNJ-ja vlerëson se, duke e vendosur zotin Câmpeanu në spitalin psikiatrik, pa marrë në konsideratë gjendjen e tij të brishtë, autoritetet kombëtare e kanë vënë në mënyrë të paarsyeshme jetën e tij në rrezik. Gjykata çmon se mospërbushja e vazhdueshme e detyrave nga personeli mjekësor ka përbërë një faktor tjetër përcaktues në vdekjen e parakohshme të të riut.

**144.** Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se autoritetet shtetërore nuk i kanë siguruar zotit Câmpeanu nivelin e kërkuar të mbrojtjes së jetës. Kështu, ata nuk i kanë përbushur kërkesat materiale të nenit 2 të Konventës.

**145.** Gjykata vëren më tej se autoritetet jo vetëm që nuk u janë përgjigjur nevojave mjekësore më thelbësore të zotit Câmpeanu kur ai ishte gjallë, por nuk kanë sqaruar as rrethanat e vdekjes së tij, dhe sidomos nuk kanë identifikuar personat përgjegjës.

**146.** Përmes raporteve të ndryshme të autoriteteve kombëtare u vunë në

dukje disa parregullsi procedurale, veçanërisht moskryerja, në kundërshtim me dispozitat e së drejtës së brendshme, të një autopsie, menjëherë pas vdekjes, së zotit Câmpeanu dhe mungesa e një hetimi efektiv lidhur me metodën terapeutike të zbatuar ndaj të riut. [...]

**147.** Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata vlerëson se autoritetet nuk ia kanë nënshtruar rastin e zotit Câmpeanu shqyrtimit të kujdesshëm të kërkuar nga neni 2 i Konventës, duke mos kryer kështu një hetim efektiv për rrethanat e vdekjes së tij. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës edhe në aspektin procedural të tij.

#### Mungesa e mjetit efektiv

**148.** Neni 13 i Konventës garanton që në të drejtën e brendshme të ekzistojë një mjet ankimi, i cili bën të mundur vënien në vend brenda shtetit të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konvente. Për pasojë, kjo dispozitë kërkon patjetër që të ketë një mjet ankimi të brendshëm, i cili i jep instancës kombëtare kompetente fuqi për ta shqyrtuar përmbajtjen e një "ankese të pranueshme" mbi bazën e Konventës dhe për të ofruar zhdëmtimin e duhur, ndonëse shtetet kontraktuese gëzojnë njëfarë hapësire vlerësimi, për sa i përket mënyrës se si duhet t'u përmbahen detyrimeve që u cakton kjo dispozitë. [...] Detyrimi që rrjedh nga neni 13 ndryshon në varësi të natyrës së ankesës që kërkuesi ka paraqitur mbi bazën e Konventës. Megjithatë, mjeti i ankimit i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë "efektiv", si praktikisht ashtu edhe juridikisht, veçanërisht në kuptimin që ushtrimi i tij nuk duhet të pengohet në mënyrë të papërligjshur nga veprime ose mosveprime të autoriteteve të shtetit të paditur (*Paul dhe Audrey Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, par. 9697, GJEDNJ, 2002II).

**149.** Kur bëhet fjalë për një të drejtë me rëndësi kaq themelore sa e drejta e jetës, apo ndalimi i torturës ose i trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, neni 13 kërkon, përveç pagesës së një zhdëmtimi aty ku është rasti, edhe kryerjen e hetimeve të thelluara dhe efektive të tilla, që të çojnë në identifikimin e dënimit e personave përgjegjës dhe, të cilat, të përfshijnë mundësi reale për ankuesin të kërkojë proces hetimor [...]. Gjykata është e mendimit se "autoriteti" për të cilin bën fjalë neni 13 mund të mos jetë medoemos, në të gjitha rastet, një institucion gjyqësor në kuptimin e ngushtë. Por, kompetencat dhe garancitë procedurale që ai paraqet, duhet të merren parasysh për të përcaktuar, nëse ankimi është efektiv (*Klass dhe të tjerë*, i cituar më lart, par. 67). Sipas Gjykatës, mjetet gjyqësore të ankimit i ofrojnë viktimës dhe familjes së tij garanci

të forta pavarësie, qasje në procedurë dhe zbatim të vendimeve për dëmshpërblim, në përputhje me kërkesat e nenit 13 (Zoti Câmpeanu e të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, cituar më lart, par. 110).

**151.** Në çështjen konkrete, objekt gjykimi, Gjykata ka përcaktuar tashmë se brishtësia e zotit Câmpeanu, e marrë së bashku me faktin që autoritetet nuk e kanë zbatuar legjislacionin në fuqi dhe nuk i kanë dhënë të interesuarit një ndihmë të përshtatshme juridike, ishin faktorë të cilët e përforconin legjitimitetin juridik të vendimit të saj për t'i njohur QBJ-së, si përjashtim, cilësinë për të vepruar në emër të zotit Câmpeanu. Pa ndërhyrjen e QBJ-së, rasti i zotit Câmpeanu nuk do të ishte sjellë kurrë në vëmendjen e autoriteteve, qofshin ato shtetërore apo ndërkombëtare [...].

**152.** [...] Gjykata çmon se mundësitë e paraqitura nga Qeveria, për të dëshmuar ekzistencën e ankimeve të përshtatshme në dritën e nenit 13, janë të pamjaftueshme, ose jo efektive, duke pasur parasysh ndikimin e tyre të kufizuar dhe mungesën e garancive procedurale.

**153.** Duke pasur parasysh konsideratat e mësipërme, Gjykata çmon se shteti i paditur nuk ka krijuar ndonjë mekanizëm të tillë që t'u ofrojë dëmshpërblim personave të sëmurë me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët e quajnë veten viktimë në dritën e nenit 2 të Konventës. Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të nenit 13, së bashku me nenin 2 të Konventës, për arsye se shteti nuk ka garantuar dhe vënë në zbatim një kuadër juridik, që të kishte mundësuar shqyrtimin nga një autoritet i pavarur të pretendimeve për shkelje të së drejtës së jetës të zotit Câmpeanu.

[...]

#### Shpërblimi i drejtë

**166.** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljeve të konstatuara dhe kompleksitetin e çështjes, Gjykata i cakton një dëmshpërblim prej 10,000 euro QBJ-së dhe 25,000 euro studios ligjore *Interights*.

“

**Nencheva dhe të Tjerët k. Bullgarisë, 18.06.2013, Nr. 48609/06**

*Nëse vdekja e pesëmbëdhjetë fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, që ishin nën përkujdesjen e shtetit, përbënte shkelje të së drejtës së jetës nga shteti i paditur.*

”

**Faktet** – Nëntë kërkuesit janë prindër të shtatë nga pesëmbëdhjetë fëmijët dhe të rinjtë e moshës nën 22 vjeç, të cilët humbën jetën gjatë dimrit të viteve 1996/97 në një shtëpi përkujdesjeje për fëmijë me probleme të rënda të shëndetit mendor në Dzhurkovo të Bullgarisë. Përpara GJEDNJ-së, kërkuesit u ankuan se shteti kishte mundur t'i përmbushte detyrimet të tij pozitive për të mbrojtur jetën e personave që kishte nën përkujdesje, duke u cenuar atyre jetën dhe shëndetin dhe duke shkelur kështu, nenin 2 të Konventës. Gjithashtu, kërkuesit ngritën pretendimin, se shteti bullgar nuk kishte kryer hetimet e duhura për të identifikuar personat përgjegjës për këtë ngjarje.

#### Vlerësimi i Gjykatës

##### Parimet e Përgjithshme

**15.** Gjykata kujton se fjalia e parë e nenit 2, që është një nga nenet thelbësore të Konventës pasi i kushtohet një rres prej vlerave themelore të shoqërive demokratike që formojnë Këshillin e Evropës, u vendos Shteteve detyrimin që jo vetëm të mos shkaktojnë vdekje me «qëllim», por edhe të marrin masat e nevojshme për mbrojtjen e jetës së personave nën juridiksionin e tyre (*McCann dhe të Tjerët*, par. 147, L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998, par. 36, Përmbledhjet 1998III, *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 48, GJEDNJ, 2002I, *Vo k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 53924/00, par. 88, GJEDNJ 2004VIII, dhe *Dodov k. Bullgarisë*, nr. 59548/00, par. 79, 17 janar 2008).

**16.** Gjykata ka pasur rastin t'i shqyrtojë këto detyrime, ndër të tjera, në fushën e veprimtarive të rrezikshme (Öneryıldız, Iliya Petrov k. Bullgarisë, nr. 19202/03, 24 prill 2012, *Kolyadenko dhe të Tjerët k. Rosisë*, nr. 17423/05, 20534/05, 20678/05, 23263/05, 24283/05 dhe 35673/05, 28 shkurt 2012), e shëndetit publik (*Calvelli dhe Ciglio*), e rrezikut nga fatkeqësitë (*Boudaieva dhe të Tjerët k. Rosisë*, nr. 15339/02, 21166/02, 20058/02, 11673/02 e 15343/02, *Murillo Saldias dhe të Tjerët k. Spanjës* nr. 76973/01, 28 nëntor 2006), të sistemit social (*Dodov*), dhe e veprimtarive të tjera, për të cilat autoritetet shtetërore mbajnë përgjegjësi, si për shembull, siguria e vendeve publike, për të shmangur lëndimin apo vdekjen e njerëzve që ndodhen aty (*Ciechońska k. Polonisë*, nr. 19776/04, par. 67, 14 qershor 2011). **Detyrimi i Shtetit për**

**të mbrojtur jetën është konsideruar se përfshin edhe detyrimin për të garantuar shërbimin e ndihmës së shpejtë, kur autoritetet informohen se jeta apo shëndeti i një personi është në rrezik për shkak të një aksidenti** (*Furdik k. Sllovakisë*, nr. 42994/05, 2 dhjetor 2008). Kjo listë nuk është shteruese. Kështu, Gjykata ka vërejtur se detyrimi për mbrojtjen e jetës duhet të interpretohet si i vlefshëm në kontekstin e të gjitha veprimtarive, publike ose jo, që kanë të ngjarë të venë në rrezik të drejtën e jetës (Öneryıldız, par. 71). Gjykata ka thënë gjithashtu se **ky detyrim zbatohet edhe ndaj autoriteteve në fushën e mësimdhënies shkollore**, të cilët marrin përsipër detyrimin për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së nxënësve, e më saktë të fëmijëve të vegjël, të cilët janë veçanërisht të brishtë dhe që ndodhen në kontrollin ekskluziv të autoriteteve (*Ilbeyi Kemaloğlu dhe Meriye Kemaloğlu k. Turqisë*, nr. 19986/06, par. 35, 10 prill 2012).

**17.** Detyrimet sipas nenit 2 përfshijnë detyrimin parësor që shteti ka për të mbrojtur jetën, duke miratuar një legjislacion penal konkret për sprapsjen e veprimeve kundër jetës së individëve (*Boudaieva e të Tjerët*, par. 129).

**18.** Gjykata vlerëson se **neni 2, në disa autoriteteve detyrimin pozitiv për marrjen e masa parandaluese praktike për të mbrojtur një individ nga një tjetër, ose në disa rrethana të veçanta, për ta mbrojtur nga vetja**. Megjithatë, ky detyrim duhet interpretuar në një mënyrë të tillë, që autoritetet të mos u vendoset një barrë e padurueshme ose e tepërt, duke pasur parasysh veçanërisht paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjeve operacionale, që

bëhen sipas përparësive dhe burimeve.[...]. **Duke qenë se ky është një detyrim pozitiv, duhet të provohet se autoritetet kanë pasur dijeni ose duhej të kishin pasur dijeni në momentin që jeta e individit është kërcënuar në mënyrë reale dhe të menjëhershme dhe se ata nuk kanë marrë në kuadër të kompetencave të tyre, masat e arsyeshme që pa dyshim do ta kishin shmangur këtë rrezik** (shih *Van Colle k. Mbretërisë së Bashkuar* nr. 7678/09, par. 88, 13 nëntor 2012, *A. dhe të Tjerët k. Turqisë*, nr. 30015/96, par. 44-45, 27 korrik 2004, dhe *Ilbeyi Kemaloğlu dhe Meriye Kemaloğlu*, par. 36).

**19.** Detyrimet sipas nenit 2 nuk mbarojnë këtu. Në rastin e humbjes së jetëve njerëzore në rrethana për të cilat shteti mban përgjegjësi, kjo dispozitë vendos ndaj shtetit detyrimin për të garantuar, përmes të gjitha mjeteve që ka në dispozicion – gjyqësore e të tjera – dhe për të bërë të mundur që kuadri legjislativ e administrativ i hartuar për të mbrojtur të drejtën e jetës të zbatohet ashtu si duhet, dhe për të garantuar shtypjen dhe sanksionimin e të gjitha shkeljeve të kësaj të drejte (*Boudaieva dhe të Tjerët*, par. 138).

**20.** Gjykata ka deklaruar në mënyrë të përsëritur se një sistem gjyqësor efikas, si ai që kërkon neni 2, mund të përfshijë dhe, në disa rrethana, duhet të përfshijë, një mekanizëm penal. Nëse cenimi i të drejtës së jetës, ose integritetit fizik nuk është i qëllimshëm, detyrimi pozitiv sipas nenit 2 për një sistem gjyqësor efikas nuk kërkon domosdoshmëri në të gjitha rastet një mjet të tipit penal. Në kontekstin specifik të neglizhencës mjekësore « një detyrim i tillë mund të përmbushet edhe kur sistemi gjyqësor u ofron të interesuarve një mjet vetëm përpara gjykatave civile ose, bashkë me to, edhe një mjet para gjykatave penale, me synimin që të përcaktohet përgjegjësia e mjekëve për një çështje dhe, nëse është rasti, të sigurohet zbatimi i të gjitha sanksioneve civile të përshtatshme, si dëmshpërblimi dhe botimi i vendimit. Mund të parashikohen edhe masa disiplinore (*Vo*, par. 90, *Calvelli dhe Ciglio*, par. 51, *Mastromatteo k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 37703/9, par. 90, 94, 95, dhe *Öneryıldız*, par. 92). Në disa raste të vdekjeve nga neglizhenca, Gjykata ka vendosur se procedurat administrative janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet pozitive të autoriteteve në lëmin e nenit 2 (*Murillo Saldias dhe të Tjerët*).

**21.** Në fushën e shëndetit publik, Shteti duhet të vendosë një kuadër rregullues që spitalet, qoftë publike apo private, të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e jetës së të sëmurëve. Ata duhet që njëkohësisht të ngrenë një sistem gjyqësor

efikas dhe të pavarur, i cili të mund të përcaktojë shkaqet e vdekjes së një individi që ndodhet nën përgjegjësinë e personelit mjekësor si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat dhe, sipas rasti, t'i detyrojë ata të përgjigjen për veprimet e tyre (*Calvelli dhe Ciglio*, par. 49). Detyrimi për të rregulluar veprimtarinë e institucioneve mjekësore vlen edhe për pjesëtarët e personelit mjekësor, në masën që veprimet e tyre mund të venë në rrezik jetën e pacientëve, në veçanti, kur aftësia e këtyre të fundit për t'u kujdesur për veten është e kufizuar (*Dodov*, par. 81).

**22.** Gjykata ka vlerësuar se neni 2 përmban detyrimin e kryerjes së një hetimi zyrtar nga autoritetet në lëmin e veprimtarive të rrezikshme kur vdekja ka ndodhur pas ngjarjeve që kanë qenë nën përgjegjësinë e pushtetit publik. Në fakt, shteti është i vetmi që ka njohuritë e mjaftueshme dhe të nevojshme për të identifikuar dhe përcaktuar fenomenet komplekse që kanë qenë zanafilla e këtyre incidenteve (*Öneryıldız*, par. 93). Qëllimi themelor i këtyre hetimeve është të sigurojnë zbatimin e dispozitave të së drejtës së brendshme, të cilat mbrojnë të drejtën e jetës dhe, kur ka pretendime për sjelljen e agjentëve që veprojnë nën autoritetin e shtetit, të sigurojnë që ata të përgjigjen për vdekjet që kanë ndodhur nën përgjegjësinë e tyre (*Mastromatteo*, par. 89, dhe *Paul dhe Audrey Edwards*, par. 69 dhe 71).

[...]

**23.** Gjykata ka pohuar gjithashtu se një sistem gjyqësor efikas, siç e kërkon neni 2, mund të përfshijë dhe, në disa rrethana duhet të përfshijë, një mekanizëm zbatues penal. Ajo ka nënvizuar se ky nuk është një detyrim rezultati, por detyrim mjeti, në kuptimin që është procesi në vetvete dhe jo rezultati i procesit, ai që është i rëndësishëm për të vlerësuar efektivitetin e hetimit të ngjarjeve nga autoritetet (*Shih mutatis mutandis, Nadrossov k. Rusisë*, nr. 9297/02, par. 38, 31 korrik 2008).

[...]

**24.** [J]uridiksionet shtetërore nuk duhet të asnjë rast të lënë pa dënuar sulmet e pajustificuara ndaj të drejtës së jetës. Kjo është e nevojshme për të ruajtur besimin e publikut dhe siguruar respektimin e shtetit të së drejtës, si edhe për të parandaluar shfaqjen e tolerancës ndaj akteve të paligjshme apo bashkëpunimin në kryerjen e tyre (shih *mutatis mutandis, Hugh Jordan k. Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 24746/94, par. 108, 136140). Detyra e Gjykatës është që të verifikojë, nëse dhe në çfarë mase, gjykatat e brendshme, para

se të arrijnë në një përfundim të caktuar, mund të thuhet se e kanë shqyrtuar çështjen në gjykim në mënyrë të kujdeshme, sipas kërkesave të nenit 2 të Konventës, në mënyrë që të mos pakësohet forca sprapse e sistemit gjyqësor dhe rëndësia e rolit që ai duhet të luajë në parandalimin e shkeljeve të së drejtës së jetës (*Öneryıldız*, par. 96, *Giuliani dhe Gaggio*, par. 306).

#### **Zbatimi i parimeve në çështjen në shqyrtim**

**25.** Fillimisht, Gjykata duhet të përcaktojë se cilat kanë qenë detyrimet e Shtetit në rrethanat e çështjes në shqyrtim.

**26.** Ajo vlerëson se, duke pasur parasysh pretendimet e kërkuarit se autoritetet nuk e përmbushur detyrimin e tyre për të mbrojtur të drejtën e jetës së fëmijëve të tyre, është thelbësore që Gjykata të bindet se autoritetet në fjalë duhet të kishin pasur dijeni që në fillim për ekzistencën e një rreziku real për jetën e këtyre fëmijëve dhe se ata nuk kishin marrë masa brenda kufijve të kompetencave të tyre, që nga një këndvështrim i arsyeshëm, do ta kishin shmangur rrezikun, pa asnjë mëdyshje. Për këtë qëllim, shumë elementë janë përcaktues për vlerësimin e përgjegjësive së autoriteteve shtetërore.

**27.** Palët nuk kundërshtojnë që autoritetet ishin të angazhuar në kujdesin ndaj fëmijëve të tyre, për shkak se i kishin vendosur ata në institucionin e Dzhurkovos. Bëhet fjalë për persona në gjendje të brishtë – fëmijë dhe të rinj me moshë nën 22 vjeç, me shqetësime mendore dhe fizike të rënda, të cilët ose ishin braktisur nga prindërit, ose ishin vendosur aty nga prindërit. Pra, të gjithë ata i ishin besuar kujdesit shtetëror në një institucion publik të specializuar dhe gjendeshin [...] nën kontrollin ekskluziv të autoriteteve.

**28.** Gjykata vëren gjithashtu, se Qeveria nuk kundërshton seriozitetin e mangësive që karakterizojnë kushtet e jetesës në këtë institucion gjatë gjithë periudhës në shqyrtim. Fëmijët e kërkuarve u ishin nënshtruar kushteve shumë të këqija të jetesës: atyre u mungonin ushqimi, barnat mjekësore, veshjet; shtrojat për shtretërit ishin në sasi të pakta dhe ata jetonin në kthina që ngroheshin në mënyrë të pamjaftueshme gjatë dimrit. Kushte të tilla jetese i vendosnin në rrezik në mënyrë të paevitueshme jetët e këtyre fëmijëve, që vuanin nga sëmundje të cilat kërkonin përkujdesje specifike e të vazhdueshme.

**29.** Gjykata vëren më tej se në kushtet e një dimri të ashpër dhe një krize të rëndë ekonomike, informacioni konkret për rreziqet që u

kanoseshin fëmijëve për shkak të ngrohjes, ushqimit dhe barnave mjekësore të pamjaftueshme ishte bërë i njohur që në 10 shtator 1996. Në fakt, sipas elementëve në dosje, që prej asaj date, drejtoresha e institucionit, e mbështetur nga kryetari i bashkisë, kish gjykuar se situata i ekspozonte fëmijët ndaj rreziqeve të rënda dhe kish njoftuar autoritetet, duke u kërkuar atyre ndihmën e duhur. Kështu, duket se që në muajin shtator [...], nivelet më të larta të Ministrisë së Punës e Politikave Sociale dhe institucionet e tjera publike ishin në dijeni të rreziqeve ndaj shëndetit dhe jetës së fëmijëve në strehën e Dzhurkovos [...]. Gjykata e konsideron si të provuar se autoritetet publike në shumë nivele, kishin dijeni të sakta për rreziqet reale ndaj shëndetit të fëmijëve në institucionin e Dzhurkovos. Për më tepër, në atë periudhë, shkalla e vdekjeve në institucion ishte shumë më e lartë se zakonisht.

**30.** Më tej, duhet vërejtur - dhe ky është një element thelbësor në këtë çështje - se ndodhitë tragjike nuk ishin të papritura e të paparashikueshme, siç është rasti kur ndodh një fatkeqësi natyrore për të cilën shteti nuk ka mundësi të marrë masa për ta përballuar atë [...]. Në fakt, pesëmbëdhjetë fëmijë dhe të rinj, fëmijë të kërkuarve, kanë vdekur ndërmjet 15 dhjetorit 1996 dhe 14 marsit 1997, pra gjatë një periudhe tre mujore. Duhej që ky fakt, minimumi, të ishte parë si i dyshimtë dhe të kërkohej një shpjegim (*Shih mutatis mutandis, Salman k. Turqisë* [DM], nr. 21986/93, par. 105, *Slimani k. Francës*, nr. 57671/00, par. 30 dhe 47, *Pankov k. Bullgarisë*, nr. 12773/03, par. 50, 7 tetor 2010). Edhe pse, siç rezultoi nga raportet e ekspertizës mjekësore që u paraqitën para gjykatave të brendshme, në vdekjet individuale kishin ndikuar faktorë të ndryshëm, megjithatë, rrethanat e jashtëzakonshme të kësaj çështjeje dallojnë nga situata të tjera, ku mund të pranohet se një rast vdekje i izoluar në një institucion shëndetësor mund të rezultojë për shkaqe që nuk mund t'u atribuohen autoriteteve mjekësore, ose nga një gabim mjekësor, pa venë në diskutim detyrimin e shtetit për të mbrojtur jetën (*Powell k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45305/99; *Dodov*, par. 82).

**31.** Kështu, Gjykata vlerëson se, edhe pse çështja në shqyrtim nuk lidhen me veprimtari të rrezikshme, ajo paraqet një situatë rreziku për jetën e personave të brishtë të vendosur nën kujdesin shtetëror, për të cilën autoritetet kishin pasur plotësisht dijeni dhe e cila mund të përshkruhej si një dramë në nivel kombëtar. Prandaj, kjo çështje kishte të bënte jo vetëm kushtet individuale të kërkuarve, por edhe me vetë interesin publik. Po ashtu, rrethanat e denoncuarat e tejkalojnë rastin e

një neglizhence të profesionistëve të shëndetësisë dhe Gjykata është e mendimit se, duke pasur parasysh tërësinë e elementëve të shfaqura dhe mbrojtjen e interesit publik, **autoritetet shtetërore kishin detyrimin të merrnin urgjentisht masat e duhura** për të mbrojtur jetën e fëmijëve, pavarësisht veprimeve të prindërve të tyre dhe **të jepnin një shpjegim për shkaqet e vdekjeve dhe për përgjegjësitë përkatëse përmes një hetimi ex-officio.**

**32.** Lidhur me detyrimin e autoriteteve për të marrë masa mbrojtëse, elementë të shumtë në dosje, si për shembull mungesa e reagimit për shumë muaj ndaj paralajmërimeve të drejtoreshës për gjendjen në institucion, ose mungesa e një ndihme mjekësore të shpejtë dhe të duhur, tregojnë se autoritetet nuk kishin marrë masa të shpejta, konkrete dhe të mjaftueshme për të parandaluar vdekjet e denoncuar, në një kohë kur ata kishin njohuri të saktë për rreziqet reale dhe të menjëhershme për jetën e personave në fjalë [...]

**33.** Lidhur me detyrimin e shtetit të paditur për të nisur një hetim zyrtar efektiv për rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se, në kundërshtim me sugjerimin e qeverisë se padia civile u lejonte kërkuesve që të kërkonin dhe të përfitonin një dëmshpërblim individual, kjo nuk është një përgjigje e mjaftueshme sipas nenit 2 të Konventës [...]. Në fakt, Gjykata konstaton se faktet e çështjes flasin për një situatë të jashtëzakonshme dhe jo për një rast të zakonshëm neglizhence. Prandaj, pavarësisht mundësisë që kishin kërkuesit, në kuadrin e procesit civil, për të kërkuar dhe marrë dëmshpërblim, për sa kohë që ky proces varej vetëm nga iniciativa e viktimave, Gjykata vlerëson se

kjo rrugë nuk përmbush atë që i kërkohet shtetit në bazë të nenit 2, i cili u vendos autoriteteve bullgare detyrimin për të kryer një hetim *ex-officio*.

[...]

**34.** Duket se hetimi i çështjes nuk ka pasur si qëllim që, nga njëra anë, të hidhte dritë mbi të gjitha rrethanat e ngjarjeve tragjike të ndodhura, të përcaktonte të gjithë faktorët që kishin kontribuar në rastet e vdekjeve dhe të shqyrtonte rëndësinë përkatëse të faktorëve natyrorë dhe, nga ana tjetër, të nxirrte në pah, mungesën e një reagimi të shpejtë dhe të përshtatshëm ndaj rreziqeve për shëndetin dhe jetën e fëmijëve. Një analizë e tillë, e realizuar në mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme do të kishte bërë të mundur identifikimin e personave konkretë që ishin përgjegjës për të parandaluar të tilla ngjarje në të ardhmen.

Përfundime

**35.** Si përfundim, [...] Gjykata mendon se padia civile për dëmshpërblim, në dispozicion të kërkuesve, nuk ishte e mjaftueshme në rrethanat e jashtëzakonshme të çështjes në shqyrtim për të përmbushur detyrimet e shtetit sipas nenit 2 të Konventës [...]

**36.** Më tej, Gjykata vlerëson se, në rrethanat e veçanta të kësaj çështje, Shteti i paditur nuk e ka përmbushur detyrimin e tij për mbrojtjen e jetës së fëmijëve, që ishin nën përgjegjësinë e tij dhe nuk ka përmbushur detyrimin për të hedhur dritë mbi faktet, përmes një mekanizmi të duhur procedural dhe nuk ka mbrojtur interesin publik, si rezultat i ngjarjeve veçanërisht tragjike në këtë çështje. Prandaj, ajo arrin në përfundimin se ka shkelje të nenit 2 të Konventës.

“

**Jasinskis k. Letonisë, 21.12.2010, Nr. 45744/08**

*Nëse humbja e jetës së djalit të kërkuesit dhe moskryerja nga ana e autoriteteve e një hetimi efektiv për këtë ngjarje ka cenuar nenin 2, par. 1, të Konventës për të drejtën e jetës.*

”

**Faktet** - I biri i kërkuesit, i cili kishte pengesa në të folur dhe të dëgjuar, u rrëzua nga shkallët pasi ishte në gjendje të dehur. Ai pësoi dëmtime në kokë, duke humbur edhe ndërgjegjen për disa minuta. Pasi mbërritën në vendngjarje, forcat e policisë e shoqëruan të dëmtuarin në rajonin e policisë dhe megjithëse u vunë në dijeni për aftësitë e tij të kufizuara, ata nuk pritën mbërritjen e ambulancës. Polici në detyrë, megjithëse në fytyrën e viktimës vuri re një të gërvishur, vlerësoi se ekzaminimi mjekësor nuk ishte i nevojshëm, pasi i dëmtuari kishte vetëm nevojë të kthellohej

nga pija. I dëmtuari nuk kishte asnjë mundësi komunikimi me efektivat e policisë, pasi asnjëri prej tyre nuk e kuptonte gjuhën e shenjave. Për më tepër, atij nuk iu ofrua asnjë mjet alternativ komunikimi. Efektivat e policisë tentuan dy herë ta zgjonin nga gjumi të dëmtuarin dhe pas 14 orësh, thirrën ambulancën dhe e dërguan atë në spital. Djali humbi jetën disa orë më vonë. Autopsia vërtetoi se vdekja ishte shkaktuar nga dëmtime në kokë, të cilat rezultuan vdekjeprurëse. Kërkuesi paraqiti një ankesë kundër efektivit të policisë, që kishte qenë në detyrë, duke theksuar se trajtimi i të birit në rajonin e policisë kishte qenë i mangët; se ambulanca nuk ishte njoftuar në kohë dhe për më tepër, se ai nuk ishte informuar mbi gjendjen e të birit. Nga hetimet në të tri shkallët e ankimit rezultoi se efektivat e policisë kishte vepruar në përputhje me ligjin dhe rregulloren e zbatueshme në këtë rast. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Byroja e Sigurimit të Brendshëm. Kërkuesi iu drejtua GJEDNJ-së, duke pretenduar se humbja e jetës së djalit të tij dhe moskryerja nga autoritetet e një hetimi efektiv mbi këtë ngjarje përbënte shkelje të nenit 2, par. 1, të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Aspekti material

**58.** Gjykata thekson se fjalia e parë e nenit 2 të Konventës, e cila konsiderohet si një nga garancitë kryesore të saj dhe pasqyron një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike, anëtare të Këshillit të Evropës (shih ndër të tjera *McCann dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, par. 147, Seria A, nr. 324), i detyron shtetet anëtare jo vetëm të mos marrin jetën e shtetasve të tyre në mënyrë “të qëllimshme”, por edhe të marrin masat e nevojshme për të ruajtur jetën e shtetasve që ndodhen nën juridiksionin e tyre (shih *L.C.B k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, par. 36, GJEDNJ, 1998-III).

**59.** Për shkak të rëndësisë së nenit 2 të KEDNJ-së, Gjykata duhet t'i vlerësojë raste të tilla në mënyrë shumë të kujdesshme, duke marrë në konsideratë jo vetëm veprimet e ndërmarra nga agjentët shtetërore, por edhe të gjitha rrethanat e tjera. Personat e privuar nga liria ndodhen në një pozitë të brishtë dhe për këtë arsye, autoritetet shtetërore përkatëse kanë për detyrë t'i mbrojnë ata. Kur autoritetet shtetërore vendosin ndalimin e një personi me aftësi të kufizuara, ata duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të garantuar kushte të përshtatshme, në përputhje me nevojat e veçanta të personit të ndaluar (shih *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 30, GJEDNJ, 2001-VII, *Farbuths k. Letonisë* nr. 4672/02, par. 56, 2 dhjetor 2004). Për më tepër, GJEDNJ-ja është shprehur edhe më parë se shtetet anëtare kanë detyrë të marrin masa efektive për mbrojtjen e personave në gjendje të brishtë nga keqtrajtimi, të cilin autoritetet kanë pasur ose duhet të kishin pasur dijeni se po ndodhte (shih *Z. dhe të dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 29392/95, par. 73, GJEDNJ, 2001-V).

**60.** Detyrimi i autoriteteve për të dhënë shpjegime mbi personat e ndaluar është veçanërisht i domosdoshëm kur këta persona humbin jetën brenda vendeve të ndalimit (shih *Salman k. Turqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 21986/93, par. 99, GJEDNJ, 2000 VII). Për më tepër, autoritetet shtetërore kanë për detyrë të mbrojnë jetën e personave të cilëve u është kufizuar liria (shih ndër të tjera, *Naumenko k. Ukrainës*, nr. 42023/98, par. 112, 10 shkurt 2004, dhe *Dzienciak k. Polonisë*, nr. 77766/01, par. 91, 9 dhjetor 2008). **Në kontekstin e nenit 2, detyrimi për të mbrojtur jetën e personave të ndaluar, përfshin edhe detyrimin e autoriteteve për t'u dhënë atyre ndihmën e nevojshme mjekësore** (shih *Tais k. Francës*, nr. 39922/03, par. 98, 1 qershor 2006, dhe *Huyly k. Turqisë*, nr. 52955/99, par. 58, 16 nëntor 2006). Mosgarantimi i kujdesit shëndetësor të përshtatshëm sjell shkelje të Konventës (shih *Huyly*, cituar më lart, par. 58).

**61.** Gjykata vlerëson se çështja e parë për t'u zgjidhur është nëse efektivat e policisë kishin, ose duhet të kishin, dijeni për rrezikun që i kanosej shëndetit të djalit të kërkuesit (shih *mutatis mutandis*, *Keenan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, par. 93, GJEDNJ 2001III) dhe më pas të vlerësojë, nëse efektivat e policisë kishin treguar kujdesin e duhur për gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e kufizuar të të ndaluarit.

**62.** Duke mbajtur në vëmendje momentin e parë të takimit mes djalit të kërkuesit dhe policisë, Gjykata vëren se pasi kishin mbërritur në vendngjarje, policët ishin njoftuar se djali i kërkuesit kishte rënë nga shkallët dhe kishte humbur ndjenjat. Ata gjithashtu ishin vënë në dijeni të aftësive të tij të kufizuara. Megjithatë, ata nuk pritën ardhjen e ambulancës.

**63.** Pavarësisht se policët vërejtën se djali kishte një gërvishje në fytyrë, ata e vlerësuan të panevojshëm ekzaminimin mjekësor të tij [...].

**66.** Gjykata vlerëson se qeveria nuk ishte në gjendje të shpjegonte arsyen përse policët nuk e pritën ambulancën në vendngjarje dhe nuk kërkuar ekzaminimin e specializuar mjekësor të djalit të kërkuesit, megjithëse kishin dijeni për gjendjen shëndetësore dhe aftësitë e tij të kufizuara, duke shkelur kështu një standard posaçërisht të zbatueshëm nga Komiteti i Parandalimit të Torturës. **Duke marrë në konsideratë faktin se i biri i kërkuesit kishte pengesa në të folur dhe të dëgjuar, sipas Gjykatës, policët ishin të detyruar t'i ofronin atij të paktën një laps dhe letër për të komunikuar me ta.**

**67.** Duke marrë në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se shteti nuk arriti të përmbushte detyrën e tij për të ruajtur jetën e viktimës, duke mos i siguruar atij ndihmën e përshtatshme mjekësore, pasi policia kishte dijeni si për aksidentin që kishte pësuar i biri i kërkuesit, ashtu edhe për aftësitë e tij të kufizuara.

**68.** Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ka një shkelje të aspektit material të nenit 2, par. 1, të Konventës.

#### **Aspekti procedural**

**70.** [...] Në lidhje me procedurat e hetimit të kryeranga autoritetet shtetërore përkushtet e ndalimit të djalit të kërkuesit, **Gjykata thekson se detyrimi i shteteve anëtare për të mbrojtur jetën e shtetasve në bazë të nenit 2 të Konventës, të kuptuar bashkë me detyrimin e përgjithshëm të shteteve, në bazë të nenit 1 të Konventës “për t'i siguruar çdokujt brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë”, kërkon domosdoshmërisht ekzistencën e mënyrave efektive të hetimit zyrtar, në rastet kur një person ka humbur jetën, si pasojë e përdorimit të dhunës** (shih *mutatis mutandis*, *McCann dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, par. 161, Seria A, nr. 324, dhe *Kaya k. Turqisë*, 19 shkurt 1998, par. 105, Raportet 1998-I).

**72.** Gjykata, kohët e fundit, ka konstatuar se **në bazë të nenit 2 të Konventës, hetimi efektiv duhet të kryhet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme** (shih *Šilih k. Sllovenisë* [DHOMA E MADHE], nr. 71463/01, par. 159, 9 prill 2009). Megjithatë, duhet theksuar se ky detyrim mund të ndryshojë, [...] në varësi të situatës së veçantë që e ka shkaktuar atë (shih *Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 51, GJEDNJ, 2002I, dhe *Banks dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 21387/05, 6 shkurt 2007). *Qëllimi kryesor i një hetimi të tillë duhet të jetë zbatimi efektiv*

*i legjislacionit të brendshëm, i cili mbron jetën e shtetasve dhe, në rastet kur përfshihen organe apo agjentë shtetërorë, të sigurojë që ata të përgjigjen për vdekjet e personave që ndodhen nën përgjegjësinë e tyre.* (Shih *Anguelova k. Bullgarisë*, nr. 38361/97, par. 137, GJEDNJ, 2002IV).

**73.** Megjithatë, **Gjykata vëren se në rastin konkret, objekt gjykimi, vdekja nuk është shkaktuar si pasojë e dhunës ose ngjarjeve të tjera të ndodhura brenda institucionit shtetëror, kështu që standardi i theksuar më lart mund të zbatohet në një nivel më të ulët, por hetimi duhet domosdoshmërisht të kryhet nga autoritete të pavarura dhe të paanshme, për të garantuar një standard minimal efektiviteti** (shih *Mikayil Mammadov k. Azerbaixhanit*, nr. 4762/05, par. 102, 17 dhjetor 2009, dhe jurisprudencën e cituar aty): Gjykata thekson se ky nuk është një detyrim rezultati, por detyrim mjetesh (shih ndër të tjera *Paul dhe Audrey Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, par. 71, GJEDNJ, 2002II), dhe se neni 2 i Konventës nuk nënkupton të drejtën që të tjerët të ndiqen penalisht apo të dënohen për një vepër penale, ose nuk përmban një detyrim absolut që të gjitha ndjekjet penale të përfundojnë me një të dënuar, apo me një dënim të veçantë (shih *Öneryıldız k. Turqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 48939/99, par. 94 dhe 96, GJEDNJ, 2004XII). Megjithatë, Gjykata vëren se rastet **kur nga ana e autoriteteve është treguar neglizhencë, e cila shkon përtej një gabimi ose pakujdesie, duke mos marrë asnjë masë të nevojshme dhe të mjaftueshme për të shmangur rrezikun e humbjes së jetës së viktimës, dhe njëkohësisht personat që kanë shfaqur neglizhencën as nuk janë hetuar as nuk janë dënuar, kjo sjell shkelje të nenit 2 të Konventës** (Shih *Öneryıldız*, par. 93).

**74.** Një ndër standardet minimale të hetimit efektiv është ndërmarrja e hetimit nga persona që gëzojnë një pavarësi hierarkike, institucionale dhe praktike ndaj atyre që hetohen (shih *Paul dhe Audrey Edwards*, par. 70; *Mastromatteo k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 37703/97, par. 91, GJEDNJ 2002VIII; dhe *Mikayil Mammadov*, par. 101).

**75.** Në lidhje me pavarësinë e organeve që kanë ndërmarrë hetimin për vdekjen e djalit të kërkuesit, Gjykata vëren se dy raundet e para të hetimit ishin kryer nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Balvi, e cila është autoriteti i përfshirë në vdekjen e viktimës. Ndërkohë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se një hetim i tillë i brendshëm nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm, kur objekt hetimi janë pretendimet për keqtrajtim,

dhe bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës (shih *Ramsahai dhe të Tjerët k. Holandës* [DHOMA E MADHE], nr. 52391/99, par. 333-341, GJEDNJ 2007, *Jašar k. “Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë”*, nr. 69908/01, 11 prill 2006, dhe *Kopylov k. Rusisë*, nr. 3933/04, par. 138, 29 korrik 2010). Gjykata thekson se i njëjti përfundim zbatohet edhe për pretendime për shkelje të nenit 2 të Konventës.

**76.** Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se hetimi kishte qenë jo efektiv, përderisa nuk kishte përmbushur standardin minimal të pavarësisë dhe paansisë. Mbetet për t'u vlerësuar nëse problemi i hetimit jo efektiv dhe të njëanshëm është korrigjuar gjatë hetimeve të ndërmarrura nga Byroja e Sigurisë së Brendshme të Policisë së Shtetit, gjetjet e së cilës u konfirmuan më pas në tri raste nga ana e prokurorisë.

**80.** Gjykata vëren se hetimi i ndërmarrë nga Byroja e Sigurisë së Brendshme të Policisë së Shtetit kishte pasur mangësi për arsye të ndryshme dhe për rrjedhojë, nuk ishte e nevojshme të vlerësohej paansia e këtij hetimi. Byroja e Sigurisë së Brendshme e Policisë së Shtetit nuk bëri asnjë përpjekje për të gjetur arsyen se përse policët nuk kishin pritë ambulancën, për më tepër kur kishin pasur dijeni për nevojat e veçanta që kishte i biri i kërkuesit për shkak të aftësisë së tij të

kufizuar. Pavarësisht këtyre mangësive, Byroja arriti në përfundimin se policët në detyrë nuk kishin bërë asnjë shkelje (shih *Douglas-Williams k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 56413/00, 8 janar 2002).

**81.** Së fundmi, Gjykata nuk mund të mos shprehë vërejtje për mungesën e efektivitetit dhe paanshmërisë së hetimit, konkretizuar nga fakti se përgjegjësia për hetimin u përcoll tri herë nga zyrat e policisë tek prokuroria dhe anasjelltas (shih *mutatis mutandis*, *Denis Vasilyev k. Rusisë*, nr. 32704/04, par. 103, 17 dhjetor 2009, dhe *Mikheyev k. Rusisë*, nr. 77617/01, par. 120, 26 janar 2006).

**82.** Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se hetimi mbi rrethanat e ndarjes nga jeta e të birit të kërkuesit nuk ka qenë efektiv.

**83.** Për rrjedhojë, në këtë rast, ka edhe një shkelje të aspektit procedural të nenit 2, par. 1, të Konventës.

#### **Shpërblimi i drejtë**

**88.** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljeve të konstatuara në këtë çështje, Gjykata i cakton kërkuesit një dëmshpërblim prej 50,000 euro në kuadër të dëmit jo material.

## II. NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMI ÇNJERËZOR E DEGRADUES

“

Helhal k. Francës, 19.02.2015, Nr. 10401/12

Nëse mbajtja në burg e kërkuesit në kushte të papërshtatshme përbën trajtim poshtëruar dhe çnjërëzor sipas nenit 3 të Konventës.

”

**Faktet** – Kërkuesi i cili vuan nga paraplegjia e gjymtyrëve të poshtme, defekim dhe urinim të pavullnetshëm, është duke vuajtur një dënim me 30 vjet heqje lirie. Në gusht të vitit 2010, ai i drejtoi një kërkesë gjykatës për pezullimin e dënimit për shkak të kushteve të tij shëndetësore. Ai u ankua se ambientet e burgut nuk ishin të përshtatshme për aftësitë e tij të kufizuara dhe se, për rrjedhojë, ai nuk mund të lëvizte me karrige me rrota. Për të bërë dush, atij i nevojitej gjithmonë ndihma e të burgosurve të tjerë. Në shkurt të vitit 2011, një gjykatë e brendshme e rrëzoi kërkesën e zotit Helhal, bazuar në raportin mjekësor të dy ekspertëve, të cilët vlerësonin se kushtet e burgut ishin në përputhje me gjendjen shëndetësore të kërkuesit. Megjithatë, gjykata u shpreh se kushtet materiale të institucionit të ekzekutimit të veprës penale nuk ishin të përshtatshme për nevojat e kërkuesit dhe se, për rrjedhojë, ai duhej të transferohej në një institucion tjetër me infrastrukturë të përshtatshme. Apelimet e kërkuesit për këtë vendim u rrëzuan nga shkallët e tjera të gjykatave të brendshme. Kërkuesi u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të së drejtës së garantuar nga neni 3 i Konventës.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### Detyrimi për përkujdesje

**47.** Gjykata rikujton jurisprudencën e saj të vazhdueshme, sipas së cilës detyra për t'u kujdesur për të sëmurët gjatë heqjes së lirisë i vendos shtetit disa detyrime të veçanta, si poshtë vijon: **Shteti duhet të sigurojë që personit të privuar nga liria gjatë kryerjes së dënimit t'i ofrohet kujdesi mjekësor i nevojshëm dhe të përshtatë, nëse është e nevojshme, kushtet e përgjithshme të vuajtjes së dënimit me gjendjen e veçantë shëndetësore të tij.** Këto detyrime janë rikujtuar shumë qartë në vendimet *Xiros k. Greqisë* nr. 1033/07, par. 73, 9 shtator 2010; *Ürfi Çetinkaya k. Turqisë*, nr. 19866/04, par. 87 - 92, 23 korrik 2013) [...].

**48.** Për sa i përket detyrimit të parë, në një shtet të së drejtës, heqja e lirisë është kusht për realizimin e ekzekutimit të një dënimi. **Ndonëse nuk mund të arrihet në përfundimin se ekziston një detyrim i përgjithshëm për të liruuar apo transferuar në një spital civil një të burgosur, edhe nëse ky vuan nga një sëmundje veçanërisht e vështirë, Gjykata nuk mund të**

**përfundim që, në kushte veçanërisht të rënda, mund të ndodhemi në prani të situatave për të cilat, një administrim i mirë i drejtësisë penale, kërkon marrjen e masave humanitare. Prandaj, në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të burgosurit është absolutisht në mospërputhje me kushtet e vuajtjes së dënimit, neni 3 mund të kërkojë lirimin e personit sipas disa kushteve të përcaktuara** (*Xiros*, par. 74).

Lidhur me detyrimin e dytë, **mungesa e kujdesit shëndetësor të përshtatshëm mund, që në parim, të përbëjë një trajtim në kundërshtim me nenin 3.** Fillimisht Gjykata kërkon ekzistencën e një kujdesi mjekësor të duhur për të sëmurin dhe të përshtatshëm sipas rastit specifik. Kujdesi dhe shpeshësia me të cilën jepet kujdesi mjekësor për personin janë dy elementë që merren parasysh për vlerësimin e përputhshmërisë së trajtimit të tij me kërkesat e nenit 3. Në veçanti, këta dy faktorë nuk vlerësohen nga Gjykata në terma absolutë, por duke mbajtur parasysh në çdo rast gjendjen e veçantë shëndetësore të të burgosurit. Në përgjithësi, përqendrimi i shëndetit të një të burgosuri nuk luan në vetvete një rol vendimtar për nenin 3 të

Konventës. Gjykata shqyrton në secilin rast, nëse përqendrimi i gjendjes shëndetësore të personit i atribuohet të metave të shërbimit shëndetësor (po aty, par. 75).

Për detyrimin e tretë, Gjykata kërkon që ambienti i burgut t'i përshtatet, nëse është e nevojshme, nevojave të veçanta të të burgosurit, në mënyrë që ai të vuajë dënimin në kushte që nuk venë në rrezik integritetin e tij moral (po aty, par. 76).

#### Të burgosurit me aftësi të kufizuara

[...]

**50.** Kur autoritetet shtetërore burgosin një person me aftësi të kufizuara, ata duhet të tregojnë një kujdes të veçantë, në mënyrë që kushtet e vuajtjes së dënimit me heqje lirie t'u përgjigjen nevojave specifike të aftësisë së tij të kufizuar (*Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 25; *Farbtuhs k. Letonisë*, nr. 4672/02, par. 56, 2 dhjetor 2004 ; *Zarzycki k. Polonisë*, nr. 15351/03, par. 102, 12 mars 2013).

**51. Heqja e lirisë një personi me aftësi të kufizuara në një vend ku ai nuk mund të lëvizë vetë, veçanërisht kur nuk mund të dalë jashtë qelisë për një kohë të gjatë, përbën një trajtim poshtëruar që ndalohej nga neni 3 i Konventës** (*Vincent*, par. 103 ; *Cara-Damiani k. Italisë*, nr. 2447/05, par. 72, 7 shkurt 2012).

372. Edhe pse është e vërtetë që Konventa nuk garanton në vetvete të drejtën për asistencë sociale, **Shteti nuk mund të çlirohet nga detyrimi për të siguruar që kushtet e vuajtjes së dënimit t'u përgjigjen nevojave specifike të një të burgosuri me aftësi të kufizuara, duke ia transferuar përgjegjësinë për kujdesin apo dhënien e ndihmës për të, të burgosurve të tjerë** (*Kaprykowski k. Polonisë*, nr. 23052/05, par. 74, 3 shkurt 2009 ; *Grimailovs k. Letonisë*, nr. 6087/03, par. 161, 25 qershor 2013 ; *Semikhvostov k. Rusisë*, nr. 2689/12, par. 85, 6 shkurt 2014[...]) Në disa raste, varësia nga ndihma e të burgosurve të tjerë për të shkuar në tualet, për t'u larë, veshur apo zhveshur, mund të jetë poshtëruar (shih *Zarzycki*, par. 104; *D.G. k. Polonisë*, nr. 45705/07, par. 147, 12 shkurt 2013). Mundësia për përdorimin e mjeteve sanitare ngre një problem të veçantë në këndvështrim të nenit 3 të Konventës (*D.G.*, par. 147 dhe 150 ; *Semikhvostov*, par. 81).

#### Zbatimi i parimeve për çështjen në shqyrtim

**54.** Gjykata vëren që në fillim se, nuk kundërshtohet fakti që kërkuesi ka një aftësi të kufizuar që e detyron të lëvizë kryesisht me

karrige me rrota...Prandaj vuajtja e kërkuesit duhet shqyrtuar në dritën e parimeve të sipërpërmendura për detyrimet e shtetit për t'u kujdesur për personat me aftësi të kufizuara [...].

[...]

**55.** ...Gjykata konstaton se nuk përjashtohet që kërkuesi mund të përfitonte nga fizioterapia në burg (*Shih a contrario, Cara-Damiani* par. 74). Gjykata vëren se në vlerësimin e kërkesës së saj për pezullim të dënimit, ajo mban parasysh aftësinë e kufizuar të kërkuesit. Në fakt, kjo kërkesë atij i ishte refuzuar, bazuar në raportin e ekspertëve, të cilët kishin arritur në përfundimin se gjendja shëndetësore e kërkuesit nuk ishte në mospërputhje, për sa i takon kohëzgjatjes, me vuajtjen e dënimit, me kusht që ai të mund të përfitonte nga fizioterapia dhe të kishte mundësi të përdorte një sallë sportive [...].

[A]jo që ka rëndësi është cilësia e shërbimeve të dhëna dhe veçanërisht përcaktimi nëse autoritetet kombëtare kishin kryer atë që, mund të kërkohej prej tyre në mënyrë të arsyeshme, në mënyrë që atij t'i ofrohej riedukimi i nevojshëm dhe mundësia për përmirësimin e gjendjes së tij [...].

#### Përfundim

**63.** Si përfundim, Gjykata konstaton se mbajtja në burg e kërkuesit nuk është në mospërputhje në vetvete me nenin 3 të Konventës. Por, autoritetet kombëtare nuk i kanë siguruar atij një trajtim të përshtatshëm [...]. Duke pasur parasysh shkallën e rëndë të aftësisë së kufizuar fizike të tij dhe faktin që ai vuan nga defekim dhe urinim i pavullnetshëm, periudha e heqjes së lirisë, gjatë së cilës ai ka jetuar pa mundur të përfitojë nga asnjë trajtim rehabilitues dhe i institucionalizuar, ku ai nuk mund të bënte as dush pa ndihmën e të burgosurve të tjerë, janë rrethana që e kanë vendosur kërkuesin në vështirësi të një intensiteti të tillë, që e tejkalon nivelin e paevitueshëm të vuajtjeve, të cilat janë pjesë përbërëse e vuajtjes së dënimit me heqje lirie. Këto rrethana përbëjnë një trajtim çnjërëzor, të ndaluar nga neni 3 i Konventës, dhe sjellin shkelje të kësaj dispozite. Mungesa e provave që vërtetojnë se autoritetet kanë vepruar me qëllim për të poshtëruar kërkuesin, nuk e ndryshojnë këtë përfundim (*Farbtuhs*, par. 50 dhe 60).

**70.** [...] Gjykata cakton një shpërblim prej 4000 euro si dëmshpërblim në favor të kërkuesit.

“

Grimailovs k. Letonisë, 25.06.2013, Nr. 6087/03

Nëse trajtimi i kërkuesit nga policia dhe gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit përbënte shkelje të së drejtës së tij për t'u mbrojtur nga tortura e trajtimi çnjerëzor e poshtëruës.

”

**Faktet** – Artemijs Grimailovs është një “banor i përhershëm dhe person pa shtetësi” i Republikës së Letonisë. Zoti Grimailovs ka paraqitur një sërë kërkesash duke ju referuar nenit 3 të Konventës, pas arrestimit të tij nga policia më 10 shtator 2001. Ai pretendon se gjatë arrestimit të tij, oficerët e tërhoqën zvarrë nga makina e tij dhe e gjuajtën në shpinë, të cilën ia dëmtuan keq dhe për këtë iu vendos një implant metalik, që shërbente për t'i mbajtur shpinën drejt. Ai gjithashtu parashtron në pretendimet e tij se trajtimi për sëmundjen e tij ishte i papërshtatshëm. Së fundi, ai ankohet se u bë paraplegjik dhe mbeti në një karrrocë si rezultat i kujdesit të papërshtatshëm mjekësor gjatë kohës së arrestimit, duke i shtuar kësaj dhe ambientet e papërshtatshme për të në burgjet ku kreu dënimin e tij për pesë vjet e gjysmë me heqje lirie. Ai u lirua me kusht në vitin 2006.

Para GJEDNJ-së, kërkuesi pretendon se ka qenë viktimë e torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtëruës nga policia gjatë arrestimit të tij dhe se ishte mbajtur në kushte të papërshtatshme, dhe se nuk i kishin ofruar kujdes shëndetësor në institucionet e vuajtjes së dënimit.

## Vlerësimi i Gjykatës

### 1) Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës në ngjarjet e 10 shtatorit 2001

**100.** Gjykata thekson se kur një person është plagosur gjatë ndalimit të tij ndërkohë që ka qenë nën kontrollin e policisë, çdo plagosje e tillë ngre dyshimin se individ i fjalë është nënshtruar keqtrajtimit (shih *Bursuc k. Rumanisë*, nr. 42066/98, par. 80, 12 tetor 2004; *Matko k. Sllovenisë*, nr. 43393/98, par. 99, 2 nëntor 2006; *Mrozowski k. Polonisë*, nr. 9258/04, par. 26, 12 maj 2009). Megjithatë, përdorimi i forcës gjatë ndalimit të një individ dhe madje edhe plagosja e tij mund të dalin jashtë fushës së veprimit të nenit 3, nëse përdorimi i forcës ka qenë i domosdoshëm dhe ka ardhur si pasojë e sjelljes së kërkuesit (shih *Klaas k. Gjermanisë*, 22 shtator 1993, par. 30, Seria A, nr. 269). [...]

**101.** Gjykata vëren më tej se, për të shqyrtuar ankimet në lidhje me shkelje të nenit 3 të Konventës, ajo përdor standardin e provës “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”[...] (shih *Farbtuhs k. Letonisë*, nr. 4672/02, par. 54, 2 dhjetor 2004; *Bazjaks k. Letonisë*, nr. 71572/01, par. 74, 19 tetor 2010; dhe *Krivošajs k. Letonisë*, nr. 45517/04, par. 69, 17 janar 2012).

102. Për më tepër, në rastet kur një individ

pretendon se ka qenë subjekt i një trajtimi që bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, kur ka qenë në duart e policisë ose organeve të tjera shtetërore, [...] detyrimisht fillohet një hetim zyrtar efektiv (shih *Labita k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 26772/95, par. 131, GJEDNJ, 2000IV).

**103.** Detyrimi për të hetuar nuk është një detyrim rezultatesh, por detyrim mjeti: jo çdo hetim duhet domosdoshmërisht të arrijë në një përfundim i cili të përputhet me pretendimet e kërkuesit. Megjithatë, në parim, hetimi duhet të jetë në gjendje të krijojë një pasqyrë të qartë mbi ngjarjen dhe, nëse provohet se pretendimet për shkelje janë të vërteta, personat përgjegjës duhet të identifikohen dhe ndëshkohen (shih *Mikheyev k. Rusisë*, nr. 77617/01, par. 107, 26 janar 2006).

**105.** Në mënyrë që një hetim të jetë efektiv, duhet që personat që e ndërmarrin atë hetim të jenë të pavarur nga strukturat që mund të jenë përfshirë në ngjarje (shih *Barbu Anghelescu k. Rumanisë*, nr. 46430/99, par. 66, 5 tetor 2004). Kjo nuk nënkupton vetëm pavarësi institucionale ose hierarkike, por edhe pavarësi praktike (shih për shembull, *Ergi k. Turqisë*, 28 korrik 1998, par. 83-84, Raporti 1998IV ...).

**106.** Hetimi duhet të jetë efektiv edhe në aspektin që të jetë i aftë të përcaktojë

nëse është përdorur forcë nga policia dhe nëse përdorimi i saj ka qenë i domosdoshëm (shih *Kaya k. Turqisë*, 19 shkurt 1998, par. 87, Raportet 1998-I).

**109.** Gjykata e ka të pamundur të përcaktojë, vetëm mbi bazën e materialeve që i janë paraqitur, nëse plagët e kërkuesit janë shkaktuar sipas mënyrës që ai pretendon. Megjithatë, në kuadër të argumenteve të paraqitura më lart, Gjykata nuk mund të pranojë pretendimet e qeverisë se hetimi nga organi i prokurorisë ishte efektiv për rastin në fjalë. Ndërkohë, ky hetim nuk arriti të provonte nëse pretendimet e kërkuesit për keqtrajtim ishin ose jo të vërteta (shih *Veznedaroğlu k. Turqisë*, nr. 32357/96, par. 31, 11 prill 2000; *Petru Roșca k. Moldavisë*, nr. 2638/05, par. 42, 6 tetor 2009; *Popa k. Moldavisë*, nr. 29772/05, par. 39, 21 shtator 2010; dhe *Hristovi k. Bullgarisë*, nr. 42697/05, par. 83, 11 tetor 2011).

**112.** [...] Gjykata ka vërejtur në një sërë çështjesh kundër Letonisë, se nuk është respektuar standardi minimal i hetimit të pavarur kur subjekt i hetimit kanë qenë organet e policisë (shih *Jasinskis k. Letonisë*, nr. 45744/08, par. 75, 21 dhjetor 2010; *Timofejevi k. Letonisë*, nr. 45393/04, par. 98, 11 dhjetor 2012, dhe *Vovruško k. Letonisë*, nr. 11065/02, par. 50, 11 dhjetor 2012) [...].

**113.** Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, nuk u ndërmorën të gjithë hapat e arsyeshme për të garantuar pavarësinë e hetimit dhe sigurinë e provave [...].

**114.** [...] Gjykata vlerëson se prokuroria i mori për të mirëqena deklaratat e efektivëve të policisë, të cilët ishin të përfshirë në ngjarjen e natës së arrestimit dhe pranoi plotësisht mohimin e kryerjes së veprave prej tyre. Kjo është e mjaftueshme për të shkaktuar dyshime në efektivitetin e procesit hetimor, meqenëse prokuroria nuk mori asnjë provë tjetër mbështetëse dhe ndërkohë rrëzoi pretendimet e kërkuesit. Përfundimet e saj nuk u bazuan në deklaratën e ndonjë dëshmitari, ekzaminimi mjekoligjor, ose prova të tjera.

**115.** [...] Gjykata çmon se vonesa në kryerjen e ekzaminimit mjekoligjor të kërkuesit, dy muaj pas ngjarjes, dhe mungesa e një ekzaminimi verbal janë të papranueshme (shih *Vovruško*, cituar më lart, par. 49), duke e bërë kështu të pamundur evidentimin e ndonjë shenje apo plaje në trupin e kërkuesit [...].

**116.** Gjykata vlerëson se mbikëqyrja e hetimit nga prokuroria kishte mangësi dhe se prokuroria nuk siguroi ndërmarrjen e hetimeve të tjera, të cilat do ta plotësonin kuadrin e ngjarjeve.

**119.** Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme që Gjykata të vlerësojë se autoritetet kombëtare nuk garantuan një hetim efektiv në lidhje me ankimet e kërkuesit për keqtrajtim nga policia natën e arrestimit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës.

### 2) Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës për kushtet në burg dhe trajtimin mjekësor

**150.** Gjykata thekson se neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se krijon një detyrim të përgjithshëm për të liruar për shkaqe mjekësore një person që i është hequr liria, ose për ta transferuar atë në një spital publik, edhe në rastet kur ai vuan nga një sëmundje e vështirë për t'u trajtuar. Megjithatë, ky nen e detyron shtetin të garantojë mbajtjen e të burgosurve në burg në kushte të përshtatshme, për të respektuar dinjitetin e tyre njerëzor, në mënyrë të tillë që vendimi për heqjen e lirisë të mos u shkaktojë atyre vuajtje ose stres të shtuar gjatë kohës së ekzekutimit të dënimit [...] (shih *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 92-94, GJEDNJ 2000XI; *Melnitis k. Letonisë*, nr. 30779/05, par. 69, 28 shkurt 2012; dhe *Savičs k. Letonisë*, nr. 17892/03, par. 130, 27 nëntor 2012).

**151.** Kur autoritetet shtetërore vendosin t'i heqin lirinë një personi me aftësi të kufizuara, duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të garantuar kushte të përshtatshme në përputhje me nevojat e veçanta të personit të ndaluar (shih *Farbtuhs*, par. 56; *Jasinskis*, par. 59; *Zoti H. k. Hungarisë*, nr. 28973/11, par. 29, 8 nëntor 2012 [...]).

**153.** Gjykata është shprehur edhe më parë se mbajtja e një individ me aftësi të kufizuara në qeli, veçanërisht kur ai nuk ka mundësi të dalë nga qelia në mënyrë të pavarur, përbën trajtim poshtëruës. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata ka vendosur se edhe lënia e një personi me aftësi të kufizuara në varësi të plotë të të burgosurve të tjerë është trajtim poshtëruës (shih *Vincent k. Francës*, nr. 6253/03, par. 103, 24 tetor 2006).

**158.** Gjykata vëren se pamundësia e përdorimit të ambienteve sanitare të institucionit të vuajtjes së dënimit penal përbën një ankim në kuadër të nenit 3 të Konventës (shih në një kontekst më kompleks, *D. G. k. Polonisë*, cituar më lart, par. 147 dhe 150) [...]. Për më tepër, nga të dhënat e çështjes, rezulton se e vetmja mundësi që kërkuesi të lahej vetë ishte gjatë vizitës javore në sauna, ambientet e të cilës kërkuesi nuk mund t'i

përdorte pa ndihmën e të tjerëve. Nga materialet e dosjes, nuk rezultojnë që ambientet e saunës të ishin përshtatur sipas nevojave të veçanta të kërkuarit. Gjykata vlerëson se ky indiferentizëm i autoriteteve vendase është i papranueshëm. Gjykata e ka theksuar edhe në vendime të tjera të mëparshme të saj se lejimi i të burgosurve që të përdorin dushin vetëm një herë në javë, nuk i lejon ata që të mbajnë higjienën e tyre si duhet. Ky fakt ka ndikuar në efektin kumulativ të kushteve të spitalit të burgut, të cilat përbëjnë shkelje të nenit 3 të Konventës (shih Čuprakovs k. Letonisë, nr. 8543/04, par. 44-45, 18 dhjetor 2012). Standardet ndërkombëtare të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) për këtë aspekt, shprehen qartë se të ndaluarit duhet të kenë të paktën dy herë në javë mundësi të përdorin dushet. Zoti Grimailovs nuk kishte mundësi të përdorte dushin. Gjykata vlerëson se vizita javore në sauna nuk mund të pretendohet se i garantonte atij mundësi për të mbajtur higjienën e kërkuar.

**159.** Gjykata vëren më tej se, nevojat e veçanta të kërkuarit ishin lënë pas dore për sa kohë që nuk ishte marrë asnjë masë për të

përmirësuar jetesën e tij në ambientet e burgut. Ndërkohë, këto kushte i bënin edhe më të vështira takimet e tij personale me bashkëshorten, të cilat sipas ligjit letonez mund të zgjasnin deri në 48 orë (shih *Aleksejeva k. Letonisë*, nr. 21780/07, par. 28, 3 korrik 2012). [...]

**162.** Në kuadër të gjetjeve të mësipërme dhe efekteve të tyre kumulative, duke pasur parasysh aftësitë e kufizuara të kërkuarit, Gjykata vlerëson se kushtet në ambientet e burgut, veçanërisht pamundësia e tij për të lëvizur i pavarur e për të përdorur të gjitha hapësirat e institucionit, përfshi këtu edhe ambientet sanitare, përmbushin ashpërsinë e kërkuar nga neni 3, duke përbërë kështu një sjellje në kundërshtim me këtë nen. Rrjedhimisht, është shkelur e drejta e siguruar nga neni 3 i Konventës.

### 3) Shpërblimi i drejtë

**169.** Gjykata vlerësoi se kërkuari duhet të përfitojë një dëmshpërblim prej 6,000 euro në kuadër të dëmit jo material.

“

**Zarzycki k. Polonisë, 12.03.2013, Nr. 15351/03**

*Nëse kushtet e vuajtjes së dënimit për kërkuarin përbënin trajtim poshtëruar në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.*

”

**Faktet** – Kërkuari ka dëmtuar të dy parakrahët në një aksident dhe, për këtë arsye, është vërtetuar se ka aftësi të kufizuara të shkallës së parë, duke pasur kështu nevojë për ndihmën e një personi tjetër. Në qershor të vitit 2002, ai u mbajt në paraburgim si i dyshuar për një numër veprash penale kundër një të mituri dhe të shtrëngimit të një personi për kryerjen e dëshmisë së rreme. Ai u dënua me tre vjet burgim në vitin 2002. Ndërkohë, në vitin 2003 Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë. Gjatë kohës që ishte në paraburgim, kërkuari u informua për procedurën për marrjen e protezave, ndihmën për kryerjen e ndërhyrjes, si dhe kërkesën për rimbursimin e kostove. Ai kërkoi që të pajisej me proteza bio-mekanike, por nuk ishte në gjendje të përballonte diferencën që duhej të paguante vetë. Në korrik të vitit 2003, atij i ishte dhënë leje për kryerjen e dënimit, si dhe marrjen e kujdesit ortopedik jashtë sistemit të vuajtjes së dënimit dhe nga kjo përfitoi falas dy proteza mekanike të tipit bazë, si dhe iu nënshtrua fizioterapisë. Ai u rikthye në burg në korrik të vitit 2004. Në tetor të vitit 2006, atij iu dha amnisti dhe u lirua. Pas një sërë raportesh mjekësore të kryera përpara dhe pasi kërkuari ishte pajisur me protezat mekanike, ai kishte deklaruar në mënyrë të qartë se nuk ishte në gjendje dhe i aftë për të qëndruar në burg. Megjithatë, gjatë dy periudhave të burgosjes së tij, autoritetet kishin ndërmarrë hapa për të siguruar që kërkuari të ndihmohej nga të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, ishin bërë dhe rregullime të tjera të veçanta në mënyrë që t'ia lehtësonin, ose t'i bënin më pak të vështira, kushtet e vuajtjes së dënimit, të tilla si mundësia e bërjes dush gjashtë herë në javë. Kërkuari u ankuar para GJEDNJ-së për shkelje të nenit 3.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 3

**99.** Në bazë të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, keqtrajtimi duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie, në mënyrë që të përfshihet në kuadrin e mbrojtjes që garanton neni 3 i Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal është relativ. Ai varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore, si edhe në disa raste gjinia, moshë dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih ndër të tjera *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 91, GJEDNJ, 2000-XI; *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 24, GJEDNJ, 2001-VII; dhe *Enea k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 74912/01, par. 55, GJEDNJ, 2009).

**100.** Gjykata e ka konsideruar trajtimin “poshtëruar” sipas kuptimit të nenit 3, kur ky trajtim e ka bërë viktimën të ndjejë frikë, ankth dhe inferioritet, ndjenja të cilat e kanë poshtëruar dhe përlulur atë (shih për shembull, *Kudła*, cituar më lart, par. 92). Për të kryer një vlerësim të tillë, Gjykata do të marrë parasysh nëse trajtimi ka pasur për qëllim të fyejë dhe poshtërojë personin në fjalë dhe nëse kjo gjë ka ndikuar negativisht në personalitetin e tij ose të saj në mënyrë të papajtueshme me nenin 3 (shih *Raninen k. Finlandës*, 16 dhjetor 1997, par. 55, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve, 1997-VIII). Megjithatë, mungesa e një qëllimi të tillë nuk përjashton detyrimisht shkeljen e nenit 3 të Konventës (shih *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 74, GJEDNJ, 2001-III).

**101.** Vuajtja dhe përlulja e pësuar duhet që në çdo rast të shkojnë përtej shkallës së pashmangshme, që lidhet drejtpërdrejt me një formë të ligjshme trajtimi ose ndëshkimi. [...] Neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se krijon një detyrim të përgjithshëm për të liruuar të burgosurit dhe për t'i transferuar ata në spital civil, edhe në rastet kur ata vuajnë nga sëmundje të vështira për t'u trajtuar (shih *Mouisel k. Francës*, nr. 67263/01, par. 40, GJEDNJ 2002IX). Megjithatë, ky nen i vendos detyrimin shtetit për të siguruar që kushtet e burgimit të jenë në përputhje me dinjitetin njerëzor, dhe që ekzekutimi i masës së dënimit të mos e bëjë viktimën të pësojë stres ose vuajtje përtej një niveli të pashmangshëm, të cilat janë të natyrshme gjatë heqjes së lirisë. Gjithashtu, duhet siguruar që kërkesat e të ndaluarit në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore të trajtohen me rigorozitet (shih *Kudła*, cituar më lart, par. 92-94).

**102.** Personat e ndaluar gjenden në pozitë të brishtë dhe për këtë arsye autoritetet

kanë detyrimin që t'i mbrojnë ata. Kur autoritetet vendosin të mbajnë në paraburgim një person me aftësi të kufizuara, ato gjithashtu duhet të garantojnë një kujdes të veçantë ndaj këtij personi, në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore (shih *Price*, cituar më lart, par. 30; *Engel k. Hungarisë*, nr. 46857/06, par. 27-30, 20 maj 2010; dhe *Vincent k. Francës*, nr. 6253/03, par. 94-103, 24 tetor 2006).

**103.** Në këto lloj çështjesh, Gjykata duhet të mbajë parasysh tre faktorë të rëndësishëm, në mënyrë që të vlerësojë nëse ndalimi i një kërkuari është në përputhje me gjendjen e tij/saj shëndetësore. Këta faktorë janë: (a) gjendja e të burgosurit, (b) cilësia e përkujdesjes së siguruar dhe (c) nëse kërkuari duhet të mbahet ose jo ende në burg për shkak të gjendjes së tij shëndetësore (Shih për shembull, *Farbtuhs*, cituar më lart, par. 53).

**104.** Në zbatim të këtyre parimeve, Gjykata ka vërejtur më parë se arrestimi i një personi me aftësi të kufizuara, në kushte të papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore, duke ia besuar këtë person bashkëvuajtësve të qelisë së tij, për ta larë, veshur dhe zhveshur, përbën trajtim poshtëruar (shih *Price*, cituar më lart, par. 30; *Engel*, cituar më lart, par. 27-30, dhe *Vincent*, cituar më lart, par. 94-103).

**109.** Gjykata vëren se një sërë raportesh mjekësore të përpiluara, pasi kërkuari ishte pajisur me protezë, shprehin qartë se zoti Zarazcky nuk ishte i aftë të qëndronte vetëm në burg.

[...]

**116.** Për sa i përket cilësisë së kujdesit, Gjykata vëren se gjatë të dy periudhave të ndalimit të tij, autoritetet kishin ndërmarrë disa masa për të garantuar trajtimin e duhur të tij, në përputhje me nevojat e tij të veçanta.

**117.** Gjithashtu, Gjykata vëren se gjendja e kërkuarit nuk kishte nevojë për ndihmë tepër të specializuar, prandaj, një infermiere e trajnuar do të ishte e mjaftueshme. Kërkuari ishte në pjesën më të madhe autonom, veçanërisht pasi nisi të përdorë protezën. Ndihma që i nevojitej duhej vetëm gjatë kohës që lahej dhe vishej.

**123.** Në dritën e gjetjeve të mësipërme, Gjykata thekson se është e kënaqur që autoritetet e burgut e kishin vërejtur situatën e kërkuarit dhe kishin siguruar pa vonesë një zgjidhje të përshtatshme për të (Shih të kundërtën tek *Vladimir Vasilyev k. Rusisë*, nr. 28370/05, par. 67-69).



**125.** Në përfundim, Gjykata vëren se administrata e burgut ka vepruar paraprakisht për plotësimin e kërkesave të kërkuarit. Autoritetet kompetente i kishin siguruar kërkuarit në mënyrë të përhershme ndihmën e duhur, në përputhje me nevojat e tij të veçanta. Për më tepër, nuk ka asnjë provë që tregon se ka ndodhur ndonjë incident ose ka ekzistuar një qëllim i sigurt për të poshtëruar dhe përlulur kërkuarin. Gjykata vlerëson se megjithëse një i ndaluar me aftësi të kufizuara

fizike është më tepër i brishtë për t'u përballur me një paraburgim të rëndë, trajtimi i kërkuarit në çështjen konkrete, objekt gjykimi, nuk ka arritur nivelin e ashpërsisë së kërkuar për t'u konsideruar trajtim poshtëruar, në shkëlqje të nenit 3 të Konventës (shih të kundërtën tek *Price*, cituar më lart, par. 28-30; *Engel*, cituar më lart, par. 27 dhe 30, dhe *Vincent*, cituar më lart, par. 94-103). Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në këtë çështje nuk ka pasur shkëlqje të nenit 3 të Konventës.

për t'i garantuar çdo individ brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga **Konventa, i marrë së bashku me nenin 3, e detyron shtetin të marrë masa të posaçme për të garantuar që individët brenda juridiksionit të tij të mos jenë subjekt i torturës, ose trajtimit çnjerëzor, e poshtëruar, apo ndëshkimit, duke përfshirë këtu edhe keqtrajtimet e kryera nga individë privatë** (shih *mutatis mutandis*, H.L.R. k. *Francës*, 29 prill 1997, par. 40, *Raportet 1997-III*). Këto masa duhet të garantojnë mbrojtje efektive, veçanërisht për fëmijët dhe individët e tjerë në gjendje të brishtë, duke përfshirë veprime të arsyeshme për të parandaluar keqtrajtimin për të cilin autoritetet kishin ose duhet të kishin dijeni se po ndodhte (shih *mutatis mutandis*, *Osman k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, par. 116, *Raportet 1998-VIII*, dhe *E. Dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33218/96, par. 88, 26 nëntor 2002).

**139.** Megjithatë, duke pasur parasysh vështirësitë e perceptimit të shoqërive moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhet të bëhen në drejtim të përparësive dhe burimeve, qëllimi i këtij detyrimi pozitiv duhet të interpretohet në mënyrë të tillë, që të mos u vendosë autoriteteve një barrë të pamundur apo shpërpjesëtimorë. Jo çdo rrezik për keqtrajtim i detyron autoritetet, sipas Konventës, të marrin masa operacionale në kuadër të shmangies së këtij rreziku. Për te qenë përpara një detyrimi pozitiv, duhet që autoritetet të kenë ditur ose të kenë pasur dijeni në kohën kur ka ndodhur ngjarja, për ekzistencën e një rreziku real keqtrajtimi, apo për keqtrajtimin për shkak të akteve kriminale të personave të tretë ndaj një individi të caktuar dhe të mos kenë marrë asnjë masë efektive, e cila në mënyrë të arsyeshme do të kishte shmangur rrezikun në fjalë. Një fakt tjetër i rëndësishëm është nevoja për t'u siguruar që policia i ka ushtruar siç duhet tagrat e saj për të kontrolluar dhe parandaluar krimin, duke respektuar hetimet e veprave penale dhe nxjerrjen përpara drejtësisë të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale, përfshi këtu edhe garancitë e parashikuara nga neni 8 i Konventës (shih *Mubilanzila Mayeka dhe Kaniki Mitunga k. Belgjikës*, nr. 13178/03, par. 53, GJEDNJ, 2006-XI; *Anëtarët e Kongregacionit Gldani të Dëshmitarëve të Jehovait dhe të Tjerët k. Gjeorgjisë*, nr. 71156/01, par. 96, 3 maj 2007; dhe *Milanović*, cituar më lart, par. 84; shih edhe *mutatis mutandis*, *Osman*, cituar më lart, par. 116).

**140.** Për rrjedhojë, Gjykata do të shqyrtojë nëse shteti i paditur ka shkelur detyrimet e tij pozitive në kuadër të nenit 3 të Konventës, në

trajtimin e çështjes së kërkuarit të parë.

**141.** Gjykata vëren se aktet e dhunës kundër kërkuarit, të cilat vijnë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, duhet që normalisht të kishin gjetur zgjidhje përmes zbatimit të dispozitave penale ndaj atyre që i kanë kryer ato akte (shih *Beganović k. Kroacisë*, nr. 46423/06, par. 71, 25 qershor 2009, në lidhje me nenin 3, dhe *Sandra Janković*, cituar më lart, par. 47, në lidhje me nenin 8).

**142.** Megjithatë, në çështjen konkrete, objekt gjykimi, pjesa më e madhe e autorëve të keqtrajtimeve ishin fëmijë nën 14 vjeç që, sipas legjislacionit vendas, nuk mund të procedoheshin penalisht. Për më tepër, ka të ngjarë, që asnjë nga veprat konkrete të ndërmarra prej tyre nuk përbënte veprë penale në vetvete, por pavarësisht kësaj, në tërësinë e tyre, incidentet dhe ngacmimet ishin të papajteshme me kërkesat e nenit 3 të Konventës. Kështu, çështja konkrete duhet dalluar nga çështje që kanë të bëjnë me përgjegjësitë procedurale të shtetit, në kuadër të së drejtës penale për keqtrajtimet, të cilat shkelin nenin 3 të Konventës, kur autoritetet shtetërore e kanë për detyrë të ndërmarrin një hetim të pavarur *ex-officio*.

**143.** Çështja konkrete ka të bëjë me detyrimin pozitiv të shtetit në situata të ndryshme jashtë fushës penale, kur autoritetet kompetente shtetërore janë në dijeni të një situatë serioze që lidhet me shqetësimin apo ushtrimin e dhunës ndaj një individi me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore [...].

**144.** [...] Gjykata ka shqyrtuar së pari, nëse autoritetet kompetente ishin, ose duhet të ishin, në dijeni të shqetësimeve të shkaktuara dhe dhunës së ushtruar ndaj kërkuarit të parë.

**146.** Gjykata vlerëson se autoritetet kombëtare ishin në dijeni të shqetësimeve të vazhdueshme që i shkaktoheshin kërkuarit të parë nga fëmijë të lagjes së tij dhe nga fëmijë që ndiqnin një shkollë aty pranë. Gjykata do të shqyrtojë nëse autoritetet kishin ndërmarrë masa të arsyeshme për të mbrojtur kërkuarin nga këto veprime.

**147.** Gjykata vëren se incidentet e dhunës kanë zgjatur për një periudhë kohe dhe se, për rrjedhojë, autoritetet nuk kanë marrë masa të mjaftueshme për të zgjidhur problemin dhe për të parandaluar përsëritjen e tij.

**149.** Në këto kushte, Gjykata vlerëson se autoritetet kompetente të shtetit të

“

**Dordević k. Kroacisë, 24.7.2012, Nr. 41526/10**

*Nëse ngacmimet dhe shqetësimet e vazhdueshme që u shkaktoheshin kërkuarve nga persona privatë dhe mos marrja e masave nga autoritetet shtetërore për të mbrojtur ata, përbënin shkëlqje të së drejtës për të mos iu nënshtruar trajtimeve çnjerëzore e poshtëruar, të drejtës së jetës private e familjare dhe parimit të mosdiskriminimit.*

”

**Faktet** - Kërkuari i parë, i cili vuante nga aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, jetonte me nënën e tij (kërkuarja e dytë) në një banesë në katin e parë. Të dy kërkuarit u ankuan se gjatë periudhës korrik 2008 dhe shkurt 2011, ata ishin ngacmuar vazhdimisht nga nxënësit e një shkolle fillore aty pranë dhe se autoritetet nuk i kishin mbrojtur siç duhet. Gjatë kësaj periudhe, u regjistruan një sërë incidentesh nga fëmijë të cilët i binin ziles së derës së familjes në çdo kohë, pështynin mbi kërkuarin e parë, duke e goditur dhe shtyrë sa andej këndeje, duke ia djegur duart me cigare, duke bërë vandalizma në ballkonin e kërkuarve dhe duke i sharë. Këto sulme e kishin shqetësuar së tepërmi kërkuarin e parë, duke i shkaktoar frikë dhe ankth. Në shumë raste, ata ishin ankuar tek autoritete të ndryshme, duke përfshirë Shërbimet Sociale dhe Avokatin e Popullit. Ata kishin thirrur shumë herë edhe policinë për t'i raportuar incidentet dhe për t'i kërkuar ndihmë. Por, pas çdo thirrje, policia herë mbërrinte shumë vonë në vendngjarje dhe herë të tjera, vinte vetëm për t'u thënë fëmijëve të shpërndaheshin, apo të ndalonin së bëri zhurmë. Gjithashtu policia kish intervistuar disa nxënës dhe kish arritur në përfundimin se, edhe pse nxënësit e kishin pranuar se kishte pasur sjellje të dhunshme ndaj kërkuarit të parë, ata ishin shumë të rinj për të mbajtur përgjegjësi penale. Kërkuari u ankuan përpara GJEDNJ-së për shkëlqje të së drejtave të tyre të garantuara nga nenet 3, 8 dhe 14 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### 1) Në lidhje me pretendimin për shkëlqje të nenit 3 të Konventës

#### (a) Për sa i përket ankuesit të parë

**137.** Gjykata thekson se neni 3 i Konventës duhet të konsiderohet se mbron njërën prej të drejtave më themelore të Konventës dhe se mishëron vlerat thelbësore të shoqërive demokratike, që bëjnë pjesë të Këshillit të Evropës (shih *Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, par. 49, GJEDNJ 2002-III). Në ndryshim

nga parashikimet e tjera të Konventës, kjo e drejtë duhet të garantohet në terma absolutë, pa asnjë përjashtim. Gjithashtu, mundësia e derogimit të detyrimeve të këtij neni nuk ekziston as në kuadër të nenit 15 të Konventës (Shih ndër të tjera, *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, par. 79, *Raportet 1996-V*).

**138.** Gjykata vëren se, për sa i përket pyetjes nëse, në kuadër të nenit 3, shteti duhet të mbajë përgjegjësi për keqtrajtimin e j individëve nga subjektet jo shtetërore, detyrimi i Palëve të Larta Kontraktuese, në kuadër të nenit 1 të Konventës,

paditur nuk kanë marrë masa të arsyeshme për të parandaluar ndodhjen e veprimeve abuzive kundër kërkuesit të parë, pavarësisht se ishin në dijeni të ekzistencës së një rreziku të tillë.

**150.** Për rrjedhojë ndaj kërkuesit të parë është shkëlur neni 3 i Konventës.

#### (b) Në lidhje me kërkuesen e dytë

**151.** Megjithëse objektivi thelbësor i nenit 8 është të mbrojë individët nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve publike, kjo nuk nënkupton se shteti duhet gjithmonë të abstenojë nga kjo lloj ndërhyrjeje: përveç këtyre detyrimeve negative, ekzistojnë detyrime pozitive të shtetit në lidhje me garantimin e të drejtës për jetë të qetë private. Këto detyrime mund të përfshijnë ndërmarrjen e masave të hartuara për të respektuar jetën private edhe në fushën e marrëdhënieve të individëve mes njëri-tjetrit (shih *X dhe Y k. Holandës*, 26 mars 1985, par. 23, Seria A, nr. 91; *Botta k. Italisë*, 24 shkurt 1998, par. 33, *Raportet* 1998; *Mikulic k. Kroacisë*, nr. 53176/99, par. 57, GJEDNJ, 2002; dhe *Sandra Jankovic*, cituar më lart, par. 44).

**152.** Gjykata ka vlerësuar edhe më parë, në kontekste të ndryshme, se konteksti i jetës private përfshin edhe integritetin psikologjik të një individi. Në kuadër të nenit 8, në disa raste, shtetet kanë detyrën të mbrojnë integritetin moral të një individi nga veprimet e personave të tretë. Gjithashtu, Gjykata ka vërejtur se shtetet kanë një detyrim pozitiv për të siguruar respektimin e dinjitetit njerëzor dhe cilësinë e jetës në disa aspekte (shih *L. k. Lituanisë*, nr. 27527/03, par. 56, GJEDNJ, 2007-IV, dhe *mutatis mutandis*, *Pretty*, cituar më lart, par. 65).

**153.** Gjykata vlerëson se ngacmimet e shqetësimet e vazhdueshme kanë ndikuar edhe në jetën private dhe familjare të kërkueses së dytë. Autoritetet shtetërore nuk kanë vendosur dhe nuk kanë marrë masat përkatëse për të parandaluar shqetësimet e mëtejshme të kërkuesit të parë. Këto autoritete nuk kanë siguruar mbrojtjen e duhur në këtë aspekt as të kërkueses së dytë. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me kërkuesen e dytë.

#### 2) Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 14 të Konventës

**157.** Për sa i përket nenit 14 të Konventës, Gjykata thekson se ai nen nuk zbatohet

i pavarur, por se luan një rol shumë të rëndësishëm, duke plotësuar parashikimet e tjera të Konventës dhe Protokolleve të saj, sepse ai mbron individët e gjendur në situata të njëjta nga çdo formë diskriminimi në gëzimin e të drejtave të vendosura nga Konventa (shih *Dudgeon k. Mbretërisë së Bashkuar*, 22 tetor 1981, par. 67, Seria A, nr. 45; *Chassagnou dhe të Tjerët k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 25088/94, 28331/95 dhe 28443/95, par. 89, GJEDNJ 1999-III; dhe *Timishev k. Rosisë*, nr. 55762/00 dhe 55974/00, par. 53, GJEDNJ, 2005-XII).

[...]

**158.** Gjykata ka konstatuar po ashtu se, edhe në një situatë kur nuk zbatohet një dispozitë materiale, neni 14 mund të jetë sërish i zbatueshëm (shih *Savez crkava "Riječ života" dhe të Tjerët k. Kroacisë*, nr. 7798/08, par. 58, 9 dhjetor 2010). Për pasojë, çështjet e pranueshmërisë lidhur me nenin 14 mund të vlerësohen edhe më vete.

**159.** Për çështjen në fjalë, Gjykata do ta shqyrtojë pretendimin e bazuar në nenin 14 nga këndvështrimi i shterimit të mjeteve efektive ligjore kombëtare, sipas ligjit për Parandalimin e Diskriminimit.

[...]

**161.** Mbrojtja nga diskriminimi duhej të ishte adresuar në gjykatat e zakonshme [...]. E drejta për të mos u diskriminuar është e garantuar nga Kushtetuta kroate dhe në Kroaci, Konventa është drejtpërdrejt e zbatueshme. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kërkuesit përpara se të sillnin një ankim përpara Gjykatës, duhet t'i drejtoheshin fillimisht gjykatave të brendshme për të ndrequr situatën, duke adresuar problemin.

**162.** [...] Kërkuesit nuk i përdorën mjetet e ankimit që kishin në dispozicion.

**163.** Për rrjedhojë, ankimi për shkelje të nenit 14 të Konventës duhet të rrëzohet në bazë të nenit 35, par. 1 dhe 4, për shkak të mos shterimit të mjeteve të brendshme të ankimit.

#### 3) Shpërblimi i drejtë

**172.** Gjykata vlerësoi se kërkuesit duhet të përfitojnë një dëmshpërblim prej 11,500 eurosh në kuadër të dëmit jo material.

“

**Arutyunyan k. Rosisë, 10.01.2012, Nr. 48977/09**

Nëse kushtet në të cilat kërkuesi vuante dënimin me heqje lirie ishin në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore dhe nëse kishte shkelje të nenit 3 të Konventës.

”

**Faktet** – Kërkuesi është një person paraplegjik dhe ka pasur probleme shëndetësore të shumta, përfshi këtu dhe një transplant të dështuar të veshkave, shikim të dobët, diabet dhe probleme serioze me obezitetin. Në prill të vitit 2009, ai u akuzua për vrasje nga pakujdesia dhe u mbajt në një institucion të rregullt paraburgimi. Qelia e tij ndodhej në katin e katërt të ndërtesës, e cila nuk kishte ashensor, ndërsa njësitë mjekësore dhe administrative ndodheshin në katin e parë. Në mungesë të ashensorit, kërkuesi duhej të zbriste dhe të ngjiste shkallët rregullisht, në mënyrë që të kryente hemodializën, si dhe të gjithë trajtimet e tjera mjekësore. Në maj të vitit 2010, ai u shpall fajtor sipas akuzës së ngritur kundër tij dhe u dënua me njëmbëdhjetë vjet heqje lirie. Dy muaj më vonë, ai u dërgua në një tjetër institucion paraburgimi për të kryer dënimin para se të transferohej përfundimisht në një spital rajonal, ku dhe filloi të marrë ndihmën e duhur mjekësore.

Kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkelje të së drejtës për të mos iu nënshtuar trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës, garantuar nga neni 3 i Konventës, për shkelje të së drejtës për liri dhe siguri, garantuar nga neni 5, par. 1, i Konventës, si edhe për shkelje të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë, garantuar nga neni 5, par. 3, i Konventës.

#### Vlerësimi i Gjykatës

#### Në lidhje me trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës

##### a) Parime të përgjithshme

**68.** Në bazë të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, keqtrajtimi duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie, në mënyrë që të përfshihet në kuadrin e mbrojtjes së garantuar nga neni 3 i Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal është relativ, ai varet nga të gjitha rrethanat e rastit, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, si edhe në disa raste gjinia, moshë dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih ndër të tjera *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 24, GJEDNJ, 2001-VII; *Mouiel k. Francës*, nr. 67263/01, par. 37, GJEDNJ, 2002-IX; dhe *Naumenko k. Ukrainës*, nr. 42023/98, par. 108, 10 shkurt 2004). Pretendimet për keqtrajtim duhet të mbështeten në prova (shih *mutatis mutandis*, *Klaas k. Gjermanisë*, 22 shtator 1993, par. 30, Seria A, nr. 269). Për të vlerësuar këto prova, Gjykata përdor standardin “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”, por shton edhe variablen se prova të tilla duhet të ndiqen njëkohësisht nga ekzistenca e përfundimeve bindëse, të qarta dhe koherente, ose nga prezumime të fakteve të pakundërshtueshme

(shih *Ireland k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, par. 161, shkurtimisht, Seria A, nr. 25, dhe *Labita k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 26772/95, par. 121, GJEDNJ, 2000-IV).

**69.** Në mënyrë që një ndëshkim, ose trajtim i lidhur me të, të konsiderohet “çnjerëzor” ose “poshtëruës”, vuajtja ose poshtërimi duhet në çdo rast të shkojë përtej elementëve të pashmangshëm të vuajtjes ose poshtërimit që lidhen me një formë ligjore trajtimi ose ndëshkimi (shih *Jallish k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 54810/00, par. 68, GJEDNJ, 2006-IX).

**70.** Në rastin e personave që u është hequr liria, neni 3 vendos një detyrim pozitiv për shtetin, i cili duhet të garantojë mbajtjen e personit në kushte që respektojnë dinjitetin e tij njerëzor; që mënyra e ekzekutimit të masës së dënimin të mos e vendosë atë në një gjendje ankthi apo mundimi për shkak të një intensiteti që e tejkalon nivelin e pashmangshëm të vuajtjeve, si pjesë e qenësishme e heqjes së lirisë; dhe se, duke marrë parasysh kërkesat praktike të burgimit, shëndeti dhe mirëqenia e personit të sigurohen në mënyrë të përshtatshme, ndër të tjera, duke garantuar edhe ndihmën e duhur mjekësore (shih *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 94, GJEDNJ,

2000-XI, dhe *Riviere k. Francës*, nr. 33834/03, par. 62, 11 korrik 2006). Prandaj, mungesa e kujdesit mjekësor të përshtatshëm dhe burgosja e një personi të sëmurë në kushte të papërshtatshme, në parim, mund të bjerë në kundërshtim me nenin 3 (shih *Lihen k. Turqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 22277/93, par. 87, GJEDNJ, 2000-VII, dhe *Naumenko*, cituar më lart, par. 112).

**71.** Gjykata ndeshet shpesh me ankime për kujdes shëndetësor të pamjaftueshëm ose të papërshtatshëm në burgje. Edhe pse neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se krijon një detyrim të përgjithshëm për t'i liruar nga burgu, ose për t'i shtruar në spitale civile të ndaluarit që vuajnë nga ndonjë sëmundje, madje edhe në rastet kur ata janë duke vuajtur nga një sëmundje që është shumë e vështirë për t'u trajtuar (shih *Mouiel*, cituar më lart, par. 40), ky nen i vendos shtetit detyrimin për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të cilëve u është hequr liria. Gjykata nuk mund të përjashtojë mundësinë që, në raste veçanërisht të rënda, mund të krijohen situata kur administrimi i duhur i drejtësisë penale kërkon marrjen e masave humanitare (shih *Matencio k. Francës*, nr. 58749/00, par. 76, 15 janar 2004, dhe *Sakkopoulos k. Greqisë*, nr. 61828/00, par. 38, 15 shkurt 2004). Në rrethana të veçanta, e drejta e garantuar nga neni 3 mund të shkojë aq larg, sa të kërkojë lirim me kusht të një të burgosuri, i cili është i sëmurë rëndë ose ka aftësi të kufizuara. Në zbatim të këtyre parimeve, Gjykata është shprehur tashmë se burgosja për një periudhë të gjatë e një personi të moshuar, të sëmurë, mund të futet në fushën e veprimit të nenit 3 (shih *Papon k. Francës* (nr. 1), nr. 64666/01, GJEDNJ, 2001-VI; *Sawoniuk k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 63716/00, GJEDNJ 2001-VI; dhe *Priebke k. Italisë*, nr. 48799/99, 5 prill 2001).

#### b) Zbatimi i parimeve në çështjen konkrete

**73.** Në çështjen objekt gjykimi, pyetja që shtrohet është nëse kushtet në të cilat kërkuesi vuante dënimin ishin të përshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore dhe, nëse kjo situatë ka pasur një nivel të mjaftueshëm ashpërsie për t'u përfshirë brenda qëllimit të nenit 3 të Konventës.

**76.** Lista e ankesave të kërkuesit mund të ndahet në dy grupe të mëdha; grupi i parë përfshin mundësitë e tij për përdorur ambientet administrative, teknike, argëtuese dhe mjekësore në ndërtesë ose jashtë saj, si për shembull, gjykatat ose spitalin; dhe grupi i dytë lidhet me pakënaqësitë e tij në lidhje me faktin se i është hequr liria në një burg të zakonshëm, dhe jo në një spital burgu.

**77.** [...] Në kuadër të fakteve të çështjes, Gjykata rithekson se ndërkohë, ajo ka gjykuar një rast për shkelje të nenit 3, për shkak të mungesës së mundësive për përdorimin e ambienteve të jashtme (shih *Poltoratskiy k. Ukrainës*, nr. 38812/97, par. 146, GJEDNJ, 2003V). Megjithatë, për Gjykatën, më problematik është fakti se kërkuesi ka qenë i irrituar, i lodhur nga gjendja ku ndodhej dhe në pamundësi për të luftuar stresin dhe poshtërimin, e shkaktuar nga mungesa e një ashensori në ndërtesë, dhe se herë pas here, ai ka refuzuar të largohet nga qelia, për të kryer hemodializën, ose kontrollet mjekësore.

**79.** Në këtë çështje, nuk ka asnjë provë për ekzistencën e një qëllimi të drejtpërdrejt për poshtërimin e kërkuesit. Gjykata nuk mund të dalë në përfundimin se autoritetet e burgut kanë qenë indiferente ndaj kërkesave të zotit Arutyunyan [...]. Megjithatë, Gjykata e vlerëson si të papranueshëm faktin se autoritetet ruse kanë refuzuar në mënyrë të vazhdueshme ankesat e kërkuesit për t'u transferuar në një institucion tjetër të vuajtjes së dënimit, ose në një spital burgu. Madje, as përfaqësuesit e qeverisë nuk kundërshtuan faktin që ky institucion ishte i papërshtatshëm për kërkesat e veçanta të kërkuesit; se nuk kishte pajisje dhe personel të përshtatshëm mjekësor, për t'i siguruar zotit Arutyunyan kujdesin e duhur shëndetësor, duke përfshirë këtu edhe hemodializën [...]. Gjykata vlerëson se, pavarësisht numrit të ankesave të bëra nga kërkuesi, nuk u mor asnjë masë për t'i gjetur atij një vend të përshtatshëm për vuajtjen e dënimit në ndonjë rajon tjetër të Rusisë (shih për arsyetim të njëjtit *Mathew k. Holandës*, nr. 24919/03, par. 204 dhe 215, GJEDNJ, 2005IX).

**80.** Gjykata rithekson se duhet shqyrtuar edhe grupi i dytë i ankesave të kërkuesit, i cili përmban pretendime për kushte të papërshtatshme sanitare dhe higjienike në burg, duke kujtuar se një pjesë e madhe e ekzaminimeve mjekësore janë kryer brenda një dhome të zakonshme në godinën e burgut. [...].

**81.** Si përfundim, Gjykata vlerëson se autoritetet vendase nuk mundën ta mbanin kërkuesin në një vend të sigurt dhe të përshtatshëm për aftësitë e tij të kufizuara, duke i mohuar atij përdorimin efektiv të ambienteve mjekësore, marrjen pjesë në aktivitete në ambiente të jashtme dhe në ajër të pastër. Kërkuesit i është dashur të durojë kushte ndalimi të papërshtatshme, të cilat i kanë shkaktuar atij vuajtje fizike dhe mendore, që mund të ishin shmangur dhe të cilat kanë cenuar dinjitetin e tij njerëzor, duke i shkaktuar një trajtim

çnjerëzor. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës.

#### Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 1, të Konventës

**87.** Gjykata thekson se nocionet "i ligjshëm" dhe "në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj", të parashikuara në nenin 5, par. 1, të Konventës, i referohen në thelb legjislacionit të brendshëm dhe deklarojnë detyrimin e shtetit për të vepruar në përputhje me rregullat materiale dhe procedurale. Megjithatë, ligjshmëria e heqjes së lirisë, sipas legjislacionit vendas, nuk është gjithmonë një element vendimtar. Përveç kësaj, Gjykata duhet të vlerësojë nëse periudha e ndalimit ka qenë në përputhje me qëllimin e nenit 5, par. 1, të Konventës, i cili garanton që individëve të mos i hiqet ose kufizohet liria në mënyrë arbitrare.

**88.** Gjithashtu, Gjykata duhet të vlerësojë nëse ligji vendas është në përputhje me Konventën, duke përfshirë këtu edhe parimet e përgjithshme që shprehen ose që rrjedhin prej saj [...]. Gjykata thekson se, kur heqja e lirisë është në përputhje me ligjin, është veçanërisht e rëndësishme që të përmbushet parimi i sigurisë juridike. Për rrjedhojë, ka shumë rëndësi që rastet dhe mënyrat se si mund të hiqet liria, sipas legjislacionit vendas, të jenë të përcaktuara në mënyrë të qartë. Në këtë mënyrë, ligji vendas plotëson standardin e "ligjshmërisë" të vendosur nga Konventa, një standard i cili kërkon që mbi të gjitha ligji të jetë mjaft i saktë për të lejuar personin – në rastet kur është e nevojshme dhe përmes këshillimit juridik – të parashikojë, në një masë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i kryer (shih *Ječius k. Lituanië*, nr. 34578/97, par. 56, GJEDNJ, 2000-IX, dhe *Baranowski k. Polonisë*, nr. 28358/95, par. 50-52, GJEDNJ, 2000-III).

**92.** Megjithatë, edhe duke supozuar se argumentet e qeverisë për ndalimin e kërkuesit janë të vlefshme, Gjykata nuk mund të kuptojë faktin se përse, në vendimin e 21 janarit 2010, nuk u dha asnjë arsye për domosdoshmërinë e mbajtjes së kërkuesit në paraburgim. Gjithashtu, vendimi nuk parashikonte një afat kohor kur do të përfundonte, ose kur do të rivlerësohej masa e sigurimit. Gjykata ka vlerësuar në një sërë çështjesh të ngjashme kundër Rusisë shkelje të nenit 5, par. 1 (c), të Konventës (shih për shembull *Solovyev k. Rusisë*, nr. 2708/02, par. 95-100, 24 maj 2007; *Shukhardin*, cituar më lart, par. 65-70; dhe *Belov k. Rusisë*, nr. 22053/02, par. 80-83, 3 korrik 2008). Në veçanti, Gjykata ka vërejtur se mungesa

e argumenteve nga autoritetet gjyqësore, në vendimet që autorizojnë paraburgimin për një kohë të pacaktuar, është në kundërshtim me parimin e mbrojtjes nga arbitrariteti shtetëror, garantuar nga neni 5, par. 1, (shih gjithashtu *Nakhmanovich k. Rusisë*, nr. 55669/00, par. 70-71, 2 mars 2006, dhe *Stašaitis k. Lituanië*, nr. 47679/99, par. 67, 21 mars 2002). Lejimi i një individi që të vuajë masën e sigurimit arrest me burg, pa pasur një vendim juridik të bazuar mbi argumente dhe fakte konkrete e duke mos i caktuar afat masës së sigurimit, sjell shkelje të nenit 5, nen i cili parashikon që heqja e lirisë të jetë një përjashtim nga e drejta e lirisë dhe mund të lejohet vetëm për rastet e renditura në mënyrë shteruese dhe të përcaktuara në mënyrë rigorozë (shih *Khudoyorov k. Rusisë*, nr. 6847/02, par. 142, GJEDNJ, 2005-X).

**93.** Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë arsye që të arrijë në një përfundim të ndryshëm për rastin konkret, objekt gjykimi. Ajo vlerëson se vendimi i 21 janarit 2010 nuk përmbush kriterin e qartësisë, parashikueshmërisë dhe ligjshmërisë, që një urdhër ndalimi duhet të përmbajë sipas kuptimit të nenit 5, par. 1.

**94.** Për rrjedhojë, Gjykata vëren se ka pasur shkelje të nenit 5, par. 1 (c), të Konventës për sa i përket paraburgimit të kërkuesit nga 24-28 janar 2010.

[...]

#### Shpërblimi i drejtë

**114.** Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk duhet të përfitojë dëmshpërblim në kuadër të dëmit material. Ndërkohë, Gjykata i akordoi zotit Arutyunyan 15,000 euro në kuadër të dëmit jo material.



Zoti H. k. Hungarisë, 08.11.2012, Nr. 28973/11

Nëse ndalimi i kërkuesit dhe kushtet e vuajtjes së dënimit shkelnin garancitë sipas nenit 3 dhe nenit 5 të Konventës.



**Faktet** - Kërkuesi është një person që ka probleme me të folurit dhe dëgjimin, është analfabet dhe nuk mund të përdorë gjuhën e shenjave. Ai gjithashtu vuan nga çrregullime të shëndetit mendor. Ai komunikon përmes përdorimit të një metode të veçantë të gjuhës së shenjave, e kuptueshme vetëm nga mamaja e tij. Në 10 prill 2011, ai u arrestua si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes, si edhe u mor në pyetje në komisariatit e policisë në praninë e një përkthyesi të gjuhës së shenjave, i cili u ankua se nuk e kuptonte kërkuesin. Ai u mbajt i paraburgosur deri më 4 korrik 2011, kur Gjykata e Shkallës së Parë vendosi lirimin e tij me arrest shtëpie, duke theksuar se ndaj kërkuesit duhet të merrej një masë më e lehtë sigurimi persona, për shkak të aftësive të tij të kufizuara dhe vështirësive në komunikim.

Kërkuesi u ankua se kushtet në të cilat ishte ndaluar dhe mbajtur në paraburgim së bashku me të paraburgosurit e tjerë nuk ishin të përshtatshme për një person në gjendjen e tij. Në shtator të vitit 2011, ai u vendos nën kujdestari të pjesshme. Ndërkohë, kur çështja u gjykua përpara GJEDNJ-së, procesi penal ndaj tij ishte ende i papërfunduar.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Pretendimi për shkelje të nenit 3

**28.** Gjykata kujton se keqtrajtimi duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie, për të qenë brenda qëllimit të nenit 3 të Konventës. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, si kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Për të vlerësuar nëse trajtimi është “poshtëruar” në kuadër të nenit 3, një nga faktorët që do të merret në konsideratë nga Gjykata është nëse qëllimi i tij ishte të poshtëronte apo përulte personin, edhe pse mungesa e ndonjë qëllimi të tillë nuk mund përjashtojë përfundimisht gjetjen e një shkeljeje të nenit 3 (shih ndër të tjera *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 24, GJEDNJ, 2001VII; *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 67-68 dhe 74, GJEDNJ, 2001-III; dhe *Engel k. Hungarisë*, nr.46857/06, par. 26, 20 maj 2010).

**58.** Gjykata thekson se fjalia e parë e nenit 2 të Konventës, e cila konsiderohet si një nga garancitë kryesore të saj dhe pasqyron një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike që bëjnë pjesë në Këshillin e Evropës (shih ndër të tjera *McCann dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, par. 147, Seria A, nr. 324), i detyron shtetet anëtare që jo vetëm të mos marrin jetën e

shtetasve të tyre në mënyrë “të qëllimshme”, por edhe të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e shtetasve nën juridiksionin e tyre (shih *L.C.B k. Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, par. 36, GJEDNJ, 1998-III).

**29.** Kur autoritetet shtetërore vendosin ndalimin e një personi me aftësi të kufizuara, ata duhet të tregojnë kujdes të veçantë për të garantuar kushte të përshtatshme, në përputhje me nevojat e veçanta të personit të ndaluar (shih *mutatis mutandis Jasinskis k. Letonisë*, nr. 45744/08, par. 59, 21 dhjetor 2010, *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 33394/96, par. 30). Për më tepër, GJEDNJ-ja është shprehur edhe më parë se shtetet anëtare kanë detyrimin që të marrin masa efektive për mbrojtjen e personave në gjendje të brishtë nga keqtrajtimi, për të cilin autoritetet kanë pasur, ose duhet të kenë pasur dijeni se po ndodhte (shih *Z dhe të dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar* [Dhoma e Madhe], nr. 29392/95, par. 73, GJEDNJ, 2001-V).

**31.** Gjykata nuk është e bindur nëse masat që qeveria referoi se ishin marrë – konkretisht, mbajtja e kërkuesit në një qeli me kushëririn e tij, afër zyrës së rojës, përfshirja e të burgosurve të tjerë dhe nënës së kërkuesit në përbalimin e situatës dhe lehtësimin e korrespondencës së tij – ishin të mjaftueshme [...]. Meqenëse, kërkuesi i përket një grupi të caktuar të brishtë dhe, si i tillë, duhet të

kishte përfituar nga masa të marra prej autoriteteve të cilat do të kishin parandaluar situata që cilësohen si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar, Gjykata vëren se ishte detyrë e qeverisë të provonte se në këtë rast, autoritetet vendase kishin marrë masat e duhura. Shpërndarja në mënyrë të tillë e barrës së provës është analoge me mënyrën me të cilën Gjykata shqyrton situatat në të cilat një individ është marrë në komisariatit e policisë në gjendje të mirë, por menjëherë sapo e kanë liruar është sëmurë; ndaj është e detyrueshme për shtetin të japë shpjegime bindëse se si janë shkaktuar plagët, sepse në rast të kundërt do të ngrihet një çështje sipas nenit 3 të Konventës (shih ndër të tjera *Selmouni k. Francës* [Dhoma e Madhe], nr. 25803/94, par. 87, GJEDNJ, 1999V).

**32.** Në çështjen konkrete, objekt gjykimi, Gjykata vëren se qeveria nuk mundi të siguronte prova bindëse, veçanërisht në lidhje me pjesën e parë të ndalimit [...].

**33.** Në përfundim, Gjykata vlerëson se, pavarësisht faktit që, megjithëse me vonesë, autoritetet u munduan ta trajtonin sërish situatën, ndalimi i kërkuesit pa marrë asnjë masë të nevojshme në kohën e duhur, mund të kishte shkaktuar trajtim çnjerëzor dhe poshtëruar, në shkelje të nenit 3 të Konventës, edhe si pasojë e aftësive të kufizuara të kërkuesit. Për rrjedhojë, në këtë rast ka pasur një shkelje të nenit 3.

### Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 5, par. 2

**41.** Gjykata vëren se par. 2, neni 5, përmban një garanci minimale për personat e ndaluar, të cilët duhet të marrin dijeni se përse u është cenuar liria. Ky parashikim është një pjesë integrale e skemës së mbrojtjes, garantuar nga neni 5 [...] (shih *Fox, Campbell dhe Hartley k. Mbretërisë së Bashkuar*, 30 gusht 1990, par. 40, Seria A, nr. 182). Neni 5 par. 2 nuk kërkon që informacioni i nevojshëm të transmetohet në një formë të caktuar dhe të përmbajë një listë të detajuar të akuzave të ngritura kundër personit të ndaluar (shih *X. k. Gjermanisë*, nr. 8098/77, vendim i Komisionit 13 dhjetor 1978, Vendime dhe Raporte 16, f. 111).

Gjithsesi, sipas vlerësimit të Gjykatës, nëse aftësitë e kufizuara intelektuale të një personi nuk merren në konsideratë në këtë proces, nuk mund të thuhet se individit i është siguruar informacion i mjaftueshëm, përmes të cilit ai mund të ndërmarrë masa efektive në kuadër të nenit 5, par. 4, të Konventës, duke vënë në diskutim ligjshmërinë e ndalimit, përveç rasteve kur është njoftuar avokati ose ndonjë person tjetër

i autorizuar (shih *X. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 6998/75, Raport i Komisionit 16 korrik 1980, par. 111, Seria B, nr. 41).

**42.** Në rastin konkret, kërkuesi kishte aftësi të kufizuara intelektuale në të folur dhe në të dëgjuar. Gjithashtu, ai nuk mund të komunikonte me gjuhën zyrtare të shenjave [...].

**43.** Gjykata vëren se, është për të ardhur keq që autoritetet nuk morën asnjë “masë të arsyeshme”- nocion mjaft i ngjashëm me “përshtatjen e arsyeshme”, përmendur në nenet 2, 13 dhe 14 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – për të adresuar në mënyrën e duhur kushtet e kërkuesit, veçanërisht duke i siguruar atij asistencë ligjore nga një avokat ose një person tjetër i përshtatshëm. Sipas Gjykatës, punonjësit e policisë që morën në pyetje kërkuesin duhet ta kenë kuptuar se, në rrethanat në fjalë, nuk ishte i mundur asnjë lloj komunikimi kuptimplotë me kërkuesin dhe se **ata duhet të kishin kërkuar asistencë pikësëpari nga nëna e kërkuesit** (e cila më e pakta do t’i kishte informuar punonjësit e policisë për shkallën e problemeve të kërkuesit në komunikim) – dhe jo thjesht ta detyronin kërkuesin të nënshkruante procesverbalin e marrjes në pyetje.

**44.** Vërejtjet e mësipërme janë të mjaftueshme që Gjykata të arrijë në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 5, par. 2, të Konventës.

### Shpërblimi i drejtë

**88.** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljeve të konstatuara në këtë çështje, Gjykata i cakton kërkuesit si dëmshpërblim 16.000 euro në kuadër të dëmit jo material dhe 3.000 euro për shpenzimet gjyqësore.



### Groni k. Shqipërisë, nr. 25336/0, 7 korrik 2009

Nëse mosdhënia e kujdesit të duhur mjekësor për kërkuesin ka cenuar të drejtën e tij për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor e degradues.



**Faktet** – Kërkuesi,<sup>102</sup> zoti Groni, vuante dënimin në Shqipëri pas ndalimit të tij në prill 2001, në bazë të urdhër-arrestit të lëshuar në Itali. Nga shtatori 2003 deri në shkurt 2004, zoti Groni bëri kërkesë për ekzaminim të duhur mjekësor, si pasojë e përkeqësimit të gjendjes së tij shëndetësore. Disa muaj më vonë, në gusht 2004, ai u diagnostikua me sklerozë multiple. Mjekët raportuan se sëmundja mund t'i shkaktonte tronditje, dëmtime të organeve, paaftësi të përhershme ose vdekje. Në vitin 2005, ai u ankua për neglizhencë të prokurorisë dhe shefit të Spitalit të Burgut të Tiranës, në lidhje me kujdesin e vonuar mjekësor ndaj tij dhe trajtimin me ilaçe jo të përshtatshme. Në janar 2008, GJEDNJ-ja vendosi një masë të ndërmjetme, sipas Rregullës 39, duke kërkuar transferimin e menjëhershëm të kërkuesit në një spital civil, në mënyrë që t'i nënshtruhej ekzaminimit dhe trajtimit të duhur. Transferimi u krye më 28 janar, 17 ditë më pas.

<sup>102</sup> Kjo çështje trajton edhe aspekte të tjera, të cilat janë jashtë qëllimit të këtij punimi, ndaj edhe faktet dhe pretendimet përkatëse nuk janë përfshirë në këtë punim.

## Vlerësimi i Gjykatës

### B. Themeli i çështjes

**38.** Ankuesi pretendon se autoritetet nuk i kanë dhënë trajtimin mjekësor të kërkuar prej tij, sipas mendimit dhe recetave të mjekëve civilë, duke shkakuar keqtrajtimin e tij. Ai u bazua tek raportet mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore dhe, në veçanti, tek raportet mjekësore të datës 19 prill 2005 dhe 12 dhjetor 2006, të cilat theksojnë mungesën e trajtimit mjekësor të marrë nga ankuesi për një periudhë të zgjatur kohe dhe ndikimet e këtij mostrajtimi në përkeqësimin e shëndetit të tij.

**39.** Qeveria insistoi se ankuesi kishte marrë trajtimin e saktë dhe të duhur mjekësor. Në parashtrimet e saj tregohet se, nga koha e arrestimit në vitin 2001 e në vijim, ankuesi kishte marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut të Tiranës nëntë herë, ku i ishte ofruar trajtimi dhe ekzaminimet e duhura mjekësore. Qeveria përfundoi se pretendimi i ankuesit, sipas nenit 3, ishte i pabazuar.

**40.** Pas njoftimit të Gjykatës për marrjen e masës së përkohshme, sipas nenit 39 të Rregullores së gjykatës, qeveria parashtrori se mjekimi i ankuesit me *interferon beta* kishte një kosto shumë të lartë për administratën e burgjeve. Por, gjithsesi, Qeveria pranoi se ky mjekim jepet pa pagesë për publikun e përgjithshëm në spitale.

**41.** Gjykata vëren se palët paraqitën të dhëna të ndryshme në lidhje me ndihmën mjekësore të marrë nga ankuesi në burg. Si rrjedhim, gjykata do të fillojë shqyrtimin e saj të pretendimeve të ankuesit në lidhje me nenin 3, për përcaktimin e fakteve përkatëse.

#### a) Përcaktimi i fakteve

[...]

**42.** Nuk diskutohet nga palët se, që pas arrestimit të tij në vitin 2001, deri në gusht të 2004, ankuesi ka marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut për simptoma dhe sindroma të ndryshme. Pavarësisht moshës së re, ankuesi vuante, përveç të tjerash, nga vështirësi në lëvizje dhe dhimbje të fortë në ekstremitetet e poshtme, probleme në urinim dhe nga kapsllëku. Vetëm në gusht të vitit 2004, pas një ekzaminimi të hollësishëm, ankuesi u diagnostikua se vuante nga skleroza multiple.

**43.** Nga janari deri në shtator 2005, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut për trajtim dhe ekzaminime vetëm në një rast, pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura. Kështu, më 19 prill 2005, një grup mjekësh e vizituan, konfirmuan diagnozën e sklerozës multiple dhe e trajtuan në mënyrë të vazhdueshme me interferon-beta, në përputhje me protokollin mjekësor [...].

**44.** Gjykata vëren me shqetësim se, gjatë heqjes së lirisë së kërkuesit nga muaji prill i vitit 2005, deri në 28 janar 2008, datë në të cilën ankuesi i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor si rezultat i marrjes së masës së përkohshme nga gjykata, ankuesi ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtimin e duhur mjekësor. Raporti i fundit mjekësor për gjendjen shëndetësore të ankuesit konfirmoi se zhvillimi i sëmundjes me kalimin e viteve kishte ardhur si rezultat i mungesës së kujdesit mjekësor.

**45.** Në të paktën dy raste, babai i ankuesit i ka kërkuar administratës së burgut një kontroll të pavarur mjekësor të shëndetit të ankuesit dhe trajtim të duhur mjekësor për të [...]. Gjithsesi, këto kërkesa ishin refuzuar: siç rezultoi nga certifikata mjekësore e dhënë nga qeveria, ekzaminimet mjekësore të mëparshme të ankuesit ishin bërë të munduara vetëm pas miratimit të prokurorit. Është alarmuese që çështja e ekzaminimit mjekësor të ankuesit ishte lënë në dorën e prokurorit, jo mjekëve, për të vendosur nëse ankuesi do të kishte nevojë për ekzaminime të tjera mjekësore.

**46.** Shkurtimeisht, faktorët e sipërpërmendur duket se mbështesin pretendimet e ankuesit se kujdesi i tij mjekësor në burg ka qenë i papërshtatshëm. Në rrethana të tilla, i takonte qeverisë që ta kundërshtojë këtë konstatim. Gjithsesi, qeveria nuk ofroi asnjë dokument për të justifikuar arsyet përse autoritetet refuzuan t'i jepnin ankuesit trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, dhe nuk shpjegoi se trajtimi me vitamina dhe anti-depresantë mund të konsiderohet i përshtatshëm (Shih *mutatis mutandis*, *Ostrovar k. Moldavisë*, nr. 35207/03, par. 86, 13 shtator 2005). Qeveria thjesht dhe në mënyrë tepër sipërfaqësore pretendon, pa shpjeguar ose pa ofruar argumente të mëtejshme, se kërkuesi i është nënshtruar "trajtimit spitalor disa herë në ambientet e spitalit të burgut". Si rezultat, gjykata është e mendimit se qeveria nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për përkeqësimin e shëndetit të kërkuesit në burg.

**47.** Si rezultat, gjykata e pranon versionin e kërkuesit për problemet e tij shëndetësore dhe ndihmën mjekësore të marrë gjatë burgimit. Në veçanti, gjykata pranon se nga tetori i vitit 2004, e deri në prill të vitit 2005, ankuesit i është refuzuar ekzaminimi mjekësor dhe trajtimi në spitalin e burgut dhe se trajtimi mjekësor i tij në burg nuk ishte në përputhje me kushtet e tij shëndetësore. Gjatë gjithë periudhës së vuajtjes së dënimit, nga tetori i vitit 2004 e në vijim, autoritetet nuk arritën ta monitoronin sëmundjen e tij dhe t'i ofronin trajtimin

e duhur mjekësor, gjë që çoi në përkeqësimin e kushteve shëndetësore të tij. Nga maji i vitit 2005 deri në 28 janar të vitit 2008, u mendua se kërkuesi nuk kishte nevojë për trajtim mjekësor shtesë, pavarësisht nga raportet e mjekëve civilë për një gjë të tillë. Vetëm më 17 qershor 2008, kërkuesit iu ofrua trajtimi i nevojshëm, si rezultat i ekzaminimeve mjekësore të 28 janarit 2008.

**48.** Gjykata tani do të shqyrtojë nëse këto fakte, të marra së bashku me rrethanat përkatëse të çështjes, çojnë në "trajtim çnjerëzor dhe degradues", siç sugjerohet nga ankuesi.

#### b) Shqyrtimi i ankesës

**49.** Gjykata thekson se neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ai ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin apo dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih *Labita k. Italisë*, nr. 26772/95, par. 119, GJEDNJ, 2000-IV).

**50.** Gjykata thekson më tej se, sipas jurisprudencës së saj, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal ashpërsie për t'u konsideruar se hyn në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ky minimum varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, efektet e saj fizike dhe mendore dhe, në disa raste, nga seksi, mosha, gjendja shëndetësore e viktimës (Shih ndërmjet autoriteteve të tjera, *Irlanda k. Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 18 janarit 1978, Seritë A nr. 25, f. 65, par. 162). Megjithatë qëllimi i një trajtimi të tillë është faktor për t'u marrë parasysh, në veçanti, nëse trajtimi kishte si qëllim poshtërimin ose degradimin e personit, mungesa e një qëllimi të tillë nuk çon në mënyrë të paevitueshme në arritjen e përfundimit se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 (shih *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 74, GJEDNJ, 2001-III).

**51.** Në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit nuk përputhet absolutisht me burgimin, neni 3 mund të kërkojë vendosjen e një personi të tillë në kushte të caktuara (shih *Papon k. Francës* (nr. 1), nr. 64666/01, GJEDNJ, 2001-VI, dhe *Priebke k. Italisë*, nr. 48799/99, 5 prill 2001). Ka tre elemente të veçanta që duhen shqyrtuar në lidhje me përputhshmërinë e shëndetit të kërkuesit me qëndrimin e tij në burgim: (a) kushtet mjekësore të të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; dhe (c) këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të kërkuesit (shih *Mouiel k. Francës*, nr. 67263/01, par. 40-42, GJEDNJ, 2002-IX).

52. Gjithsesi, neni 3 nuk mund të interpretohet sikur parashikon një detyrim të përgjithshëm për lirim të burgosurve për arsye shëndetësore. Në fakt, ai i vendos detyrimin shtetit që të mbrojë mirëqenien fizike të personave të cilëve iu është mohuar liria. Gjykata e pranon se, ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut, jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në institucionet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, shteti duhet të sigurojë mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenien e të burgosurve nëpërmjet, ndër të tjerash, ofrimin të ndihmës së nevojshme mjekësore (shih *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 94, GJEDNJ, 2000-XI; shih gjithashtu *Hurtado k. Zvicrës*, vendimi i 28 janarit 1994, Seritë A nr. 280-A, opinion i Komisionit, f. 15-16, par. 79; dhe *Kalashnikov k. Rusisë*, nr. 47095/99, par. 95 dhe 100, GJEDNJ, 2002-VI). Në çështjen *Farbtuhs k. Letonisë* (nr. 4672/02, par. 56, 2 dhjetor 2004), Gjykata theksoi se nëse autoritetet vendosin të çojnë dhe të mbajnë një person të sëmurë rëndë në burg, duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për të garantuar kushte burgimi të cilat u përshtaten nevojave të veçanta të të burgosurit, për shkak të paaftësisë së tij (shih gjithashtu *Paladi k. Moldavisë*, nr. 39806/05, par. 81, 10 korrik 2007).

53. Gjykata mban parasysh raportet e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) të cilat, ndonëse nuk përmbajnë informacion që lidhet drejtpërdrejt me kushtet aktuale të ndalimit dhe gjendjen shëndetësore të ankuesit, gjithsesi e informojnë gjykatën duke i dhënë një panoramë të plotë të situatës së përgjithshme në burgjet në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë (Shih për shembull, *I.I. k. Bullgarisë*, nr. 44082/98, par. 71, 9 qershor 2005).

54. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, gjykata vëren se, provat nga burime të ndryshme mjekësore, konfirmojnë që kërkuesi kishte probleme të shumta mjekësore, të cilat kërkonin kujdes të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku kërkuesi ishte vizituar në shumë raste, dhe sëmundja e tij prezumohet se mund të ishte trajtuar në atë njësi.

55. Në të njëjtën kohë, gjykata u referohet vëzhgimeve të saj se kërkuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore (Shih par. 46 dhe 47 më lart). Edhe ndërkohë që ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, kërkuesi mund të ketë pasur dijeni se ishte në rrezik

të një urgjence mjekësore në çdo moment, e cila mund të ishte me pasoja serioze, dhe se në burg nuk gjendej ndihmë e kualifikuar mjekësore. Kërkuesit, jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por edhe u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij. Kjo mund të ketë krijuar një gjendje ankthi të konsiderueshëm të kërkuesi.

56. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i kërkuesit me *interferon beta* do ta rëndonte shumë buxhetin e Shtetit. Ndonëse Gjykata nuk i nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky ilaç publikut në spitale i ofrohet pa pagesë. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar mohimin e të drejtës së kërkuesit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të shoqërisë, që shpenzimet e barnave mjekësore të tij të mbuloheshin plotësisht nga shteti përkatës.

57. Kërkuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, nga skleroza multiple. Edhe nëse zbulohet dhe trajtohet shpejt, kjo sëmundje mund të shkaktojë paaftësi (njohëse, gjyquese, dhe çrregullime të kujtesës, probleme në lëvizje, dhimbje, gjendje të dobët dhe mosfunksionim të muskujve unazorë), si dhe vdekje. Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e burgimit, e intensifikuan frikën e tij. **Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur dhe refuzimi i autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor, që jepej nga mjekët civilë, i krijuan një ndjenjë të fortë mungese sigurie e cila, bashkë me vuajtjet fizike, çuan në trajtimin degradues të tij, të parashikuar nga neni 3.**

58. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

“

Dybeku k. Shqipërisë, 18.12.2007, Nr. 41153/06

Nëse mungesa e kujdesit të përshtatshëm shëndetësor gjatë vuajtjes së dënimit për kërkuesin, i cili vuante nga aftësi të kufizuara mendore, shkelte të drejtën e tij për të mos iu nënshtruar trajtimit çnjerëzor e poshtëruar.

”

**Faktet** - Prej vitit 1996 e në vazhdim, kërkuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake dhe, për shumë vite, ka qenë i shtruar për kurim në disa spitale psikiatrike në Shqipëri. Në gusht të vitit 2002, si pasojë e një shpërthimi të ndodhur në apartamentin e motrës së kërkuesit, mbetën të vdekur dy fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, si edhe një person i tretë. Një ditë pas ngjarjes, kërkuesi u arrestua dhe u akuzua për veprën penale të vrasjes dhe posedimit të paligjshëm të lëndëve eksplozive. Në maj 2003, duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, sipas të cilit, në kohën e kryerjes së veprës, çrregullimi mendor i ZOTIT Dybeku ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi se kërkuesi ishte i aftë t'i nënshtronte procesit gjyqësor. Për rrjedhojë, kjo gjykatë e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Ankesat e babait dhe të avokatit të zotit Dybeku kundër administratës dhe personelit mjekësor të spitalit të burgut për pakujdesi dhe trajtim mjekësor jo të përshtatshëm, nuk u morën në konsideratë nga autoritetet. Kërkuesi paraqiti një ankesë përpara GJEDNJ-së për shkelje të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Konventës

24. Gjykata vlerëson se pavarësisht se kërkuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës, kërkesa e tij do të shqyrtohet sipas këtij neni të KEDNJ-së.

[...]

35. Gjykata rithekson se neni 3 i Konventës përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ai i ndalon absolutisht kushtet e torturës dhe trajtimin e dënimit çnjerëzor, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (*Shih Van der Ven k. Holandës*, nr.50901/99 par. 46, ECHR 2003-II, dhe *Poltoratskiy k. Ukrainës*, nr. 38812/97, par. 130, GJEDNJ, 2003-V).

36. Gjykata vëren se, sipas jurisprudencës së saj, trajtimi i sëmundjes duhet të ndikojë në nivelin minimal në kushtet e vuajtjes së dënimit, në mënyrë që të jetë brenda kuptimit të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të vuajtjes së dënimit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore por, në disa raste, varet nga gjinia, moshja dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE],

nr. 30210/96, par. 91, GJEDNJ, 2000-XI; *Mouiel k. Francës*, nr. 67263/01, par. 37, GJEDNJ, 2002-IX; dhe *Papon k. Francës* (nr.1), nr. 64666/01, GJEDNJ, 2001-VI).

44. Gjykata vëren se asnjë nga palët në proces nuk e kundërshtoi faktin se kërkuesi vuante nga çrregullime të rënda të shëndetit mendor të një natyre kronike, të cilat i shkaktonin atij ndjenja paranoje. Vlerësimi i fundit mbi shëndetin e kërkuesit ishte bërë në vitin 2002 dhe që prej asaj kohe, kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë, duke mos iu nënshtruar asnjë ekzaminimi pas përkeqësimit të gjendjes së tij. Sipas Gjykatës, trajtimi që duhej të merrte kërkuesi, në bazë të praktikave mjekësore të zbatueshme, do të varej nga vendimi i autoriteteve shtetërore.

48. Gjykata pranon se gjendja psikologjike e kërkuesit e bën atë më të cenueshëm se të paraburgosurit e tjerë, duke i shkaktoar ndjenja stresi, ankthi dhe pasigurie. Fakti që autoritetet shqiptare pranuan që kërkuesi ishte trajtuar në mënyrë të njëjtë me të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij të veçantë, tregoi se autoritetet shqiptare nuk kanë zbatuar rekomandimet e Këshillit të Evropës në lidhje me trajtimin e të burgosurve me nevoja të veçanta. Në vendimet e fundit, Gjykata ka tërhequr vëmendjen lidhur me

rëndësinë e këtyre rekomandimeve, pavarësisht natyrës jo të detyrueshme që ato kane për shtetet anëtare (shih *Rivière k. Francës*, nr. 33834/03, par. 72, 11 korrik 2006, dhe *Naumenko k. Ukrainës*, cituar më lart, par. 94).

**49.** Gjykata çmon se autoritetet shqiptare nuk arritën të paraqisnin informacion të detajuar mbi kushtet e ndalimit të kërkuesit, ose të provonin se kushtet e tij mendore ishin të përshtatshme për të qëndruar në të njëjtin ambient me të gjithë të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, vizitat periodike të kërkuesit në spitalin e burgut nuk mund të konsiderohen si zgjidhje efektive, përderisa zoti Dybeku është duke kryer një dënim të përjetshëm.

**50.** Gjykata vëren se kërkuesit mund t'i ishte ofruar trajtimi i përshtatshëm mjekësor, pa përfshirë kosto të larta financiare. **Mungesa e një trajtimi të tillë, duke marrë në konsideratë gjendjen shëndetësore të zotit Dybeku, nuk**

**mund të justifikohet** (shih *Poltoratskly*, par. cituar më lart, dhe *Iovchev v. Bulgaria*, nr.41211/98, par. 136, 2 shkurt 2006).

**51.** Gjykata, duke marrë në konsideratë pasojat kumulative të burgimit të kërkuesit, të cilat patën efekt të dëmshëm në shëndetin e tij, në bazë të raportit të Komitetit të Parandalimit të Torturës të Këshillit të Evropës, si edhe në referim të jurisprudencës së saj të mëparshme, arrin në përfundimin se kërkuesi ka qenë subjekt i një trajtimi çnjerëzor dhe poshtëruës.

**52.** Pra, është shkelur neni 3 i Konventës.

### Shpërblimi i drejtë

**68.** Në lidhje me shpërblimin e drejtë, Gjykata çmoi se kërkuesi duhet të përfitonte si dëmshpërblim 5.000 euro për sa i përket dëmit jo pasuror.

30210/96, par. 91, *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 67, dhe *Gelfmann k. Francës*, nr. 25875/03, par. 48, 14 dhjetor 2004).

**60.** Konventa nuk përmban asnjë dispozitë specifike në lidhje me gjendjen e personave që u është hequr liria dhe që lidhet, mbi të gjitha, me gjendjen e personave të sëmurë. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet se heqja e lirisë një personi të sëmurë mund të shtrojë probleme në këndvështrim të nenit 3 të Konventës (vendimi *Mouisel k. Francës*, nr. 67263/01, par. 38, dhe *Matencio k. Francës*, nr.58749/00, par. 76, 15 janar 2004).

**61.** Kështu, duke vijuar me shqyrtimin e gjendjes shëndetësore të një të burgosuri dhe pasojat e burgosjes në zhvillimin e saj (gjendjes shëndetësore), Gjykata ka vlerësuar se disa trajtime cenojnë nenin 3, për shkak se i shkaktohen një personi që vuan nga probleme të shëndetit mendor (shih vendimin *Keenan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, par. 111-115) [...].

**62.** Për të përcaktuar nëse një trajtim është poshtëruës, sipas nenit 3, Gjykata do të shqyrtojë veçanërisht nëse qëllimi i këtij trajtimi ishte poshtërimi i personit. Megjithatë, mungesa e një qëllimi të tillë, nuk përjashton në mënyrë përfundimtare konstatimin e një shkelje të nenit 3 (vendimi *Peers k. Greqisë*, par. 67-68 dhe 74, dhe *Price k. Mbretërisë së Bashkuar*, par. 24).

**63.** Gjithashtu, Gjykata ka pohuar të drejtën e të gjithë të burgosurve për të vuajtur dënimin në kushte të përshtatshme me dinjitetin njerëzor, në mënyrë që të sigurohet që, procedurat e ekzekutimit të masave të marra të mos i vendosin ata në vështirësi, apo në sprovë të një intensiteti të tillë, që e tejkalon nivelin e paevitueshëm të vuajtjeve të qenësishme gjatë periudhës së heqjes së lirisë; ajo ka shtuar se përveç shëndetit të të burgosurit, duhet të sigurohet mirëqenia e tij në mënyrën e duhur, sipas kërkesave praktike të burgosjes (vendimi *Kudła* par. 94, dhe *Mouisel k. Francës*, par. 40).

**64.** Kështu, **mungesa e kujdesit shëndetësor të duhur dhe**, në mënyrë më të përgjithshme, heqja e lirisë e një individi të sëmurë në kushte të papërshtatshme, mund të përbëjë **në parim një trajtim në kundërshtim me nenin 3** (shih *Ilhan k. Turqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 22277/93, par. 94, *Gennadi Naoumenko k. Ukrainës*, nr. 42023/98, par. 94, 10 shkurt 2004, par. 112 dhe *Farbutuhs k. Letonisë*, nr. 4672/02, par. 51, 2 dhjetor 2004).

**65.** Në rastin në shqyrtim, shtrohet çështja e përputhshmërisë së gjendjes shëndetësore

të kërkuesit, me kushtet e vuajtjes së dënimit gjatë katër muajve, në një institucion ku ai nuk mund të lëvizte në mënyrë të pavarur dhe **nëse kjo situatë përmbante një nivel të mjaftueshëm ashpërsie për t'u futur në fushën e veprimit të nenit 3 të Konventës.**

**66.** Gjykata vëren se kërkuesi dhe qeveria bien dakord për faktin se burgu i Fresnes, një ndërtesë shumë e vjetër, është veçanërisht i papërshtatshëm për burgosjen e personave me aftësi të kufizuara fizike, si ato të kërkuesit, i cili nuk mund të lëvizte përveçse me karrige me rrota.

[...]

**67.** Fakti që për të kaluar nëpër dyert, kërkuesi ishte i detyruar të mbahej nga të tjerët, ndërkohë që një prej rrotave të karriges së tij çmontohej dhe më pas montohej sërish [...], në fakt, mund të konsiderohet si poshtëruës, përveç faktit që kërkuesi ishte tërësisht në mëshirën dhe gatishmërinë e personave të tjerë.

[...]

**68.** Në çështjen në shqyrtim nuk ka asnjë provë për ekzistencën e një qëllimi për poshtërimin e kërkuesit. Megjithatë, Gjykata vlerëson se heqja e lirisë së një personi me aftësi të kufizuara dhe vuajtja prej tij e dënimit në një vend ku ai nuk mund të lëvizë dhe, veçanërisht, të largohet nga qelia në mënyrë të pavarur, përbën një trajtim poshtëruës sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës. Për këtë arsye, ajo arrin në përfundimin se ka shkelje të kësaj dispozite në çështjen në shqyrtim [...].

*Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 14 të Konventës*

**69.** Kërkuesi pretendon se ka shkelje të nenit 14 të Konventës, të marrë së bashku me nenin 3 të Konventës, për shkak se ai ka qenë viktimë e diskriminimit për arsye të trajtimit të ndryshëm midis të burgosurve me aftësi të kufizuara dhe të burgosurve të tjerë [...].

[...]

**71.** [...] **një trajtim i ndryshëm është diskriminues sipas kuptimit të nenit 14**, nëse mungon një "përligje objektive dhe e arsyeshme", që do të thotë, nëse ai nuk ndjek një "qëllim të ligjshëm", ose nëse **"nuk ndjek një raport të arsyeshëm proporcional midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihej"**. Shtetet kontraktuese gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të vendosur nëse, dhe në çfarë mase, diferencat në trajtim midis personave në situata të ngjashme

**Vincent k. Francës, 24.10.2006, Nr. 6253/03**

*Nëse heqja e lirisë së kërkuesit me aftësi të kufizuara fizike në një institucion të vuajtjes së dënimit, ku ai nuk mund të qarkullonte lirisht, përbënte trajtim poshtëruës dhe trajtim diskriminues.*

**Faktet** – Kërkuesi (Zoti Vincent), i cili që prej vitit 1989 vuan nga paraplegjia, nuk mund të lëvizë pa ndihmën e një karrigeje me rrota. Në kohën e paraqitjes së kërkesës para GJEDNJ-së, ai ishte duke vuajtur një dënim me 10 heqje lirie. Në nëntor të vitit 2002, ndaj tij u nis një procedim penal dhe u mor masa e sigurisë arrest me burg. Prej asaj kohe, kërkuesi u transferua në institucione të ndryshme të ekzekutimit të vendimit penal. Që prej ndalimit të tij të parë, kërkuesi paraqiti një sërë ankesash ndaj infrastrukturës së institucioneve, qelitë e të cilave, sipas tij, nuk ishin të përshtatshme, duke ia bërë të pamundur lëvizjen lirisht pa ndihmën e të tjerëve. Ai pretendonte se kishte vështirësi në përdorimin e dushit në qelinë e vet, duke mos mundur të bënte dush për më shumë se një muaj. Në shkurt të vitit 2005, ai u transferua në një institucion tjetër, në të cilin u vendos në një qeli individuale të përshtatur për aftësitë e tij të kufizuara. Gjithashtu, atij iu krijua mundësia të përdorte ashensorin për të shkuar në shërbimin e kujdesit shëndetësor. Në mars të vitit 2006, ai u transferua përsëri në një institucion tjetër, për të cilin u ankua sërish se ishte i papërshtatshëm. Kërkuesi u ankua përpara GJEDNJ-së për trajtim poshtëruës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 3, dhe për diskriminim për shkak të aftësive të tij të kufizuara.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### Lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 14 të Konventës

**59.** Gjykata ripohon se, sipas jurisprudencës së saj, që një keqtrajtim të futet në fushën e

veprimit të nenit 3, ai duhet të përmbajë një shkallë minimale ashpërsie. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ai varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, kryesisht nga kohëzgjatja e trajtimit dhe pasojat e tij fizike dhe mendore, si edhe në disa raste nga seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (vendimi *Kudła k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr.

përligjin një trajtim të ndryshëm të tyre (shih *Larkos k. Qipros* [DHOMA E MADHE], nr. 29515/95, par. 29, *Thlimmenos k. Greqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 34369/97, par. 40, dhe *Koua Poirrez k. Francës*, nr. 40892/98, par. 46).

**72.** Gjykata vëren se, për çështjen në shqyrtim, ajo ka arritur në përfundimin se ka shkelje të nenit 3, për shkak se kërkuesi ishte burgosur për disa muaj në një godinë ku nuk mund të lëvizte lirisht me karrigen e tij me rrota.

Edhe pse nuk mund të mohohet se ky konstatim është i lidhur drejtpërdrejt me gjendjen shëndetësore të kërkuesit, Gjykata, megjithatë, konstaton se nga rrethanat e çështjes, nuk del në pah ndonjë sjellje

diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar të kërkuesit (*Scoppola k. Italisë*, (vendim), nr. 10249/03, 8 shtator 2005). Të gjithë personat në të njëjtën situatë do të ishin ndeshur me të njëjtat vështirësi.

**73.** Për sa më sipër, Gjykata nuk vëren asnjë shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa ose Protokollat e saj [...].

#### **Lidhur me zbatimin e nenit 41 të Konventës**

**74.** Gjykata rikujton se ajo nuk ka kompetencë për të kërkuar lirim me kusht të kërkuesit.

Për sa i përket dëmit shkaktuar kërkuesit, ajo i akordon atij shumën 4.000 euro.

## **Vlerësimi i Gjykatës**

### **Trajtimi poshtëruar**

**24.** Gjykata kujton se keqtrajtimi duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie, për të qenë brenda qëllimit të nenit 3 të Konventës. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, si kohëzgjatja e trajtimit, efektet fizike dhe mendore të tij, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës. Për të vlerësuar nëse trajtimi është “poshtëruar” në kuadër të nenit 3, një nga faktorët që merret në konsideratë nga Gjykata është ekzistenca e qëllimit për ta poshtëruar apo përulur personin, edhe pse mungesa e ndonjë qëllimi të tillë, nuk mund përjashtojë përfundimisht gjetjen e një shkeljeje të nenit 3 (shih *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 67-68 dhe 74, GJEDNJ, 2001-III).

**27.** [...] Gjykata vëren se pavarësisht konstatimeve të mjekut gjatë natës që kërkuesja kaloi në komisariatit e policisë, asnjë veprim nuk u ndërmor për të përmirësuar gjendjen e saj.

**28.** Ndërkohë, gjatë natës së parë në burgun e Wakefield-it, kërkuesja kishte qenë e ekspozuar ndaj gardianëve meshkuj të burgut, për shkak se infermierja në detyrë e kishte të pamundur ta ngrinte zonjën Price që ta çonte në banjë.

**29.** Gjykata vëren se në procesverbalet e pranimit në burgun e Wakefield-it, ka shënime nga mjekët dhe infermierët se kërkuesja do të ndeshte probleme gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, duke pasur vështirësi për të shkuar në shtrat dhe në banjë dhe për të mbajtur higjienën personale. Në këtë situatë serioze, personeli i burgut u autorizua për t'i gjetur kërkueses një vend në një spital jashtë burgut, por kjo rezultoi e pamundur, sepse në ato momente, zonja Price nuk kishte paraqitur ndonjë shqetësim konkret [...].

**30.** Nuk ka asnjë provë konkrete se në këtë rast autoritetet kanë pasur ndonjë qëllim të sigurt për të poshtëruar apo përulur kërkuesen. Megjithatë, Gjykata vlerëson se për të arrestuar një person me aftësi të kufizuara të theksuara, në kushtet kur për shkak të të ftohtit, personi rrezikon të marrë plagë të tjera, për shkak të infrastrukturës që ia bën të pamundur përdorimin e krevatit, dhe sidomos, të vajtjen në banjë ose mbajtjen e higjienës personale pa vështirësi, përbën trajtim poshtëruar, në kundërshtim me parashikimin e nenit 3 të Konventës. Ndaj, në këtë rast Gjykata gjen një shkelje të kësaj dispozite.

### **Shpërblimi i drejtë**

**34.** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së konstatuar dhe të gjitha rrethanat e tjera të çështjes, Gjykata i cakton kërkueses si dëmshpërblim 4,500 sterlina në kuadër të dëmit jo material.

“

**Price k. Mbretërisë së Bashkuar, 10.07.2001, Nr. 33394/96**

*Nëse kushtet e heqjes së lirisë në komisariatit e policisë dhe burgun e grave përbënin trajtim çnjerëzor e poshtëruar sipas nenit 3.*

”

**Faktet** – Adele Price, shtetase britanike kishte lindur pa gjymtyrë (phocomelia), për shkak se nëna e saj kishte përdorur drogë gjatë shtatzënisë. Ajo gjithashtu vuante nga një sëmundje kronike e veshkave. Gjatë një procesi gjyqësor, zhvilluar përpara Gjykatës së Rrethit Lincoln, që lidhej me shlyerjen e një kredie, zonja Price refuzoi t'i përgjigjej një pyetje të bërë nga gjykata mbi situatën e saj financiare. Për këtë gjë, ajo u dënua me 7 ditë burgim me justifikimin se nuk kishte treguar respekt për gjykatën. Gjyqtari nuk e shqyrtoi faktin se ku do ta vuante kërkuesja dënimin përpara se të urdhëronte që arrestimin e menjëhershëm të saj. Meqenëse procesi gjyqësor u zhvillua pasdite, ishte e pamundur që zonja Price të transferohej në një burg dhe për këtë arsye, ajo e kaloi natën në dhomat e komisariatit të policisë në Lincoln. Dhoma, e cila ishte e pajisur me një krevat prej druri dhe një dyshek, nuk ishte e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara. Kërkuesja kishte qenë e detyruar të flinte në karrocën e saj, sepse krevati ishte tepër i fortë dhe që aty ajo nuk mund të përdorte butonin e emergjencës dhe të ndriçimit. Gjithashtu ajo nuk kishte pasur mundësi të përdorte banjën për shkak të infrastrukturës. Në procesverbalet e ndalimit të saj, shkruhej se kërkuesja ankohej çdo gjysmë ore nga të ftohtit, i cili i shkaktonte shumë probleme edhe për shkak të sëmundjes së saj të veshkave. Gjatë natës u thërrit një mjek, i cili po ashtu i konstatoi të gjitha problemet e mësipërme, duke nxjerrë përfundimin se dhoma e komisariatit nuk ishte e përshtatshme për mbajtjen e personave me aftësi të kufizuara. Pavarësisht kësaj, polici në detyrë nuk mori asnjë masë për ta transferuar zonjën Price në një ambient tjetër. Të nesërmen, kërkuesja u dërgua në burgun për femra, ku u mbajt në qendrën për kujdesin shëndetësor të institucionit 3 ditë. Në qelinë e saj në këtë institucion, zonja Price kishte tashmë mundësi të përdorte shërbimet bazë por, megjithatë, kishte probleme me mbajtjen e higjienës personale për shkak të infrastrukturës. Deri në ditën e lirit, ajo kishte qenë e detyruar të mbante kateter për shkak të problemeve që kishte me veshkat.

Kërkuesja iu drejtua Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me pretendimin se ajo kishte pësuar një trajtim poshtëruar gjatë qëndrimit në komisariatit e policisë dhe në burg për shkak se për vajtur në banjë, i ishte dashur të ekspozohej edhe ndaj gardianëve meshkuj të burgut. Gjithashtu, zonja Price pretendoi se për 10 javë pas lirit nga burgun kishte pasur probleme shëndetësore.

“

**Aswat k. Mbretërisë së Bashkuar, 14.04.2013, Nr. 17299/12**

*Nëse ekstradimi në SHBA i kërkuesit, i cili vuante nga probleme të rënda të shëndetit mendor dhe akuzohej për kryerjen e veprave terroriste, shkelte nenin 3 të Konventës.*

”

**Faktet** – Në gusht të vitit 2005, kërkuesi u arrestua në Mbretërinë e Bashkuar në bazë të një urdhër-arresti të lëshuar për të, në bazë të kërkesës së paraqitur nga Shtetet e Bashkuara në lidhje me përfshirjen e tij në themelimin e një kampi trajnimit xhihadist. Në mars të vitit 2006, Sekretari i Shtetit urdhëroi ekstradimin e tij. Në mars 2008, kërkuesi u transferua në një spital psikiatrik të sigurisë së lartë, sepse ai përmbushte kriteret e arrestimit në kuadër të legjislacionit për shëndetin mendor në Mbretërinë e Bashkuar. Në nëntor 2011, gjykata e shkallës së parë për personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor shqyrtoi çështjen e kërkuesit dhe arriti në përfundimin se ai vuante nga skizofrenia paranojake, e cila e bënte të domosdoshme që kërkuesi të vazhdonte të qëndronte i mbyllur në spital, për të garantuar shëndetin dhe sigurinë e tij. Kërkuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij, garantuar nga neni 3 i Konventës.



## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 3

**49.** Në lidhje me aspektin thelbësor të ankimit të kërkuarit tashmë është përcaktuar qartë se Shtetet Palë kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, vendqëndrimin dhe dëbimin apo largimin e të huajve. Megjithatë, në ushtrimin e kësaj të drejte, Shtetet Palë duhet të mbajnë në vëmendje nenin 3 të Konventës, i cili garanton një prej vlerave më thelbësore të shoqërive demokratike. Pikërisht për këtë arsye, Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se, në kuadër të nenit 3, ekstradimi, dëbimi, ose largimi i individëve në shtete të treta ndalon në mënyrë absolute torturën, ose trajtimin çnjerëzor, ose poshtëruar dhe se garancitë e këtij neni zbatohen pavarësisht nga natyra e dënueshme e sjelljes së personit në fjalë (shih *Ahmed k. Austrisë*, 17 dhjetor 1996, Raportet e Vendimeve dhe Gjykimeve 1996-VI, f. 2206, par. 38, dhe *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, Raportet 1996-V, f. 1853, par. 73-74).

**50.** Në disa raste, Gjykata ka theksuar se ndalimi i një personi që vuan nga ndonjë sëmundje, ngre çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës dhe se, mungesa e kujdesit të duhur shëndetësor, mund të shkaktojë një trajtim në kundërshtim me këtë të drejtë (shih *Slawomir Musiał k. Polonisë*, nr. 28300/06, par. 87, 20 janar 2009 së bashku me referencat e cituara aty). [...] ndjenja e inferioritetit dhe e pafuqisë, tipike për personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor, bën të domosdoshme që t'i kushtohet vëmendje më e madhe respektimit të Konventës. Ka tre elementë të veçantë që duhen marrë në konsideratë për të parë përputhshmërinë me Konventën te kushteve të vuajtjes së dënimit nga kërkuari: (a) gjendja shëndetësore e tij, (b) përshtatshmëria e ndihmës dhe kujdesit shëndetësor, dhe (c) përshtatshmëria e mbajtjes së kërkuarit në burg në raport me gjendjen e tij shëndetësore (Shih po aty, *Dybeku k. Shqipërisë*, nr. 41153/06, par. 41, 18 dhjetor 2007).

**52.** Shkelja e nenit 3 të Konventës, në rastin e ekstradimit të kërkuarit në Shtetet e Bashkuara, do të varej nga kushtet në të cilat ai do të mbahej i burgosur dhe nga shërbimi mjekësor, që do t'i vihej në dispozicion. [...]

**55.** Nga parashtrimet e Departamentit Amerikan të Drejtësisë, Gjykata pranon se në rast se kërkuari dënohet, ai do të ketë qasje të plotë në institucionet mjekësore dhe veçanërisht në shërbimet e shëndetit mendor, në varësi të institucionit ku do të mbahet. [...]

**57.** [...] Në bazë të raporteve të gjendjes shëndetësore të kërkuarit, Gjykata vëren se ekziston një rrezik real se ekstradimi i tij në një vend tjetër, i cili mund të bëhet me kushte më të këqija se ambienti i burgut, mund të sjellë një përkeqësim të shëndetit mendor dhe fizik të tij, përkeqësim i cili do të shkaktoje shkelje të nenit 3 të Konventës (shih *Bensaid k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 37).

**58.** Për aq kohë sa ankimi i kërkuarit lidhet me kohëzgjatjen e burgimit të tij potencial, duke lënë mënjanë gjendjen e tij aktuale të shëndetit mendor, Gjykata vlerëson se nuk është provuar se masat që mund të ndërmerren do të jenë haptazi jo proporcionale. Gjykata ka theksuar edhe më parë se, në parim, çështjet e dënimeve të përshtatshme, në momentin që zbatohen, mund të përbëjnë keqtrajtim, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës [...]. Gjykata arrin në përfundimin se arrestimi i kërkuarit nuk do të sillte një rrezik real keqtrajtimi, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, për shkak të kohëzgjatjes së dënimit, sepse vepra penale për të cilën kërkuari mund të shpallet fajtor është kryerja e veprimeve terroriste.

“

S.H.H. k. Mbretërisë së Bashkuar, 29.01.2013, Nr. 60367/10

Nëse kthimi i kërkuarit në vendin e origjinës pas refuzimit të kërkesës për azil shkel të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, trajtimit çnjerëzor e poshtëruar.

”

**Faktet** – Kërkuari është një shtetas afgan, i cili vuan nga aftësi të kufizuara për shkak të shpërthimit të një rakete në vitin 2006. Ai arriti në Mbretërinë e Bashkuar në vitin 2010 dhe apliko për azil, por kërkesa e tij u refuzua. Kërkuari pretendonte se nëse rikthehej në vendin e origjinës, do të ndeshet me dhunë dhe diskriminim, ndërkohë që një prej udhëheqësve të një force politike vendase do ta detyronte të bëhej terrorist për të kryer vetëvrasje me bombë. Përpara Gjykatës, kërkuari pretendoi se kthimi i tij në Afganistan do të shkelte të drejtën e garantuar nga neni 3 i KEDNJ-së, sepse do ta ekspozonte atë ndaj një rreziku të lartë dhune, për shkak të aftësive të tij të kufizuara. Ai gjithashtu pretendoi se në vendin e tij nuk do të merrte ndihmë të mjaftueshme dhe do të diskriminohej.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 3 dhe dëbimin

**69.** Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës, është e ditur tashmë se dëbimi nga një Shtet Kontraktues mund të ngrejë një çështje në kuadër të nenit 3 dhe të angazhojë përgjegjësinë e shtetit në kuadër të Konventës, në rastet kur faktot se dëbimi i personit do ta vinte atë përpara një rreziku serioz, në kundërshtim me nenin 3. Në raste të tilla, neni 3 parashikon se shteti i paditur është i detyruar të mos e dëbojë azil-kërkuarin. Neni 3 ka një karakter absolut dhe nuk është e mundur të vihen në balancë arsyet e dëbimit, në ato raste kur provohet se keqtrajtimi do të ndodhë (shih *Saadi k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 37201/06, par. 125 dhe 138, GJEDNJ, 2008).

**70.** Vlerësimi i ekzistencës së shkaqeve thelbësore, për të besuar se kërkuari ndeshet me të vërtetë me një rrezik real, kërkon domosdoshmëri që Gjykata të vlerësojë kushtet në shtetin pritës përkundrejt standardeve të nenit 3 të Konventës (shih *Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë* [DHOMA E MADHE], nr. 46827/99 dhe 46951/99, par. 67, GJEDNJ, 2005-I). Këto standarde nënkuptojnë që keqtrajtimi me të cilin kërkuari do të ndeshet nëse kthehet, duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie të tillë që të jetë brenda fushës së veprimit të nenit 3. Përcaktimi i këtij niveli është relativ dhe varet nga të gjitha rrethanat e çështjes (shih *Hilal k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45276/99, par. 60, GJEDNJ 2001-II). Në kuadër të karakterit absolut të së drejtës,

së mbrojtur nga neni 3 i Konventës, ky nen mund të zbatohet edhe kur rreziku buron nga një person ose një grup personash që nuk janë persona publikë. Gjithsesi, duhet të provohet se rreziku është i vërtetë dhe se autoritetet e shtetit pritës nuk janë të afta të shmangin rrezikun duke garantuar mbrojtjen e nevojshme (shih H.L.R. k. Francës, 29 prill 1997, Raportet 1997-III, par. 40).

**71.** Përcaktimi i ekzistencës së një rreziku real duhet të jetë shumë rigoroz (shih *Chahal Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, Raportet 1996-V, par. 96; dhe *Saadi*, cituar më lart, par. 128). Në parim, kërkuari duhet të paraqesë prova të cilat tregojnë se ka shkaqe substanciale për të besuar se, nëse do të zbatohet masa për të cilën kërkuari ankohet, ai do të ekspozohet ndaj rrezikut për t'iu nënshtruar një trajtimi në kundërshtim me nenin 3 (shih *N. k. Finlandës*, nr. 38885/02, par. 167, 26 korrik 2005). Gjykata pranon se duke pasur parasysh situatën e veçantë në të cilën ndodhen azil-kërkuarit, përgjithësisht duhet që atyre t'u jepet përfitimi i dyshimit, kur bëhet fjalë për shqyrtimin e besueshmërisë së deklaratave të tyre, si dhe dokumenteve të dorëzuara në mbështetje të tyre. Megjithatë, kur informacioni i paraqitur krijon hapësirë për dyshime të forta në lidhje me vërtetësinë e deklaratave të azil-kërkuarit, individit duhet të paraqesë shpjegime të besueshme (shih ndër të tjera *Collins dhe Akasiebie k. Suedisë*, nr. 23944/05, 8 mars 2007 dhe *R.C. k. Suedisë*, nr. 41827/07, 9 mars 2010).

72. Në mënyrë që të përcaktojë nëse në rastin objekt shqyrtimi, ekziston një rrezik real keqtrajtimi, Gjykata duhet të shqyrtojë pasojat e mundshme që do të vinin nëse kërkuesi do të dërgohej në Afganistan, duke mbajtur në vëmendje situatën e përgjithshme atje dhe rrethanat e posaçme në të cilat ai ndodhet (shih *Vilvarajah dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 30 tetor 1991, par. 108, Seria A, nr. 215). Nëse një kërkues nuk është ekstraduar, ose larguar akoma në kohën kur Gjykata shqyrton çështjen, koha e duhur do të jetë ajo gjatë procedurës gjyqësore përpara Gjykatës (shih Saadi, cituar më lart, par. 133). Nevojitet të bëhet një vlerësim i plotë dhe *ex nunc* (i mëtejshëm ose që këtej e tutje), nëse situata në vendin e origjinës mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Megjithatë në këto raste, qëndrimi historik është me rëndësi, sepse mund të hedhë dritë mbi situatën aktuale dhe zhvillimet e së ardhmes, në çështjen konkrete, vendimtare janë kushtet aktuale dhe prandaj merren në konsideratë informacionet që janë zbuluar pasi është marrë vendimi përfundimtar nga autoritetet kombëtare (shih *Salah Sheekh k. Holandës*, nr. 1948/04, par. 136, 11 janar 2007).

[...]

### 1. Rreziku i dhunës për shkak të aftësive të kufizuara

86. Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka mundur të paraqesë prova të rëndësishme, në mbështetje të pretendimeve të tij, se një person me aftësi të kufizuara në vetvete është në rrezik serioz për të qenë subjekt dhune, duke u ndeshur edhe me vështirësi të tjera si, diskriminimi dhe gjendja e keqe humanitare, në ndryshim nga pjesa tjetër e popullsisë afgane. Provat e paraqitura *ndër të tjera* nga UNHCR, UNAMA, UNCESCR, AIHRC dhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit në asnjë pikë të tyre nuk përmendin se një person me aftësi të kufizuara në Afganistan është subjekt i një rreziku shumë të madh dhune, keqtrajtimi ose sulmi.

87. Në mungesë të provave të tjera të kundërta, Gjykata arrin në përfundimin se kjo ankesë e kërkuesit mund të konsiderohet se përmban një hapësirë të madhe spekulimi dhe nuk vlerëson se kërkuesi ka arritur të provojë se, për shkak të aftësive të tij të kufizuara, ai do të jetë subjekt i dhunës dhe i diskriminimit në Afganistan në mënyrë të tillë, që të shkelet neni 3 i Konventës.

### 2. Kushtet e jetesës

89. Gjykata vlerëson se në rrethanat e çështjes konkrete duhet të zbatohen parimet e vendosura në çështjen *N. k. Mbretërisë së Bashkuar* [...].

Gjykata pranon se në çështjen objekt gjykimi, aftësia e kufizuar e kërkuesit nuk mund të konsiderohet si sëmundje "natyrore", e cila nuk kërkon trajtim mjekësor. Pavarësisht kësaj, konsiderohet e rëndësishme që në të dy këto çështje, një dëmtim i mundshëm nuk mund të trajtohet në mënyrën e duhur, për shkak të mungesës së kujdesit mjekësor ose kujdesit social, në kundërshtim me aktet ndërkombëtare, ose për shkak të mosveprimeve nga autoritetet e shtetit pritës.

90. Gjykata vlerëson se çështja konkrete objekt gjykimi, ndryshon nga çështja *M.S.S k. Belgjikës dhe Greqisë*. [...] në dallim nga ajo, në rastin konkret, zbatimi lidhet me kushtet e jetesës dhe situatën humanitare në Afganistan, i cili nuk është Shtet Palë në Konventë dhe, për rrjedhojë, nuk ka detyrimin të përmbushë detyrimet në kuadër të legjislacionit Evropian, duke mos pasur kështu mundësi të jetë përgjegjës për shkelje të Konventës, si pasojë e mos ofrimit të përkuajdesjes së duhur sociale për personat me aftësi të kufizuara.[...]

91. Në çështjen konkrete objekt gjykimi, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se situata në Afganistan, pavarësisht se ishte shumë serioze, mund të krahasohet me situatën në Somali (shih çështjen *Sufi and Elmi k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart). Së pari, sepse Afganistani ka një qeveri qendrore dhe infrastrukturë institucionale që funksion. Së dyti, Afganistani dhe, veçanërisht, Kabuli, ku kërkuesi do të depërtohet, është nën kontrollin e qeverisë. Së treti, megjithatë raportet e UNCHR-së kanë vërejtur se hapësira humanitare në Afganistan është zvogëluar në disa rajone, si rezultat i paqëndrueshmërisë së vazhdueshme, atje vazhdon të ketë një prani të konsiderueshme agjencish ndërkombëtare. Së katërti, edhe përse vështirësitë me të cilat ndeshen njerëzit me aftësi të kufizuara në Afganistan nuk mund të nënvlerësohen, nuk mund të thuhet se këto probleme vijnë si rezultat i veprimeve të drejtpërdrejta të autoriteteve afgane dhe jo i mungesës së burimeve të mjaftueshme [...].

92. [...] Gjykata do të përcaktojë nëse rasti i kërkuesit përbën një rast tepër të veçantë, bazuar në arsye humanitare.

93. [...] Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se kërkuesi nuk do të ketë mundësi objektive për të kontaktuar familjen e tij pasi të jetë rikthyer në Afganistan dhe se, kjo e fundit nuk do të ofronte atij ndihmë pas kthimit. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të pranojë pretendimin e kërkuesit se, pasi të dëbohet, ai do të mbetet krejt i vetëm dhe pa ndihmën e nevojshme në vendin e tij. [...] Megjithatë, cilësia e jetës së kërkuesit pa dyshim

do të ndryshojë për të keq në mënyrë të ndjeshme, kjo arsye e vetme nuk mund të jetë vendimtare (shih *N. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 50 dhe 51).

94. Në përfundim, për të adresuar në mënyrën e duhur pretendimet e kërkuesit në çështjen konkrete, Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara duhet të kuptohet së bashku me qëllimin e nenit 3. Gjykata është e mendimit se parimet e Konventës nuk zbatohen

në boshllëk, dhe se duhet të interpretohen në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (shih mutatis mutandis, *ndër të tjera, Neulinger dhe Shuruk k. Zvicrës* [DHOMA E MADHE], nr. 41615/07, par. 131-132, GJEDNJ 2010). Megjithatë, në bazë të arsyeve të mësipërme, edhe duke e interpretuar nenin 3 të Konventës së bashku me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se e drejta e garantuar nga neni 3 në rastin konkret cenohet.

“

Hukić k. Suedisë, 27.09.2005, Nr. 17416/05

Nëse kthimi i një prej kërkuesve që vuante nga sindroma 'down' në vendin e origjinës shkelte nenin 3 të Konventës.

”

**Faktet** - Katër kërkuesit janë një familje myslimane nga Bosnja, të cilët kanë hyrë në Suedi në 2003 dhe kanë bërë kërkesë për azil dhe leje qëndrimi. Ata pretendonin se fëmija i tyre më i vogël, i cili është dhe kërkuesi i katërt në këtë çështje, vuante nga sindroma 'down' dhe nuk merrte asnjë trajtim mjekësor në vendin e tyre të origjinës. Bordi i Migracionit e rrëzoi kërkesën e tyre, duke argumentuar se kërcënimet dhe sulmet ndaj kërkuesit të parë nuk pretendoheshin të kryheshin nga autoritetet shtetërore dhe se, për më tepër, këta të fundit nuk janë shprehur se nuk mund të siguronin atyre mbrojtje. Sipas autoriteteve, kërkuesi i sëmurë kishte mundësi të merrte kujdes mjekësor të përshtatshëm në Bosnje dhe Hercegovinë dhe argumenti se cilësia e këtij kujdesi shëndetësor në Suedi ishte më e lartë, nuk ishte një arsye e vlefshme për ta lejuar këtë familje të qëndronte në shtetin suedez. Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Bordi i Apelit për Migracionin. Edhe aplikimet e tjera për azil të bëra nga kërkuesit u refuzuan. Kërkuesit paraqitën raporte mjekësore, të cilat parashtronin se kërkuesi i katërt kishte reaguar shumë pozitivisht ndaj trajtimit të marrë në Suedi dhe se, për të pasur një reagim edhe më të mirë të gjendjes shëndetësore të kërkuesit të katërt, ishte e domosdoshme që ai të qëndronte në Suedi ose në ndonjë shtet tjetër perëndimor, ku mund të merrte të njëjtin trajtim. Kërkuesit pretenduan se në rast se ktheheshin në Bosnje dhe Hercegovinë, do të ishin në rrezik të vriteshin ose të arrestoheshin, sepse kërkuesit të parë, në kuadër të punës së tij të mëparshme si polic, i ishte dashur të arrestonte persona të lidhur me mafien. Rrjedhimisht, atyre do të u shkeleshin të drejtat e garantuara nga neni 3 i Konventës në rast se deportoheshin sërish në Bosnje dhe Hercegovinë.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### Pretendimi për shkelje të nenit 3 të Konventës

1. [...] Gjykata thekson se në bazë të së drejtës ndërkombëtare të konsoliduar dhe të zbatueshme, duke përfshirë këtu edhe Konventën, Shtetet Palë kanë të drejtë të kontrollojnë hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve. Megjithatë, dëbimi i të huajve nga territori i një shteti palë, mund të ngrejë çështje në kuadër të nenit 3 të Konventës dhe të përfshijë përgjegjësinë e shtetit në kuadër të Konventës, **kur ekzistojnë rrethanat të mjaftueshme të cilat tregojnë se personi në**

**fjalë mund të ndeshet me rrezik dhe të trajtohet në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, në rast kthimi të tij në vendin e origjinës. Në këto rrethana, neni 3 nënkupton detyrimin e shteteve për të mos e dëbuar personin në fjalë** (shih ndër të tjera *H.L.R. k. Francës*, 29 prill 1997, Raportet e Vendimeve dhe Gjykimeve 1997-III, f. 757, par. 33-34).

Gjykata vlerëson se, në lidhje me rrezikun e pretenduar për arrestim në rast dëbimi, kërkuesit nuk paraqitën asnjë provë të rëndësishme në mbështetje të këtyre pretendimeve, si edhe asnjë kërcënim të marrë. Për më tepër, nuk kishte asnjë

tregues se sulmi ndaj tyre, gjithmonë në rast se ky i fundit ndodhte, do të ishte i porositur nga ana e autoriteteve. Ndërkohë, këta të fundit në asnjë rast nuk kishin treguar mungesë vullneti për mbrojtjen e kërkuarve. **Për më tepër, Gjykata thekson se dëbimi i kërkuarve do të bëhet në një Shtet tjetër Palë në Konventë, i cili është zotuar të mbrojë të drejtat themelore në kuadër të Konventës** (shih *Tomic k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 17837/03, 14 tetor 2003). Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankesës është haptazi e pabazuar në kuadër të nenit 35, par. 3, të Konventës.

2. [...] Në kuadër të jurisprudencës së konsoliduar të Gjykatës, të huajt që janë subjekt dëbimi, në parim, nuk mund të pretendojnë të qëndrojnë në territorin e një Shteti Palë për të vazhduar një trajtim mjekësor që garantohet nga shteti që bën kthimin ose dëbimin. Megjithatë, në raste përjashtimore, vendimi për të dëbuar një kërkuar në kuadër të parimeve humanitare mund të sjellë shkelje të nenit 3 të Konventës (shih ndër të tjera the *D. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 maj 1997, Raportet 1997-II, par. 54). Gjykata vëren se pretendimi i kërkuarve se, në rast dëbimi, kërkuar i katërt do të pësonte një dëm të riparueshëm, si pasojë e mungesës së kurimit të përshtatshëm për aftësitë e tij të kufizuara në Bosnje dhe Hercegovinë është i pavend, pasi në bazë të dokumenteve të çështjes objekt gjykimi, rezulton se në këtë shtet ekzistojnë trajtime të njëjta me ato në Suedi për sindromën *down*. Pavarësisht seriozitetit të aftësisë së kufizuar të kërkuarit të katërt, sindroma *down* nuk mund të krahasohet me statet e fundit të një sëmundjeje terminale. **Megjithatë, fakti që rrethanat në të cilat do të gjendet kërkuar i katërt në Bosnje dhe Hercegovinë, do të jenë më pak të përshtatshme se ato në të cilat ai gjendet në Suedi, nuk mund të konsiderohen si vendimtare në vështrim të nenit 3** (shih *Bensaid k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44599/98, par. 38, GJEDNJ, 2001-I; *Salkic dhe të Tjerët k. Suedisë*, nr. 7702/04, 29 qershor 2004) [...]. Në vlerësim të Gjykatës, rasti konkret, objekt gjykimi, nuk përfshihet në rastet përjashtimore, në bazë të jurisprudencës së mirë përcaktuar të Gjykatës, që do të sillte shkelje të nenit 3 të Konventës në rast dëbimi. Për rrjedhojë, edhe kjo pjesë e ankesës është haptazi e pabazuar në kuadër të nenit 35, par. 3 dhe 4, të Konventës.

## III. LIRIA DHE SIGURIA

“

Mihailovs k. Letonisë, 22.01. 2013, nr. 35939/10

*Nëse vendosja dhe mbajtja e kërkuarit, i cili vuante nga epilepsia, në një institucion shtetëror të përkujdesjes sociale kundër vullnetit të tij, por me lejen e kujdestares ligjore, shkelte të drejtën e tij për liri, sipas nenit 5 të Konventës.*

”

**Faktet** - Kërkuar, Genadijs Mihailovs, banon në një institucion shtetëror të përkujdesjes sociale. Ai vuan nga epilepsia dhe aftësia e tij e kufizuar ishte përcaktuar në vitin 1994. Në mars të vitit 2000, kërkuar u pranua në një spital psikiatrik në Riga. Në prill të po atij viti, ekspertët psikiatër arritën në përfundimin se kërkuar nuk vuante nga një çrregullim i shëndetit mendor, por nga epilepsia, e cila bënte që ai të shfaqte sindroma dhe simptoma psikotike. Ai vuante nga të dridhura, mendime obsesive, disforia dhe arsytim i kufizuar. U rekomandua që atij t'i hiqej zotësia për të vepruar dhe u vërejt se ai nuk ishte në gjendje të merrte pjesë në seanca gjyqësore ose të jepte shpjegime të përshtatshme.

Bashkëshortja e kërkuarit kërkoi që atij t'i hiqej zotësia për të vepruar. Gjykatat e brendshme urdhëruan një ekzaminim psiko-ligjor. Kërkuarit iu hoq zotësia për të vepruar në mungesë dhe gruaja e tij u caktua si kujdestare ligjore. Në nëntor të vitit 2000, ajo kërkoi që bashkëshorti i saj të transferohej në një institucion të specializuar të përkujdesjes sociale, pa dhënë asnjë arsye. Kërkuar u fut në një listë pritjeje për t'u vendosur në "një institucion përkujdesjeje për njerëz me problem të shëndetit mendor". Në vitin 2002, ai u transferua në një Qendër Rehabilitimi Psikologjik.

Në vitin 2007, kërkuar paraqiti një kërkesë-padi që t'i rikthehej zotësia për të vepruar. Gjykata kërkoi një raport shëndetësor për të dhe ai u vlerësua në gjendje të qëndrueshme, të pakthyeshme dhe progresive. Por, ai paraqiste distrofi, shqetësime dhe agresivitet dhe kërkesa iu rrëzua.

Në tetor të vitit 2009, ai u vizitua nga anëtarë të një shoqate lokale: zoti Petrovs dhe zoti Bragnitskis. Ky i fundit iu drejtua gjykatës që ajo të urdhëronte daljen e kërkuarit nga përkujdesja sociale, por gjykata vlerësoi se këtë kërkesë mund ta paraqiste vetëm kujdestarja ligjore e tij. Në vijim, bashkëshortja e kërkuarit kërkoi që anëtarët e OJF-së të ndaloheshin ta takonin kërkuarin, pasi gjendja e tij shëndetësore vetëm përqësohej që kur ata kishin nisur t'i bënin vizita. Ajo kërkoi gjithashtu që të gjithë vizitorët e tjerë të kërkuarit të merrnin lejen me shkrim prej saj. Ajo i dha një prokurë një prej punonjësve socialë në qendër që t'i hapnin korrespondencën e kërkuarit. Në korrik të vitit 2009, ajo kërkoi zgjidhjen e martesës, por e tërhoqi kërkesë-padinë, pasi mësoi dëshirën e kërkuarit për të pasur zotin Bragnitskis si kujdestarin e tij të ri ligjor.

Në shkurt të vitit 2010, Qendra Rehabilituese e vlerësoi situatën e kërkuarit si të qëndrueshme, por të pakthyeshme dhe vuri në dukje se nuk këshillonte që ai të jetonte në shtëpinë e tij, pa mbikëqyrje të vazhdueshme.

Ndërkohë, zoti Bragnitskis bënte përpjekje për t'u caktuar si kujdestar i kërkuarit, me qëllimin që t'i kthente atij zotësinë për të vepruar dhe lirin nga qendra sociale. Por, kjo kërkesë e tij u rrëzua nga gjykata, e cila caktoi të birin e kërkuarit si bashkë-kujdestarin e tij, së bashku me gruan.

Në shtator të vitit 2011, gjykata i shpalli të dy kujdestarët si të papërshtatshëm, pasi kërkuar nuk ishte lejuar asnjëherë të largohej nga qendra dhe as ishte shoqëruar ndonjëherë, me gjithë kërkesat e tij të vazhdueshme për të vizituar varret e prindërve të tij. Në përputhje me dëshirën e kërkuarit, kujdestar i tij ligjor u caktua zoti Petrovs. Kërkuar shprehu dëshirën të vazhdonte të qëndronte në Qendër (pas zhvendosjes së tij nga komuna Ille në Lielbërze) dhe herë pas here qëndronte në banesën e zotit Petrovs.

Kërkuar pretendoi para GJEDNJ-së se pranimi dhe mbajtja e tij në Qendrën Rehabilituese cenonte të drejtën e tij për liri, pasi ai mbahej aty kundër vullnetit të tij, në kundërshtim me nenin 5 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### (a) Nëse kërkuesit i ishte hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës

**75.** Gjykata rithekson se, për të vlerësuar nëse dikujt i është “hequr liria” sipas kuptimit të nenit 5 të Konventës, fillimisht konsiderohet gjendja aktuale e personit dhe mbahen parasysh një sërë kriteresh si natyra, kohëzgjatja dhe mënyra e zbatimit të masës në fjalë (shih *Stanev*, par. 115). Gjykata më tej vëren se **nocioni i heqjes së lirisë sipas nenit 5, par. 1, nuk përfshin vetëm elementin objektiv të mbylljes së një personi në një hapësirë të kufizuar për një periudhë kohe e cila mund të jetë e parëndësishme. Një personi mund të konsiderohet se i është hequr liria, nëse nuk ekziston as elementi subjektiv, që do të thotë se ai nuk e ka pranuar në një mënyrë të vlefshme heqjen e lirisë së tij** (shih *Storck k. Gjermanisë*, nr. 61603/00, par. 74).

**76.** Në kontekstin e heqjes së lirisë për arsye të problemeve të shëndetit mendor, Gjykata u referohet parimeve të përgjithshme të çështjes *Stanev* (par. 116-120). Në veçanti, ajo rithekson se ka konstatuar heqje të lirisë në rrethanat e mëposhtme: (a) kur kërkuesi, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe që është pranuar në një spital psikiatrik me kërkesë të përfaqësuesit të tij ligjor, është përpjekur, por pa sukses, që të largohet nga spitali (shih *Shtukurov*, par. 108); (b) kur kërkuesi fillimisht e ka dhënë pëlqimin për shtrimin në një klinikë, por më pas është përpjekur të largohet prej saj (*Storck*, cituar më lart, par. 76); (c) kur kërkuesi është një person madhor, i cili e ka pasur të pamundur të jepte pëlqimin e vet për pranimin në një institucion psikiatrik, prej të cilit ai nuk është përpjekur asnjëherë të largohet (*H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45508/99, par. 89-94, GJEDNJ, 2004IX); dhe (d) kur kërkuesi, një person me probleme të shëndetit mendor, është vendosur në një qendër të përkujdesjes sociale, ku ai mbikëqyrej në mënyrë të vazhdueshme dhe prej së cilës ai nuk mund të largohet pa leje sa herë që të dëshironte (*Stanev*, par. 124-130).

**77.** Duke u kthyer tek faktet e çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuesi ishte vendosur në dy institucione shtetërore të përkujdesjes sociale në mënyrë të njëpasnjëshme: nga 30 janar 2002, deri në një prill 2010, në Qendrën Ële në komunën Ële dhe nga 1 prill 2010, deri më sot, në Qendrën Ële në Lielbërze. Bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata fillimisht do të shqyrtojë, nëse vendosja e kërkuesit në Qendrën Ële në komunën Ële

ishte heqje e lirisë sipas nenit 5 par. 1 të Konventës dhe më pas, do të shqyrtojë vendosjen e kërkuesit në Qendrën Ële në Lielbërze.

**78.** Gjykata vëren se palët kanë mosmarrëveshje lidhur me rrethanat ose elementin objektiv të vendosjes së kërkuesit në Qendrën Ële, në komunën Ële, për sa i përket faktit nëse institucioni ishte një institucion i hapur ose i mbyllur. Megjithatë, Gjykata thekson se kjo rrethanë nuk është përcaktuese për çështjen. Gjykata vë në dukje jurisprudencën e saj, sipas së cilës, një person mund të konsiderohet se i është hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, edhe gjatë një periudhe kur ai ose ajo ishte në një seksion të hapur me qasje të rregullt, të pashoqëruar, në ambientet e spitalit dhe kishte mundësi të largohej i pashoqëruar jashtë spitalit (shih *H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar*, par. 92). Faktori kyç që përcakton zbatimin e nenit për kërkuesin në Qendrën Ële në komunën Ële është nëse **autoritetet drejtuese të qendrës kanë ushtruar kontroll tërësor dhe efektiv për trajtimin, kujdesin, qëndrimin dhe lëvizjen e tij** nga 30 janari 2002, kur ai u pranua në institucion, deri në 1 prill 2010, kur ai u transferua në Lielbërze (*D.D. k. Lituanië*, nr. 13469/06, par. 146, 14 shkurt 2012; dhe *Kędzior k. Polonisë*, nr. 45026/07, par. 57, 16 tetor 2012).

**79.** Nga parashtrimet e palëve, rezulton se kërkuesi nuk mund të largohej nga institucioni pa lejen e autoriteteve drejtuese të tij. Leja kushtëzohej nga gjendja shëndetësore e kërkuesit dhe jepej vetëm kur ai shoqërohej nga personeli i institucionit, ose nga ndonjë pacient tjetër. [...] Gjykata vëren se gjykata e brendshme ka konstatuar se bashkëshortja dhe më tej i biri, si kujdestarë ligjorë të tij, nuk e kanë nxjerrë kurrë kërkuesin jashtë Qendrës. Ndaj ajo nuk gjen asnjë arsye për ta venë në pikëpyetje këtë gjetje. Për më tepër, bashkëshortja e kërkuesit i ka kufizuar të gjitha kontaktet sociale të tij deri në pikën sa e ka ndaluar kërkuesin të takonte njerëz të tjerë pa lejen e saj. [...] Gjykata më tej vëren pretendimin e kërkuesit, i cili nuk u kundërshtua nga Qeveria, se kurdoherë që pacientët largoheshin nga institucioni pa leje, ata ktheheshin mbrapsht nga policia. Kjo situatë është e ngjashme me atë të ZOTIT *Stanev* (*Stanev*, par. 28 dhe 127, i cili kishte kaluar afatin e lejes dhe personeli e ktheu në qendër pa marrë parasysh dëshirat e tij) dhe zonja *D.D.* (shih *D.D. v. Lituanië*, par. 30 dhe 146, e cila ishte larguar nga institucioni dhe e kishin kthyer mbrapsht me policë). Këta faktorë bëjnë që Gjykata të konsiderojë [...] se kërkuesi ishte nën mbikëqyrje të vazhdueshme dhe nuk ishte i lirë të largohej nga institucioni pa leje kur të dëshironte.

**80.** Lidhur me kohëzgjatjen e masës, Gjykata vëren se ajo ishte e papërcaktuar dhe se kërkuesi kishte jetuar në qendrën Ële, në komunën Ële, për më shumë se tetë vjet. Kjo periudhë është mjaftueshëm e gjatë që ai të ndiente pasojat e plota negative të kufizimeve të vendosura ndaj tij.

**81. Gjykata i kthehet elementit “subjektiv” [...]. Gjykata rithekson se fakti që kërkuesit i mungonte de jure zotësia për të vepruar, për të vendosur vetë për çështje të tij, nuk do të thotë domosdoshmërisht se de facto ai e kishte të pamundur të kuptonte situatën ku ndodhej** (shih *Shtukurov*, cituar më lart, par. 108). Ndërsa Gjykata pranon se, ka situata kur dëshirat e një personi me aftësi të kufizuara mendore mund të zëvendësohen në mënyrë të vlefshme nga ato të një personi tjetër, që vepron në kontekstin e masave mbrojtëse dhe se, ndonjëherë, është e vështirë të përcaktohen dëshirat e vërteta, apo preferencat e personit në fjalë (shih *Stanev*, cituar më lart par. 130), Gjykata konstaton se ky nuk ishte rasti i kërkuesit. Dokumentet që iu paraqitën Gjykatës tregojnë se kërkuesi subjektivisht e perceptonte pranimin e tij të detyruar në Qendrën Ële si heqje të lirisë. [...] Ai nuk e ka pranuar kurrë se ka dhënë pëlqimin e tij për pranimin në institucion dhe e ka kundërshtuar atë gjatë kohës së qëndrimit në Qendër. Në disa raste, kërkuesi ka paraqitur padi para gjykatave të brendshme për rikthimin e zotësisë së tij për të vepruar, duke parashtruar se kjo gjë do të mundësohej largimin e tij nga Qendra. Në kërkesat e tij të mëtejshme drejtuar autoriteteve shtetërore, ai ka deklaruar shprehimisht se ishte vendosur në Qendër kundër vullnetit të tij [...] dhe se dëshironte të kishte një tjetër kujdestar ligjor, i cili do të kërkonte daljen e tij [...].

[...]

**82.** Së fundmi, Gjykata vëren se, edhe pse vendosja e kërkuesit në qendër ishte kërkuar nga kujdestarja ligjore e tij, pra një individ privat, kjo masë ishte zbatuar nga një institucion shtetëror, qendra sociale shtetërore. Prandaj, autoritetet kishin përgjegjësi për këtë situatë (shih *Shtukurov*, par. 110; *D.D. k. Lituanië* par. 151; dhe *Kędzior*, par. 59).

**83.** Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesit i ishte hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës nga 30 janari 2002, deri në 1 prill 2010 në Qendrën Ële, në komunën Ële.

### (ii) Qendra Ële në Lielbërze

**84.** Gjykata vëren se palët kanë mosmarrëveshje lidhur me elementët objektivë dhe subjektivë të vendosjes së kërkuesit në Qendrën Ële në Lielbërze nga 1 prill 2010, e në vijim. [...] Gjykata ka dyshime nëse mund të konsiderohet se kërkuesit i është hequr liria në Qendrën Ële, në Lielbërze. [...] vetë kërkuesi ka pranuar se kjo Qendër ishte një institucion i hapur. Më tej vëren se ai vetë kishte refuzuar të transferohej në një tjetër qendër kujdesi [...] duke u shprehur se ai ishte i kënaqur me qëndrimin e tij në Qendrën Ële, në Lielbërze [...] Kërkuesi është larguar nga Qendra në disa raste, për të ndenjur për një kohë me kujdestarin e tij të ri, zotin Petrovs. Së fundmi, Gjykata vëren se kërkuesi nuk iu drejtua ndonjë autoriteti shtetëror për të kërkuar nxjerrjen e tij nga qendra [...].

[...]

**85.** [...] Prandaj kërkuesit nuk i ishte hequr liria sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës që nga 1 prill 2010, e në vijim në Qendrën Ële, në Lielbërze [...].

### (b) Nëse vendosja e kërkuesit në Qendrën Ële, në komunën Ële, ishte në përputhje me nenin 5, par. 1.

[...]

**86.** Duket se i vetmi kusht për t'i hequr kërkuesit lirinë, ishte dhënia e pëlqimit nga kujdestarja ligjore, gruaja e tij, e cila ishte personi që kërkoi mbajtjen e kërkuesit në qendrën e përkujdesjes sociale (shih *Shtukurov*, cituar më lart par. 112). Lidhur me këtë, Gjykata pranon se kishte një bazë ligjore për vendosjen e kërkuesit në qendrën e përkujdesjes sociale.

**87.** Megjithatë, Gjykata vlerëson se nocioni i “ligjshmërisë” në kontekstin e nenit 5, par. 1, ka një kuptim më të gjerë. **Kuptimi i termit “procedurë e parashikuar me ligj” është ai i një procesi të rregullt, që do të thotë se çdo masë e cila i heq një personi lirinë e tij, duhet të merret dhe të ekzekutohet nga një autoritet i përshtatshëm dhe nuk duhet të jetë arbitrare** (shih *Winterwerp* par. 45, *X k. Finlandës*, nr. 34806/04, par. 148). Me fjalë të tjera, heqja e lirisë nuk mund të konsiderohet “e ligjshme” sipas kuptimit të nenit 5 par. 1, nëse procedura e brendshme nuk përmban garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit.

**88.** Në vendimin *Winterwerp*, Gjykata parashtrroi tre standarde minimale të cilat duhet të përmbushen, në mënyrë që të

plotësohet kushti i “ heqjes së ligjshme të lirisë së personave me probleme të shëndetit mendor”, sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, (e): me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, duhet të tregohet në mënyrë të besueshme se individ në fjalë ka probleme të shëndetit mendor, që do të thotë se **ekzistenca e një çrregullimi të vërtetë mendor duhet të përcaktohet nga një autoritet kompetent në bazë të një mendimi mjekësor objektiv**; çrregullimi mendor duhet të jetë i një shkalle dhe natyre që **bën të domosdoshëm kufizimin e detyrueshëm të lirisë; dhe se vlefshmëria e kësaj heqjeje lirie varet nga vijimësia e çrregullimit** (po aty, par. 39). Për këtë, Gjykata rithekson se, për të vendosur nëse një person ka “probleme të shëndetit mendor”, autoritetet e brendshme kanë një liri veprimi të caktuar, pasi në radhë të parë, u takon atyre të vlerësojnë provat e paraqitura në një çështje të caktuar; detyra e Gjykatës është që të kontrollojë, sipas Konventës, vendimet e këtyre autoriteteve (po aty, par. 40; *Stanev*, par. 155). Nuk është detyrë e Gjykatës që të rivlerësojë mendimet e ndryshme mjekësore, të cilat hyjnë kryesisht brenda kompetencës së Gjykatave të brendshme; megjithatë ajo duhet të vlerësojë nëse në marrjen e **vendimeve, objekt gjykimi, gjykatat e brendshme kanë pasur** në dispozicion prova të mjaftueshme për të justifikuar heqjen e lirisë (shih *Herz k. Gjermanisë*, nr. 44672/98, par. 51, 12 qershor 2003, *Plesó k. Hungarisë*, nr. 41242/08, par. 61, 2 tetor 2012).

**89.** Gjykata ka vërejtur se, në disa rrethana, mirëqenia e një personi me probleme të shëndetit mendor mund të jetë një faktor tjetër që merret parasysh, së bashku me provat mjekësore, për të vlerësuar nëse është e nevojshme që një person të vendoset në një institucion. Gjykata mendon se çdo masë mbrojtëse duhet të pasqyrojë sa më shumë që të jetë e mundur dëshirat e individëve të aftë të shprehin vullnetin e tyre. Mosmarrja e **këtij mendimi mund të sjellë situata abuzimi dhe të pengojë ushtrimin e të drejtave nga personat e cenueshëm**. Prandaj, çdo masë e marrë pa konsultimin paraprak të personit të interesuar, si rregull, kërkon një vlerësim të kujdesshëm (*Stanev*, par. 153).

[...]

**90.** [...] Gjykata konstaton se kuadri rregullator për vendosjen e individëve në qendra të përkujdesjes sociale, të cilët ashtu si kërkuesi, nuk kanë zotësi për të vepruar, nuk siguron garancitë e nevojshme [...]

**91.** [...] Duke pasur parasysh sa më lart, si edhe mungesën e një vlerësimi të përshtatshëm mjekësor për vendosjen e kërkuesit në qendër dhe mungesën e vlerësimit të rregullt të çrregullimeve të shëndetit mendor të tij, Gjykata vëren se vendosja e kërkuesit në Qendrën Ìle, në komunën Ìle nuk ishte bërë “në përputhje me ligjin” dhe se heqja e lirisë së tij nuk justifikohet nga germa (e) e nenit 5, par. 1, të Konventës.

**92.** [...] Prandaj ka pasur shkelje të nenit 5, par. 1.

**(c) Neni 5, par. 4, i Konventës për qendrën Ìle, në komunën Ìle**

**93.** Ndër parimet që kanë dalë në pah nga **jurisprudenca e Gjykatës në kuadër të nenit 5, par. 4**, për personat që kanë “probleme të shëndetit mendor” janë:

- **në rastet kur nuk bëhet një kontroll gjyqësor automatik e periodik i heqjes së lirisë, individit të cilit i është hequr liria për një periudhë të papërcaktuar apo të gjatë, në parim, ka të drejtë të kërkojë ligjshmërinë e heqjes së lirisë së tij, duke nisur procedura në intervale kohe “të arsyeshme” përpara një gjykate të brendshme;**
- **neni 5, par. 4, kërkon që kjo procedurë të ketë karakter gjyqësor dhe t’i sigurojë individit garanci të përshtatshme me llojin e kufizimit të lirisë në fjalë.** Në mënyrë që të përcaktohet nëse procesi përmban garanci të përshtatshme, duhet të mbahen në vëmendje edhe rrethanat e veçanta të rastit që shqyrtohet;
- **procesi gjyqësor sipas nenit 5, par. 4, nuk duhet të përmbajë gjithmonë të njëjtat garanci që kërkohen në kuadër të nenit 6, par. 1,** të Konventës për mosmarrëveshjet civile ose penale. Megjithatë, është thelbësore që subjekti i interesuar të ketë **qasje** në gjykatë dhe të ketë mundësi të dëgjohet personalisht ose përmes një përfaqësuesi (*Stanev*, par. 171).

**94.** Kjo vlen kur heqja fillestare e lirisë fillimisht autorizohet nga një autoritet gjyqësor (shih *X k. Mbretërisë së Bashkuar*, 5 nëntor 1981, par. 52), por vlen edhe më shumë në rrethanat e çështjes objekt shqyrtimi, kur vendosja e kërkuesit në Qendër ishte iniciuar nga një individ privat, konkretisht nga kujdestarja e kërkuesit, dhe kur vendimi ishte marrë nga autoritetet bashkiake dhe institucioni i përkujdesjes sociale, pa përfshirjen e gjykatave (shih *D.D. k. Lituanisë*, par. 164, dhe *Kędzior*, par. 76).

**95.** Gjykata pranon se format e kontrollit gjyqësor mund të jenë të ndryshme nga një fushë në tjetrën dhe mund të varen nga natyra e heqjes së lirisë [...] Megjithatë, në rastin në shqyrtim, gjykatat nuk ishin përfshirë në asnjë kohë dhe në asnjë lloj forme në vendimin për vendosjen e kërkuesit në qendër. Me sa duket, në situata si ajo e legjislacionit letonez, nuk parashikohet kontroll gjyqësor automatik për të rishikuar ligjshmërinë e pranimi të një personi në një institucion si Qendra Ìle. Për më tepër, ky kontroll nuk mund të iniciohet nga personi në fjalë, pasi ai nuk ka zotësi për të vepruar. Shkurtimisht, kërkuesi ishte privuar nga mundësia për të ndjekur në mënyrë të pavarur një mjet ligjor me karakter gjyqësor, për të kundërshtuar

institucionalizimin e tij të vazhdueshëm. Kjo konfirmon sërish mungesën e një kuadri ligjor efektiv në këtë fushë [...].

[...]

**96.** [...] Gjykata ...konstaton se ka shkelje të nenit 5, par. 4, të Konventës për sa i përket Qendrës Ìle, në komunën Ìle.

**97.** Nga ana tjetër, duke mbajtur parasysh se kërkuesit nuk i ishte hequr liria nga data 1 prill 2010 e në vijim në Qendrën Ìle, në Lielbërze, Neni 5, par. 4, i Konventës nuk është i zbatueshëm dhe nuk ka shkelje të kësaj dispozite.

“

**Lashin k. Rusionë, 22.01.2013, Nr. 33117/02**

*Nëse heqja e zotësisë së kërkuesit për të vepruar dhe shtrimi i tij në një spital psikiatrik përbënin shkelje të së drejtës së tij për jetë private dhe të drejtës për moskufizim të paligjshëm të lirisë.*

”

**Faktet** – Kërkuesit, i cili vuante nga skizofrenia, iu hoq zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor në vitin 2000. Babai i tij u caktua kujdestari ligjor i tij. Pas këtij vendimi, kërkuesi bëri dy apelime për rikthimin e zotësisë për të vepruar. Në vitin 2002, ai u shtrua në një spital psikiatrik në bazë të një urdhri mjekësor. Ndërsa në vitin 2003, vajza e tij u caktua si kujdestare ligjore dhe ai doli nga spitali psikiatrik. Kërkuesi u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të të drejtave të tij, garantuar nga neni 8, neni 5, par. 1 (e), neni 5, par. 4, neni 12 dhe 13 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës

#### a. Përpjekjet për të rifituar zotësinë për të vepruar deri më 20 dhjetor 2002.

**77.** Gjykata rikujton se heqja e zotësisë për të vepruar mund të përbëjë një ndërhyrje në jetën private të individit në fjalë (shih *Matter k. Sllovakisë*, nr. 31534/96, par. 68, 5 korrik 1999, dhe *Shtukurov k. Rusionë*, nr. 44009/05, par. 83, GJEDNJ 2008). Në rastin konkret, qeveria nuk ka kundërshtuar se heqja e zotësisë së kërkuesit për të vepruar përbën një ndërhyrje të tillë dhe Gjykata nuk sheh ndonjë arsye për të vërejtur ndryshe, sidomos nga këndvështrimi i kufizimeve të ndryshme serioze ndaj autonomisë personale të ZOTIT Lashin, shkaktuar nga kjo masë.

**79.** Në këtë rast, çështja që shtrohet për shqyrtim është nëse aftësia e kufizuar e kërkuesit për të kërkuar kthimin e zotësisë së tij për të vepruar, duhet të shqyrtohet si një ndërhyrje e shtetit në të drejtat e garantuara nga neni 8, apo në funksion të detyrimeve pozitive të shtetit në bazë të kësaj dispozite. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton nëse rasti është analizuar në aspektin e detyrimit pozitiv të shtetit për të marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme, për të siguruar të drejtat e kërkuesit në kuadër të par.1 të nenit 8, apo si një ndërhyrje e autoritetit publik e justifikuar në kuadër të par.2 të nenit 8. Parimet që zbatohen në këto raste janë mjaft të ngjashme. Megjithatë, në të dy kontekstet duhet pasur parasysh balanca e drejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe të komunitetit në tërësi (shih *Oluić k. Kroacisë*, nr. 61260/08, par. 46, 20 maj 2010, së bashku me referencat e cituara aty). Kjo

qasje është plotësisht e zbatueshme edhe në rastin në fjalë: Gjykata do të shqyrtojë nëse është mbajtur një ekuilibër i drejtë midis të drejtave të garantuara nga neni 8 dhe çdo interesi tjetër të ligjshëm, privat apo publik, të cilët konkurronin gjatë zhvillimit të procedurave në 2002.

**80.** Gjykata pranon se revokimi i zotësisë së një individi për të vepruar dhe mos ndryshimi i kësaj mase mund të bazohet në një numër qëllimesh të ligjshme, të tilla si mbrojtja e interesave të individit të prekur nga kjo masë. Autoritetet kombëtare kanë një hapësirë të caktuar vlerësimi në marrjen e vendimit nëse një individi i duhet kthyer ose jo zotësia për të vepruar. Detyra e parë e gjykatave të brendshme është që të vlerësojnë provat e paraqitura përpara tyre. Ndërkohë, detyra e Gjykatës është të shqyrtojë nëse vendimet e këtyre organeve janë marrë në përputhje me Konventën (shih *mutatis mutandis, Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 40, Seria A, nr. 33; *Luberti k. Italisë*, 23 shkurt 1984, Seria A, nr. 75, par. 27; dhe *Shtukurov k. Rusisë*, cituar më lart, par. 67).

**81.** Hapësira e vlerësimit që autoritetet kanë në këtë rast, varet nga dy faktorë të rëndësishëm. Së pari, nëse masa në shqyrtim ka një efekt vendimtar në autonominë personale të kërkuesit, si në rastin konkret (shih *X. dhe Y. k. Kroacisë*, nr. 5193/09, par. 102, 3 nëntor 2011), Gjykata duhet të shqyrtojë arsyetimin që autoritetet kombëtare kanë bërë për të justifikuar këtë masë të rreptë. Së dyti, Gjykata duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë cilësisë së procedurave të brendshme (shih *Shtukurov k. Rusisë*, cituar më lart, par.91). Meqenëse, neni 8 i Konventës nuk përmban kërkesa të qarta procedurale, procesi i vendimmarrjes duhet të garantojë që ndërhyrja në jetën private të individit të jetë e drejtë dhe të respektojë të drejtat e mbrojtura nga ky nen (shih *Görgülü k. Gjermanisë*, nr. 74969/01, par. 52, 26 shkurt 2004).

#### Aspekti procedural

**82.** Për sa i përket anës procedurale të vendimeve të brendshme, Gjykata vëren se më 26 shkurt 2002, gjykata vendase refuzoi t'i kthente kërkuesit zotësinë për të vepruar. Kjo gjykatë e dha këtë vendim pa e dëgjuar kërkuesin në seancë. Gjykata thekson se në raste të tilla, individi nuk është vetëm një palë e interesuar, por është edhe objekt i vetë shqyrtimit nga gjykata (shih *X. dhe Y. k. Kroacisë*, cituar më lart, par. 83, së bashku me referenca të tjera, shih edhe *mutatis mutandis, Winterwerp*, cituar më lart, par. 74). Ka disa raste përjashtimore nga rregulli i përgjithshëm se kur individi duhet të jetë i pranishëm gjatë këtyre seancave (shih *Berková k.*

*Slovakisë*, nr. 67149/01, par. 138 e në vijim, 24 mars 2009). Megjithatë, këto përjashtime lejohen vetëm kur gjykata vendase e ka shqyrtuar me kujdes këtë çështje. Në rastin konkret objekt gjykimi, gjykata e rrethit është shprehur se pjesëmarrja e kërkuesit në seancë do të "dëmtonte shëndetin e tij", por nuk ka asnjë provë që kjo gjykatë të ketë kërkuar mendimin e një mjeku specialist për këtë çështje. Gjykata nuk është në dijeni të ndonjë faktori tjetër që pengonte paraqitjen e ankuesit personalisht në gjykatë. Gjykata vlerëson se, supozimi që për shkak se një person vuan nga skizofrenia, ai duhet të përjashtohet nga procedurat gjyqësore, nuk është i mjaftueshëm.

**83.** Aspekti i dytë i procedurave të brendshme me interes për t'u shqyrtuar nga Gjykata është refuzimi i gjykatës vendase për të kryer një ekzaminim të ri psikiatrik të kërkuesit. Gjykata rithekson gjetjet e saj në çështjen *Stanev k. Bullgarisë* [DHOMA E MADHE] (nr. 36760/06, par. 241), GJEDNJ 2012), ku ajo është shprehur se, sipas kuptimit të qasjes në gjykatë në kuadër të nenit 6, par. 1, "e drejta për t'i kërkuar një gjykatë të rishikojë heqjen e zotësisë për të vepruar është një nga të drejtat më të rëndësishme të individit në fjalë".

**84.** [...] Gjykata arrin në përfundimin se, në kuadër të rrethanave të çështjes, kërkuesi kishte të drejtë t'i nënshtrohej një rishikimi tërësor të statusit të tij, procedurë e cila në parim duhet të kishte përfshirë një vlerësim të gjendjes së tij nga një mjek i ri.

**87.** Gjykata thekson se në rastet kur vlerësimi i një eksperti pritet të luajë një rol tepër të rëndësishëm në procesin gjyqësor, paanësia e ekspertit bëhet një nga kriteret më të rëndësishme që duhet marrë në konsideratë. Mungesa e paanësisë mund të sjellë cenim të parimit të barazisë së armëve, garantuar nga neni 6 i Konventës (shih *mutatis mutandis, Sara Lind Eggertsdóttir k. Islandës*, nr. 31930/04, par. 47, 5 korrik 2007, së bashku me referencat e cituara aty). Sipas vlerësimit të Gjykatës, paanësia e ekspertit është njësoj e rëndësishme në kontekstin e vlerësimit të aftësive të individit në një moment kur diskutohet një ndër të drejtat më bazike, në kuadër të nenit 8.

**89.** Gjykata rikujton se në bazë të vendimit të 26 shkurtit 2002, kërkuesi ka vazhduar të vuajë nga një çrregullim mendor, i cili kishte ndikuar në heqjen e zotësisë së tij për të vepruar në vitin 2000. Megjithatë, në një situatë ku gjykata vendase nuk e ka parë personalisht individin në fjalë dhe nuk bën një vlerësim të ri të gjendjes së tij mendore, një përfundim i arritur prej kësaj gjykatë nuk mund të konsiderohet si i besueshëm.

#### Aspekti substancial

**90.** [...] Gjykata nuk ve në dyshim raportin mjekësor vendas, veçanërisht raportin e vitit 2000, në të cilin saktësohej se kërkuesi vuante nga skizofrenia. Megjithatë, Gjykata risjell në vëmendje rastin *Shtukurov*, cituar më lart, par. 94, ku ajo u shpreh se "ekzistenca e një çrregullimi mendor, madje edhe e një çrregullimi të rëndë, nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të justifikuar heqjen e plotë të zotësisë për të vepruar". Për analogji me rastet që kanë të bëjnë me kufizimin e lirisë, në mënyrë që të justifikohet heqja e plotë e zotësisë për të vepruar, çrregullimi mendor duhet të jetë "i një lloji apo shkalle të tillë" që të justifikojë ndërmarrjen e një mase të tillë. Në çështjen *Shtukurov* Gjykata konstatoi se në procedimet e brendshme, çështja e "llojit dhe shkallës" së çrregullimit të shëndetit mendor të kërkuesit mbetën të pazgjdhura.

**92.** Gjykata pranon se ishte e nevojshme të merreshin disa masa parandaluese për sigurinë personale të kërkuesit. Megjithatë, Kodi Civil rus nuk parashikon asnjë masë të përkohshme të kufizimit të zotësisë për të vepruar për personat që vuajnë nga probleme të shëndetit mendor – këto masa ekzistojnë vetëm për personat që kanë varësi nga droga ose alkooli (po aty, par. 95). Për rrjedhojë, gjykata vendase, ashtu sikurse edhe në çështjen *Shtukurov*, nuk kishte mundësi tjetër përveçse t'i hiqte kërkuesit zotësinë për të vepruar – masë tepër e rreptë, e cila shpie si pasojë në humbjen e autonomisë së plotë gati në të gjitha fushat e jetës. Në vlerësim të Gjykatës, duke u bazuar edhe tek rrethanat e çështjes konkrete, kjo masë nuk ishte në proporcion me qëllimin legjitim për të cilin u ndërmore.

#### Përfundim

**93.** Në përfundim, Gjykata vlerëson se rikonfirmimi i mungesës së zotësisë së kërkuesit për të vepruar në vitin 2002, duke u bazuar në raportin e vitit 2000, nuk ishte i justifikuar për të paktën dy arsye: së pari, sepse nuk u bë një vlerësim i ri i gjendjes së shëndetit mendor të kërkuesit, i cili nuk ishte personalisht i pranishëm gjatë gjykimit; dhe së dyti, në bazë të raportit të vitit 2000, aftësitë e kërkuesit nuk ishin aq të kufizuara sa për t'i hequr atij zotësinë për të vepruar. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuesit, të garantuar nga neni 8 i Konventës.

#### b. Përpjekjet për të rifituar zotësinë për të vepruar pas 20 dhjetorit 2002

**97.** Gjykata thekson se në shumicën dërrmuese të rasteve, kur aftësitë e një individi për të vepruar dhe arsyetuar varen nga çrregullime të shëndetit mendor, gjendja e tij është subjekt ndryshimesh. Për këtë arsye, parimet e mbrojtjes së personave që u është hequr zotësia juridike për të vepruar rekomandojnë një rivlerësim të herë pas hershëm të gjendjes së këtyre personave. Një kërkesë e tillë parashikohet edhe nga neni 12 (4) i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Në çështjen *Stanev*, cituar më lart, Gjykata ka vërejtur se ekziston tashmë një tendencë në nivel evropian për t'u dhënë personave që u është hequr zotësia për të vepruar qasje të drejtpërdrejtë në gjykata për të kërkuar rikthimin e zotësisë së tyre (par. 243). Fillimisht, Rusia nuk e parashikonte në legjislationin e saj mundësinë për rishikimin e situatës së një individi, të cilit i ishte revokuar zotësia për të vepruar; kohë më pas kjo e drejtë i takonte vetëm kujdestarit ligjor të individit në fjalë (shih *mutatis mutandis, Salontaji-Drobnjak k. Serbisë*, nr. 36500/05, par. 134, 13 tetor 2009). Ndërkohë, në çështjen konkrete, kujdestari i kërkuesit refuzoi të bënte kërkesë për të rishqyrtuar gjendjen e zotit Lashin dhe, për rrjedhojë, kërkuesi nuk zotëronte një mjet ligjor për të rikthyer statusin e tij juridik. Duke marrë në konsideratë vënien në pikëpyetje të të drejtave të kërkuesit, Gjykata arrin në përfundimin se pamundësia e tij për të përdorur për një kohë të gjatë të drejtat e tij, të garantuara nga neni 8, bie në kundërshtim me të drejtat e garantuara nga ky nen i Konventës. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 1, të Konventës

**109.** Gjykata vëren se në mënyrë që të garantohet e drejta e mbrojtur nga neni 5 par. 1, kufizimi i lirisë në fjalë duhet të përmbushë dy kërkesa kryesore. Së pari, duhet të jetë i ligjshëm në bazë të legjislationit vendas, duke përfshirë respektimin e procedurave të parashikuara nga ligji. Në këtë drejtim, Konventa i referohet legjislationit vendas dhe përcakton detyrimet në përputhje me rregullat procedurale dhe materiale në fuqi. Së dyti, jurisprudenca e Gjykatës në kuadër të nenit 5, kërkon që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e nenit 5, pikërisht për të mbrojtur individët nga arbitrariteti i shtetit (shih *Creangă k. Rumanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 29226/03, par. 84, 23 shkurt 2012; *Herczegfalvy k. Austrisë*, 24 shtator 1992, par. 63, Seria A, nr. 244; *Venios k. Greqisë*, nr. 33055/08,

par. 48, 5 korrik 2011, dhe *Karamanof k. Greqisë*, nr. 46372/09, par. 40 e në vijim, 26 korrik 2011). Kjo nënkupton që kufizimi i lirisë së një individi nuk duhet të jetë vetëm në përputhje me ligjin vendas, por duhet të jetë edhe një veprim i nevojshëm, në kuadër të rrethanave të çështjes (shih *Witold Litwa k. Polonisë*, nr. 26629/95, par. 78, GJEDNJ, 2000-III).

**110.** Për sa u përket dy kushteve të mësipërme, një individi nuk mund t'i hiqet liria për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor, nëse nuk përmbushen tre kushtet e mëposhtme që konsiderohen si garanci minimale: së pari, të vërtetohet se personi vuan nga çrregullime të shëndetit mendor; së dyti, çrregullimi mendor duhet të jetë i një lloji apo shkalle që të legjitimojë izolimin e detyrueshëm (si p.sh., kur individi ka nevojë për terapi, mjekim ose trajtime të tjera klinike, në mënyrë që të kurojë ose përmirësojë gjendjen e tij, ose në rastet kur ai ka nevojë për kontroll, për shkak se mund të dëmtojë veten ose të tjerët – shih *Hutchison Reid k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 50272/99, par. 52, GJEDNJ, 2003-IV); vlefshmëria e izolimit të vazhdueshëm varet nga kohëzgjatja e një çrregullimi të tillë (shih *Winterwerp*, cituar më lart, par. 39; *Shtukaturov*, cituar më lart, par. 114; dhe *Varbanov k. Bullgarisë*, nr. 31365/96, par. 45, GJEDNJ, 2000X).

#### **Për periudhën 9 dhe 20 dhjetor 2002**

**113.** [...] Gjykata vëren se pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, formuluar me terma jo të saktë, vlefshmëria e vendimit për të mos i rikthyer kërkuesit zotësinë për të vepruar u konfirmua. Asnjë rrethanë nuk vërteton se vendimi i vitit 2009 duhet të kishte pasur një efekt prapaveprues dhe të ndikonte në gjendjen e kërkuesit. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se “ligjshmëria” e izolimit të kërkuesit në vitin 2002 duhet të vlerësohet në kuadër të dispozitave të Ligjit për Kujdesin Psikiatrik, sikurse duhet të ishte interpretuar në kohën kur ndodhën ngjarjet.

**114.** [...] Në kuadër të rrethanave të ngjarjes, Gjykata arrin në përfundimin se, ndalimi i kërkuesit në periudhën e parë, nuk ishte në përputhje me ligjin dhe procedurën e parashikuar në Ligjin për Kujdesin Psikiatrik.

#### **Për periudhën pas 20 dhjetorit 2002**

**116.** Situata e kërkuesit gjatë periudhës së dytë ngjan së tepërmi me atë të shqyrtuar në çështjen *Shtukaturov* (cituar më lart). Gjykata rithekson se vendosja e tij në një spital psikiatrik nuk do të konsiderohet si veprim i kryer me

“vullnet” në kuadër të Konventës, për shkak se është marrë pëlqimi i kujdestarit. Megjithëse ndonjëherë është e vështirë për të dalluar vullnetin e vërtetë të një personi që vuan nga probleme të shëndetit mendor (shih *Storck k. Gjermanisë*, nr. 61603/00, par. 74, GJEDNJ, 2005V), Gjykata është e bindur se në rastin konkret, kërkuesi nuk ka shprehur vullnetin e tij për t'u shtruar në spital. [...] Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka pasur mundësi të mbrojë të drejtat e tij gjatë procesit gjyqësor. Vetëm ky fakt i marrë më vete është i mjaftueshëm që Gjykata të vlerësojë se ndalimi i tij nuk është bërë në përputhje me nenin 5, par. 1, të Konventës.

**117.** Për më tepër, **kujdestari i kërkuesit është i njëjti institucion që ka kërkuar shtrimin e tij në spital dhe që ishte përgjegjës për trajtimin e kërkuesit dhe i cili është paditur nga kërkuesi gjatë procesit gjyqësor. Me fjalë të tjera, mungesa e paanësisë së kujdestarit të ri ligjor përkundrejt kërkuesit është e qartë.**

**119.** Gjykata thekson se, ajo natyrisht nuk do të shqyrtojë mendimin e një mjeku paanshmëria dhe kualifikimet e të cilit nuk vihen në pikëpyetje, në një kohë kur ky mjek ka pasur kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin. Megjithatë, në rastin konkret, Gjykata do t'i shqyrtojë në mënyrë kritike gjetjet e psikiatërve për shkak se **(a) përfundimet e tyre nuk janë dorëzuar për shqyrtim gjyqësor në proceset e brendshme; (b) paanësia linte vend për dyshime; dhe (c) raportet e tyre nuk ishin të specifikuar mjaftueshëm në pikat thelbësore për të vendosur nëse trajtimi i detyrueshëm ishte i nevojshëm.**

#### **Përfundimi**

**120.** Elementët e përmendur më sipër janë të mjaftueshëm që Gjykata të arrijë në përfundimin se shtrimi i detyruar i kërkuesit në periudhën 9 dhjetor 2002 deri 10 dhjetor 2003, bie ndesh me nenin 5, par. 1, të Konventës.

Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 4, të Konventës

**121.** Gjykata rithekson parimin e vendosur në par. 39 të vendimit *Winterwerp* se, për efekt të vlefshmërisë së heqjes së lirisë së një individi, arsyetimi duhet të varet nga vazhdimësia e çrregullimit të shëndetit mendor, lloji dhe shkalla e kësaj sëmundjeje. [...] Në një situatë thuhet identike, **Gjykata vërejtë se pamundësia e një pacienti të një spitali psikiatrik për të kërkuar vetë, ose përmes kujdestarit, daljen nga spitali, kur nuk është bërë asnjë rishikim periodik gjyqësor i ligjshmërisë së shtrimit të tij në spital, përbën**

**shkelje të nenit 5, par. 4, të Konventës** (shih *D.D. k. Lituanië*, nr. 13469/06, par. 164 e në vijim, 14 shkurt 2012).

**122.** Gjykata arrin në përfundimin se në këtë situatë, kërkuesi nuk kishte mundësi të “niste procedura gjyqësore për të kundërshtuar

ligjshmërinë e shtrimit të tij në spital”. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 5, par. 4, të Konventës.

#### **Shpërblimi i drejtë**

**128.** Gjykata vlerësoi se kërkuesi duhet të përfitojë si dëmshpërblim 25.000 euro në kuadër të dëmit jo material.

“

**Stanev k. Bullgarisë (Dhoma e Madhe), 17.01.2012, Nr. 48977/09**

*Nëse heqja e zotësisë së kërkuesit për të vepruar, vendosja e tij në një qendër sociale pa vendim gjyqësor dhe mohimi i të drejtës së tij për të kërkuar rivendosjen e zotësisë për të vepruar, përbënin shkelje të lirisë dhe sigurisë, shkelje të së drejtës për mjet efektiv dhe të së drejtës për proces të rregullt ligjor.*

”

**Faktet** – Zoti Stanev ishte diagnostikuar me skizofreni dhe, për rrjedhojë, gjykatat vendase i kishin hequr zotësinë për të vepruar. Në vitin 2002, me dëshirën e kujdestarit të tij ligjor, kërkuesi u vendos në qendrën sociale Pastra, e cila ndodhej në një zonë malore të veçuar, ku qëndroi për 9 vjet. Kujdestari i tij ligjor e mori vendimin për shtrimin e kërkuesit në këtë qendër pa u konsultuar me zotin Stanev dhe pa asnjë vendim gjyqësor. Kërkuesi pretendoi se ky institucionalizim i detyrueshëm cenonte të drejtën e tij për të jetuar lirë. Para GJEDNJ-së, zoti Stanev u anka se i ishte mohuar drejta për të jetuar në komunitet, se kushtet e jetesës në qendrën sociale ishin çnjerëzore dhe poshtëruese, si edhe se iu mohua drejta për t'u drejtuar gjykatave, për të kërkuar rivendosjen e zotësisë së tij të plotë për të vepruar dhe pretendoi shkelje të lirisë dhe sigurisë.

#### **Vlerësimi i Gjykatës**

##### **Në lidhje me cenimin e lirisë dhe sigurisë**

**115.** Gjykata thekson se ndryshimi mes heqjes së lirisë, që futet në fushën e mbrojtjes së nenit 5 të Konventës, dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, që futet në fushën e zbatimit të nenit 2 të Protokollit 4 të Konventës, ka të bëjë me shkallën ose intensitetin dhe jo me natyrën apo substancën. Megjithëse, procesi i klasifikimit të veprimit në njërin apo në tjetrin rast, shpesh herë nuk është një detyrë e thjeshtë, sepse kufiri mes njërit dhe tjetrit është vetëm çështje opinioni, Gjykata nuk mund të mos e bëjë këtë klasifikim, në bazë të të cilit do të varet zbatimi ose jo i nenit 5 të Konventës (shih *Guzzardi k. Italisë*, 6 nëntor 1980, par. 92-93, Seria A, nr. 39). Në mënyrë që të përcaktohet **nëse dikujt i është hequr liria, pikënisja duhet të jetë gjendja e tij specifike dhe vlerësimi duhet të bëhet duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e faktit si lloji, kohëzgjatja, efektet dhe mënyra e**

**zbatimit të masës në fjalë** (shih *Storck*, par. 71 dhe *Guzzardi*, cituar më lart, par. 92).

**116.** Në kontekstin e heqjes së lirisë për shkak të shëndetit mendor, Gjykata është shprehur se një individ duhet të konsiderohet njësoj sikur është “i ndaluar” edhe gjatë periudhës kur ai ka qenë i shtruar në një spital civil në një pavijon të zakonshëm, pa mbikëqyrjen e rojeve të veçanta, edhe nëse ka pasur mundësi të largohet nga spitali i pashoqëruar (shih *Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 maj 1985, par. 42, Seria A, nr. 93).

**117.** Më tej, lidhur me vendosjen e personave në një institucion, Gjykata është shprehur se nocioni i heqjes së lirisë nuk përfshin vetëm elementin objektiv të vendosjes së personit në një hapësirë të kufizuar për një periudhë kohe jo të papërfillshme. Një personi mund të konsiderohet se i është hequr liria nëse nuk ekziston edhe një element subjektiv, që do të thotë se ai nuk e ka pranuar në mënyrë të vlefshme heqjen e lirisë ( *Storck*, par. 74).

**118.** Gjykata është shprehur se ka heqje të lirisë në situatat e mëposhtme: (a) kur kërkuesi, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe është pranuar në një spital psikiatrik me kërkesë të përfaqësuesit të tij ligjor, është përpjekur të largohet nga spitali (shih *Shtukurov k. Rusisë*, nr. 44009/05, par. 108, GJEDNJ, 2008); kur një kërkues ka kërkuar të shtrohet në një klinikë, por më pas është munduar të largohet (shih *Storck*, cituar më lart, par. 76); dhe kur kërkuesi ka qenë madhor, por i pazoti për të dhënë miratimin e tij për t'u shtruar në një institucion psikiatrik, pavarësisht se nuk është munduar asnjëherë të largohet prej aty (shih *H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 45508/99, par. 89-94, GJEDNJ, 2004-IX).

**119.** Gjithashtu, Gjykata është shprehur edhe më parë se e drejta për liri është shumë e rëndësishme në një shoqëri demokratike dhe se një individ nuk mund ta humbasë përfitimin e mbrojtjes nga Konventa për arsyen e vetme se ai mund t'u jetë dorëzuar autoriteteve ... (shih *De Wilde, Ooms dhe Versyp k. Belgjikës*, 18 qershor 1971, par. 6465, Seria A, nr. 12), veçanërisht kur nuk është vënë në diskutim se personi nuk ka zotësi për të vepruar në lidhje me pranimin ose kundërshtimin e veprimit në fjalë (shih *H.L. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 90).

**120.** Për më tepër, Gjykata ka pasur rastin të vërejtë se **fjalja e parë e nenit 5, par. 1, duhet të interpretohet se krijon një detyrim pozitiv për shtetin për të mbrojtur lirinë e individëve brenda juridiksionit të tij.** Në të kundërt, do të ketë një boshllëk në mbrojtjen nga heqjet arbitrare të lirisë, gjë e cila do të binte në kundërshtim me rëndësinë e lirisë personale në një shoqëri demokratike. Pra, shteti është i detyruar të marrë masa për të siguruar një mbrojtje efektive për personat në gjendje të brishtë, duke përfshirë këtu edhe masa të arsyeshme për të parandaluar heqjen e lirisë për të cilën autoritetet kanë ose duhet të kishin dijeni (shih *Storck*, cituar më lart, par. 102). [...] **Gjykata është shprehur se autoritetet shtetërore kanë përgjegjësi në rast të heqjes së lirisë në një spital psikiatrik me kërkesë të kujdestarit ligjor të një kërkuesi (Shtukurov) dhe heqjen e lirisë në një klinikë private (Storck).**

**121.** Gjykata vëren se në çështjen konkrete është e domosdoshme të përcaktohet nëse, në terma të përgjithshëm, vendosja e një personi që i është kufizuar zotësia për të vepruar në një qendër sociale, përbën "heqje të lirisë" sipas kuptimit të nenit 5, par. 1 [...].

[...].

**123.** Bazuar në faktet e çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se vendosja e kërkuesit në një qendër sociale u atribuohet autoriteteve shtetërore. Mbetet për të përcaktuar nëse kufizimet që erdhën nga ky veprim kanë sjellë "heqje të lirisë" sipas kuptimit të nenit 5.

**124.** Për sa i përket aspektit objektiv të kufizimit të lirisë, **Gjykata vëren se kërkuesi ishte vendosur në një qendër nga e cila kishte mundësi të largohej, por duhet theksuar se çështja nëse ndërtesa ishte e kyçur ose jo nuk është vendimtare** (shih *Ashigdane*, cituar më lart, par. 42). [...]

**125.** Gjykata vlerëson nëse **sistemi i lejeve të qendrës mbanin dokumentet e identifikimit të kërkuesit, i administronin atij financat, përfshi shpenzimet për transportin, përbëjnë një kufizim të konsiderueshëm të lirisë së tij personale** [...]. 129. Për sa i përket kohëzgjatjes së masës, duhet të nënvizohet se, në kundërshtim me parashikimet e ligjit vendas [...], kërkuesit nuk i është kërkuar të japë mendimin e tij në lidhje me shtrimin në qendrën sociale. Ndërkohë, ai asnjëherë nuk e ka miratuar këtë veprim në mënyrë të shprehur [...].

**130.** Për sa i përket anës subjektive të masës, duhet theksuar se në ndryshim nga parashikimet e legjislationit vendas [...], kërkuesit nuk iu kërkuar të jepte mendimin e tij për t'u vendosur në qendrën sociale. Ndërkohë, ai nuk e konfirmoi asnjëherë në mënyrë të shprehur vendosjen aty. Për më tepër, ai u dërgua në qendrën sociale me ambulancë dhe u vendos aty, pa u njoftuar për arsyet ose kohëzgjatjen e kësaj mase të marrë nga kujdestari i tij ligjor. Gjykata vëren se ekzistojnë disa situata, në të cilat dëshirat e individit me aftësi të kufizuara mendore, mund të zëvendësohen në mënyrë të ligjshme me dëshirat e një individi tjetër i cili vepron në kontekst mbrojtës dhe se ndonjëherë është e vështirë për të konstatuar se cila ka qenë dëshira e individit në fjalë. Megjithatë, Gjykata është shprehur edhe më parë se, fakti që një individ nuk ka zotësi të plotë për të vepruar, nuk nënkupton detyrimisht se ai është i paaftë për të kuptuar situatën në të cilën ndodhet (shih *Shtukurov*, cituar më lart, par. 108). Në çështjen konkrete, legjislationi vendas u jep një hapësirë të caktuar dëshirave të kërkuesit, i cili duket se duhet të jetë në dijeni të situatës në të cilën ndodhet [...].

**131.** Këto rrethana e largojnë çështjen konkrete objekt gjykimi nga *H.M. k. Zvicrës*, në të cilën Gjykata është shprehur se nuk kishte heqje të lirisë, pasi kërkuesja ishte vendosur

në një qendër shëndetësore vetëm për të mirën e saj dhe më vonë kish shprehur në mënyrë të qartë vullnetin e saj për të qëndruar aty. **Në çështjen konkrete në gjykim, qeveria nuk arriti të provonte se, pasi kishte mbërritur në qendrën sociale, kërkuesi kishte shprehur menjëherë ose në një moment të mëvonshëm vullnetin e tij për të qëndruar aty.** Në këto rrethana, Gjykata nuk krijon bindjen se kërkuesi kishte rënë dakord, ose kishte pranuar në mënyrë të heshtur vendosjen e tij në qendrën sociale.

**132.** Duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat e veçanta të çështjes konkrete, veçanërisht përfshirjen e autoriteteve në vendimin e shtrimit të kërkuesit në qendrën sociale, rregullat e dhënies së lejes, kohëzgjatjen e qëndrimit në qendër dhe mungesën e pëlqimit të kërkuesit, Gjykata arrin në përfundimin se situata në fjalë përbën një heqje të lirisë sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës. Rrjedhimisht, parashikimet e këtij neni zbatohen për rastin në fjalë.

**Nëse vendosja e kërkuesit në qendrën sociale ishte në përputhje me nenin 5, par. 1**

**143.** Gjykata thekson se heqja e lirisë duhet të ketë qenë para së gjithash e "ligjshme" në mënyrë që të jetë në përputhje me të drejtën e garantuar nga neni 5, par. 1, duke shtuar këtu edhe faktin se procedura e heqjes së lirisë duhet të jetë e parashikuar në ligj. Kështu, Konventa i referohet legjislationit vendas dhe përcakton detyrimin e zbatueshmërisë së rregullave të tij materiale dhe procedurale. Megjithatë, ajo kërkon që çdo heqje e lirisë së individëve të jetë në përputhje me parashikimet e nenit 5, në mënyrë që të mbrojtë individët nga arbitrariteti shtetëror (shih *Herczegfalvy k. Austrisë*, 24 shtator 1992, par. 63, Seria A, nr. 244). **Për më tepër, heqja e lirisë së një personi është një masë aq serioze, sa që mund të justifikohet vetëm në rast se masat e tjera më të lehta janë konsideruar si të pamjaftueshme për ta mbrojtur atë individin, ose për të mbrojtur interesin publik.** Kjo nënkupton se nuk mjafton vetëm që heqja e lirisë së një personi të bëhet në përputhje me legjislationin vendas, por duhet të jetë edhe e nevojshme për rrethanat konkrete (shih *Witold k. Polonisë*, nr. 26629/95, par. 78, GJEDNJ, 2000-III).

**144.** Nën-par. (a) deri në (f) të nenit 5, par. 1, përcaktojnë një listë shteruese të rasteve kur lejohet kufizimi i lirisë. Një masë e tillë nuk mund të jetë e ligjshme nëse nuk përmbush njërin prej këtyre kritereve (po aty, par. 49, shih gjithashtu

*Saadi k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 13229/03, par. 43, GJEDNJ, 2008, dhe *Jendrowiak k. Gjermanisë*, nr. 30060/04, par. 31, 14 prill 2011).

**145.** Personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, nuk mund tu kufizohet liria si të "sëmurë mendorë", përveç rasteve kur plotësohet një nga kushtet e mëposhtme: së pari, personi duhet të ketë treguar në mënyrë të qartë se ka probleme të shëndetit mendor; së dyti, çrregullimi mendor duhet të jetë i atij lloji ose shkalle që të bëjë të detyrueshëm izolimin; së treti, vlefshmëria e një izolimi të tillë varet nga kohëzgjatja e një çrregullimi të tillë (shih *Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 39, Seria A, nr. 33; *Shtukurov*, cituar më lart, par. 114; dhe *Varbanov*, cituar më lart, par. 45).

**146.** Në lidhje me kushtin e dytë cituar më lart, heqja e lirisë së një personi që vuan nga çrregullime të shëndetit mendor duhet të jetë e nevojshme jo vetëm në rastet kur individit i nevojitet terapi, mjekim ose trajtim klinik, për të kuruar ose lehtësuar gjendjen e tij, por edhe kur individit ka nevojë për kontroll dhe mbikëqyrje, në mënyrë që të parandalohet, për shembull, dëmtimi që mund t'i shkaktojë vetes ose personave të tjerë (shih *Hutchison Reid k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 50272/99, par. 52, GJEDNJ, 2003IV).

**149.** Në bazë të instrumenteve ligjore vendase, Gjykata vëren se legjislationi bullgar parashikon si masë mbrojtëse që individët mund të vendosen në qendra sociale, vetëm kur shprehin pëlqimin e tyre, duke mos e parashikuar si urdhër shtrëngues nga ata që listohen në nën-par. (a) deri në (f) të nenit 5 par. 1. Megjithatë, në rrethanat e veçanta të çështjes konkrete objekt gjykimi, masa e marrë ka shkaktuar një kufizim të konsiderueshëm të lirisë personale, duke sjellë kështu një heqje lirie, pa u marrë parasysh vullneti apo dëshirat e kërkuesit.

**150.** Edhe në rast se do të ishte ndjekur procedura e parashikuar nga ligji, Gjykata vëren se sipas legjislationit vendas, kujdestari i një personi me zotësi të kufizuar për të vepruar, nuk është i legjitimuar për të ndërmarrë veprime ligjore në emër të personit që ka në kujdestari. Kontratat e lidhura në një rast të tillë do të jenë të vlefshme, nëse kanë nënshkrimin e kujdestarit dhe personit që është në kujdestari të pjesshme. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se vendimi i marrë nga kujdestari i kërkuesit, për ta shtruar këtë të fundit në një qendër sociale për personat me çrregullime të shëndetit mendor, është i pavlefshëm në bazë të legjislationit bullgar. Ky përfundim në vetvete është i mjaftueshëm



që Gjykata të përcaktojë se heqja e lirisë së kërkuesit ka qenë në kundërshtim me nenin 5.

**151.** Në çdo rast, Gjykata vlerëson se masa e ndërmarrë nuk ka qenë e ligjshme sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, të Konventës, për sa kohë që ajo nuk përlligjet me parashikimet e ndonjë prej nën-paragrafëve (a) deri në (f) [...].

**159.** Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat e çështjes, Gjykata vëren se vendosja e kërkuesit në qendrën në fjalë nuk ishte urdhëruar “në bazë të procedurës së parashikuar nga ligji” dhe se kjo heqje lirie nuk përlligjet nga nën-par. (e) i nenit 5, par. 1. Për më tepër, përfaqësuesit e qeverisë nuk kanë paraqitur asnjë nga shkaqet e tjera të listuara në nën-par. (a) deri në (f), të cilët mund të kishin përlligjur heqjen e lirisë në rastin konkret.

**160.** Për rrjedhojë, në këtë rast ka pasur shkelje të nenit 5, par.1 të Konventës.

#### **Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 4, të Konventës**

**168.** Gjykata thekson se neni 5, par. 4, u jep individëve të cilëve i është hequr liria të drejtën të nisin një proces për të kontrolluar anën procedurale dhe materiale të heqjes së lirisë së tyre, të cilat janë thelbësore për “ligjshmërinë” e ndalimit në kuadër të Konventës. Kuptimi i ligjshmërisë, sipas par. 4 të nenit 5, është i njëjtë me atë të par. 1 të po atij neni, **prandaj një individ ka të drejtë të rishikojë ligjshmërinë e heqjes së lirisë, jo vetëm në bazë të legjislacionit të brendshëm, por edhe në kuadër të Konventës, sipas parimeve të përgjithshme të parashikuara në të dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga neni 5, par. 1.** Neni 5, par. 4, nuk garanton të drejtën e kontrollit gjyqësor me qëllim që t’i japë më tepër pushtet gjykatës, në lidhje me të gjitha aspektet e çështjes, përfshi edhe çështje thjesht pragmatiste, për të zëvendësuar autoritetin vendimmarrës me të drejtën e vet për të vendosur. Megjithatë, kontrolli gjyqësor duhet të jetë mjaftueshëm i detajuar, për të evidentuar kushtet e nevojshme, të cilat legjitimojnë heqjen e lirisë së një personi në mënyrë të ligjshme në kuadër të nenit 5, par. 1 (shih *E. k. Norvegjisë*, 29 gusht 1990, par. 50, Seria A, nr. 181-A). Gjykata “kontrolluese” nuk duhet të ketë vetëm funksione këshilluese, por duhet të vendosë mbi “ligjshmërinë” e ndalimit dhe të urdhërojë lirimin e personit në rastet kur ndalimi nuk ka qenë i ligjshëm (shih *Ireland k. Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, par. 200, Seria A, nr. 25; *Weeks k. Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987, par. 61, Seria A, nr. 114; *Chahal k. Mbretërisë së Bashkuar*,

15 nëntor 1996, par. 130, Raporti i gjykimeve dhe vendimeve 1996V; dhe *A. dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 3455/05, par. 202, GJEDNJ, 2009).

**169.** Format e kontrollit gjyqësor, që përmbushin kriteret e nenit 5, par. 4, mund të ndryshojnë nga një fushë në tjetrën dhe varen nga lloji i kufizimit të lirisë. Nuk është detyrë e Gjykatës që të përcaktojë se cili do të ishte sistemi më i përshtatshëm i kontrollit në çështjen në shqyrtim (shih *Shtukurov*, cituar më lart, par. 123). [...]

**171.** Ndër parimet që kanë dalë në pah nga jurisprudenca e Gjykatës, në kuadër të nenit 5 par. 4, në lidhje me personat të cilët kanë “probleme të shëndetit mendor” janë:

a. një individ të cilit i është hequr liria për një periudhë të papërcaktuar apo të gjatë është në parim ka të drejtë të nisë procedura në intervale kohe “të arsyeshme”, përpara një gjykate, për të kërkuar ligjshmërinë e ndalimit të tij, sipas Konventës, në çdo rast kur nuk bëhet një kontroll gjyqësor automatik i ndalimit në mënyrë periodike;

b. neni 5, par. 4, kërkon që procedura e ndjekur të ketë karakter gjyqësor dhe t’i sigurojë individit garanci të përshtatshme me llojin e kufizimit të lirisë në fjalë; në mënyrë që të përcaktohet nëse procesi ka siguruar garanci të përshtatshme, duhet të merren parasysh edhe rrethanat e veçanta të rastit që shqyrtohet;

c. procesi gjyqësor sipas nenit 5, par. 4, nuk duhet të përmbajë gjithmonë të njëjtat garanci që kërkohen në kuadër të nenit 6, par. 1, të Konventës për mosmarrëveshjet civile ose penale. Megjithatë, është thelbësore që subjekti i interesuar të ketë qasje në gjykatë dhe të ketë mundësinë të dëgjohet prej saj personalisht, ose përmes një përfaqësuesi (shih *Megyeri k. Gjermanisë*, 12 maj 1992, par. 22, Seria A, nr. 237-A)[...].

**172.** Gjykata vëren se qeveria bullgare nuk e evidentoi asnjë mjet ankimi, i cili i jepte mundësitë drejtpërdrejtë kërkuesit të kundërshtonte ligjshmërinë e shtrimit të tij në qendrën sociale dhe kontrollin e zbatimit të kësaj mase në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, Gjykata vëren se edhe gjykatat e brendshme nuk u përfshinë në asnjë rast dhe në asnjë moment në këtë çështje dhe se legjislacioni kombëtar nuk parashikon periudha të vendosjes së individëve me probleme të shëndetit mendor në qendra sociale.

**177.** Për rrjedhojë, **Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi nuk kishte mundësi të përdorte mjetet ligjore të referuara nga përfaqësuesit e qeverisë ose se ato nuk kishin natyrë gjyqësore. Për më tepër, asnjëra prej këtyre masave nuk ofronte mundësi për një kontroll gjyqësor të ligjshmërisë së vendosjes së kërkuesit në qendrën sociale, në kuadër të legjislacionit vendas dhe të Konventës.**

**178.** Duke mbajtur parasysh gjetjet e saj, Gjykata rrëzon pretendimin e qeverisë se kërkuesi nuk i ka shteruar rrugët e brendshme të ankimit në lidhje me shkeljen e nenit 5 par.4, të Konventës dhe vlerëson se ka pasur një shkelje të këtij neni.

#### **Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 5, të Konventës**

**182.** Gjykata vëren se neni 5, par. 5, është zbatuar nëse është i mundur kërkimi i një kompensimi për heqjen e lirisë së një personi në kundërshtim me par. 1, 2, 3 ose 4 (shih *Wassink k. Holandës*, 27 shtator 1990, par. 38, Seria A, nr. 185-A, dhe *Houtman dhe Meeus k. Belgjikës*, nr. 22945/07, par. 43, 17 mars 2009). **E drejta për kompensim, e parashikuar nga par. 5, nënkupton se është evidentuar shkelja e njërës prej paragrafëve të tjerë të nenit 5 të Konventës nga autoritetet ose institucionet kombëtare.** Në këtë kuadër, gëzimi efektiv i të drejtës së garantuar nga neni 5, par. 5, duhet të garantojë një shkallë të mjaftueshme sigurie (shih *Ciulla k. Italisë*, 22 shkurt 1989, par. 44, Seria A, nr. 148; *Sakik dhe të tjerët k. Turqisë*, 26 nëntor 1997, par. 60, Raportet 1997-VII; dhe *N.C. k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 24952/94, par. 49, GJEDNJ, 2002-X).

**189.** Në këtë rast pyetja që shtrohet është nëse vendimi i Gjykatës, i cili ka konstatuar shkelje të par. 1 dhe 4 të nenit 5, do të legjitimojë të drejtën e kërkuesit për të kërkuar kompensim në bazë të ligjit bullgar. Gjykata vëren se legjislacioni përkatës nuk e parashikon një mjet të tillë dhe se qeveria nuk ka parashtruar ndonjë argument që provon të kundërtën.

**190.** Nuk është provuar se kërkuesi ka pasur mundësi të mbrojë veten përpara se çështja të gjykohej në Gjykatë, ose se do të ketë mundësi ta bëjë këtë, pasi ky vendim të marrë formë të prerë.

**191.** Për rrjedhojë ka pasur një shkelje të nenit 5, par. 5, të Konventës.

Në lidhje me shkeljen e nenit 3 i marrë më vete dhe së bashku me nenin 13 të Konventës

**201.** Neni 3 i Konventës garanton një prej vlerave më thelbësore të shoqërive demokratike. Ai ndalon në terma absolutë torturën ose trajtimin çnjerëzor, poshtërues ose ndëshkimin, pavarësisht rrethanave dhe sjelljes së viktimës (shih ndër të tjera *Kudla k. Polonisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30210/96, par. 90, GJEDNJ, 2000-XI; dhe *Poltoratskiy k. Ukrainës*, nr. 38812/97, par. 130, GJEDNJ, 2003-V).

**202.** Keqtrajtimi duhet të përmbajë një nivel minimal ashpërsie në mënyrë që të përfshihet në kuadrin e mbrojtjes që garanton neni 3 i Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal është relativ, ky vlerësim varet nga të gjithë rrethanat e rastit, siç janë kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore, si edhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kudla*, cituar më lart, par. 91, dhe *Poltoratskiy*, cituar më lart, par. 131).

**203.** Trajtimi është konsideruar nga Gjykata, “çnjerëzor”, nëse *ndër të tjera*, ai ka qenë i paramenduar, është përdorur për orë të tëra dhe ka shkaktuar dëmtime fizike ose vuajtje të shumta fizike ose psikologjike (shih *Labita k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 26772/95, par. 120, GJEDNJ, 2000-IV). Gjykata e konsideron një trajtim “poshtërues” sipas kuptimit të nenit 3, kur ky trajtim e ka bërë viktimën të ndjejë frikë, ankth dhe inferioritet, ndjenja të cilat e kanë poshtëruar dhe përulur atë (shih *Jalloh k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 54810/00, par. 68, GJEDNJ, 2006-IX). Për të kryer një vlerësim të tillë, Gjykata do të marrë parasysh nëse trajtimi ka pasur për qëllim të fyejë dhe poshtërojë personin në fjalë. Edhe në rastet kur veprimi nuk është ndërmarrë në mënyrë të qëllimshme, shkelja e nenit 3 të Konventës nuk mund të përjashtohet (shih *Peers k. Greqisë*, nr. 28524/95, par. 67, 68 dhe 74, GJEDNJ, 2001-III, dhe *Kalashnikov k. Rusisë*, nr. 47095/99, par. 95, GJEDNJ, 2002-VI).

**204.** Vuajtja dhe përulja e pësuar në çdo rast duhet ta tejkalojë shkallën e pashmangshme, të lidhur drejtpërdrejt me një formë të legjitimuar trajtimi ose ndëshkimi. Masat e sigurimit personal, që i heqin personit lirinë, mund të përmbajnë një element të tillë. Neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet se krijon një detyrim të përgjithshëm për të liruar të burgosurit dhe për t’i transferuar ata në një spital civil, edhe në rastet kur ata vuajnë nga sëmundje të vështira për t’u trajtuar. Megjithatë, ky nen i vendos shtetit detyrimin për të siguruar që kushtet e burgimit të jenë në përputhje me dinjitetin njerëzor, si dhe që ekzekutimi i masës së sigurimit të mos e nënshtrojë viktimën ndaj

stresit ose vuajtjes përtej nivelit të pashmangshëm të këtyre ndjesive, të cilat janë të qenësishme për burgosjen dhe, duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgosjes, të sigurojë që shëndeti dhe mirëqenia e tij të sigurohen në mënyrë të përshtatshme nëpërmjet, ndër të tjera, sigurimit të ndihmës mjekësore të nevojshme (shih *Kudla*, cituar më lart, par. 92-94).

**205.** Për të përcaktuar kushtet e kufizimit të lirisë, në kuadër të nenit 3 të Konventës, duhet të merren në konsideratë pasojat kumulative të këtyre kushteve dhe kohëzgjatja e masës së marrë (shih *Kalashnikov*, cituar më lart, par. 95 dhe 102; *Kehayov k. Bullgarisë*, nr. 41035/98, par. 64, 18 janar 2005; and *Iovchev k. Bullgarisë*, nr. 41211/98, par. 127, 2 shkurt 2006).

**212.** Si përfundim, ndërsa merr parasysh përmirësimet e bëra në qendrën sociale të Pastrës që prej fundit të vitit 2009, Gjykata mendon se, në tërësi, kushtet e jetesës me të cilat kërkuesi u përball gjatë një periudhe afërsisht shtatë vjeçare, përbënin një trajtim poshtërues.

**213.** Si rrjedhojë, në këtë rast është shkelur e drejta e garantuar nga neni 3 i Konventës.

**217.** Ndërkohë, duke iu referuar jurisprudencës së saj të konsoliduar, neni 13 i Konventës garanton ekzistencën e një mjetei ankimi efektiv në nivel kombëtar, përmes të cilit mund të zgjidhet një "mjet i arsyeshëm" dhe të gjendet një zgjidhje (shih *McGlinchey dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 50390/99, par. 62, GJEDNJ, 2003V) [...].

**220.** Për sa i përket referimit nga qeveria të procedurës së rikthimit të zotësisë për të vepruar, në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se edhe në rast se do të ishte ndërmarrë procedura e kthimit të zotësisë së plotë të kërkuesit për të vepruar dhe ky i fundit do të kishte pasur mundësi të largohej nga qendra sociale, atij nuk do t'i jepej asnjë dëmshpërblim për keqtrajtimin e pësuar gjatë asaj kohe. Për rrjedhojë, mjetei në fjalë nuk e riparon shkeljen e së drejtës së pësuar.

**221.** Gjykata vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, të marrë së bashku me nenin 3 të saj.

Në lidhje me procesin e rregullt gjyqësor

**229.** Gjykata thekson se neni 6, par. 1, i garanton çdo individ të drejtën për t'iu drejtuar një gjykate për pretendimet e tij në lidhje

me të drejtat dhe detyrimet civile (shih *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, par. 36, Seria A, nr. 18). E drejta "për t'iu drejtuar gjykatës", ku e drejta e qasjes në gjykatë është një aspekt i saj, mund të pretendohet nga çdo person që ka argumente të arsyeshme se dikush ka ndërhyrë në të drejtën e tij në mënyrë të jashtëligjshme dhe ankuesi nuk ka pasur asnjë mundësi objektive për ta kundërshtuar këtë përpara një gjykate, në përputhje me kriteret e nenit 6, par. 1, të Konventës (shih *ndër të tjera, Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 32555/96, par. 117, GJEDNJ, 2005-X, dhe *Salontaji-Drobnjak k. Serbisë*, nr. 36500/05, par. 132, 13 tetor 2009).

**230.** E drejta për të pasur qasje në gjykatës nuk është një e drejtë absolute dhe mund të jetë subjekt kufizimesh të lejuara, sepse e drejta për qasje "nga vetë natyra e saj, kërkon rregullim nga shteti, rregullim i cili ndryshon në kohë dhe vend sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe individëve" (shih *Ashingdane*, cituar më lart, par. 57). Shtetet Kontraktuese gëzojnë një hapësirë vlerësimi në hartimin e një rregullimi të tillë [...].

**231.** Për më tepër, Konventa ka qëllim të garantojë të drejta praktike dhe efektive dhe jo të drejta që janë teorike dhe të paqena. Kjo është veçanërisht e vërtetë për sa u takon garancive që ofron neni 6, në pikëpamje të vendit të rëndësishëm që e drejta për një proces të rregullt zë në një shoqëri demokratike (shih *Prince Hans-Adam II i Liehtenshteinit k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 42527/98, par. 45, GJEDNJ, 2001-VIII).

**239.** Në kuadër të fakteve të çështjes objekt gjykimi, **Gjykata vëren se kërkuesi e kishte të pamundur të bënte vetë kërkesë për rikthimin e zotësisë së plotë për të vepruar, përveç se përmes kujdestarit të tij ose një prej personave të listuar në nenin 277 të Kodit të Procedurës Penale.**

**240.** Gjykata dëshiron të theksojë gjithashtu se për sa i përket të drejtës për të pasur qasje në një gjykatë, legjislacioni vendas nuk bën dallim mes personave që kanë zotësi të pjeshme për të vepruar dhe atyre që nuk kanë zotësi për të vepruar. Për më tepër, legjislacioni vendas nuk parashikon asnjë mundësi për rishikimin periodik të zotësisë për të vepruar të personave që e kanë atë pjesërisht të kufizuar. Së fundmi, në rastin e kërkuesit, masa në fjalë nuk ishte e kufizuar në kohë.

**244.** Gjykata thekson se në kuadër të rëndësisë gjithmonë e më në rritje

**të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e personave të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, këtyre individëve po u jepet gjithmonë e më shumë autonomi ligjore. Në këtë vështrim, Gjykata i referohet Konventës së OKB-së së vitit 2006, për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Rekomandimit nr. R (99) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet në lidhje me mbrojtjen ligjore të të rriturve pa zotësi për të vepruar [...].**

**245.** Në kuadër të konsideratave të mësipërme, veçanërisht në lidhje me përshtatjen e legjislacionit kombëtar me instrumentet ligjore ndërkombëtare, **Gjykata vlerëson se neni 6 par. 1, i Konventës duhet të interpretohet se garanton në parim që çdokush**

**që i është kufizuar zotësia për të vepruar, sikurse kërkuesit në rastin konkret, të ketë qasje të drejtpërdrejtë në gjykatë, për të kërkuar rikthimin e zotësisë së tij për të vepruar.**

**246.** Në çështjen objekt gjykimi, Gjykata vërejt se një qasje e tillë nuk garantohet në mënyrë të mjaftueshme nga legjislacioni bullgar. Kjo gjetje është e mjaftueshme për të konstatuar se kërkuesit i është shkelur e drejta e garantuar nga neni 6, par. 1, i Konventës.

**Shpërblimi i drejtë**

**264.** Gjykata vlerësoi se kërkuesi duhet të përfitojë si dëmshpërblim 15.000 euro në kuadër të dëmit jo material.

**“ Shtukaturov k. Ruisë, 27.03.2008, Nr. 44009/05**  
Nëse heqja e zotësisë së kërkuesit për të vepruar, pa e përfshirë atë në procesin gjyqësor, dhe vendosja e tij në një spital psikiatrik shkelnin të drejtën për liri, për proces të rregullt ligjor dhe për jetë private. ”

**Faktet** – Kërkuesi vuante nga një çrregullim i shëndetit mendor dhe për këtë iu hoq zotësia për të vepruar. Nëna e tij paraqiti një kërkesë në gjykatën e rrethit gjyqësor për nxjerrjen e një urdhri, i cili e privonte atë nga kjo zotësi, me arsyetimin se kishte aftësi të kufizuara për të bërë një jetë të pavarur dhe se e kishte të nevojshëm caktimin e një kujdestari. Kërkuesi nuk ishte njoftuar zyrtarisht për procesin gjyqësor që zhvillohej për të. Në dhjetor të vitit 2004, gjykata e rrethit shqyrtoi kërkesën në një seancë, e cila u ndoq nga prokurori i rrethit dhe një përfaqësues i një spitali psikiatrik, ku kërkuesi kishte qenë pacient atë vit. Gjykata e rrethit e shpalli atë ligjërisht si person me aftësi të kufizuara mendore. Për marrjen e këtij vendimi, gjykata u mbështet në raportin psikiatrik, i cili përcaktonte se individ i vuante nga skizofrenia. Nëna e kërkuesit u caktua kujdestarja e tij ligjore. Pas kësaj, kërkuesi kontaktoi një avokat me të cilin diskutoi rastin e tij dhe përgatiti një ankesë. Avokati deklaroi se kërkuesi ishte plotësisht i aftë për të kuptuar çështjet komplekse ligjore. Ankesa u refuzua pa u shqyrtuar, pasi kërkuesi nuk kishte zotësi për të vepruar dhe se një vendim gjyqësor mund ta ankimonte vetëm nëpërmjet kujdestares së tij ligjore. Në nëntor të vitit 2005, nëna e kërkuesit e shtroi atë në një spital psikiatrik. Kërkuesit ju refuzua mundësia (leja) për të takuar avokatin e tij, por ai arriti të merrte një formular, ku e autorizonte avokatin e tij për të paraqitur një kërkesë pranë GJEDNJ-së në emër të tij. Nga dhjetori 2005 e tutje, kërkuesit i janë refuzuar të gjitha kontaktet me botën e jashtme. Në mars të vitit 2006, GJEDNJ-ja njoftoi qeverinë ruse se sipas rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës, kërkuesit dhe avokatit të tij duhej t'u sigurohej koha e nevojshme dhe t'u krijohej lehtësira për t'u takuar dhe përgatitur çështjen e lënë pezull para Gjykatës. Kërkuesi u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të neneve 6, 8, 5 par. 1, 5; 13 dhe 14 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 6 të Konventës

**66.** Në pjesën më të madhe të vendimeve të mëparshme të Gjykatës, të cilat kanë pasur të bëjnë me persona me “probleme të shëndetit mendor”, vlerësimi i procesit të ndalimit të tyre është shqyrtuar në kuadër të nenit 5 të Konventës. Megjithatë, Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se garantitë procedurale të nenit 5, par. 1 dhe par. 4, janë të ngjashme me ato të nenit 6, par. 1, të Konventës (shih *Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 60, Seria A, nr. 33, *Sanchez-Reisse k. Zvicrës*, 21 tetor 1986, Seria A, nr. 107; *Kampanis k. Greqisë*, 13 korrik 1995, Seria A, nr. 318-B; dhe *Ilijkov k. Bullgarisë*, nr. 33977/96, par. 103, 26 korrik 2001). Kështu, për të vendosur në rastin konkret nëse procesi për heqjen e zotësisë për të vepruar të kërkuarit ka qenë “i drejtë”, Gjykata do t’i referohet *mutatis mutandis*, jurisprudencës së saj në kuadër të nenit 5, par. 1 (e) dhe nenit 5, par. 4, të Konventës.

**67.** Gjykata vëren se për të vendosur nëse një individ ka probleme të shëndetit mendor dhe është i paaftë për të vepruar, autoritetet kombëtare kanë një hapësirë të caktuar vlerësimi në marrjen e vendimit. Është detyrë e gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat e paraqitura përpara tyre. Ndërkohë, detyra e Gjykatës është që të shqyrtojë nëse vendimet e këtyre organeve janë marrë në përputhje me Konventën (shih *Luberti k. Italisë*, 23 shkurt 1984, par. 27, Seria A, nr. 75).

**68.** Në kuadër të nenit 6, par. 1, të Konventës, Gjykata pranon se në rastet që përfshijnë personat me probleme të shëndetit mendor, edhe gjykatat e brendshme gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi. Kështu për shembull, ato mund të vendosin për aspekte procedurale, me qëllim që të sigurojnë administrimin e mirë të drejtësisë dhe të mbrojnë shëndetin e individit në fjalë. Megjithatë, këto masa nuk duhet të cenojnë thelbin e të drejtës së kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, sikurse garantohet nga neni 6 i Konventës. Për të përcaktuar nëse një masë e ndërmarrë ka qenë e nevojshme siç qe, për shembull, përjashtimi i kërkuarit nga seanca gjyqësore për heqjen e zotësisë së tij për të vepruar, Gjykata do të marrë në konsideratë të gjithë faktorët me rëndësi që lidhen me çështjen (siç janë kompleksiteti dhe natyra e çështjes përpara gjykatave kombëtare, çfarë e drejte i rrezikohet kërkuarit, nëse prezenca e tij do të dëmtonte atë vetë, ose të tjerët etj.).

**71.** Në një sërë çështjesh të mëparshme, Gjykata ka konfirmuar se një person me probleme

të shëndetit mendor duhet të lejohet të dëgjohet personalisht, ose kur është e nevojshme, përmes përfaqësimit – shih për shembull, *Winterwerp*, cituar më lart, par. 60. [...] Çështja konkrete ishte shumë e rëndësishme për kërkuarin, sepse atij i vihej në diskutim autonomia e në pjesën më të madhe të veprimtarive jetësore, duke përfshirë këtu edhe kufizimin e lirisë së tij.

**72.** Më tej, Gjykata vëren se kërkuari luante një rol të dyfishtë në procesin gjyqësor: ai ishte palë e interesuar dhe, në të njëjtën kohë, subjekti kryesor i shqyrtimit. Prezenca e tij ishte e domosdoshme jo vetëm për ta lejuar që të përfaqësohej në çështjen e tij, por edhe për t’i lejuar gjyqtarit të krijonte bindjen mbi aftësitë e tij mendore (shih *mutatis mutandis*, *Kovalev k. Rusisë*, nr. 78145/01, par. 35-37, 10 maj 2007).

**73.** [...] Gjykata arrin në përfundimin se **zgjedhja e gjyqtarit vendas për të arritur në një vendim përfundimtar vetëm mbi bazën e vlerësimit të dokumenteve, pa e parë ose dëgjuar kërkuarin, ishte një vendim i pa arsyetuar dhe në shkelje të parimit të kontradiktoritetit, garantuar nga neni 6, par. 1** (shih *Mantovanelli k. Francës*, 18 mars 1997, par. 35, Raportet e vendimeve dhe gjykimeve 1997-II).

**75.** Në përfundim, Gjykata vëren se duhet të shqyrtohen të gjitha procedurat gjyqësore, duke përfshirë edhe vendimin e apelit (shih *C.G. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 43373/98, par. 35, 19 dhjetor 2001). Gjykata vëren se apeli i kërkuarit u rrëzua dhe nuk u shqyrtua fare nga gjykata e apelit.

**76.** Gjykata arrin në përfundimin se në rrethanat e çështjes konkrete, procesi gjyqësor përpara gjykatës së rrethit nuk ka qenë i drejtë. Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të nenit 6, par. 1, të Konventës.

### Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 8 të Konventës

**85.** Gjykata thekson se çdo ndërhyrje në të drejtën e individit për respektimin e jetës së qetë private do të sjellë një shkelje të nenit 8 të Konventës, përveç rasteve kur ndërhyrja është “në përputhje me ligjin”, ndjek një ose disa qëllime të ligjshme në bazë të par. 2 të të njëjtit nen dhe është “e nevojshme në një shoqëri demokratike” në kuptimin, që është proporcionale me qëllimin.

**87.** [...] Në kuadër të nenit 8, autoritetet shtetërore duhet të mbajnë një balancë të drejtë ndërmjet interesit të individit me probleme të shëndetit mendor dhe qëllimeve të tjera të

ligjshme. Megjithatë, në vlerësimin e një çështje kaq komplekse siç është përcaktimi i aftësive mendore të një individi, autoritetet duhet të gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi. Kjo shpjegohet me faktin se autoritetet kombëtare kanë kontakte të drejtpërdrejta me individin në fjalë dhe, si rrjedhojë, kanë mundësi të marrin vendime për çështje të tilla. Detyra e Gjykatës është që të rishikojë, në bazë të Konventës, sesi ata i kanë ushtruar të drejtat e tyre përmes vendimeve (shih *mutatis mutandis* *Bronda k. Italisë*, 9 qershor 1998, par. 59, Raportet 1998-IV).

**88.** Hapësira e vlerësimit që u lihet autoriteteve në këto raste ndryshon rast pas rasti, në bazë të natyrës së çështjes dhe rëndësisë së interesit që vendoset në diskutim (shih *Elsholz v. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 25735/94, par. 49, GJEDNJ 2000-VIII). Një shqyrtim tepër i rreptë zbatohet në rastet kur bëhet fjalë për kufizime serioze të jetës private të një individi.

**89.** Meqenëse, neni 8 i Konventës nuk përmban kërkesa të qarta procedurale, procesi i vendimmarrjes duhet të garantojë që ndërhyrja në jetën private të individit të jetë e drejtë dhe të respektojë të drejtat e mbrojtura nga ky nen (shih *Görgülü k. Gjermanisë*, nr. 74969/01, par. 52, 26 shkurt 2004).

**94.** Gjykata nuk i vë në dyshim kompetencat e mjekëve që ekzaminuan kërkuarin dhe pranon se ai vuante nga një sëmundje serioze. Megjithatë, sipas këndvështrimit të Gjykatës, ekzistenca e një çrregullimi të shëndetit mendor, qoftë ky edhe një çrregullim serioz, nuk mund të jetë arsyeja e vetme për heqjen e zotësisë për të vepruar. Në analogji me çështjet që lidhen me kufizimin e lirisë, në mënyrë që të justifikohet heqja e zotësisë për të vepruar, çrregullimi mendor i një individi duhet të jetë “i një shkalle apo lloji të tillë”, që bën të nevojshme marrjen e një mase të tillë (shih *mutatis mutandis*, *Winterwerp*, cituar më lart, par. 39). Megjithatë, pyetja që iu drejtua mjekëve nga gjyqtari ishte formuluar në mënyrë të tillë, që nuk vinte në dukje “shkallën apo llojin” e sëmundjes së shëndetit mendor të kërkuarit. Si rrjedhojë, raporti i 12 nëntorit 2004 nuk analizoi në mënyrë të detajuar shkallën e mungesës së aftësive të kërkuarit.

**95.** Duket se kuadri ligjor në fuqi nuk i linte gjyqtarit ndonjë zgjidhje tjetër. Kodi Civil rus bën dallimin mes zotësisë së plotë për të vepruar dhe mungesës së zotësisë së plotë për të vepruar, por nuk parashikon asnjë “kufi” për situata të ndryshme, përveç atyre të personave të varur nga droga apo alkooli. Gjykata i referohet Rekomandimit nr. R (99) 4 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës,

cituar më lart në par. 59 të këtij vendimi. Megjithëse parimet e referuara aty nuk kanë një karakter detyrues për Gjykatën, ato mund të përcaktojnë një standard të përbashkët evropian në këtë fushë. Në kundërshtim me këto parashikime, legjislacioni rus nuk parashikon një reagim “të personalizuar” për çdo rast. Si rezultat, në çështjen konkrete, të drejtat e kërkuarit sipas nenit 8 u kufizuan më tepër se sa ishte e nevojshme.

**96.** Në përfundim, duke shqyrtuar procesin e vendimmarrjes dhe arsyetimin e gjykatave vendase, Gjykata vlerëson se ka pasur një ndërhyrje jo proporcionale me qëllimin që e legjitimon atë, në të drejtën e kërkuarit për të gëzuar një jetë të qetë private. Si rrjedhojë, duke i hequr kërkuarit zotësinë e plotë për të vepruar, është shkelur e drejta e garantuar nga neni 8 i Konventës.

### Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 5, par. 1, të Konventës

**112.** Gjykata pranon se ndalimi i kërkuarit ishte i “ligjshëm”, nëse ky term përdoret për përputhshmërinë formale të një ndalimi me parashikimet procedurale dhe materiale sipas legjislacionit vendas. [...]

**113.** Megjithatë, Gjykatë vëren se “ligjshmëria” në kuadër të nenit 5, par. 1 (e), ka edhe një kuptim më të gjerë. “Nocioni i procedurave të parashikuara me ligj [...] si një nga aspektet e procesit të rregullt, është që çdo masë që cenon lirinë e një individi duhet të ndërmerret dhe të ekzekutohet nga autoritetet kompetente dhe të mos jetë arbitrare” (shih *Winterwerp*, cituar më lart, par. 45). Me fjalë të tjera, ndalimi nuk mund të konsiderohet “i ligjshëm” sipas kuptimit të nenit 5, par. 1, nëse procedura e brendshme nuk ofron garanci të mjaftueshme ndaj arbitraritetit.

**114.** Në vendimin *Winterwerp* (cituar më lart), Gjykata ka përcaktuar tre kushte minimale, të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të kemi të bëjmë me një “heqje të ligjshme të lirisë së një personi që vuan nga çrregullime të shëndetit mendor”, sipas kuptimit të nenit 5, par. 1 (e): përveç se në raste emergjente, individi në fjalë duhet të duket qartë se vuan nga aftësi të kufizuara mendore pra, duhet të përcaktohet një çrregullim i vërtetë i shëndetit mendor përpara autoriteteve kompetente, në bazë të ekspertizës së një mjeku të specializuar; çrregullimi i shëndetit mendor duhet të jetë e atij lloji apo shkalle, që bën të nevojshme një izolim të menjëhershëm; dhe vlefshmëria e izolimit të vazhdueshëm duhet të varet nga vazhdimësia e një çrregullimi të tillë.

**115.** Duke u kthyer në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuksi pretendon se heqja e lirisë së tij kishte qenë arbitrare, pasi nuk ishte provuar në mënyrë të besueshme se ai vuante nga çrregullime të shëndetit mendor në kohën kur u izolua [...]. Në mungesë të dokumenteve justifikuese, që duhet të paraqiste qeveria në lidhje me gjendjen e shëndetit mendor të kërkuksit në kohën e izolimit, Gjykata arrin në përfundimin se, nuk "u provua në mënyrë të qartë" që gjendja e shëndetit mendor të kërkuksit kish bërë të nevojshëm izolimin e tij.

**116.** Për sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se shtrimi në spital i kërkuksit në periudhën nga 4 nëntori 2005, deri më 16 maj 2006, nuk ishte i "ligjshëm" sipas kuptimit të nenit 5, par. 1 (e), të Konventës.

#### **Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 5, par. 4, të Konventës**

**121.** Gjykata vëren se në bazë të nenit 5, par. 4, të Konventës, një individ që vuan nga probleme të shëndetit mendor e që mbahet në një institucion psikiatrik për një periudhë të gjatë dhe të papërcaktuar, gëzon në parim të drejtën që të fillojë një proces gjyqësor për rivendosjen e zotësisë së tij për të vepruar, në rast se kontrolli gjyqësor nuk është parashikuar të bëhet automatikisht në intervale të caktuara kohe (shih *Winterwerp*, cituar më lart, par. 55, dhe *Luberti*, cituar më lart, par. 31; shih gjithashtu *Rakevich k. Rusisë*, nr. 58973/00, par. 43 e në vijim, 28 tetor 2003).

**122.** Ky proces bëhet në rastet kur ndalimi fillestar i personit është iniciuar me autorizim të një autoriteti gjyqësor (shih *X k. Mbretërisë së Bashkuar*, 5 nëntor 1981, par. 52, Seria A, nr. 46), dhe aq më tepër, në rrethanat e çështjes konkrete, kur shtrimi në spital i kërkuksit u autorizua nga kujdestarja e tij ligjore dhe jo nga një gjykatë.

**125.** Gjykata vëren se shtrimi në spital i kërkuksit nuk ishte i vullnetshëm. Hera e fundit në të cilën gjykatat vendase shqyrtuan zotësinë e kërkuksit për të vepruar ishte 10 muaj përpara se ai të shtrohej në spital. Procesi gjyqësor në të cilin kërkuksit iu hoq zotësia për të vepruar kishte të meta serioze dhe, gjykata vendase nuk e shqyrtoi në asnjë rast nevojën e kërkuksit për t'u vendosur në atë institucion. Në kuadër të rrethanave të tilla, pamundësia e kërkuksit për të iniciuar procesin e rishikimit gjyqësor të zotësisë së tij për të vepruar, sjell shkelje të nenit 5, par. 4, të Konventës.

#### **Zbatimi i nenit 34 të Konventës**

##### **Përpara ndërmarrjes së një vendimi të ndërmjetëm**

**138.** Gjykata përsërit se është mjaft e rëndësishme për funksionimin efektiv të sistemit të ankesave individuale, garantuar nga neni 34, që kërkuksit aktualë ose potencialë të jenë në gjendje të komunikojnë lirisht me Gjykatën, pa iu nënshtruar asnjë forme presioni nga autoritetet, me qëllim që të tërheqin apo të ndryshojnë ankesat e tyre (shih *Akdivar dhe të Tjerët k. Turqisë*, 16 shtator 1996, opinion i Komisionit, par. 105, Raportet 1996-IV; dhe *Ergi k. Turqisë*, 28 korrik 1998, par. 105, Raportet 1998-IV).

**139.** Gjykata vëren se ndërhyrja në të drejtën e një individi për të bërë një ankesë mund të jetë e formave të ndryshme. Kështu, në çështjen *Boicenco k. Moldavisë* (nr. 41088/05, par. 157 e në vijim, 11 korrik 2006), Gjykata vendosi se refuzimi i kërkesës së kërkuksit për t'u vizituar nga një mjek, me qëllim që të ngrinte pretendimet e tij në bazë të nenit 41 të Konventës, solli një ndërhyrje në të drejtën e individit për të bërë një kërkesë dhe, për rrjedhojë, u vlerësua në kundërshtim me nenin 34 të Konventës.

**140.** [...] Në çështjen konkrete, kufizimet e vendosura e bënë thuajse të pamundur që kërkuksi të ndiqte çështjen e tij përpara Gjykatës dhe formulari i ankimit u plotësua nga kërkuksi vetëm pasi ai doli nga spitali. Autoritetet vendase nuk mund të mos ishin në dijeni se kërkuksi kishte nisur një proces përpara GJEDNJ-së, duke u ankuar, ndër të tjera, për mbajtjen e tij në spital. Në rrethanat të tilla, pengimi i kërkuksit për të pasur marrëdhënie me botën e jashtme për një kohë të gjatë cenoi të drejtën e tij, në bazë të nenit 34 të Konventës.

##### **Pas marrjes së vendimit të ndërmjetëm**

**141.** Gjykata vëren se në mars të vitit 2006, ajo i ka dërguar qeverisë ruse një vendim të ndërmjetëm në kuadër të nenit 39. Gjykata i kërkonte qeverisë të lejonte kërkuksin të takohet me avokatin e tij në ambientet e spitalit nën mbikëqyrjen e personelit të spitalit. Mendohej se vendimi do t'i siguronte kërkuksit mundësi për të ndjekur çështjen e tij përpara Gjykatës.

**142.** Gjykata vëren refuzimin e autoriteteve për të zbatuar këtë vendim të ndërmjetëm. Gjykatat vendase e shqyrtuan

situatën në lidhje me vendimin e ndërmjetëm dhe pretenduan se ai i ishte adresuar shtetit rus si i tërë dhe jo një entiteti të veçantë. Gjykatat vendase arritën në përfundimin se ligji rus nuk e njihte fuqinë urdhëruese të një vendimi të ndërmjetëm, të dhënë nga GJEDNJ-ja. Për më tepër, ato nënvizuan se kërkuksi nuk mund të kryente asnjë veprim pa miratimin e nënës së tij. Për rrjedhojë, avokati, zoti Bartenev, nuk mund të konsiderohej si përfaqësuesi i tij ligjor në kuptimin e legjislacionit vendas dhe as në procesin përpara GJEDNJ-së.

**143.** Ky interpretim i Konventës bie në kundërshtim me vetë Konventën. Për sa i përket statusit të avokatit të kërkuksit, nuk ishte detyrë e gjykatave vendase të caktonin nëse ai ishte apo jo përfaqësues i kërkuksit në procesin e mbetur pezull përpara GJEDNJ-së, sepse mjaftonte që Gjykata ta trajtonte atë si përfaqësuesin e tij.

**144.** Për sa i përket fuqisë juridike të një vendimi të ndërmjetëm, Gjykata dëshiron t'i referohet çështjes *Aoulmi k. Francës*, nr. 50278/99, par. 107, GJEDNJ, 2006l):

"107. .... Në kuadër të Konventës, vendimet e ndërmjetme, sikurse janë zbatuar shpesh në praktikë, luajnë një rol tepër të rëndësishëm në parandalimin e situatave të pakthyeshme, të cilat do të pengonin Gjykatën të shqyrtonte në mënyrën e duhur ankesat e një kërkuksi dhe, kur është e përshtatshme, t'i garantojë kërkuksit përfitimet praktike dhe efektive të garantuara nga të drejtat e parashikuara në Konventë. Për rrjedhojë, moszbatimi nga ana e shtetit i një vendimi të ndërmjetëm do të cenonte efektivitetin e një ankese individuale, garantuar nga neni 34 i Konventës dhe detyrimet e përgjithshme të shtetit, në kuadër të nenit 1 të Konventës [...].

Në përfundim, një vendim i ndërmjetëm është i detyrueshëm dhe moszbatimi i tij bëhet shkak për shkelje të nenit 34 të Konventës. Për Gjykatën nuk përbën dallim nëse ishte shteti në tërësi, ose cilindo nga organet e tij, ai që refuzoi të zbatonte një vendim të ndërmjetëm.

**146.** Duke mos e lejuar kërkuksin të komunikonte me avokatin e tij, autoritetet e kanë penguar atë *de facto* të ankohej përpara Gjykatës, pengesë që ekzistoi për aq kohë sa autoritetet e mbajtën kërkuksin në spital. Kështu, qëllimi i vendimit të ndërmjetëm, dhënë nga Gjykata, ishte të parandalonte një situatë që mund të pengonte vetë Gjykatën të "shqyrtonte në mënyrën e duhur ankimin, për t'i garantuar kërkuksit përfitimet praktike dhe efektive të Konventës" (shih *Aoulmi*, në pjesën e sapo cituar).

**148.** Gjykata vëren se sistemit ligjor rus i mungojnë mekanizmat ligjorë për të zbatuar vendimet e ndërmjetme, dhënë nga Gjykata në kuadër të Rregullit 39. Megjithatë, kjo nuk minimizon përgjegjësinë e shtetit për të përmbushur detyrimet e tij në kuadër të nenit 34 të Konventës. Në përfundim, moszbatimi nga ana e autoriteteve e një vendimi të ndërmjetëm, marrë në bazë të rregullit 39 u bë shkak për një shkelje të nenit 34 të Konventës.

**149.** Duke iu referuar materialeve përpara saj, Gjykata arrin në përfundimin se pengimi i kërkuksit të takohet dhe komunikonte me avokatin e tij për një kohë të gjatë, si edhe moszbatimi i vendimit të ndërmjetëm, dhënë në kuadër të Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës, kanë bërë që Federata Ruse të shkelë detyrimet e saj në kuadër të nenit 34 të Konventës.

## IV. PROCESI I RREGULLT

“

D.D. k. Lituanisë, 14.2.2012, Nr. 13469/06

Nëse proceset gjyqësore për emërimin e kujdestarit dhe vendosjen e kërkujes në një qendër sociale shkelnin procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 6, dhe të drejtën e kërkujes për liri, sipas nenit 5.

”

**Faktet** - Kërkujes, e cila ishte diagnostikuar me skizofreni në vitin 2000, i ishte hequr zotësia për të vepruar me kërkesë të babait të saj birësues, i cili më vonë u emërua kujdestari i saj ligjor. Kujdestari kërkoi që kërkujesja të pranohet në një shtëpi për personat me aftësi të kufizuara për të mësuar. Në korrik të vitit 2004, kërkujesja u pranua në këtë qendër përkujdesjeje kundër vullnetit të saj, pas një vendimi të një komisioni të caktuar nga shërbimet sociale. Komisioni kishte arritur në përfundimin se kërkujesja nuk ishte në gjendje të kujdesej për nevojat e saj themelore; se nuk e kuptonte vlerën e parave dhe se kishte pasur raste krizash zemërimi. Në vitin 2005, me ndihmën e ish-psikiatrit të saj dhe më pas, të shokut të saj, D.G., kërkujesja kërkoi rihapjen e procesit gjyqësor për kujdestarinë dhe emërimin e D.G.-së si kujdestar të saj. Ajo pohoi se kurrë nuk ishte informuar apo thirrur në seancën gjyqësore, ku ishte caktuar si kujdestar i saj babai birësues dhe se marrëdhënia e saj me babanë birësues ishte shumë e nderë. Gjithashtu, ajo pretendoi se ishte dërguar në shtëpinë për personat me aftësi të kufizuara me iniciativën e tij dhe po ashtu, se zotësia për të vepruar i ishte hequr pa dijeninë e saj. Më 7 nëntor 2005, gjykata e brendshme mbajti një seancë me dyer të mbyllura dhe e rrëzoi kërkesën e kërkujeses për t'u asistuar nga një avokat, me arsyetimin se ai që do të përfaqësonte atë edhe interesat e saj do të ishte avokati i kujdestarit të saj. Kërkujesja pretendon se ajo u dërgua në zyrën e gjyqtarit gjatë kohës së pushimit të seancës dhe u paralajmërua që të mos thoshte asgjë negative për babanë e saj birësues. Pas pushimit dhe gjatë seancës, ajo ra dakord që babai i saj birësues të mbetej kujdestari i saj, por kërkoi që të largohej nga qendra e përkujdesjes. Më pas, gjykata refuzoi të rihapë gjykimin për kujdestarinë e saj. Kërkujesja u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 6, par. 1, dhe neni 5, par. 4, i Konventës.

### Vlerësimi i gjykatës

#### Në lidhje me shkeljen e nenit 6, par. 1

**116.** Në pjesën më të madhe të vendimeve të mëparshme të Gjykatës, të cilat kanë përfshirë persona me “probleme të shëndetit mendor”, vlerësimi i procesit të ndalimit të tyre është shqyrtuar në kuadër të nenit 5 të Konventës. Megjithatë, Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se garantitë procedurale të nenit 5, par. 1 dhe par. 4, janë të ngjashme me ato të nenit 6, par. 1, të Konventës (shih *Stanev k. Bullgarisë* [DHOMA E MADHE], nr. 36760/06, par. 232, 17 janar 2012 dhe jurisprudencën e cituar aty). Pra, për të shqyrtuar nëse në çështjen konkrete objekt gjykimi, procedurat për rivendosjen e kujdestarisë ishin të “rregullta”, Gjykata do t'i referohet *mutatis mutandis*,

jurisprudencës së saj në kuadër të nenit 5, par. 1 (e) dhe nenit 5 par 4, të Konventës.

**117.** Në kuadër të nenit 6, par. 1, të Konventës, Gjykata pranon se në rastet që përfshijnë personat me probleme të shëndetit mendor, gjykatat kombëtare gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi për të bërë rregullimet përkatëse procedurale, me qëllim që të sigurojnë administrimin e mirë të drejtësisë, të mbrojnë shëndetin e individit në fjalë dhe shëndetin e të tjerëve (shih *Shtukurov k. Rusisë*, nr. 44009/05, par. 68, 27 mars 2008).

**118.** Gjykata pranon se mund të ekzistojnë situata ku një person, të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, e ka tërësisht të pamundur të shprehë një mendim koherent ose t'i japë udhëzimet e duhura avokatit të tij. Megjithatë,

Gjykata vlerëson se në shumë çështje, fakti që një individ duhet të vendoset nën kujdestari, për shkak se ka aftësi të kufizuara në administrimin e veprimeve të veta, nuk nënkupton se ai është i paaftë për të shprehur një mendim për situatën në të cilën ndodhet dhe të kundërshtojë kujdestarin e tij ligjor. Në raste të tilla, kur potenciali i konfliktit ka një ndikim të rëndësishëm në situatën e tij juridike, si në rastin kur kërkon ndryshim të kujdestarit, është tepër e rëndësishme që individit në fjalë të ketë qasje në gjykatë dhe mundësi për t'u dëgjuar prej saj drejtpërsëdrejti, ose përmes një forme përfaqësimi. Çrregullimet e shëndetit mendor mund të ndryshojnë ose të kufizojnë mënyrën e ushtrimit të një të drejte të tillë, përveç rasteve shumë të veçanta, si ato që u përmendën më sipër. Mund të sigurohen garanci të veçanta procedura lehtë për të mbrojtur interesin e individit që, për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor, nuk është plotësisht i aftë për të ushtruar zotësinë për të vepruar (shih *mutatis mutandis Winterwerp k. Mbretërisë së Bashkuar*, par. 60).

**119.** Gjykata nënvizon se parimi kryesor që udhëheq nenin 6 është drejtësia. Pyetja nëse procedurat e zhvilluara kanë qenë të rregullta, mund të shtrohet edhe në rastet kur kërkuesi ose kërkujesja kanë marrë pjesë në gjykim, pavarësisht mungesës së ndihmës juridike nga një avokat dhe ia dalin të përfaqësohen, pavarësisht të gjitha vështirësive (shih *mutatis mutandis, McVicar k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46311/99, par. 50-51, GJEDNJ, 2002-III). Gjykata thekson se me rëndësi është edhe të shihet se drejtësia po administrohet në mënyrë të drejtë dhe se një palë në një proces gjyqësor civil, duhet të ketë mundësi efektive për të marrë pjesë në këtë proces, ndër të tjera, të ketë mundësi të mbështesë argumentet e saj. Ashtu si me aspekte të tjera të nenit 6, rëndësia e asaj që ka vlerë për kërkujesen, ka lidhje me vlerësimin e përshtatshmërisë dhe rregullsisë së procedurave (shih *P. dhe S. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 56547/00, par. 91, GJEDNJ, 2002-VI).

[...]

**122.** Gjykata do të ndalet në procesin e ndryshimit të kujdestarisë së kërkujeses në vitin 2005. Gjykata vëren se nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se në atë kohë, kërkujesja vuante nga ndonjë aftësi e kufizuar e një shkalle të tillë që të pengonte pjesëmarrjen e saj në këtë proces. [...]

**124.** Siç rezulton nga materialet e dosjes objekt gjykimi, marrëdhënia mes kërkujeses dhe babait të saj birësues nuk ka qenë gjithmonë e mirë. [...] Rrjedhimisht, Gjykata e

vlerëson të vlefshëm argumentin e kërkujeses se mes saj dhe kujdestarit të saj ligjor ekzistonte një konflikt interesi dhe se avokati i përfaqësuesit të saj, nuk mund ta përfaqësonte kërkujesen në mënyrën e duhur. Sipas vlerësimit të Gjykatës, në kuadër të një procesi gjyqësor të drejtë, do të duhej që kërkujeses t'i ishte caktuar një avokat, qoftë edhe kryesisht.

[...]

**126.** Në përfundim, Gjykata thekson se kërkujesja duhet të kishte marrë pjesë në gjithë procesin (shih *C.G. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 43373/98, par. 35, 19 dhjetor 2001). Veçanërisht, duke shqyrtuar seancën gjyqësore të 7 nëntorit 2005, Gjykata vëren se gjyqtari vendos refuzoi kërkesën për regjistrimin në audio të seancës. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të rishqyrtojë ankesat që kërkujesja ka bërë gjatë kësaj seance, pavarësisht se qeveria kundërshton faktin që kërkujeses i është mohuar të qëndronte gjatë procesit afër shtetasit D.G., individit të vetëm, të cilit ajo i besonte. Gjykata nuk mund të nënvlerësojë as ankesën e kërkujeses se e kanë detyruar të largohet nga salla e gjyqit për të shkuar në zyrën e gjyqtarit dhe më pas për të deklaruar në seancë se ajo nuk kishte asnjë kundërshtim ndaj kujdestarit ligjor. Në këtë kuadër, Gjykata vlerëson se situata e përgjithshme gjatë seancës ka krijuar tek kërkujesja ndjenjën e izolimit dhe të inferioritetit, duke krijuar një shqetësim emocional për të, i cili nuk do të kishte ekzistuar nëse kërkujesja do të ishte përfaqësuar vetë gjatë gjykimin.

**127.** Në kuadër të gjetjeve të mësipërme dhe duke marrë në konsideratë ngjarjet që kanë ndodhur para rishqyrtimit të kujdestarisë së kërkujeses, Gjykata arrin në përfundimin se procesi gjyqësor i datës 7 nëntor 2005, përpara Gjykatës së Rrethit [...], nuk ka qenë i rregullt. Për rrjedhojë, Gjykata rrëzon pretendimin e qeverisë se kërkujesja ka ngritur pretendime abuzive dhe vlerëson se ka pasur shkelje të nenit 6, par. 1, të Konventës.

#### 2) Në lidhje me shkeljen e nenit 5, par. 4, të Konventës

**163.** Parimet që udhëheqin jurisprudencën e Gjykatës në lidhje me respektimin e nenit 5, par. 4, për individët me “probleme të shëndetit mendor” janë:

a. një individ me probleme të shëndetit mendor, i cili është shtruar në një institucion psikiatrik për një kohë të gjatë, ose të papërcaktuar, në parim ka të drejtë në çdo rast kur nuk ka një afat periodik automatik për rishikimin e zotësisë së tij për të

vepruar, të ndërmarrë një proces për shqyrtimin e "ligjshmërisë" së heqjes së zotësisë së tij për të vepruar dhe të ndalimit të tij për "afate të arsyeshme kohore" – sipas kuptimit të Konventës;

b. neni 5, par. 4, *kërkon që procedura e ndjekur të ketë karakter juridik dhe t'i sigurojë individit në fjalë garanci të përshtatshme me llojin e kufizimit të lirisë. Në mënyrë që të përcaktohet nëse procedura e ndjekur i siguron këto garanci, duhen marrë parasysh rrethanat e veçanta të çdo rasti;*

c. procedurat gjyqësore sipas nenit 5, par. 4, nuk duhet që në çdo rast të shoqërohen nga të njëjtat garanci, si ato të kërkuara nga neni 6, par. 1, *për proceset civile ose penale. Megjithatë, është thelbësore që personi në fjalë të ketë të drejtën e qasjes në gjykatë dhe të dëgjohet nga gjykata personalisht ose përmes përfaqësuesit. Duhet të sigurohen garanci të veçanta procedurale, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara mendore, të cilët nuk mund të vetë-përfaqësohen (shih Megyeri k. Gjermanisë, 12 maj 1992, par. 22, Seria A, nr. 237-A; dhe Stanev, cituar më lart, par. 171).*

**164.** Këto parime zbatohen në rastet kur ndalimi i parë është autorizuar nga autoritetet gjyqësore (shih *Xk. Mbretërisë së Bashkuar*, 5 nëntor 1981, par. 52, Seria A, nr. 46) dhe është i zbatueshëm veçanërisht edhe në rastin konkret, ku shtrimi i kërkueses në qendrën Kedainai është bërë me kërkesë të një individi privat, konkretisht kujdestarit të saj, dhe është miratuar nga autoritetet vendore dhe sociale, pa asnjë miratim nga ndonjë gjykatë vendase.

**166.** Në rastin konkret, qeveria pretendon se kërkuesja mund të kishte nisur procedurën ligjore në fjalë përmes kujdestarit të

saj. Megjithatë, ky mjet nuk ishte i mundshëm për të, sepse kërkuesja varej plotësisht nga vullneti i kujdestarit të saj, i cili në atë kohë ishte babai i saj birësues, dhe që, për më tepër, që në krye të herës, kishte kërkuar shtrimin e saj në qendrën Kedainai. Gjykata vëren gjithashtu se kujdestari real i kërkueses është pikërisht kjo qendër sociale, ku kërkuesja është e shtruar dhe ndaj të cilës ajo është ankuar në shumë raste, duke përfshirë këtu edhe procesin gjyqësor përpara gjykatave të brendshme. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se kur një individi, të aftë për të shprehur një pikëpamje të vetën, pavarësisht se i është kufizuar zotësia për të vepruar, i është cenuar liria si pasojë e kërkesës së kujdestarit ligjor, i duhet dhënë mundësia për ta kundërshtuar këtë vendim përpara një gjykate, duke u përfaqësuar nga një person i tretë. Së fundmi, sikundër në rastin e një hetimi të kryer nga autoritetet e ndjekjes penale, Gjykata ndan të njëjtin mendim me kërkuesen se, një hetim nga ana e prokurorisë nuk mund të konsiderohet si shqyrtim gjyqësor në përputhje me kërkesat e nenit 5, par. 4, të Konventës (shih *Shtukaturov*, cituar më lart, par. 124).

**167.** Në kuadër të gjetjeve të mësipërme, Gjykatë rrëzon pretendimin e qeverisë se kërkuesja ka ngritur një ankim abuziv dhe vlerëson se në këtë rast ka pasur edhe një shkelje të nenit 5, par. 4 të Konventës.

Gjykata i shpalli pretendimet e tjera të kërkueses haptazi të pabazuara në kuadër të nenit 35, par. 4, të Konventës.

### 3) Shpërblimi i drejtë

**212.** Gjykata vlerësoi se kërkuesja duhet të përfitojë dëmshpërblim prej 8.000 euro në kuadër të dëmit jo material.



Salontaji-Drobnjak k. Serbisë, 30.01.2010, nr. 36500/05

*Nëse kërkuesit i ishte shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor gjatë procesit të vlerësimit të zotësisë së tij për të vepruar, dhe nëse atij ishte mohuar e drejta e qasjes në gjykatë, për sa i përket kërkesës për rikthimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas nenit 6 të Konventës.*



**Faktet** - Kërkuesi, që nga viti 1973, ka nisur rreth 200 procese gjyqësore në gjykatën e rrethit, kundër punëdhënësit dhe organeve të tij drejtuese, ndaj disa palëve private dhe zyrtarëve shtetërorë, duke pretenduar parregullsi, shqetësime dhe shpërdorim detyre. Ai ka bërë edhe disa kallëzime penale, bazuar në të njëjtat shkaqe. Disa procese gjyqësore përfunduan në favor të kërkuesit.

Në vitin 1996, kërkuesi e kërcënoi drejtorin e përgjithshëm të punëdhënësit me një thikë gjahu dhe një granatë dore të rreme, të cilat më pas i dorëzoi vullnetarisht, por duke i shkaktuar drejtorit një prerje në dorën e djathtë. Gjatë procesit penal kundër tij, kërkuesi u vlerësua nga dy ekiye mjekësore. Gjykata e rrethit vendosi se kërkuesi nuk mbante përgjegjësi penale, pasi ai nuk mund të kontrollonte veprimet e tij dhe as të kuptonte pasojat e këtyre veprimeve. Ajo urdhëroi trajtimin e detyrueshëm psikiatrik të kërkuesit, por pa e shtruar në spital.

Disa vite më vonë, në vitin 2002, gjykata e rrethit i rekomandoi Qendrës së Kujdesit Social (QKS) që të kërkonte formalisht nisjen e procesit për vlerësimin e zotësisë së kërkuesit për të vepruar. Pasi QKS-ja e nisi këtë proces, gjykata urdhëroi që kërkuesi t'i nënshtrohej një ekzaminimi psikiatrik nga Këshilli Psikiatrik Ligjor i Fakultetit të Mjekësisë së Novi Sadit (Këshilli). Ndër të tjera, gjykata arsyetoi se "duke pasur parasysh që kërkuesi është përfshirë në kaq shumë procese gjyqësore dhe se numri i këtyre rasteve vazhdon të rritet, është në interesin e gjykatës që të shqyrtohet aftësia e tij vendim-marrëse[...] siç është shprehur edhe Gjykata e Rrethit të Novi Sadit dhe Gjykata e Lartë e Serbisë.

Kërkuesi e kundërshtoi ekzaminimin nga Këshilli Psikiatrik- Ligjor, me kusht që të plotësoheshin disa kërkesa, si: informimi paraprak i tij për identitetin e ekspertëve që do të kryenin ekzaminimin; mundësia për të refuzuar ose pranuar ekspertët e përzgjedhur; kryerja e ekzaminimit në një sallë gjyqi në praninë e gjyqtarit dhe të publikut; dhe regjistrimi audio- video i ekzaminimit. Këto kërkesa u refuzuan nga Këshilli. Ndërkohë QKS-ja caktoi një kujdestar të përkohshëm ligjor për kërkuesin, që ta përfaqësojë atë në procesin gjyqësor.

Pas disa seancave dëgjimore, gjykata e rrethit urdhëroi ekzaminimin e detyrueshëm të kërkuesit dhe e vendosi në një institucion psikiatrik për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj. Në dhjetor të vitit 2004, instituti psikiatrik i Novisadit arriti në përfundimin se kërkuesi vuante nga paranoja e paraqitjes së kërkesë-padive (paranoja querulans) dhe rekomandoi kufizimin e zotësisë së tij për të vepruar. Ekspertët kujtuan ndër të tjera numrin e madh të proceseve gjyqësore të nisura nga kërkuesi, borxhet e tij si pasojë e shpenzimeve gjyqësore, etj. QKS-ja emëroi një tjetër kujdestar ligjor për ta përfaqësuar kërkuesin në proces.

Gjykata e rrethit vendosi kufizimin e pjesshëm të zotësisë së tij për të vepruar, duke u mbështetur në argumentet e Institutit Psikiatrik të Novi Sadit. Kërkuesi u ankua ndaj këtij vendimi, por pa sukses. Në qershor të vitit 2005, kërkuesi paraqiti një kërkesë para gjykatës së rrethit për rikthimin e zotësisë së tij për të vepruar. Por, juristi i gjykatës refuzoi ta pranonte kërkesën, duke iu referuar një urdhri të brendshëm të lëshuar nga nënkryetari i gjykatës në maj të vitit 2005, sipas të cilit nuk do të pranohet asnjë kërkesë-padi apo parashtrim i kërkuesit derisa atij t'i caktohej një kujdestar ligjor. Në qershor 2005, QKS-ja caktoi djalin e kërkuesit si kujdestarin e tij ligjor, i cili kërkoi para gjykatës rikthimin e zotësisë së plotë të kërkuesit për të vepruar, por QKS-ja parashtrroi se do ta kundërshtonte këtë kërkesë. Gjykatat e brendshme e rrëzuan kërkesën e djalit të kërkuesit.

Para GJEDNJ-së, kërkuesi parashtrroi se atij i ishin shkelur të drejtat për një proces të rregullt gjyqësor gjatë procesit të vlerësimit të zotësisë së tij për të vepruar, dhe se atij ishte mohuar e drejta e qasjes në Gjykatë, për sa i përket kërkesës për rikthimin e zotësisë së plotë për të vepruar, sipas nenit 6 të Konventës.<sup>103</sup>

<sup>103</sup> Kërkuesi parashtrroi dhe pretendime në bazë të nenit 8 dhe 13 të Konventës, por në këtë çështje, vlerësimet e gjykatës sipas nenit 6 janë më të rëndësishmet.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Lidhur me shkëlqet e nenit 6, par. 1, të Konventës

**98.** Shumica e rasteve që i janë paraqitur Gjykatës për “personat me probleme të shëndetit mendor” kanë pasur të bënin me kufizimin e lirisë së tyre dhe rrjedhimisht janë shqyrtuar sipas nenit 5 të Konventës. Megjithatë, **Gjykata është shprehur në mënyrë të vazhdueshme se garancitë procedurale sipas nenit 5, par. 1 dhe 4, janë shumë të ngjashme me ato të nenit 6 par. 1**, të Konventës (Shih *Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 60, Seritë A, nr. 33; *Sanchez-Reisse k. Zvicrës*, 21 tetor 1986, Seritë A, nr. 107; *Kampanis k. Greqisë*, 13 korrik 1995, Seritë A, nr. 318-B; *Ilijkov k. Bullgarisë*, nr. 33977/96, par. 103, 26 korrik 2001). Prandaj, për të vendosur nëse proceset në shqyrtim ishin të rregullta, Gjykata do të mbajë parasysh, *mutatis mutandis*, jurisprudencën e saj sipas neneve 5, par. 1 (e) dhe 5 par. 4, të Konventës, si edhe nenin 6, par. 1, të saj.

**99.** Gjykata rikujton se, për të vendosur nëse një individ duhet t'i hiqej liria për shkak të problemeve të shëndetit mendor, autoritetet shtetërore u njihet një hapësirë e caktuar vlerësimi [...] (shih *Luberti k. Italisë*, 23 shkurt 1984, par. 27).

**100.** Në kontekstin e nenit 6, par. 1, të Konventës, Gjykata vlerëson se në rastet që përfshijnë një person me probleme të shëndetit mendor, gjykatat e brendshme gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi. Kështu për shembull, ato mund të bëjnë rregullimet e duhura procedurale, për të garantuar administrimin e mirë të drejtësisë, mbrojtjen e shëndetit të personit, etj. Megjithatë, këto masa nuk duhet të prekin thelbin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt gjyqësor, sipas nenit 6 (Shih *ndër të tjera, Shtukurov k. Rusisë*, nr. 44009/05, par. 68, 27 mars 2008).

**101.** Në rastin në shqyrtim, Gjykata fillimisht vëren se kërkuesi u përjashtua nga seanca përfundimtare gjyqësore dhe prandaj e pati pasur të pamundur që të kundërshtonte personalisht raportin e ekspertëve, të cilët rekomandonin kufizimin e zotësisë së tij për të vepruar. Së dyti, vendimi i gjykatës së rrethit deklaronte se pjesëmarrja e kërkuesit personalisht në seancë ishte e pakuptimtë, duke mos dhënë asnjë arsytim shtesë [...] Së treti, pjesëmarrja e kërkuesit nuk mund të përjashtojë, bazuar në një parashikim arbitrar e hipotetik se ishte “e kotë” [...]. Së fundmi, bazuar në dosjen gjyqësore, edhe pse kërkuesit i ishte caktuar një avokat, kryesisht, për ta

përfaqësuar në seancën dëgjimore në fjalë, ai nuk kishte pasur mundësi që të takojë me të, apo t'i jepte udhëzime për çështjen [...].

**102.** Për sa më sipër [...], Gjykata arrin në përfundimin se, në procesin në fjalë, të marrë në tërësinë e tij (shih *Barberà, Messegué dhe Jabardo k. Spanjës*, 6 dhjetor 1988, par. 68), nuk janë përmbushur kërkesat e procesit të rregullt gjyqësor. Për rrjedhojë, ajo gjen shkelje të nenit 6, par. 1, të Konventës.

**Lidhur me pretendimin e kërkuesit se atij i ishte mohuar qasja në gjykatë për kërkesën për rikthimin e zotësisë së plotë për të vepruar.**

**103.** Në vendimin *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, të datës 21 shkurt 1975, Gjykata vlerësoi se neni 6, par. 1, “i garanton çdo njeriu të drejtën për të paraqitur pretendime që lidhen me të drejtat e dhe detyrimet e tij civile para një gjykatë” (par. 36). **E drejta për të përdorur gjykatën, një aspekt i së cilës është e drejta e qasjes në të, është një e drejtë ku çdokush mund të bazohet nëse, për shkaqe të arsyeshme, mendon se ka një ndërhyrje të paligjshme në ushtrimin e të drejtave civile të tij/saj dhe ankohet se nuk i ishte dhënë mundësia për të paraqitur një pretendim përpara gjykatës në përputhje me kriteret e nenit 6, par. 1** (Shih *ndër të tjera, Roche k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 32555/96, par. 117, GJEDNJ, 2005X).

**104.** Sigurisht që e drejta e qasjes në gjykatë nuk është absolute dhe mund të kufizohet (shih *Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 maj 1985, par. 57). Në përcaktimin e këtyre rregullave, Shtetet gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi (Shih *mutatis mutandis, Klass dhe të tjerët k. Gjermanisë*, 6 shtator 1978, par. 49). Megjithatë, kufizimet nuk duhet të reduktojnë qasjen në një mënyrë të tillë dhe në atë masë sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Më tej, një kufizim nuk është në përputhje me Nenin 6, par. 1, nëse nuk ndjek një qëllim të ligjshëm dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të zgjedhura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (Shih *Ashingdane*, par. 57).

**105.** Për sa i përket rastit në shqyrtim [...] Gjykata është e mendimit se kufizimi ka qenë jo proporcional. Së pari, edhe pse kërkuesi dhe kujdestari i tij kanë paraqitur një numër kërkesëpadish, ende katër vjet më vonë asnjë gjykatë nuk e ka marrë në shqyrtim themelin e kërkesës së tij për rikthim të zotësisë së plotë për të vepruar të kërkuesit. Së dyti, [...] nuk ka pasur një

ekzaminim psikiatrik tërësor të kërkuesit të kryer në kontekstin e këtij procesi. Së fundmi, legjislativi i brendshëm nuk parashikon një rivlerësim gjyqësor periodik të gjendjes së kërkuesit dhe roli kyç është lenë pothuaj tërësisht në hapësirën e vendimit të QKS-së (shih *mutatis mutandis, X k. Mbretërisë së Bashkuar*, 5 nëntor 1981, par. 53 dhe 54).

**106.** Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i bërë të mundur

Gjykatës që të arrijë në përfundimin se thelbi i të drejtës së kërkuesit për të pasur qasje në gjykatë është cenuar. Prandaj ka pasur një shkelje të nenit 6, par. 1, të Konventës.

### Shpërblimi

Në përfundim të gjykimit, GJEDNJ i akordoi kërkuesit 12.000 euro dëmshpërblim dhe 3000 euro për shpenzime gjyqësore.

“

**Dauti k. Shqipërisë, nr. 19206/05, 3 shkurt 2009**

*Nëse vendimi gjyqësor i gjykatave të brendshme se vendimi i Komisionit të Ankimeve ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor shkelte qasjen në gjykatë sipas nenit 6 të Konventës.*

”

**Faktet** - Në prill të vitit 1992, kërkuesi pësoi një aksident të rëndë në punë, duke mbetur kështu i paaftë për të vazhduar punën. Në shtator 2001, Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (K.M.C.A.P. Dibër), pas kërkesës së zotit Dauti, njohu paaftësinë e kërkuesit për punë me efekt nga dita e ndodhjes së aksidentit në prill 1992. K.M.C.A.P. Dibër vendosi se kompensimi duhet të jepej për periudhën mars 2001-mars 2002. Pas apelit të kërkuesit, në janar 2003, Komisionin Mjekësor i Ankimeve për Caktimin e Paftësisë për Punë (K.M.C.A.P. Epror - Komisioni i Ankimeve) anuloi vendimin e K.M.C.A.P. Dibër dhe e deklaroi kërkuesin të aftë për punë. Në maj 2003, në bazë të deklarimeve të dëshmitarëve dhe raporteve mjekësore, Gjykata e Rrethit Dibër konstatoi se kërkuesi kishte pësuar aksidentin në prill 1992 gjatë orarit të punës. Vendimi mori formë të prerë dhe u bë i detyrueshëm në korrik 2003.

Në qershor 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë nuk e pranoi padinë e kërkuesit për deklarimin të pavlefshëm të vendimit të Komisionit të Ankimeve, me argumentimin se këto vendime janë të formës së prerë dhe nuk i nënshtrohen rishqyrtimit gjyqësor. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht në tetor 2003 dhe mars 2004. I njëjti qëndrim u mbajt edhe nga Gjykata Kushtetuese në dhjetor 2004.

Në korrik 2005, K.M.C.A.P. Dibër e konstatoi kërkuesin të paaftë për punë me efekt nga marsi 2001 dhe i dha atij kompensimet e aftësisë së kufizuar për periudhën një vjeçare qershor 2005-qershor 2006. Më pas Komisioni i Ankimeve, njohu paaftësinë për punë të kërkuesit dhe e zgjati periudhën e dëmshpërblimit deri në janar 2008.

Çështja themelore që iu shtrua Gjykatës dhe që lidhej me pretendimin për shkelje të qasjes në gjykatë, lidhej me vlerësimin nëse Komisioni i Ankimeve përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” sipas kuptimit të nenit 6, par. 1, të Konventës

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkëlqet e nenit 6, par. 1, të Konventës

**45.** Meqenëse mendohet se në këtë rast, zbatohet neni 6, par. 1, i Konventës, kërkuesi kishte të drejtë që çështja e tij të shqyrtohej nga një

“gjykatë” që përmbush kushtet e parashikuara në këtë nen.

**46.** Ndonëse neni 6, par. 1, parashikon “të drejtën për të shkuar në gjykatë”, ai nuk i detyron shtetet kontraktuese që mosmarrëveshjet në lidhje me të “drejtat dhe detyrimet civile” t’ia nënshtrojnë një procedure të zhvilluar në të gjitha

fazat e saj para “gjykatave”, që përmbushin kërkesat e ndryshme të nenit. Nevoja për fleksibilitet dhe efikasitet, që është plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund të justifikojë ndërhyrjen fillestare të organeve administrative ose profesionale dhe, aq më tepër, të organeve gjyqësore që nuk i përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. “Qasja në gjykatë” mbulon çështjet e faktit dhe çështjet e ligjit (shih *Le Compte, Ven Leuven dhe De Meyere v. Belgjikës*, 23 qershor 1981, par. 51, seria, A, nr. 43).

**47.** Gjykata vëren se, në bazë të nenit 6, par. 1, të Konventës, **duhet që vendimet e organeve administrative, që nuk i përmbushin kërkesat e këtij neni, t’i nënshtrohen më pas kontrollit të një organi gjyqësor** (shih për shembull, *Ortenberg v. Austrisë*, 25 nëntor 1994, par. 31, seria A, nr. 295-B, dhe *Crisan k. Rumanisë*, nr. 42930/98, par. 24, 27 maj 2003).

**48.** [...] Në këtë rast, mbi bazën e praktikës së brendshme, kërkuesi paraqiti një padi para gjykatave të brendshme, por pretendimet e tij u refuzuan me shkakun se vendimi i Komisionit të Ankimeve ishte përfundimtar dhe nuk i nënshtrohej kontrollit gjyqësor. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi ankimin e kërkuetit në lidhje me mungesën e kontrollit gjyqësor të vendimit të Komisionit të Ankimeve [...].

**49.** Gjykata nuk është e bindur për argumentin e Qeverisë se çështja e këtij kërkueti ka qenë nga pikëpamja lëndore e ndryshme nga ajo e kërkuetit tjetër. Thelbi i pretendimeve të kërkuetit lidhet me pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Ankimeve, njësoj si i kërkuetit tjetër. Gjykata nxjerr përfundimin se gjykatat e brendshme mund të kishin vepruar në të njëjtën mënyrë edhe me këtë çështje dhe të shqyrtonin si “çështjet e faktit, ashtu edhe ato të ligjit”.

**50.** Pra, është e nevojshme të përcaktohet nëse Komisioni i Ankimeve përbënte një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” sipas kuptimit të nenit 6, par. 1, të Konventës.

**51.** Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë konsiderohet e pavarur, ndër të tjera, vëmendje duhet t’i kushtohet mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatit në detyrë, ushtrimit të garancive ndaj presioneve të jashtme, si dhe çështjes nëse organi perceptohet apo shfaqet si i pavarur (shih ndër të tjera *Morris v. Mbretërisë së Bashkuar* nr. 38784/97, par. 58, KEDNJ, 2002-I).

**52.** Gjykata vëren se Komisioni i Ankimeve përbëhet tërësisht nga mjekë në detyrë,

të emëruar nga ISSH-ja dhe të aprovuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e të cilës mjekët punojnë. Në Komisionin e Ankimeve nuk ka anëtarë të kualifikuar ligjorë apo gjyqtarë (shih për kontrast, *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere*).

**53.** **Ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbajnë rregulla që të rregullojnë mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për palëvizshmërinë e tyre. Rregullat e statutit nuk parashikojnë mundësinë e betimit nga anëtarët e tij. Duket sikur ata mund të largohen në çdo moment nga detyra, sipas dëshirës së ISSH-së ose Ministrisë së Shëndetësisë, që ushtrojnë liri vendosjeje të pakufizuar.** Pozicioni i anëtarëve të komisionit të ankimeve është i hapur ndaj presioneve të jashtme. Një situatë e tillë e minon perceptimin e pavarësisë.

**54.** Nga sa më sipër, Gjykata mendon se **Komisioni i Ankimeve nuk mund të konsiderohet si një “gjykatë e pavarur dhe e paanshme”, siç kërkohet në nenin 6, par. 1, të Konventës.**

**55.** Duke pasur parasysh faktin që Komisioni i Ankimeve nuk përbën një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme” dhe që vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në këtë kohë, nuk mund të kundërshtohen para një gjykate vendase, gjykata vjen në përfundim se ka pasur shkelje të së drejtës së kërkuetit për t’iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6, par. 1, të Konventës.

#### **Shkeljet e pretenduara të nenit 13 të Konventës**

**56.** Ankimuesi u ankua se nuk ka mjet efektiv mbrojtjeje me anë të të cilit të kundërshtohet vendimi i komisionit të ankimeve para gjykatave të brendshme. Ai u mbështet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon: “Cilido, që i shkelen të drejtat dhe liritë që parashikohen në Konventë, ka mjete efektive përpara një autoriteti të brendshëm, pavarësisht nëse shkelja është bërë nga persona që veprojnë në cilësi zyrtare.”

[...]

**58.** Gjykata ripërsërit se, në masën që e drejta e Konventës e pretenduar nga ankuesi është një “e drejtë civile”, neni 6, par. 1, ajo mendohet se përbën një *lex specialis* në lidhje me nenin 13. Garancitë e tij janë më rigorozë dhe përfshijnë ato të nenit 13 (shih *Menesheva v. Rusisë*, nr. 59261/00, par. 105).

**59.** Gjykata mendon se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet ankesa e kërkuetit sipas kërkesave më pak rigorozë.

#### **Shpërblimi**

**64.** Gjykata pranon se ankimuesit duhet t’i jetë shkaktuar një masë e konsiderueshme stresi dhe shqetësimi, si rezultat i mohimit të së drejtës së tij për t’iu drejtuar gjykatës. Duke bërë një vlerësim mbi një bazë të drejtë, ajo i jep ankimuesit një shumë 6000 euro në kuadër të dëmit jo material.



## V. E DREJTA PËR JETË PRIVATE DHE FAMILJARE

“

Ivinović k. Kroacisë, 18.09.2014, Nr. 13006/13

Nëse kufizimi i zotësisë së kërkujes për të vepruar shkelte të drejtën për një jetë të qetë private, sipas nenit 8, dhe të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, sipas nenit 6.

”

**Faktet** - Kërkujesja ishte e paralizuar dhe përdorte karrige me rrota. Një qendër e kujdesit social ku ajo gjendej e shtruar, nisi procedurën përpara gjykatave vendase për të kufizuar zotësinë e saj për të vepruar. Gjykata e shkallës së parë i kufizoi asaj zotësinë për të vepruar, duke u shprehur se kërkujesja nuk mund të dispononte paratë dhe pasuritë e tjera në pronësi të saj dhe as të merrte vendime të pavarura për kujdesin shëndetësor të saj. Kjo gjykatë u bazua në mendimin e dy mjekëve psikiatër, të cilët vlerësuan që kërkujesja nuk mund të bënte zgjedhje të pavarura pa nevojën e një kujdestari. Pas shterimit të mjeteve të brendshme, kërkujesja u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të së drejtës së saj për jetë të qetë private, garantuar nga neni 8 i Konventës, dhe të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, garantuar nga neni 6, par. 1.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### Në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës

**35.** Gjykata rikujton se **heqja e zotësisë për të vepruar mund të përbëjë një ndërhyrje në jetën private të individit** në fjalë (shih *Shtukurov k. Rosisë*, nr. 44009/05, par. 83, GJEDNJ, 2008 dhe *Lashin k. Rosisë*, nr. 33117/02, par. 77, 22 janar 2013). Ka ndërhyrje në jetën private edhe kur individit i kufizohet zotësia për të vepruar (krahasojë me *Berková k. Sllovakisë*, nr. 67149/01, par. 164, 24 mars 2009, dhe *Salontaji-Drobnjak k. Serbisë*, nr. 36500/05, par. 144, 13 tetor 2009).

**36.** Gjykata thekson se meqenëse, neni 8 i Konventës nuk përmban kërkesa të qarta procedurale, procesi i vendimmarrjes duhet të garantojë që ndërhyrja në jetën private të individit të jetë e drejtë dhe të respektojë të drejtat e mbrojtura nga ky nen (shih *Görgülü k. Gjermanisë*, nr. 74969/01, par. 52, 26 shkurt 2004). Gjykata duhet të vlerësojë, nga këndvështrimi në tërësi i çështjes i, nëse arsyet e përdorura për të justifikuar masat e ndërmarra ishin “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” dhe nëse, gjatë procesit të vendimmarrjes, ishin marrë parasysh të drejtat e kërkujes në kuadër të nenit 8 të Konventës. Duhet mbajtur parasysh se autoritetet

kombëtare e kanë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë me individin në fjalë. Për rrjedhojë, detyra e Gjykatës nuk është që të zëvendësojë autoritetet kombëtare në ushtrimin e përgjegjësiave të tyre në lidhje me kufizimin ose heqjen e zotësisë për të vepruar, por të rishikojë nën dritën e Konventës vendimet e marra nga këto autoritete gjatë ushtrimit të pushtetit të tyre (shih *mutatis mutandis*, *T.P. dhe K.M. k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 28945/95, par. 71, GJEDNJ, 2001-V; *Sahin k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30943/96, par. 64, GJEDNJ 2003VIII; *Sommerfeld k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 31871/96, par. 62, GJEDNJ, 2003VIII (ekstrakte); *Görgülü*, cituar më lart, par. 41; dhe *Wildgruber k. Gjermanisë*, nr. 32817/02, 16 tetor 2006).

**37.** Hapësira e vlerësimit e autoriteteve shtetërore kompetente në këto raste ndryshon rast pas rasti, në bazë të natyrës së çështjes dhe rëndësisë së interesit që vihet në diskutim. Hapësira e vlerësimit për shtetin varet nga cilësia e procesit të vendimmarrjes. Nëse procesi ka pasur mangësi serioze në këtë aspekt, përfundimet e autoriteteve të brendshme do të kritikohen më shumë (shih *Salontaji-Drobnjak*, cituar më lart, par. 143). Në këtë drejtim, Gjykata thekson se në rastet

kur bëhet fjalë për kufizime serioze të jetës private të një individi zbatohet një shqyrtim shumë i rreptë.

**38.** Duke iu referuar rrethanave konkrete të çështjes objekt gjykimi, Gjykata vëren se gjykatat e brendshme i hoqën kërkujeses zotësinë për të vepruar, duke e ndaluar atë të dispononte paratë dhe pasuritë e tjera të saj, si edhe të merrte vendime të pavarura në lidhje me trajtimin e saj mjekësor. Sipas vlerësimit të Gjykatës, **heqja e zotësisë së një individi për të vepruar, qoftë edhe kufizimi i saj, është një masë shumë serioze dhe duhet të merret vetëm në situata përjashtimore** (shih *mutatis mutandis*, *X dhe Y k. Kroacisë*, nr. 5193/09, par. 91, 3 nëntor 2011). Duke mbajtur parasysh rëndësinë e pasojave të një mase të tillë për jetën private të kërkujeses, Gjykata vlerëson se duhet të bëhet një ekzaminim i kujdesshëm nga ana e gjykatave vendase i të gjithë faktorëve përkatës me rëndësi, për të siguruar përmbushjen e kërkesave të nenit 8 të Konventës.

**39.** Gjykata thekson se procedurat përpara gjykatave duhet të jenë në përputhje me shtetin e së drejtës dhe duhet të identifikohen me administrimin e mirë të drejtësisë dhe gjykatat e brendshme duhet t'i shtjellojnë argumentet për marrjen e një vendimi të tillë; në të kundërt, të drejtat e garantuara nga Konventa do të ishin teorike dhe të pavërteta. [...] ky detyrim prezumon të drejtën e një pale për të marrë pjesë në proces në mënyrë që, pretendimet e saj të shqyrtohen në mënyrë të kujdesshme (shih *mutatis mutandis*, *Ruiz Torija k. Spanjës*, 9 dhjetor 1994, par. 29, Seria A, nr. 303A; *Hiro Balani k. Spanjës*, 9 dhjetor 1994, par. 27, Seria A, nr. 303B; dhe *Novoseletskiy k. Ukrainës*, nr. 47148/99, par. 111, GJEDNJ, 2005II).

**42.** Për sa u përket problemeve shëndetësore të kërkujeses, Gjykata vëren se nuk ka asnjë të dhënë në dosjen në fjalë, që të tregojë se kërkujesja nuk është kujdesur për përmirësimin e shëndetit

të saj. Gjykatat e brendshme nuk paraqitën asnjë argument në lidhje me këtë. [...]

**43.** Për sa i takon gjendjes financiare të kërkujeses, autoritetet kombëtare nuk arritën t'i paraqisnin të gjitha faktet që lidhen me çështjen. Pra, të paraqisnin të gjitha rastet kur kërkujesja kishte marrë borxhe.

**45.** Në lidhje me përfaqësimin e kërkujeses në proceset në fjalë, Gjykata vëren se një punonjëse e qendrës ku kërkujesja ishte vendosur, ishte caktuar si kujdestarja e saj ligjore. Megjithatë, **duke u nisur nga fakti se vetë qendra i kishte nisur procedurat për kufizimin e zotësisë së kërkujeses për të vepruar, caktimi i një punonjëseje të saj si kujdestare ligjore e kërkujeses e vendos atë në një konflikt të pastër interesi mes punëdhënësit dhe personit nën kujdestari** [...]. Gjykata thekson se, veçanërisht në rastet që kanë të bëjnë me persona me aftësi të kufizuara mendore, autoritetet shtetërore kanë detyrimin të sigurojnë që këta persona të mbështeten nga një përfaqësues i pavarur, duke bërë të mundur që ankesat e tyre në bazë të Konventës të trajtohen në mënyrën e duhur (shih *Qendra për Burime Ligjore në emër të Valentin Câmpeanu k. Rumanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 47848/08, par. 161, 17 korrik 2014).

**46.** Në përfundim, Gjykata vlerëson se duke i kufizuar zotësinë për të vepruar, gjykatat vendase i kanë cenuar kërkujeses të drejtën e garantuar nga neni 8 i Konventës.

Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte ankesën e kërkujeses për shkeljen e nenit 6, par. 1, të Konventës.

Shpërblimi i drejtë

**57.** Gjykata vlerësoi se kërkujesja duhet të përfitojë si dëmshpërblim 7.500 euro në kuadër të dëmit jo material.

“

Dmitriy Ryabov k. Ruisë, 01.08.2013, Nr. 33774/08

Nëse heqja e kujdestarisë mbi të birin e kërkuarit shkelte të drejtën për jetë private e familjare dhe parimin e mosdiskriminimit.

”

**Faktet** - ZOTIT Ryabov dhe bashkëshortja e tij e ndërë vuanin të dy nga skizofrenia. Kërkuarit i ishte kufizuar e drejta prindërore në lidhje me djalin e tij menjëherë pas lindjes së këtij të fundit në vitin 2002. Djali ishte lënë nën kujdestarinë e gjyshes nga ana e mamasë. Kërkuari u ankua në të gjitha gjykatat vendase për cenim të jetës së qetë familjare, me argumentin se, edhe në rastet kur i lejohej sipas vendimit të gjykatës të takohej me të birin, takimi duhej të zhvillohej vetëm me pëlqimin e kujdestares së djalit. Kërkuari iu drejtua GJEDNJ-së me pretendimin se vendimet e gjykatave që kufizuan të drejtat e tij prindërore, me arsyetimin se ai përbente një rrezik për djalin e tij, nuk ishin bindëse dhe shkelnin të drejtën e tij, garantuar nga neni 8 i Konventës. Më tej, duke iu referuar nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës, kërkuari pretendon se kufizimet e së drejtës prindërore ishin diskriminuese ndaj tij, për shkak të cilësimit të tij si person me aftësi të kufizuara mendore.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 8 të Konventës

#### a. Në lidhje me kufizimin e të drejtave prindërore të kërkuarit

**44.** [...] Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit të Shën Pjetërburgut, në vendimin e saj të gushtit 2007, vlerësoi se do të ishte e rrezikshme për fëmijën e kërkuarit të jetonte me këtë të fundit, për shkak të rrethanave në të cilat ndodhej zoti Ryabov, rrethana këto të pavarura nga vullneti i tij. Konkretisht bëhej fjalë për faktin se kërkuari vuante nga çrregullime të shëndetit mendor të cilat, sipas gjykatës vendase, e pengonin të përmbushte detyrat e tij prindërore. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se ky vendim mund të konsiderohet se është marrë “në përputhje me legjislacionin në fuqi” sipas parashikimeve të nenit 8, par. 2, të Konventës.

**45.** Gjykata vëren më tej se ndërhyrja kishte për qëllim të mbronte “shëndetin ose moralin” dhe “të drejtat dhe liritë” e fëmijës, e për rrjedhojë ndiqte një nga qëllimet e ligjshme në kuadër të nenit 8, par. 2, të Konventës. Mbetet për t’u shqyrtuar nëse kufizimi i kontaktit me prindin, mund të konsiderohet si “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”.

**46.** Gjykatës i duhet të vlerësojë, nëse në dritën e çështjes në tërësi, arsyet e paraqitura për të justifikuar masën e marrë nga gjykatat

vendase ishin me vend dhe të mjaftueshme, sipas par. 2, të nenit 8. Pa dyshim, fakti se çfarë është në interesin më të mirë të fëmijës, ka rëndësi thelbësore në çdo çështje të këtij lloji. Për më tepër, duhet mbajtur parasysh se autoritetet shtetërore gëzojnë përfitimin e kontaktit të drejtpërdrejtë me personat në fjalë. Në vijim të këtyre konsideratave, detyra e Gjykatës nuk është që të zëvendësojë autoritetet vendase në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre për çështjet e kujdestarisë dhe të mënyrës së takimit të kërkuarit me fëmijën e tij, por të rishikojë nën dritën e Konventës vendimet e marra nga këto autoritete gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre (shih *Hokkanen k. Finlandës*, 23 shtator 1994, Seria A, nr. 299-A, f. 20, par. 55, dhe *Kutzner k. Gjermanisë*, nr. 46544/99, par. 65-66, GJEDNJ, 2002-I).

**47.** Hapësira e vlerësimit, që itakon autoriteteve kombëtare do të varet nga natyra e çështjes dhe serioziteti i interesit që rrezikohet. Pra, Gjykata vëren se autoritetet kanë një hapësirë të caktuar vlerësimi për të vendosur nëse një fëmijë ka nevojë për t’u marrë në mbrojtje ose jo. Megjithatë, në këto raste ushtrohet një shqyrtim i rreptë për çdo ndalim, siç është kufizimi i të drejtave dhe mundësive që u jepen prindërve dhe i çdo garancie ligjore të parashikuar për të siguruar një mbrojtje efektive të së drejtës së prindërve dhe fëmijëve, për respektimin e jetës së tyre familjare. Këto kufizime mbartin në vetvete rrezikun e shkatërrimit të marrëdhënieve familjare mes prindërve dhe fëmijëve (shih *Sahin k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 30943/96, par. 65, GJEDNJ, 2003VIII; *Elsholz k. Gjermanisë* [DHOMA

E MADHE], nr. 25735/94, par. 49, GJEDNJ, 2000-VIII; dhe *Kutzner*, cituar më lart, par. 67).

**48.** Neni 8 kërkon që autoritetet shtetërore të vendosin një balancë të drejtë mes interesit më të mirë të fëmijës dhe atij të prindërve. Në procesin e vlerësimit të këtyre interesave, rëndësi e veçantë i duhet dhënë interesit më të mirë të fëmijës, i cili, në varësi të natyrës dhe seriozitetit të çështjes, mbizotëron ndaj interesit të prindërve. Veçanërisht, një prind nuk mund të ligjërohet të kërkojë të drejta të garantuara nga neni 8, nëse pretendimet e tij do të dëmtonin shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës (shih *Elsholz*, cituar më lart, par. 50; *T.P. dhe K.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, [DHOMA E MADHE], nr. 28945/95, par. 71, GJEDNJ, 2001-V; *Ignaccolo-Zenide k. Rumanisë*, nr. 31679/96, par. 94, GJEDNJ, 2000-I; dhe *Nuutinen k. Finlandës*, nr. 32842/96, par. 128, GJEDNJ, 2000-VIII).

**49.** Në çështjen konkrete, gjykatat vendase në vendimet e tyre paraqitën argumente që kufizuan të drejtat prindërore të kërkuarit, përkatësisht gjendjen e shëndetit të tij mendor, faktin se që prej lindjes së të birit të kërkuarit, D. (i biri) kishte qenë në kujdesin e zonjës T.K., si edhe se kërkuari nuk kishte qenë përfshirë në mënyrë aktive në edukimin e fëmijës.

**50.** Gjykata vëren se nuk mund të çmojë në mënyrë shteruese nëse këto arsye ishin të “mjaftueshme” për qëllimet e nenit 8, par. 2, pa përcaktuar në të njëjtën kohë, nëse procesi i vendimmarrjes në tërësi i kishte mundësuar kërkuarit mbrojtjen e interesave të tij (shih *W. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1987, Seria A, nr. 121, f. 28-29, par. 64; *Elsholz*, cituar më lart, par. 52; dhe *T.P. dhe K.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 72).

**51.** Në proceset e zhvilluara përpara gjykatës së rrethit [...], kërkuari kishte mundësi të paraqiste të gjithë argumentet e tij kundër kufizimeve të të drejtave të tij prindërore dhe të kishte qasje në të gjithë informacionin përkatës, mbi bazën e të cilit gjykatat vendase kishin marrë vendimin (shih *mutatis mutandis*, *T.P. dhe K.M. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 7883, dhe *P., C. dhe S. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 56547/00, par. 13638, GJEDNJ, 2002VI).

**54.** Duke marrë në konsideratë gjetjet e mësipërme dhe hapësirën e vlerësimit që gëzon shteti i paditur, Gjykata është e bindur se procedura e zbatuar nga gjykatat vendase ishte e arsyeshme në kuadër të rrethanave të çështjes, si

edhe bazohej në një material të mjaftueshëm për të arritur në një vendim të arsyetuar për sa i përket kufizimit të të drejtave prindërore të kërkuarit. Gjithashtu, u respektua e drejta e zotit Raybov për t’u përfaqësuar dhe për të mbrojtur argumentet e tij, për të siguruar respektimin e të drejtës për jetë të qetë familjare. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” sipas kuptimit të nenit 8 të Konventës.

**55.** Pra, në këtë aspekt nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

#### b. Marrja e pëlqimit të kujdestarit për takimet me fëmijën

**57.** Gjykata vëren se në bazë të nenit 75 të Kodit rus të Familjes, një prind të cilit i janë kufizuar të drejtat prindërore, mund të mbajë kontakte me fëmijën, përveç rasteve kur ky kontakt do të kishte pasoja negative për këtë të fundit. Një kontakt i tillë, duhet të lejohet nga autoriteti që e ka marrë fëmijën nën kujdestari, ose nga kujdestari, prindërit e tij birësues, ose ndonjë autoritet tjetër të cilit i është besuar kujdesi i fëmijës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se një masë e tillë është marrë “në përputhje me legjislacionin në fuqi” dhe është në përputhje me nenin 8, par. 2, të Konventës.

**58.** Gjykata vëren më tej se ndërhyrja kishte për qëllim të mbronte “shëndetin ose moralin” dhe “të drejtat dhe liritë” e fëmijës, e për rrjedhojë, ndiqte një nga qëllimet që justifikojnë ndërhyrjen në kuadër të nenit 8, par. 2, të Konventës. Mbetet për t’u shqyrtuar, nëse kufizimi i kontaktit me prindin mund të konsiderohet si “i nevojshëm në një shoqëri demokratike”.

**61.** Në kuadër të gjetjeve të mësipërme dhe duke mbajtur parasysh hapësirën e vlerësimit që shteti i paditur gëzon, Gjykata vlerëson se kushti që kërkuari mund ta takonte djalin e tij vetëm pas marrjes së pëlqimit nga kujdestarja e djalit, ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” sipas kuptimit të nenit 8 të Konventës.

**62.** Për rrjedhojë, në këtë aspekt nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme të shqyrtonte kërkesën për shkelje të nenit 8 marrë së bashku me nenin 14, pasi vendosi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 8.

“

A.K. dhe L. K. Kroacisë, 08.01.2013, Nr. 37956/11

Nëse heqja e të drejtave prindërore të kërkueses dhe birësimi i fëmijës së saj shkelte të drejtën e saj për jetë familjare.

”

**Faktet** – Kërkuesja e parë është e ëma e kërkuesit të dytë L., i cili lindi në vitin 2008. Pak kohë pas lindjes, me pëlqimin e nënës së tij, L. u vendos në një familje në një qytet tjetër, për shkak se e ëma nuk kishte mundësi ekonomike për t' i siguruar të birit jetesën dhe se banonte në një shtëpi pa ngrohje. Në maj të vitit 2010, kërkueses iu hoq e drejta e prindërimit të L.-së, me arsyetimin se ajo vuante nga çrregullime të shëndetit mendor dhe nuk ishte e mundur të kujdesej për të birin. A. K.-ja kërkoi ndihmë ligjore falas për të apeluar vendimin, por kjo ndihmë iu dha pasi afati i apelimit kishte kaluar. Në tetor 2010, avokati i kërkueses i kërkoi gjykatës së rrethit që t' i rikthente asaj të drejtat prindërore, por kërkesa iu refuzua. Në të njëjtën kohë, L.-ja u birësua nga një person i tretë. Kërkuesja nuk mori pjesë si palë gjatë procedurës të birësimit dhe as nuk u njoftua për këtë procedurë, sepse miratimi i saj nuk ishte i nevojshëm për shkak të revokimit të të drejtave të saj prindërore. Kërkuesja u ankua përpara GJEDNJ-së për shkelje të neneve 8, 6, par. 1 dhe 14, të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës

#### Nëse ka pasur një ndërhyrje

**58.** Gjykata është shprehur edhe më parë se **bashkëjetesa e fëmijës dhe prindit përbën një nga elementët më thelbësorë të jetës familjare. Masat e ndërmarrja, të cilat e cenojnë këtë bashkëjetesë,** përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur nga neni 8 i Konventës (shih *Johansen k. Norvegjisë*, 7 gusht 1996, par. 52, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996III, par. 52; *Haase k. Gjermanisë*, nr. 11057/02, par. 82, GJEDNJ, 2004III (ekstrakte); dhe *X k. Kroacisë*, nr. 11223/04, par. 45, 17 korrik 2008).

**60.** Nuk ka dyshim se revokimi i të drejtës së fëmijës së tij/saj për birësim janë që të dyja masa shumë të rrepta. Madje, masa e fundit mund të sjellë shkatërrimin e plotë të marrëdhënies mes prindit dhe fëmijës. Në çështjen konkrete, këto masa përbëjnë një ndërhyrje në të drejtën e respektimit të jetës familjare të kërkueses, sikurse garantohet nga par. 1, i nenit 8 (shih *X. K. Kroacisë*, cituar më lart, par. 45).

#### Ligjshmëria e ndërhyrjes dhe qëllimi i ligjshëm

**61.** Gjykata pranon se masat e ndërmarrja në çështjen në fjalë janë të bazuara në legjislacionin e brendshëm, konkretisht në Kodin e

Familjes, dhe se legjislacioni përkatës kroat është i hartuar në mbrojtje të fëmijëve. Në këtë çështje nuk është zbatuar asnjë masë tjetër, e cila nuk bazohet në ligj. Për rrjedhojë, Gjykata pranon se vendimet në fjalë janë ndërmarrë për të mbrojtur interesin e fëmijës, i cili përbën një qëllim të ligjshëm sipas kuptimit të par. 2 të nenit 8 (shih *Keegan*, cituar më lartë, par. 44; *Görgülü k. Gjermanisë*, nr. 74969/01, par. 37, 26 shkurt 2004; *Glesmann k. Gjermanisë*, nr. 25706/03, par. 101, 10 janar 2008; dhe *X k. Kroacisë*, cituar më lartë, par. 46). Mbetet për t' u vlerësuar nëse ndërhyrja mund të trajtohet si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

#### E nevojshme në një shoqëri demokratike

**62.** Problemi qendror në këtë çështje është nëse procedurat e ndjekura kanë respektuar të drejtën e jetës familjare të kërkueses, ose kanë përbërë një ndërhyrje në ushtrimin e kësaj të drejte, e cila nuk mund të justifikohet në një shoqëri demokratike. Objekti thelbësor i nenit 8 është që të mbrojnë individin ndaj ndërhyrjes arbitrare të autoriteteve publike. Gjykata thekson se urdhri për ndarjen e një familjeje është një ndërhyrje tepër serioze. Gjykata është e ndërgjegjshme se autoritetet kombëtare përballen me një detyrë tepër të vështirë, siç është marrja e vendimeve për çështje të tilla kaq delikate. Të kërkojë që autoritetet të ndërmarrin procedura elastike, në varësi të rasteve konkrete, nënkupton t' u shtosh atyre një problem më tepër. Ndaj autoriteteve u duhet lejuar një hapësirë vlerësimi në këtë drejtim. Nga ana

tjetër, për vlerësimin e këtij aspekti në çështjen konkrete, është shumë i rëndësishëm fakti se duhet të provohet që vendimet janë të pakthyeshme, siç është rasti kur fëmija u është marrë prindërve dhe është vendosur për birësim. Natyrisht, këto janë raste në të cilat ekziston një nevojë edhe më e madhe se zakonisht për të kontrolluar arbitraritetin e shtetit (shih *B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1987, Seria A, nr. 121, par. 63; *X k. Kroacisë*, cituar më lart, par. 47; dhe *R. dhe H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35348/06, par. 76, 31 maj 2011).

**63.** Është e vërtetë se neni 8 i Konventës nuk parashikon rregullime procedurale, por kjo mungesë nuk është vendimtare. Konsideratat që duhet të kenë parasysh autoritetet kombëtare, kur marrin vendime për mirëqenien e fëmijëve, duhet të përfshijnë domosdoshmërisht mendimin dhe interesin e prindërve biologjikë. Sipas Gjykatës, **vendimarrja duhet të jetë e tillë, që të garantojë shprehjen e mendimeve të prindërve dhe marrjen e tij në konsideratë nga autoritetet kombëtare dhe që, këta të fundit të jenë** në gjendje të ushtrorjnë në kohën e duhur mjetet juridike në dispozicion të tyre. Sipas Gjykatës, në çështjen konkrete, duhet të përcaktohet nëse, në bazë të rrethanave specifike dhe natyrës shumë serioze të masës së marrë, prindërit janë përfshirë në procesin vendimarrës në një masë të tillë që t' u garantohet mundësia për të mbrojtur të drejtat e tyre. Nëse ata nuk janë përfshirë në një mënyrë të tillë, atëherë është shkelur e drejta e tyre për respektimin e jetës familjare dhe ndërhyrja, që vjen si pasojë e masës së ndërmarrë, nuk mund të konsiderohet si e nevojshme sipas kuptimit të nenit 8 (shih *B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, par. 64; dhe *X k. Kroacisë*, cituar më lart, par. 48).

**64.** Në procedurat e zbatueshme për çështje që lidhen me jetën familjare, prindërit biologjikë natyrisht kanë të drejtë të dëgjohen dhe të informohen plotësisht. Megjithatë, kufizimet e kësaj të drejte mund të justifikohen vetëm nëse janë marrë në kuadër të nenit 8, par. 2. Gjykata duhet t' i shqyrtojë edhe këto aspekte për të përcaktuar nëse procedurat janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke mbrojtur të drejtat e garantuara nga neni 8 i Konventës (shih *B. k. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, par. 65; *Tysiac k. Polonisë*, nr. 5410/03, par. 113, GJEDNJ, dhe *X k. Kroacisë*, cituar më lart, par. 49).

**65.** Në çështjen konkrete, Gjykata nuk do të vlerësojë nëse birësimi i fëmijës së kërkueses së parë ishte i justifikuar si i tillë, por do të përcaktojë nëse procedurat e ndjekura ishin në

përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës [...].

**70.** Në kuadër të rrethanave të çështjes, Gjykata do të shqyrtojë nëse, në fazat e procesit të birësimit, janë marrë masat e nevojshme në bazë të nenit 8 të Konventës, për të respektuar jetën private dhe familjare të kërkueses, duke mos pasur nevojë kështu të shqyrtojë nëse legjislacioni vendas, i cili nuk lejon prindërit biologjikë të marrin pjesë në procedurat e birësimit, përputhet me Konventën.

**73.** Pavarësisht gjetjeve të autoriteteve kombëtare se kërkuesja e parë vuante nga një çrregullim i shëndetit mendor dhe konstatimit nga ana e gjykatave vendase se ajo kishte aftësi të kufizuara në të folur dhe fjalor të kufizuar, të njëjtat gjykata lejuan që ajo të mbetej e pa përfaqësuar. **Gjykata e ka të vështirë të pranojë faktin se një individ, që ka vështirësi në të folur dhe fjalor të kufizuar, shkaqe këto që u morën si bazë për të mbështetur frikën se ajo e kishte të pamundur që të edukonte në mënyrën e duhur fëmijën e saj, u konsiderua se ishte në gjendje që të përfaqësonte dhe të mbronte interesat e saj në procedurat para gjykatave kombëtare për të drejtat e saj prindërore [...].**

**77.** Gjykata vëren më tej se, **kërkuesja e parë nuk ishte njoftuar për procedurat e birësimit dhe nuk u dëgjua në asnjë moment në lidhje me këtë çështje, sepse ajo nuk ishte palë në këto procedura dhe nuk kishte asnjë të drejtë për të përdorur një mjet ankimi në kontekst të këtyre procedurave.**

**78.** Ndonëse Gjykata vëren se pëlqimi i kërkueses nuk ishte i nevojshëm në procedurat e birësimit, për shkak të faktit se asaj i ishin revokuar të drejtat e saj prindërore, Gjykata vlerëson gjithashtu se, ashtu sikurse legjislacioni kroat lejon që të drejtat prindërore të rikthehen, është e domosdoshme që një prindi t' i jepet një mundësi për ta ushtruar këtë të drejtë para se fëmija e tij të jepet për birësim [...]. Në rastin konkret, duke mos e informuar kërkuesen e parë në lidhje me procedurat e birësimit, autoritetet kombëtare e privuan atë nga mundësia për të kërkuar rivendosjen e të drejtave të saj prindërore, përpara se lidhjet mes saj dhe fëmijës të ndërpriteshin përfundimisht nga birësimi. Për rrjedhojë, kërkuesja u pengua të gëzonte të drejtën e saj, garantuar nga Kodi i Familjes.

**79.** Në vlerësim të Gjykatës, kërkuesja e parë nuk është përfshirë në vendimarrjen për birësimin e fëmijës së saj.

80. Në kuadër të këtyre rrethanave, Gjykata vlerëson se nuk është marrë asnjë masë e përshtatshme në asnjë fazë të procesit që shkëputi lidhjet mes kërkuesve. Për rrjedhojë, Gjykata vendos se ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës dhe refuzon pretendimin e qeverisë për mos shterimin e rrugëve të brendshme të ankimit dhe mos respektimin e afatit 6 mujor të ankimit.

Në lidhje me ankesat e tjera të kërkuesve, Gjykata vlerësoi se nuk ishte e nevojshme t'i trajtonte.

### Shpërblimi i drejtë

70. Gjykata vlerësoi se kërkuesit duhet të përfitonin si dëmshpërblim 12.500 euro në kuadër të dëmit jo material, si edhe 2.000 euro dëmshpërblim për shpenzimet gjyqësore.

“

R.P. dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, 09.10.2012, Nr. 38245/08

Nëse caktimi i një kujdestari ligjor për kërkuesen për ta përfaqësuar në procedura gjyqësore për heqjen e të drejtës së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës së saj, shkelte të drejtën e qasjes në gjykatë.

”

**Faktet** – Kërkuesja e parë është nëna e një fëmije të lindur para kohe, i cili vuante nga probleme shëndetësore serioze, të cilat kërkonin një kujdes të vazhdueshëm. Autoritetet vendore nisën procedurat e marrjes në mbrojtje të fëmijës, për shkak të dyshimit se kërkuesja e parë nuk do të mund t'i siguronte atij kujdesin e nevojshëm, për shkak se ajo vuante nga aftësi të kufizuara. Kërkuesja e parë pajtoi avokatë për ta përfaqësuar atë gjatë procesit në fjalë, por pati ankesa serioze ndaj tyre, për shkak se nuk kishte mundësi të kuptonte këshillat që i jepnin. Autoritetet pajtuan një psikolog klinik për të vlerësuar nëse kërkuesja kishte apo jo zotësinë e nevojshme për të dhënë udhëzime për mbrojtjen e saj. Psikologu arriti në përfundimin se ajo do ta kishte tepër të vështirë të kuptonte këshillat e avokatëve dhe nuk do të ishte në gjendje të merrte një vendim në bazë të informacionit që ata do t'i jepnin. Gjykata vendosë i caktoi kërkueses një avokat kryesisht, që do të vepronte si kujdestari i saj ligjor. Ky kujdestar do të udhëzonte avokatët e kërkueses në emër të saj. Kërkuesja u ankua përpara GJEDNJ-së se kujdestari i caktuar kryesisht cenoi të drejtën e saj për të pasur qasje në gjykatë, garantuar nga neni 6, par. 1, i Konventës.

### Vlerësimi i Gjykatës

Në lidhje me shkeljen e nenit 6, par. 1, të Konventës

61. Gjykata thekson se Konventa synon të garantojë të drejta praktike dhe efektive. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për të pasur qasje në gjykatë, si një element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt gjyqësor (shih *Airey k. Irlandës*, 9 tetor 1979, par. 24, Seria A, nr. 32 dhe *Steel dhe Morris k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 68416/01, par. 59, GJEDNJ, 2005II).

62. Neni 6, par. 1, i Konventës i lë shtetit një zgjedhje të lirë të mjeteve që do të përdorë në garantimin e të drejtave të mësipërme për palët ndërgjyqësore. Institucioni i ndihmës juridike përbën një prej këtyre mjeteve, ndërkohë ka edhe të tjerë, si për shembull, lehtësimi i procedurave të zbatueshme (shih *Airey k. Irlandës*, cituar më lart, f.

14-16, par. 26; dhe *McVicar k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46311/99, par. 50, GJEDNJ, 2002III).

63. Megjithatë, Gjykata rikujton se e drejta për të pasur qasje në gjykatë nuk është një e drejtë absolute dhe mund të kufizohet. Këto kufizime lejohen të zbatohen për shkak se kjo e drejtë, për nga natyra e saj, kërkon rregullim normativ nga ana e shtetit. Ky rregullim normativ mund të ndryshojë sipas kohës dhe vendit, në varësi të nevojave dhe burimeve të shoqërisë dhe individëve (shih *Golder k. Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, par. 19, që citon «*Belgian Linguistic*» vendim i 23 korrikut 1968, Seria A, nr. 6, f. 32, par. 5). Në përcaktimin e një rregullimi të tillë, Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë të caktuar vlerësimi. Ndërkohë, vendimi përfundimtar për të vlerësuar nëse janë respektuar kriteret e Konventës, i përket Gjykatës. Nuk është pjesë e funksioneve të Gjykatës të zëvendësojë

funksionet e autoriteteve kombëtare, vlerësimet e të cilave mund të jenë politika më e mirë në fushën në fjalë (shih *Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 maj 1985, Seria A, nr. 93, f. 24, par. 57).

64. Megjithatë, kufizimet e vendosura nga shteti nuk duhet të kufizojnë apo të reduktojnë të drejtën e individit në një shkallë të tillë sa të cenohet vetë thelbi i kësaj të drejte (shih vendimet e cituar më lart, *Golder dhe "Belgian Linguistic"*, po aty, dhe gjithashtu *Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 60 dhe 75, Seria A, nr. 33). Për më tepër, një kufizim nuk do të jetë në përputhje me të drejtën e garantuar nga neni 6, par. 1, nëse nuk ndjek një qëllim të ligjshëm dhe nuk ekziston një lidhje e logjikshme proporcionaliteti mes mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohej të arrihej.

65. Në rastet që përfshijnë personat me aftësi të kufizuara, Gjykata u ka lejuar gjykatave të brendshme një hapësirë të caktuar vlerësimi për t'u mundësuar bërjen e rregullimeve përkatëse procedurale, me qëllim sigurimin e administrimit të mirë të drejtësisë dhe mbrojtjen e shëndetit të individit në fjalë (shih *Shtukurov k. Rusisë*, nr. 44009/05, par. 68, 27 mars 2008). **Në këtë linjë është edhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila kërkon që shtetet të bëjnë rregullimet e duhura për të lehtësuar rolin e personave me aftësi të kufizuara në procedurat ligjore.** Megjithatë, Gjykata është shprehur se masa të tilla nuk duhet të ndikojnë në thelbin e të drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë, siç garantohet nga neni 6, par. 1, i Konventës. Për të vlerësuar nëse një masë e caktuar ishte ose jo e nevojshme, Gjykata do të marrë parasysh të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë natyrën dhe kompleksitetin e çështjes së paraqitur përpara gjykatave kombëtare dhe çfarë rrezikonte kërkuesja (shih *Shtukurov k. Rusisë*, cituar më lart, par. 68).

67. Në kuadër të gjetjeve të sipërme dhe duke pasur parasysh kërkesat e parashtruara në Konventën e OKB-së, se shtetet palë duhet të adoptojnë rregullime të përshtatshme për të lehtësuar rolin efektiv të personave me aftësi të kufizuara në proceset gjyqësore, Gjykata çmon se në rastin konkret, objekt gjykimi, ishte e domosdoshme që Mbretëria e Bashkuar të merrte masat e duhura, në mënyrë që të sigurohej interesi më i mirë i R. P.-së, duke u përfaqësuar në procesin që u zhvillua për të vendosur fëmijën e saj në mbrojtje. Në kuadër të jurisprudencës së saj, Gjykata vlerëson se, në rast se ky përfaqësim për të mbrojtur të drejtat e R.P.-së nuk do të ishte siguruar, do të ishte shkelur neni 6, par.

1, i Konventës (shih *mutatis mutandis*, T. k. *Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 24724/94, par. 79 - 89, 16 dhjetor 1999).

69. Në lidhje me caktimin e kujdestarit ligjor si përfaqësues i kërkueses, Gjykata vëren se ai mund të vepronte vetëm në bazë të gjetjeve të raportit të psikologut klinik [...].

70. Gjykata vlerëson se, në mënyrë që të mbroheshin të drejtat e garantuara nga neni 6 par. 1, i Konventës, ishte e domosdoshme që kërkuesja të kishte një mjet efektiv, përmes të cilit të kishte mundësi të kundërshtonte përfaqësimin e saj nga kujdestari i caktuar kryesisht. Gjykata vëren se kujdestari i ka dërguar kërkueses një letër dhe një broshurë, në të cilën shpjegohej se në rast se R.P.-ja ishte e pakënaqur nga shërbimi i kujdestarit, ajo mund të komunikonte me të, ose me eprorin e tij, për të refuzuar përfaqësimin e tij [...].

72. [...] çdo mjet që do të përdorej për të kundërshtuar përfaqësimin e kërkueses nga kujdestari do të ishte efektiv në teori dhe praktikë, duke garantuar kështu të drejtën e parashikuar nga neni 6, par. 1, nëse mënyra për të kundërshtuar përfaqësimin dhe procedura përkatëse për këtë kundërshtim janë qartësisht të shpjeguara edhe për një individ që ka vështirësi në të folur dhe në nivelin e të kuptuarit.

74. Gjykata vlerëson se ishin marrë masa të përshtatshme për të garantuar që procedurat që po kryheshin, t'i shpjegoheshin kërkueses në mënyrë të qartë dhe të plotë. Ndërkohë kërkuesja i kishte në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme për të kundërshtuar përfaqësimin nga kujdestari i caktuar kryesisht (krahasojë me *Stanev k. Bullgarisë*, [DHOMA E MADHE], nr. 36760/06, 17 janar 2012, ku kërkuesit i ishte mohuar qasja e drejtpërdrejtë).

75. Në lidhje me rolin e kujdestarit të caktuar kryesisht, Gjykata vëren se ai duhej të vepronte në interesin më të mirë të palës të cilën përfaqësonte [...].

77. Gjykata nënvizon se kërkuesja e kishte të drejtën ta apelonte vendimin në Gjykatën e Apelit. Ndonëse ajo nuk ishte e përfaqësuar ligjërisht gjatë procedurave të apelimit, kjo ishte për shkak të zgjedhjes që bëri, duke refuzuar përfaqësimin *pro bono* që i ishte siguruar nga shërbimi i ndihmës juridike. Gjithashtu, Gjykata vëren se gjatë procesit të apelimit, kërkueses i ishte siguruar mundësia që të paraqiste argumentet e saj përpara gjykatës, argumente këto që ishin marrë në konsideratë gjatë gjykimit.

78. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, në këtë rast nuk është cenuar thelbi i të drejtës së kërkueses për të pasur qasje në gjykatë. Gjykata çmon se kërkueses nuk i janë cenuar të drejtat e garantuara nga neni 6, par. 1, i Konventës.

“

A.M.M. k. Rumanisë, 14.02.2012, Nr. 2151/10

Nëse procesi gjyqësor ku kërkuesi kërkonte njohje atësie shkelte të drejtën për jetë private e familjare dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor.

”

**Faktet** – Kërkuesi është një fëmijë i lindur jashtë martese në vitin 2001 dhe ka disa aftësi të kufizuara. Përpara GJEDNJ-së, ai u përfaqësua për herë të parë nga nëna e tij dhe më pas, për shkak se nëna vuante nga një aftësi e kufizuar e rëndë, nga gjyshja nga ana e nënës. Sipas certifikatës së tij të lindjes, atësia e tij është e panjohur. Në vitin 2001, nëna e tij nisi procedurat kundër Z.-së, duke pretenduar se fëmija ishte ngjizur pas një marrëdhënie me të. Ajo u mbështet në një deklaratë të shkruar me shkrim dore e nënshkruar nga Z.-ja, në të cilën ai njihnte atësinë e fëmijës dhe premtimin për të paguar detyrimin ushqimor. Gjykata urdhëroi kryerjen e testeve mjeko-ligjore, por Z.-ja nuk u paraqit në Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe nuk mori pjesë në seancat gjyqësore. Sipas legjislacionit të brendshëm, Zyra e Kujdestarisë ishte përgjegjëse për mbrojtjen e interesave të të miturve dhe personave që nuk kanë zotësi për të vepruar, duke përfshirë seancat gjyqësore në të cilat ata ishin thirrur për të marrë pjesë. Megjithatë, zyra e kujdestarisë nuk kishte marrë pjesë në seancat gjyqësore, siç i ishte kërkuar, ndërsa nga ana tjetër, as kërkuesi dhe as nëna e tij nuk kishin qenë të përfaqësuar nga një avokat në çdo fazë të gjykimit. Në vitin 2003, gjykatat e brendshme vërejtën se nëna e kërkuesit kishte vendosur të hiqte dorë nga testet e mjekësisë ligjore dhe marrja e provave të dëshmitarëve dhe, për këtë gjë, pretendimet e saj i hodhën poshtë si të pabazuara. Ndërkohë, kërkuesi pretendonte se gjykatat e brendshme nuk kishin ndërmarrë asnjë hap procedural për të siguruar paraqitjen e një përfaqësuesi të zyrës së kujdestarisë në seancat gjyqësore.

Kërkuesi parashtrori përpara GJEDNJ-së se e drejta e tij për jetë private e familjare, sipas nenit 8 Konventës, ishte shkelur për shkak se shteti, në caktimin e procedurave për njohjen e atësisë së kërkuesit, kishte vepruar në shkelje të detyrimit të tij pozitiv, sipas nenit 8.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Lidhur me shkeljen e pretenduar sipas nenit 8 të Konventës.

107. [...] Gjykata e vlerëson me vend që ta shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga kërkuesi, sipas nenit 8 të Konventës, i cili kërkon njëkohësisht që procesi vendimmarrës për jetën private dhe familjare të jetë i drejtë dhe që të respektohen ashtu si duhet interesat e mbrojtura nga kjo dispozitë (*Saleck Bardi k. Spanjës*, nr. 66167/09, par. 31, 24 maj 2011)

[...]

### a) Parimet e zbatueshme

108. Gjykata kujton se procedurat për njohjen e atësisë futen në fushën e veprimit të nenit 8 (*Mikulić v. Kroacisë* nr. 53176/99), par. 51). Edhe sikur të mos jetë përcaktuar asnjë lidhje familjare ndërmjet fëmijës dhe babait të pretenduar, neni 8 në vetvete mbron jo vetëm jetën «familjare», por edhe jetën «private», e cila përfshin aspekte të identitetit fizik dhe social të një individi. Respektimi i jetës private kërkon që çdokush të ketë mundësi të përcaktojë hollësitë e identitetit të tij si qenie njerëzore dhe të ketë të drejtë të sigurojë informacione të tilla që janë thelbësore

për formimin e personalitetit (*Gaskin k. Mbretërisë së Bashkuar*, 7 korrik 1989, par. 39, seritë A, nr. 160).

109. Gjykata rikujton gjithashtu se neni 8 ka në thelb të vet mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet arbitrare të pushtetit publik. Këtij detyrimi negativ mund t'i shtohen detyrimet pozitive për të siguruar një respektim efektiv të jetës private dhe familjare. Këto detyrime mund të kërkojnë miratimin e masave që synojnë respektimin e jetës private edhe në marrëdhëniet e individëve me njëri tjetrin (*Mikulić*, par. 57).

110. Kufiri ndërmjet detyrimeve pozitive dhe detyrimeve negative të shtetit, sipas kësaj dispozite, nuk është i përcaktuar saktë. Megjithatë, parimet e zbatueshme janë të ngjashme. Për të dy aspektet duhet të vendoset një ekuilibër i drejtë ndërmjet interesave konkurruese të individit dhe shoqërisë në tërësi; edhe pse në të dy rastet, shteti gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi (*Mizzi k. Maltës*, nr. 26111/02, par. 105-107).

111. Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj të zëvendësojë autoritetet e brendshme kompetente për të vendosur për mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me atësinë në nivel shtetëror, por të shqyrtojë sipas Konventës vendimet që kanë marrë këto autoritete në ushtrim të kompetencave të tyre (*Mikulić*, par. 59).

### b) Zbatimi i këtyre parimeve në rastin në shqyrtim

112. Në këtë rast, kërkuesi është një fëmijë i lindur jashtë martese, i cili është duke kërkuar atësinë e tij përmes rrugës gjyqësore. Padia e tij për kërkim atësie kërkon të përcaktojë lidhjet e tij juridike me Z.-në. Si rezultat, ka një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis padisë së tij për kërkimin e atësisë dhe jetës së tij private. Gjykata do të shqyrtojë nëse gjatë shqyrtimit të padisë së kërkuesit për atësinë, shteti i paditur ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e tij pozitiv, sipas nenit 8 të Konventës.

113. Gjykata konstaton se, sipas të drejtës së brendshme, Zyra e Kujdestarisë ka për detyrë të sigurojë mbrojtjen e interesave të të miturve dhe personave me aftësi të kufizuara, përfshi edhe gjatë procedurave gjyqësore. Ajo vëren gjithashtu se zyra e kujdestarisë nuk kishte marrë pjesë në procedurë, pavarësisht detyrimit të saj për të qenë e pranishme gjatë gjithë procesit. Ishin pikërisht këto mangësi në procedurë që bënë që Gjykata e Apelit të Bukureshtit të pranonte, në gjykimin e datës 29 janar 2003, apelimin e paraqitur nga nëna e kërkuesit. Por, këto mangësi

janë përsëritur gjatë gjykimit në apel. Gjatë pesë seancave në Gjykatën e Qarkut pas apelimit, Zyra e Kujdestarisë nuk është paraqitur në gjykim [...]. E ballafaquar me këtë mungesë, gjykata nuk mori asnjë masë procedurale për ta shtrënguar këtë zyrë për të marrë pjesë në gjykim. Përveç kësaj, mosparaqitja e Zyrës në gjykim nuk u shoqërua me asnjë masë tjetër për të mbrojtur interesat e fëmijës në procedurë, të tilla si, për shembull, caktimi i një avokati apo pjesëmarrja në seancën dëgjimore e një përfaqësuesi të Ministrisë së Punëve Publike, gjë e cila është konsideruar e nevojshme nga e njëjta gjykatë gjatë seancës dëgjimore të datës 22 maj 2003 [...].

[...]

115. Duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, për sa i përket dispozitës për pjesëmarrjen e detyrueshme të Zyrës së Kujdestarisë, ose të një përfaqësuesi të ministrisë së punëve publike në procedurën e kërkimit të atësisë, u takonte autoriteteve të vepronin në favor të interesit mbizotërues të fëmijës dhe të përpqeshin të kompensonin mosinteresimin e të ëmës dhe të shmangin mungesën e mbrojtjes nga fëmija.

116. Më tej, Gjykata vëren që në një datë të papërcaktuar, nëna e kërkuesit ishte pranuar në një shërbim social, pasi vuante nga një aftësi tepër e kufizuar. Duke e pasur të pamundur të provojë nëse në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet, ajo ishte ose jo në gjendje të mbronte interesat e fëmijës së saj, Gjykata rikujton vendimet e mëparshme në përcaktimin e shterimit të mjeteve të brendshme, se duhet pasur parasysh brishtësia e disa njerëzve, veçanërisht aftësia e tyre e kufizuar, për të paraqitur ankesa në mënyrë koherente apo kërkesa shumë të shkurtra (*V.D. k. Rumanisë*, nr. 7078/02, par. 87, 16 shkurt 2010).

117. Prandaj Gjykata e rrëzon argumentin e qeverisë.

118. Njëkohësisht, Gjykata vëren se e drejta e brendshme nuk parashikon asnjë masë, e cila lejon detyrimin e palës së paditur për të vepruar në përputhje me vendimin e një gjykate, për të pranuar bërjen e testeve të atësisë, e cila mund t'i korrespondojë më së miri nevojës për të mbrojtur të tretët, duke përjashtuar mundësinë për t'i detyruar ata t'i nënshtrohen analizave mjekësore, kryesisht testit të ADN-së (*Pascaud k. Francës*, nr. 19535/08, par. 62, 16 qershor 2011) [...].

119. Së fundmi, Gjykata konstaton se, për të vendosur për një padi që kërkon përcaktimin e atësisë, gjykatat duhet të mbajnë

parasysh interesin më të lartë të fëmijës (*Mikulić*, par. 65). Për sa më lart, Gjykata vlerëson se juridiksionet shtetërore nuk kanë arritur të vendosin një balancë të drejtë ndërmjet të drejtës së një kërkuesi të mitur për të mbrojtur interesat e tij gjatë procedurës për ruajtjen e identitetit të tij personal dhe të drejtës

së babait të prezumuar për të mos marrë pjesë në procedurë, dhe për të mos iu nënshtruar testit të atësisë.

**120.** Bazuar në sa parashtrohet më lart, Gjykata arrin në përfundimin se ka një shkelje të nenit 8 të Konventës.

“

**Saviny k. Ukrainës, 18.12.2008, Nr. 39948/06**

*Nëse heqja e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore të kërkuesve ndaj fëmijëve të tyre dhe vendosja e fëmijëve të kërkuesve nën përkujdesje shoqërore shkelte të drejtën e kërkuesve për jetë private e familjare, procesin e rregullt ligjor dhe parimin e mosdiskriminimit.*

”

**Faktet** – Kërkuesit janë bashkëshortë dhe kanë qenë të dy të verbër që nga fëmijëria. Nga martesja e tyre, kanë lindur shtatë fëmijë. Katër prej tyre janë vënë nën kujdesin publik në vitin 1998. Në vitin 2006, në bazë të një vendimi gjyqësor, tre fëmijët e tjerë u morën po ashtu nga institucione të përkujdesjes shoqërore publike. Autoritetet shtetërore e arsyetuan vendimin e tyre me konstatimin se mungesa e mjeteve financiare dhe aftësia e kufizuar e kërkuesve rrezikonte jetën, shëndetin dhe edukimin moral të fëmijëve. Veçanërisht, ata nuk ishin në gjendje që t'u siguronin fëmijëve ushqimin e duhur, veshjen, higjienën dhe kujdesin shëndetësor, apo t'u siguronin adaptimin (përshtatjen) në kontekstin shoqëror dhe arsimor. Apeli i kërkuesve ishte i pasuksesshëm. Kërkuesit u ankuan përpara GJEDNJ-së për shkelje të neneve 8, 14 dhe 6 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 8 të Konventës

**47.** Gjykata është shprehur edhe më parë se bashkëjetesa e fëmijës dhe prindit me njëritjetrin përbën një nga elementët më thelbësorë të jetës familjare. Masat e ndërmarra, të cilat cenojnë një bashkëjetesë të tillë sjellin ndërhyrje në të drejtën e mbrojtur nga neni 8 i Konventës (shih *ndër të tjera, McMichael k. Mbretërisë së Bashkuar*, 24 shkurt 1995, par. 86, Seria A, nr. 307B). Një ndërhyrje e tillë sjell shkelje të kësaj të drejte, përveç rasteve kur ajo është bërë “në përputhje me ligjin” dhe ndjek një nga qëllimet e ligjshme të parashikuara nga neni 8, par. 2, si dhe konsiderohet e “nevojshme në një shoqëri demokratike” (shih *McMichael*, cituar më lart, par. 87).

**48.** Për të përcaktuar nëse një ndërhyrje e caktuar ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, Gjykatës i duhet të vlerësojë nëse në

dritën e rrethanave të çështjes në tërësi, arsyet e paraqitura për të përligjur masat e marra nga gjykatat vendase ishin me vend dhe të mjaftueshme sipas par. 2 të nenit 8, si edhe nëse procesi vendimmarrës në tërësi ishte i drejtë, për të respektuar interesat e mbrojtura nga neni 8 (shih për shembull *Kutzner k. Gjermanisë*, nr. 46544/99, par. 65, GJEDNJ, 2002I, dhe *Sommerfeld k. Gjermanisë* [DHOMA E MADHE], nr. 31871/96, par. 66, GJEDNJ, 2003-VIII).

**49.** Gjykata vëren më tej se, pavarësisht hapësirës së vlerësimit që autoritetet shtetërore gëzojnë për të përcaktuar nëse një fëmijë do të vendoset nën kujdesin publik, prishja e lidhjeve familjare nënkupton shkeljen e fëmijës nga rrënjët e tij familjare, veprim ky që mund të përligjet vetëm në raste tepër përjashtimore (shih për shembull *Gnahoré k. Francës*, nr. 40031/98, par. 59, GJEDNJ, 2000-IX). Kështu, një vendim i tillë duhet të mbështetet në arsye të vlefshme dhe të rëndësishme, të cilat mbrojnë interesin më të mirë të fëmijës. U takon autoriteteve shtetërore t'i kushtojnë rëndësi pasojave që marrja e një mase të

tillë do të ketë për kujdesin e fëmijës, duke e larguar atë nga prindërit e tij (shih për shembull *Scozzari dhe Giunta k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 39221/98 dhe 41963/98, par. 148, GJEDNJ, 2000VIII).

**50.** Veçanërisht, kur një vendim i marrë arsyetohet me faktin se ishte i nevojshëm për të mbrojtur fëmijën nga rreziku, ekzistenca e një rreziku të tillë duhet provuar (shih *mutatis mutandis, Haase k. Gjermanisë*, nr. 11057/02, par. 99, GJEDNJ, 2004III (ekstrakte). Për të marrë vendimin e ndarjes së fëmijës nga prindërit, mund të jetë me vend të merren parasysh një sërë faktorësh si, për shembull, fakti që nëse fëmija vazhdon të qëndrojë nën kujdesin e prindërve, do të vuajë nga abuzime, ose do të lihet pas dore, do të ketë mangësi në edukim dhe mungesë të mbështetjes emocionale, ose se, vendosja e fëmijës nën përkujdesje publik është e nevojshme për shkak të gjendjes fizike ose shëndetit mendor të tij (shih *Wallová dhe Walla k. Republikës Çeke*, nr. 23848/04, par. 72, 26 tetor 2006 dhe *Havelka dhe të Tjerët k. Republikës Çeke*, nr. 23499/06, par. 57, 21 qershor 2007). Nga ana tjetër, vetëm fakti që një fëmijë do të vendoset në një ambient më të mirë për rritjen e tij ose të saj, nuk mund të justifikojë një masë të tillë, siç është shkelja nga prindërit (shih për shembull *K.A. k. Finlandës*, nr. 27751/95, par. 92 GJEDNJ, 2003-I). Kjo masë nuk mund të përligjet as me faktin se prindërit e fëmijës gjenden në një situatë jo të mirë, e cila mund të përmirësohet, për shembull, përmes ndihmës financiare dhe këshillimit social, pa qenë e nevojshme ndërmarrja e masave kaq radikale, siç është ndarja e familjes (shih për shembull, *Moser k. Austrisë*, nr. 12643/02, par. 68, 21 shtator 2006; *Wallová dhe Walla*, cituar më lart, par. 73-76; dhe *Havelka dhe të Tjerët*, cituar më lart, par. 61).

**51.** Në vazhdim, për të përcaktuar cilësinë e ndarjes e familjes, Gjykata do të konsiderojë veçanërisht, nëse përfundimet e arritura nga autoritetet shtetërore ishin bazuar në prova të mjaftueshme (duke përfshirë kur është e nevojshme, dëshmitë e dëshmitarëve, raportet e autoriteteve kompetente, vlerësimin e psikologëve ose ekspertëve të tjerë dhe raportet mjekësore), si edhe nëse palët e interesuara, veçanërisht prindërit, kishin mundësinë të përfaqësoheshin për të paraqitur argumentet e tyre dhe mbrojtur të drejtat e tyre në këtë proces (shih *mutatis mutandis, Schultz k. Polonisë*, nr. 50510/99, 8 janar 2002; *Remmo dhe Uzunkaya k. Gjermanisë* (dec.), nr. 5496/04, 20 mars 2007; dhe *Polásek k. Republikës Çeke*, nr. 31885/05, 8 janar 2007). Gjykata do të marrë në konsideratë, në

rastet kur është e përshtatshme, nëse janë pyetur edhe fëmijët vetë për këtë masë (shih *Havelka dhe të Tjerët*, cituar më lart, par. 62, dhe *Haase*, cituar më lart, par. 97).

**55.** Gjykata vëren se autoritetet shtetërore e bazuan vendimin e tyre në konstatimin se kërkuesit nuk kishin mjete të mjaftueshme financiare dhe cilësi perisiper t'u siguruar fëmijëve ushqimin, veshjen, kushtet sanitare dhe shëndetësore të nevojshme, si edhe edukimin dhe përshtatjen e tyre sociale, duke rrezikuar kështu jetën, shëndetin dhe moralin e fëmijëve. Gjykata vëren se këto arsye ishin relevante për të marrë një vendim të tillë.

**56.** Megjithatë, për të përcaktuar nëse këto arsye ishin të mjaftueshme, Gjykata dyshon se mungojnë provat e nevojshme për të treguar se fëmijët jetonin në kushte të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tyre [...].

**57.** Për më tepër, nuk duket se autoritetet gjyqësore kanë analizuar në thellësi shkallën e mangësisë në edukimin dhe rritjen e fëmijëve, për t'u atribuar kërkuesve aftësi të kufizuara të tilla që do të cenonin garantimin e sigurisë së nevojshme për fëmijët, krahasuar me vështirësitë financiare të kërkuesve, të cilat mund të ishin kapërcyer përmes ndihmës dhe këshillimit social. Në lidhje me vështirësitë financiare, nuk është detyrë e Gjykatës të përcaktojë nëse, për hir të unitetit të familjes, familjes në fjalë duhej t'i caktohej një ndihmë mujore financiare për të përballuar shpenzimet. Megjithatë, ky është një aspekt që duhej diskutuar nga autoritetet publike gjatë procedurave gjyqësore.

**58.** Asnjë provë autentike, e cila do të vërtetonte gjendjen emocionale dhe maturinë e kërkuesve në përballimin e vështirësive në familje, nuk u mor për të provuar që rritja e fëmijëve nga prindërit e tyre nuk ishte e përshtatshme. Në arsyetimin e vendimeve gjyqësore vendase, nuk u përmendën dhe nuk u analizuan asnjëherë përpjekjet e kërkuesve për të përmirësuar kushtet e jetesës, si për shembull, kërkesat për të mobiluar apartamentin e tyre, për ngrohje dhe kërkesat për ndihmë sociale [...].

**59.** Gjykata vëren gjithashtu se fëmijët në asnjë fazë të procesit nuk u dëgjuan nga gjyqtarët, madje ata ishin vendosur në institucione të ndryshme përkujdesjeje [...].

**60.** Duke marrë në konsideratë të gjitha gjetjet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se pavarësisht arsyeve të paraqitura nga autoritetet kombëtare për heqjen e të drejtave prindërore të

kërkuesve, këto autoritete nuk e kanë justifikuar në mënyrën e duhur ndërmarrjen e një mase kaq serioze, e cila ndërhynte në jetën familjare të kërkuesve.

**61.** Për rrjedhojë ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

[...]

“

**Kutzner k. Gjermanisë, 26.02.2002, Nr. 46544/99**

*Nëse vendimi gjyqësor që u hoqi kërkuesve të drejtat prindërore ndaj të dy vajzave të tyre, shkelte të drejtën e tyre për respektimin e jetës së qetë familjare, garantuar nga neni 8 i Konventës.*

”

**Faktet** – Kërkuesit, zoti Ingo dhe zonja Anette Kutzner janë shtetas gjermanë dhe nga martesja e tyre kanë dy vajza. Kërkuesit kanë ndjekur një shkollë të posaçme për persona që kanë vështirësi në të folur. Për shkak të aftësive të kufizuara fizike, si dhe zhvillimit të tyre mendor, vajzat e kërkuesve janë vizituar nga mjekët në mënyrë të vazhdueshme. Në bazë të këshillës së njërit prej mjekëve dhe kërkesës së zotërinjve Kutzner, vajzat kanë marrë asistencë për shkollim dhe jetesë që në moshë të hershme.

Në maj të vitit 1997, Gjykata për Kujdestarinë u hoqi kërkuesve të drejtat prindërore për të dy vajzat e tyre dhe urdhëroi që vajzat të sistemoheshin në një familje tjetër. Gjykata e mori këtë vendim pasi arriti në përfundimin se kërkuesit kishin aftësi të kufizuara intelektuale për të rritur fëmijë, por edhe sepse u konstatua që vajzat kishin shfaqur aftësi të kufizuara në zhvillimin e tyre fizik dhe mendor, si dhe sepse kërkuesit nuk kishin bashkëpunuar me shërbimet sociale.

Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Rrethit, duke u mbështetur edhe në raportin e dy ekspertëve, njëri prej të cilëve theksonte zhvillimin e kufizuar të prindërve, ndërsa tjetri gjendjen e tyre emocionale. Vajzat u strehuan në familje të ndryshme, ndërkohë që kërkuesve iu dha e drejta e takimit, por në mënyrë mjaft të kufizuar. Kërkuesit nuk u lejuan të takonin vajzat e tyre për 6 muaj, ndërsa pas kësaj periudhe vizitat u lejuan vetëm në praninë e një personi të tretë dhe mund të zgjasnin 1 orë në muaj, që më pas, u bë 2 orë në muaj.

Kërkuesit, pas shterimit të mjeteve të brendshme gjyqësore, u ankuan përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se heqja e të drejtave të tyre prindërore dhe akomodimi i vajzave në familje të tjera shkelte të drejtën e tyre për respektimin e jetës së qetë familjare, garantuar nga neni 8 i Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Cenimi i të drejtës për jetë të qetë familjare

#### a. Nëse ka ndërhyrje

**58.** Gëzimi i qetë i jetës së përbashkët mes prindit dhe fëmijës përbën një element themelor të jetës familjare (shih, ndër të tjera, *W. B. dhe R. k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1987, Seria A, nr. 121, par. 59, par. 60, dhe par. 64; *Olsën k. Suedisë* (nr. 1), 24 mars 1988, Seria A, nr. 130, par. 59; *Eriksson*

### Shpërblimi i drejtë

**74.** Gjykata vlerësoi se kërkuesit duhet të përfitonin një dëmshpërblim prej 5.000 euro në kuadër të dëmit jo material.

*k. Suedisë*, 22 qershor 1989, Seria A, nr. 156, par. 58; *Margareta dhe Roger Andersson k. Suedisë*, 25 shkurt 1992, Seria A, nr. 226-A, par. 72; *Keegan k. Irlandës*, 26 Maj 1994, Seria A, nr. 290, par. 50; *McMichael*, par. 86; *Johansen k. Norvegjisë*, 7 gusht 1996, Raportet 1996-III, par. 52; *Bronda k. Italisë*, 9 qershor 1998, Raportet 1998-IV, par. 51; *Buscemi k. Italisë*, nr. 29569/95, par. 53, GJEDNJ 1999-VI; *Gnahoré k. Francës*, nr. 40031/98, par. 50, GJEDNJ 2000-IX; dhe *K. dhe T. k. Finlandës* [DHOMA E MADHE], nr. 25702/94, par. 151, GJEDNJ, 2001-VII).

**59.** Prandaj nuk ka dyshim - dhe Qeveria nuk e kundërshtoi këtë - se masat e marra në rastin konkret (vendosja e fëmijëve në familje të tjera dhe kufizimet e vëna për takimet mes kërkuesve dhe fëmijëve të tyre) përbëjnë një “ndërhyrje” në të drejtat e kërkuesve për respektimin e jetës së tyre familjare.

#### b. Nëse ndërhyrja është e justifikuar

**60.** Një ndërhyrje në respektimin e të drejtës për një jetë të qetë familjare përbën shkelje të nenit 8 të Konventës, përveç rastit kur ndërhyrja është “në përputhje me ligjin”, ka qëllim ose qëllime që është ose janë të ligjshme në bazë të nenit 8, par. 2, të Konventës dhe është e nevojshme “në një shoqëri demokratike”, në bazë të qëllimit apo qëllimeve të sipërpërmendura. Nocioni i njësojshmërisë nënkupton se ndërhyrja i korrespondon një nevojë të ngutshme sociale dhe, veçanërisht, se është në proporcion me qëllimin e ligjshëm në bazë të të cilit është ndërmarrë (shih ndër të tjera *Gnahoré*, cituar më lart, par. 50).

**61.** Megjithëse objekti kryesor i nenit 8 është që të mbrojtë individin nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike, mund të ekzistojnë detyrime pozitive në mbrojtje të jetës familjare. Pra, kur ndërkohë ekziston një lidhje familjare, shteti duhet që në parim të veprojë në një mënyrë të tillë që kjo lidhje të zhvillohet dhe të marrë masa që kjo lidhje të forcohet dhe që prindërit dhe fëmijët të jenë bashkë (shih ndër të tjera *Eriksson*, cituar më lart, par. 71; *Margareta dhe Roger Andersson*, par. 91; *Olsson k. Suedisë* (nr. 2), 27 nëntor 1992, Seria A, nr. 250, par. 90; *Ignaccolo-Zenide*, cituar më lart, par. 94; dhe *Gnahoré*, cituar më lart, par. 51).

**62.** Kufiri midis detyrimeve pozitive dhe negative të shtetit në lidhje me këtë rregullim nuk mund të përcaktohet në mënyrë të saktë. Megjithatë, parimet që zbatohen në këtë rast janë të ngjashme. Në të dy rastet duhet të zbatohet parimi i proporcionalitetit midis interesit konkurrues të individit dhe atij të komunitetit në tërësi dhe në të dy kontekstet shteti gëzon një hapësirë të caktuar veprimi (shih ndër të tjera *W. B. dhe R. v. Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, par. 60, par. 61, dhe par. 65; *Gnahoré*, cituar më lart, par. 52).

#### c. “Në përputhje me ligjin”

**63.** Ndërhyrja në rastin konkret ishte e bazuar në nenet 1666 dhe 1666a të Kodit Civil gjerman.

#### d. Nëse ndërhyrja bëhet për një qëllim të ligjshëm

**64.** Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë dyshim se masa e ndërmarrë nga shteti në këtë rast kishte qëllim të mbronte “shëndetin dhe moralin” dhe “të drejtat e liritë” e fëmijëve.

#### e. Nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”

**121.** Gjykata thekson se për të përcaktuar, nëse masat e kundërshtuara ishin të nevojshme për t’u ndërmarrë në “një shoqëri demokratike”, duhet të marrë në konsideratë, në dritën e kësaj çështjeje si një të tërë, arsyet e paraqitura për të përligjur ndërhyrjen dhe, nëse këto arsye ishin relevante dhe të mjaftueshme sipas të par. 2 të nenit 8 të Konventës (shih ndër të tjera, *Olsson* (nr. 1), cituar më lart, par. 68; *Johansen*, cituar më lart, par. 64; *Olsson* (nr. 2), cituar më lart, par. 87; *Bronda*, cituar më lart, par. 59; *Gnahoré*, cituar më lart, par. 54; dhe *K. dhe T. k. Finlandës*, cituar më lart, par. 154).

**66.** Për të bërë këtë vlerësim, Gjykata merr në konsideratë edhe faktin se përshtatshmëria e ndërhyrjes nga ana e autoriteteve publike për kujdesin e fëmijëve ndryshon nga një Shtet Palë në tjetrin, dhe varet nga një sërë faktorësh siç janë, traditat në lidhje me rolin e familjes dhe ndërhyrja e shtetit në çështjet familjare dhe mundësia që ka për marrjen e masave publike në këtë fushë të veçantë. Megjithatë, konsiderata se çfarë gjëje është në të mirën më të madhe të fëmijës, përbën në çdo rast konsideratën mbizotëruese. Për më tepër, duhet mbajtur në vëmendje se autoritetet publike kanë mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë me të gjithë personat e interesuar, që në kohën kur masat e kujdesit janë siguruar apo menjëherë pas zbatimit të tyre. [...] Detyra e Gjykatës nuk është që të zëvendësojë autoritetet vendase në ushtrimin e përgjegjësive të tyre për rregullimin e përkujdesjes publike ndaj fëmijëve dhe të të drejtave të prindërve, fëmijët e të cilëve janë marrë në mbrojtje, por të rishikojë nën dritën e Konventës vendimet që këto autoritete kanë marrë në ushtrimin e pushtetit të tyre (shih ndër të tjera, *Hokkanen k. Finlandës*, 23 Shtator 1994, Seria A, nr. 299-A, par. 55; *Johansen*, cituar më lart, par. 64; *K. dhe T. k. Finlandës*, cituar më lart, par. 154).

**67.** Hapësira e vlerësimit për ndërhyrjen e autoriteteve kombëtare varet nga natyra e çështjes dhe serioziteti i interesit që rrezikohet, të tilla si rëndësia e mbrojtjes së një fëmijë që gjendet në një situatë në të cilën rrezikohet seriozisht shëndeti

ose zhvillimi i tij, si edhe objektivi për të bashkuar sërish familjen sa më shpejt të jetë e mundur. Kur ka kaluar një periudhë kohe e konsiderueshme nga koha kur fëmija është vendosur në mbrojtje dhe nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme *de facto*, në krahasim me gjendjen e familjes së tij, interesi i fëmijës mund të mbizotërojë ndaj interesit të prindërve për të parë familjen e bashkuar. Pra, Gjykata vëren se autoritetet kanë shumë liri veprimi për të vlerësuar, nëse një fëmijë ka nevojë për t'u marrë në mbrojtje ose jo. Megjithatë, ushtrohet një shqyrtim i rreptë për çdo ndalim, siç është kufizimi i të drejtave dhe i qasjes së prindërve dhe i çdo garancie ligjore të parashikuar, për të siguruar një mbrojtje efektive të së drejtës së prindërve dhe fëmijëve për respektimin e jetën së tyre familjare. Këto kufizime mbartin brenda rrezikun e cungimit efektiv të marrëdhënieve familjare mes prindërve dhe fëmijëve (shih *Johansen*, cituar më lart, par. 64).

**69.** Gjykata vëren se vendosja e një fëmije në mbrojtje, në një ambient më të përshtatshëm për mirëqenien e tij, nuk mund të përligjë një masë detyruese, e cila urdhëron heqjen e fëmijëve nga kujdesi i prindërve biologjikë; duhet të ekzistojnë rrethana të tjera, të cilat të tregojnë "nevojën" e një ndërhyrjeje të tillë në të drejtën e prindërve për të gëzuar një jetë të qetë familjare së bashku me fëmijën e tyre, e drejtë e cila garantohet nga neni 8 i Konventës (shih *K. dhe T. k. Finlandës*, c cituar më lart, par. 173).

**70.** Gjykata pranon se në çështjen konkrete, autoritetet vendase mund të kenë pasur shqetësime legjitime për zhvillimin e ngadaltë të fëmijëve, siç janë vërejtur nga shërbimet sociale dhe psikologët. Megjithatë, Gjykata vlerëson se vetë urdhri i mbrojtjes, si edhe mbi të gjitha mënyra sesi ai u zbatua, nuk ishin të papërshtatshme.

**71.** Fëmijët kanë përfituar që në moshë të hershme nga shërbimet sociale. Ndërkohë, sikundër rezulton, vërejtjet nga punonjësit socialë u bënë kur marrëdhënia mes tyre dhe kërkuesve u acarua, si pasojë e një konflikti. Pas këtij konflikti, punonjësja sociale paraqiti përpara autoriteteve një raport shumë negativ në lidhje me trajtimin e fëmijëve.

**72.** Për më tepër, opinionet e psikologëve të thirrur si ekspertë në faza të ndryshme gjatë procedurave gjyqësore kombëtare ishin kontradiktore, të paktën në lidhje me argumentet mbi të cilat mbështeteshin [...].

**73.** Gjithashtu, psikologët e thirrur si ekspertë nga Shoqata Gjermane për Mbrojtjen

e Fëmijëve, Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, si edhe mjekët e familjes kërkuan me urgjencë kthimin e fëmijëve tek familja e tyre biologjike. Ata theksuan veçanërisht se mirëqenia e fëmijëve nuk ishte në rrezik dhe se kërkuesit ishin plotësisht në gjendje të rrisnin fëmijët e tyre, si nga pikëpamja emocionale ashtu edhe intelektuale. Sipas këtyre ekspertëve, fëmijët duhet të kishin vetëm mbështetje në lidhje me edukimin.

Përfundimet e këtyre ekspertëve nuk mund të mos merren në konsideratë, vetëm për faktin se janë thirrur për të bërë vlerësimin nga njëra prej palëve të përfshira në proces.

**74.** Së fundmi, pavarësisht qëndrimit në çështje të tjera të të njëjtit lloj, të shqyrtuara nga Gjykata, nuk ka pasur pretendime se fëmijët janë neglizhuar ose keqtrajtuar nga kërkuesit.

**75.** Pavarësisht se masat e marra, fillimisht ato për edukimin, u cilësuan si jo të përshtatshme, **pyetja që shtrohet për shqyrtim është se përse autoritetet administrative dhe gjyqësore vendase, nuk morën masa alternative shtesë për të mbështetur fëmijët përpara se të ndërmerrnin hapin ekstrem të ndarjes së tyre nga prindërit.**

**76.** Gjykata thekson se, në parim, një urdhër mbrojtjeje duhet të trajtohet si një masë e përkohshme, e cila duhet të shfuqizohet sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo masë e përkohshme duhet të ketë si qëllim përfundimtar bashkimin e fëmijëve me prindërit biologjikë (shih *Olsson* (nr. 1), cituar më lart, par. 81). Detyrimi pozitiv për të marrë masat e duhura, për të lehtësuar ribashkimin e familjes sa më shpejt të jetë e mundur, është një përgjegjësi që bie mbi autoritetet, duke e shtuar këtë detyrim në mënyrë progresive nga momenti në të cilin urdhri i mbrojtjes ka nisur të veprojë, duke e balancuar gjithmonë këtë detyrim me detyrimin për të pasur gjithmonë në vëmendje interesin më të lartë të fëmijës (shih *K. dhe T. k. Finlandës*, cituar më lart, par. 178).

**77.** Megjithatë, në çështjen konkrete, fëmijët jo vetëm janë ndarë nga familja e tyre biologjike, por edhe janë vendosur në dy familje të ndryshme, veçmas njëri-tjetrit, duke ua ndaluar të gjitha kontaktet me prindërit e tyre për gjashtë muajt e parë. Për më tepër, opinionet e fëmijëve nuk u dëgjua nga asnjë gjyqtar.

**78.** Dokumentet në dosjen e kësaj çështjeje tregojnë se kërkuesit kanë fituar të drejtën për të takuar fëmijët e tyre vetëm pasi bënë një kërkesë në gjykatë dhe takimet janë vëzhguar në

mënyrë sistematike nga Zyra e të Rinjve Bersenbrück [...].

**79.** Gjykata vlerëson se, duke marrë në konsideratë moshën tepër të re të fëmijëve, një kontakt kaq i kufizuar me prindërit dhe me njëri-tjetrin krijon vetëm mundësi për largimin e tyre nga njëri-tjetri dhe nga prindërit.

**81.** Duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e bëra në këtë çështje, Gjykata vlerëson se megjithëse arsyet justifikuese për ndarjen e fëmijëve nga prindërit, të paraqitura nga autoritetet dhe gjykatat vendase, janë relevante, ato nuk janë të mjaftueshme për të përligjur një ndërhyrje kaq serioze në jetën e qetë familjare

**“ Spyra dhe Kranczkowski k. Polonisë, 25.09.2012, Nr. 19764/07**  
*Nëse pakujdesia e personelit mjekësor, e pretenduar se kishte shkaktuar aftësinë e kufizuar të njërit prej kërkuesve gjatë lindjes, shkelte nenet 2 dhe 8 të Konventës.*

**Faktet** – Kërkuesja e parë është e ëma e kërkuesit të dytë, i cili vuan nga aftësi të kufizuara të rënda dhe ka nevojë për ndihmë të përhershme, terapi të vazhdueshme dhe një dietë ushqimore të veçantë. Kërkuesja e parë pretendon se i biri vuan tashmë nga aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së trajtimit të duhur mjekësor në momentin kur ajo e solli atë në jetë. Sipas saj, personeli mjekësor, veçanërisht infermieret, nuk kishin zbatuar standardet e duhura mjekësore të kujdesit të fëmijëve të porsalindur. Kërkuesja ankohet gjithashtu për mungesën e efektivitetit të procedurave të brendshme të ndërmarrja nga autoritetet polake, për të hetuar mbi filluesën e këtij problemi. Përpara GJEDNJ-së, kërkuesit pretenduan shkelje të së drejtës së tyre për jetë private, sipas nenit 8 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 8 të Konventës

**122.** [...] Kërkuesit pretendojnë se aftësia e kufizuar e kërkuesit të dytë është shkaktuar nga mungesa e kujdesit të marrë gjatë shtrimit në spital [...], veçanërisht nga mungesa e respektimit nga personeli mjekësor i rregullave për kujdesin ndaj të sapolindurve [...] Kërkuesit u ankuan gjithashtu se mungonte efektiviteti i procedurave të ndjekura nga instancat e brendshme, për të hedhur dritë mbi rrethanat fillestare të aftësisë së kufizuar të kërkuesit.

[...]

të kërkuesve. Pavarësisht hapësirës së vlerësimit të autoriteteve vendase, kjo ndërhyrje nuk ishte proporcionale me qëllimin legjitim për të cilin u ndërmer.

**82.** Rrjedhimisht, ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.

### Shpërblimi i drejtë

**87.** Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së konstatuar dhe të gjithë rrethanat e tjera të çështjes, Gjykata u cakton kërkuesve një dëmshpërblim prej 15.000 euro në kuadër të dëmit jo material.



Kontraktues ka bërë atë që duhej për të siguruar një nivel të lartë kompetence të profesionistëve në fushën e mjekësisë, nuk mund të pranohet se çështje të tilla si një gabim gjykimi nga ana e një mjeku apo një koordinim i keq ndërmjet profesionistëve të fushës së mjekësisë në kuadrin e trajtimit të një pacienti, anë në vetvete të mjaftueshme që ta bëjnë një Shtet Kontraktues përgjegjës për detyrimet pozitive të mbrojtjes së jetës sipas kushteve të nenit 2 të Konventës (Powell k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 45305/99, 4 maj 2000 ; Byrzykowski k. Polonisë, nr. 11562/05, par. 104, 27 qershor 2006).

**Detyrimet pozitive që një shtet ka sipas nenit 2 të Konventës përfshijnë zbatimin nga autoritetet të një kuadri rregullator ndaj spitaleve publike apo private, dhe miratimin e masave të përshtatshme për të garantuar mbrojtjen e jetës së të sëmurëve. Këto parime vlejné pa asnjë dyshim për sulme të rënda ndaj integritetit fizik, që futen në fushën e veprimit të nenit 8 të Konventës.**

**124.** Gjykata rikujton se nuk është detyrë e saj të shqyrtojë legjislacionin e brendshëm *in abstracto* dhe as që të shprehet në një mënyrë të përgjithshme mbi përputhshmërinë e sistemit dhe praktikave të brendshme për çështje të kujdesit shëndetësor (shih për analogji, *Ruza k. Letonisë*, nr. 33978/05, 11 maj 2010). Ajo duhet, për aq sa është e mundur, ta kufizojë shqyrtimin e saj në vlerësimin nëse legjislacioni në fjalë ishte zbatuar me efektivitet ndaj kërkuesve.

[...]

**125.** Për sa kohë që kërkuesit pretendojnë mungesë efikasiteti në procedurat e ndjekura për hedhjen dritë mbi rrethanat e fillësës së aftësisë së kufizuar, Gjykata kujton se në fushën e nenit 2 të Konventës, ajo ka gjykuar se Shtetet palë kanë detyrimin që të ngrenë një sistem gjyqësor efikas dhe të pavarur, që i lejon ata të përcaktojnë shkaqet e vdekjes së një individi, që ndodhet nën përgjegjësinë e punonjësve të shëndetësisë, si ata që punojnë në sektorin publik, ashtu dhe ata të sektorit privat dhe, nëse është rasti, të detyrohen që të përgjigjen për veprimet e tyre (*Calvelli dhe Ciglio k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 32967/96, par. 49, *Lazzarini dhe Ghiacci k. Italisë*, nr. 53749/00, 7 nëntor 2002).

**126.** Në kontestin specifik të neglizhencës mjekësore, detyrimi procedural i vendosjes së një sistemi gjyqësor efikas nuk kërkon domosdoshmëri në të gjitha rastet një ndjekje penale. Detyrimi mund të konsiderohet i përmbushur nëse, për shembull, sistemi gjyqësor

u ofron të interesuarve një mjet para juridiksionit civil - të vetëm ose të kombinuar me një mjet para juridiksionit penal – të përshtatshëm për të përcaktuar përgjegjësinë eventuale të një mjeku dhe sipas rasti, zbatimin e sanksioneve civile të përshtatshme, si dëmshpërblimi apo/edhe botimi i vendimit. Mund të parashikohen edhe masa disiplinore (*Calvelli dhe Ciglio*, par. 51).

**127.** Detyrimi i shtetit, sipas nenit 2 të Konventës, mund të përmbushet qoftë kur mekanizmat mbrojtës të parashikuara në të drejtën e brendshme [...] funksionojnë në praktikë me efektivitet, qoftë kur bëhet një shqyrtim i çështjes në mënyrë të shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme (*Calvelli dhe Ciglio*, par. 53). Shqyrtimi i shpejtë i çështjeve është i rëndësishëm për sigurinë e përdoruesve të shërbimeve shëndetësore (*Byrzykowski*, par. 137).

**128.** Detyrimi procedural në fjalë nuk është një detyrim rezultati, por detyrim mjeti (*Paul dhe Audrey Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, par. 71, GJEDNJ, 2002-II).

**129.** Lidhur me çështjen objekt gjykimi, Gjykata vëren se e drejta polake u ofronte kërkuesve disa mjete që u mundësonte atyre të hidhnin dritë mbi rrethanat e fillësës së aftësisë së kufizuar, të cilat kërkuesit i kanë përdorur. [...]

**130.** Gjykata vëren se gjatë tre viteve të procedurës, autoritetet kanë vepruar aktivisht për zgjidhjen e saj [...].

**131.** Gjykata vëren gjithashtu se vonesa në paraqitjen e përfundimeve të ekspertizës ka kontribuar në mungesën e një zgjidhjeje më të shpejtë të çështjes.

**132.** Pavarësisht sa më sipër, Gjykata rikujton se objektivi i çështjes në shqyrtim ka të bëjë me përcaktimin nëse, në tërësinë e tij, rendi juridik ka lejuar trajtimin e përshtatshëm të çështjes (*Dodov c. Bullgarisë*, nr. 59548/00, par. 86, 17 janar 2008). **Në kontekstin specifik të neglizhencës mjekësore, detyrimi pozitiv i parashikuar nga neni 8 i Konventës përmbushet nëse rrugët administrative, civile apo disiplinore janë të hapura për të interesuarit** (*Balci c. Turqisë*, nr. 31079/02, par. 74, 17 shkurt 2009).

**133.** Në çështjen në shqyrtim, kërkuesit kanë përfituar nga shqyrtimi i çështjes së tyre nga gjykatat civile, si dhe nga autoritetet disiplinore të urdhrit të mjekëve. Në kuadrin e

këtyre procedurave, kryerja e të cilave nuk mund të kritikohet, janë marrë katër mendime ekspertësh të cilat, nga njëra anë, kanë hedhur poshtë hipotezën se kishte një lidhje shkakësore ndërmjet veprimeve të personelit mjekësor dhe aftësisë së kufizuar të kërkuesit, dhe nga ana tjetër, kanë hedhur dritë mbi

rrethanat e fillësës së shëndetit të tij.

[...]

**134.** Për këto arsye, Gjykata [...] arrin në përfundimin se nuk ka shkelje të nenit 8 të Konventës.

“

**Glass k. Mbretërisë së Bashkuar, 09.03.2004, Nr. 61827/00**

*Nëse mosmarrëveshja ndërmjet nënës së kërkuesit dhe personelit mjekësor për trajtimin mjekësor të kërkuesit, përbënte një ndërhyrje ndaj të drejtës për respektimin e jetës private të kërkuesit, veçanërisht të së drejtës së tij për integritet fizik.*

”

**Faktet** – Kërkuesi i parë është një shtetas britanik i mitur, i cili vuan nga aftësi të kufizuara fizike dhe mendore dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm prej 24 orësh. Nëna e tij, zonja Glass, njëkohësisht dhe kujdestarja e tij ligjore, është kërkuesja e dytë. Në korrik të vitit 1998, fëmija u shtrua në spital dhe u operua për shkak të ndërlikimeve që kishte në rrugët e frymëmarrjes. Mjekët vlerësuan se ai ishte duke u ndarë nga jeta dhe për këtë shkak konsideruan se do të ishte e nevojshme të vazhdonin të kujdeseshin për të në mënyrë intensive. Meqenëse zonja Glass nuk ishte e kënaqur me këtë përfundim, mjekët kërkuan mendimin e një eksperti të jashtëm. Pas disa kohësh gjendja e fëmijës u përmirësua dhe ai mundi të kthehej në shtëpi. Kohë pas kohë, ai pati përsëri infeksione në rrugët e frymëmarrjes. Mosmarrëveshjet mes nënës së tij dhe ekipit mjekësor vazhduan të ishin të forta. Objekt i tyre ishte fakti se si do të trajtohej fëmija në raste urgjente. Për më tepër, në dosjen e tij ishte shkruar “të mos kthehet më në jetë”. Gjatë kësaj kohe, në spital lindi një konflikt mes familjarëve të fëmijës dhe ekipit mjekësor. Kërkuesi i mbijetoi krizës dhe ishte në gjendje për t`u kthyer në shtëpi. Zonja Glass kërkoi një kontroll gjyqësor të vendimit të marrë nga spitali në lidhje me trajtimin e djalit të saj, por gjyqtari vendosi se vendime të tilla nuk mund të rishikoheshin, pasi situata konkrete kishte kaluar. E drejta për të apeluar iu refuzua. Kërkuesja u ankua më pas në Këshillin e Përgjithshëm Mjekësor dhe në polici. Pavarësisht, se u hapën procedime ndaj mjekëve, këta të fundit nuk u ngarkuan me përgjegjësi për asnjë akuze penale.

## Vlerësimi i Gjykatës

### **Në lidhje me ekzistencën e një ndërhyrjeje në nenin 8**

**70.** [...] Gjykata vlerëson se vendimi që kërkuesi të marrë një lloj të caktuar trajtimi, pa marrë në konsideratë kundërshtimin e nënës së tij, përbën një ndërhyrje në të drejtë e respektimit të jetës private të kërkuesit të parë, veçanërisht të së drejtës së tij për integritet fizik (shih *mutatis mutandis*, *X dhe Y k. Holandës*, 26 mars 1985, Seria A, nr. 91, p. 11, par. 22; *Pretty k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 2346/02, par. 61 dhe 63, GJEDNJ, 2002-III; dhe *Y.F. k. Turqisë*, nr. 24209/94, par. 33, 22 korrik 2003). Gjykata

vëren se qeveria argumentoi që mjekët u gjendën përballë një urgjence dhe iu desh të vepronin shpejt, në interesin më të mirë të kërkuesit të parë. Megjithatë, ky argument nuk e shmang faktin se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit. Në fakt, ky argument shkon në favor të nevojës për ndërhyrje dhe duhet të shqyrtohet në këtë kontekst.

### **Përputhshmëria me nenin 8, par. 2**

**73.** Një ndërhyrje në të drejtën e garantuar nga neni 8, nuk mund të justifikohet në kuadrin të nenit 8, par. 2, përveç rasti kur ajo është “në përputhje me ligjin”, ndjek një qëllim apo disa qëllime të ligjshme sipas këtij par. dhe është “e

nevojshme në një shoqëri demokratike”, në kuadër të qëllimit/qëllimeve që ajo ndjek (shih *Pretty*, cituar më lart, par. 68).

**76.** Gjykata vlerësoi se mosmarrëveshja mes zonjës Glass dhe personelit mjekësor, si edhe pretendimi se mjekët e kuruan kërkuesin gabim, duke pretenduar se ishin në rastin e një urgjence, duhet të ishte zgjidhur nga gjykatat vendase [...]. Gjykata vëren se kjo çështje duhet shqyrtuar në kuadër të “nevojës” për të ndërmarrë veprimin, si një kusht i vendosur në par. 2 të nenit 8, dhe jo nga këndvështrimi i kriterit “në përputhje me ligjin”.

**77.** Në lidhje me legjitimitetin e qëllimit të veprimeve, Gjykata vëren se veprimet e ndërmarrë nga personeli mjekësor, nga pikëpamja klinike do t’i shërbenin interesit të kërkuesit të parë [...].

**78.** Duke e përqendruar vëmendjen tek fjalë, Gjykata vlerësoi se situata e urgjencës së dytë nuk mund të konsiderohet e ndarë nga një mosmarrëveshje e ndodhur disa muaj më parë, në

lidhje me mënyrën si duhet të trajtohej kërkuesi në rast urgjence.

[...]

**83.** Gjykata vëren se duke pasur në konsideratë rrethanat e çështjes dhe vendimin e autoriteteve për të mos pranuar ankimin e zonjës Glass për trajtimin e djalit të saj pa pëlqimin e saj, është shkelur neni 8 i Konventës. Në kuadër të këtij përfundimi, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme që të shqyrtojë në mënyrë të veçantë ankesën e kërkuesve në lidhje me shënimin “të mos rikthehet në jetë”, pa marrë më parë miratimin e kujdestares ligjore, njëherazi edhe nëna e kërkuesit. Megjithatë, ky shënim nuk e pengoi trajtimin e kërkuesit me goditje elektrike kardiake dhe bërjen e frymëmarrjes artificiale, në mënyrë që kërkuesi të mbahej në jetë.

#### **Shpërblimi i drejtë**

**87.** Gjykata i akordoi kërkuesit 10.000 euro në kuadër të shpërblimit të dëmit jo material dhe 15.000 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore.

## **Vlerësimi i Gjykatës**

### **Në lidhje me shkeljen e nenit 8 të Konventës**

**31.** Gjykata duhet të përcaktojë nëse e drejta pretenduar nga zoti Botta përfshihet në qëllimin e “respektimit” të “jetës private”, garantuar nga neni 8 i Konventës.

**32.** Në vlerësim të Gjykatës, jeta private përfshin integritetin fizik dhe psikologjik të një individi. Garantitë, sipas nenit 8 të Konventës, kanë si qëllim kryesor të garantojnë zhvillimin e personalitetit të çdo individi në marrëdhëniet e tij me të tretët, pa ndërhyrjen e të tretëve (shih *mutatis mutandis*, *Niemietz k. Gjermanisë*, 16 dhjetor 1992, Seria A, nr. 251-B, p. 33, par. 29).

**33.** Në çështjen konkrete objekt gjykimi, kërkuesi ankohet jo për veprime, por për mosveprime nga ana e shtetit. Ndërkohë, synimi kryesor i nenit 8 është të mbrojtë individët nga ndërhyrjet arbitrare, që mund të ndërmerren nga autoritetet publike. Megjithatë, ky detyrim negativ nuk kërkon vetëm që shteti të “abstenojë” nga jeta e individëve, por përfshin edhe detyrime pozitive të domosdoshme për të siguruar një respektim efektiv të jetës private dhe familjare. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të ndryshme për të siguruar respektimin e jetës private edhe në lidhje me marrëdhëniet e individëve me njëri-tjetrin (shih *X dhe Y k. Holandës*, 26 mars 1985, Seria A, nr. 91, f.

11, par. 23, dhe *Stjerna k. Finlandës*, 25 nëntor 1994, Seria A, nr. 299-B, f. 61, par. 38). Megjithatë, koncepti i respektit nuk është i përcaktuar në mënyrë të saktë. Në mënyrë që të përcaktohet se një detyrim i tillë ekziston, duhet pasur në vëmendje balancimi i drejtë që duhet të ekzistojë midis interesit të përgjithshëm të shoqërisë dhe atij të individit në veçanti. Megjithatë, në çdo rast, shteti ka një hapësirë vlerësimi.

**34.** Gjykata ka theksuar, në vendime të saj të mëparshme se shteti i lindin detyrime të tilla kur konstaton një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme ndërmjet masës së kërkuar për t’u ndërmarrë nga individi dhe jetës private dhe/ose familjare të këtij të fundit (shih *Airey k. Irlandës*, 9 tetor 1979, Seria A, nr. 32, *X dhe Y k. Holandës*, cituar më lart, *mutatis mutandis López Ostra k. Spanjës*, 9 dhjetor 1994, Seria A, nr. 303-C).

**35.** Megjithatë, në çështjen konkrete, e drejta e pretenduar nga zoti Botta, konkretisht e drejta për të pasur qasje në plazh, pra, larg vendbanimit të tij të përhershëm, ka të bëjë me marrëdhënie ndërpersonale të largëta dhe pa qëllim të përcaktuar, për të cilat nuk ekziston bindja se kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me masat që duhet të ndërmarrë shteti në mënyrë urgjente për siguruar të drejtën e kërkuesit për të pasur qasje në plazh, në respektim të jetës së tij private. Rrjedhimisht, në këtë rast neni 8 nuk mund të zbatohet.

“

**Botta k. Italisë, 24.02.1998, Nr. 153/1996/772/973**

*Nëse mosveprimi i organeve shtetërore për garantimin e qasjes së kërkuesit në ambientet e një hoteli privat, shkelte të drejtën e tij për jetë private dhe të drejtën për mosdiskriminim.*

”

**Faktet** – Zoti Maurizio Botta është shtetas italian, i cili vuan nga aftësi të kufizuara fizike. Në gusht të vitit 1990, ai shkoi me pushime në një vendpushimi privat në Lido të Italisë, ku vërejti se mungonte infrastruktura e përshtatshme, që personat me aftësi të kufizuara të kishin mundësi për të shkuar në plazh. Mungesa e kësaj infrastrukture vinte në kundërshtim me ligjin italian, i cili parashikonte në një klauzolë të veçantë se plazhet private ishin të detyruara të krijonin infrastrukturë të përshtatshme, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara të kishin mundësi për t’i përdorur ato. Ndërkohë, sipas këtij parashikimi, autoritetet lokale e kishin për detyrë të mbikëqyrnin ekzistencën e këtyre ambienteve. Kërkuesi u rikthye në të njëjtin plazh një vit më vonë - në vitin 1991, dhe vërejti se asnjë masë nuk ishte marrë për të përmirësuar situatën në vendpushimin në fjalë. Pas ankimeve administrative, ai nisi një proces penal, por prokuroria e pushoi çështjen. Pas disa tentativave të tjera, në vitin 1993, kërkuesi paraqiti një ankesë para Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, për shkelje të së drejtës së tij për jetë private, garantuar nga neni 8 i Konventës, i marrë së bashku me të drejtën e garantuar nga neni 14, për ndalimin e diskriminimit. Komisioni vlerësoi se kjo çështje hynte në juridiksionin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ia referoi çështjen asaj.

“ X dhe Y k. Holandës, 26.03.1985, Nr. 8978/80

Nëse vendimi i prokurorisë për të mos nisur ndjekjen penale për shkak se kërkuesja, si viktimë e një abuzimi seksual, nuk kishte bërë kallëzim, shkel të drejtën për jetë private sipas nenit 8.

**Faktet** – Y-ja vuante nga çrregullimi i shëndetit mendor dhe për këtë arsye jetonte në një shtëpi të posaçme për fëmijë me çrregullime të shëndetit mendor dhe fizik, ku i nënshtrohej një trajtimi të posaçëm. Kur Y-ja ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç, personi B. abuzoi dy herë seksualisht me të. Menjëherë pasi mori dijeni, X-i babai i Y-së bëri një kallëzim në organet e policisë, duke përdorur autoritetin e tij prindëror, për faktin që e bija nuk kishte zotësi për të vepruar, si pasojë e moshës dhe aftësive të saj të kufizuara mendore. Prokuroria vendosi të mos fillonte ndjekje penale ndaj shtetasit B. me argumentimin se viktimja e drejtpërdrejtë e ngjarjes nuk kishte ngritur vetë padi në organet e prokurorisë brenda afatit të duhur. Duke mos mundur të niste procesin në sistemin e brendshëm, X-i iu drejtua Komisionit për të Drejtat e Njeriut, i cili vlerësoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në rastin e Y-së. Ndërkohë, për babanë e saj X., Komisioni u shpreh se ndaj tij nuk ishte shkelur e drejta për respektimin e jetës së qetë familjare garantuar nga neni 8 i Konventës.

Në këto kushte X-i iu drejtua GJEDNJ-së, me pretendimin se ndaj tij dhe Y-së ishin shkelur të drejtat e garantuara nga nenet 8, 14, 3 dhe 13 të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Cenimi i të drejtës për jetë të qetë private

23. Gjykata thekson se, qëllimi i nenit 8 të Konventës është të mbrojtë individët nga arbitrariteti i autoriteteve publike. Ky nen garanton jo vetëm mosndërrhyrjen e shtetit në jetën private të individëve, duke krijuar kështu një detyrim negativ, por edhe vendos një detyrim pozitiv për të siguruar mbrojtje efektive të jetës private dhe familjare (shih *Airey* vendim i 9 tetorit 1979, Seria A, nr. 32, par. 32) së tyre. Këto detyrime pozitive të shtetit mund të përfshijnë edhe marrjen e masave të duhura, që synojnë respektimin e jetës private edhe në marrëdhëniet mes individëve me njëri-tjetrin.

27. Gjykata vëren se mbrojtja e ofruar nga legjislacioni civil holandez në raste të ngjashme me abuzimin që i është bërë Y-së, është e pamjaftueshme. Ky është një rast në të cilin kundërshtohen vlerat themelore dhe aspektet thelbësore të jetës private. Marrja e masave efektive është një domosdoshmëri në këtë fushë dhe kjo mund të arrihet vetëm përmes ndryshimit të legjislacionit penal. Në fakt, kjo çështje është objekt rregullimi i këtij lloji legjislacioni. [...]

29. [...] Nuk është detyrë e Gjykatës të zëvendësojë autoritetet kompetente në interpretimin e legjislacionit vendas (shih *mutatis mutandis*, *Handyside*, vendim i 7 dhjetorit 1976, Seria A, nr. 24, f. 23, par. 50); dhe sipas këtij legjislacioni, në rastin konkret nuk mund të fillohej një procedim penal [...].

30. Kështu, nenet 248 dhe 239, par. 2, të Kodit Penal nuk i siguronin zonjës Y një mbrojtje praktike dhe efektive. Për rrjedhojë, arrihet në përfundimin se kërkuesja ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtës, që garantohet nga neni 8 i Konventës.

### Shpërblimi i drejtë

40. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së konstatuar, Gjykata i cakton kërkueses Y një dëmshpërblim prej 3.000 fiorina holandeze në kuadër të dëmit jo material.

## VI. E DREJTA E PRONËS

“ Katai k. Hungarisë, 18.03.2014, Nr. 939/12

Nëse pensioni i invaliditetit dhënë kërkuesit me një vendim gjyqësor të formës së prerë, i cili, si pasojë e ndryshimeve ligjore, nuk do të vazhdonte t'i jepej më kërkuesit, shkelte të drejtën e pronës, të drejtën për proces të rregullt dhe të drejtën për mjet efektiv.

**Faktet** – Në vitin 2007, kërkuesi u deklarua përmes një vendimi gjyqësor se vuante nga aftësi të kufizuara në shkallën 67 për qind. Vendimi deklaronte se vlerësimi ishte përfundimtar dhe se atij nuk do t'i bëheshin rishikime të tjera. Ndërkohë, kërkuesit iu caktua një pension për shkak të aftësive të kufizuara, i cili ishte në vlerën 37.5% të mesatares së pagës së tij mujore. Në 1 janar 2012, hyri në fuqi një skeme e re e përfitimit të pensioneve të invaliditetit, e cila ftonte të gjithë përfituesit e një pensioni të tillë, t'i nënshtroheshin një ekzaminimi të ri. Sipas kësaj skeme, nëse një individ kishte mundësi të rehabilitohej, atëherë ai do të merrte një pension rehabilitimi për një periudhë maksimale 3 vjeçare pas ekzaminimit. Ndërkohë, pension të përhershëm i invaliditeti do të përfitonin vetëm personat që vuanin nga aftësi të kufizuara dhe që nuk kishin mundësi rehabilitimi.

Kërkuesi u ankua përpara GJEDNJ-së se pensioni i invaliditetit i ishte dhënë në bazë të një vendimi gjyqësor përfundimtar, i cili del se e humbet fuqinë e tij si pasojë e ndryshimeve legjislative. Kërkuesi u ankua për shkelje të neneve 6 (proces i rregullt ligjor), 13 (e drejta për mjet efektiv), si edhe të nenit 1 të Protokollit 1 të saj (e drejta e pronës).

## Vlerësimi i Gjykatës

22. Gjykata vëren se ripërcaktimi i gjendjes së kërkuesit në mënyrë që t'i jepej një pension i ndryshëm ende nuk është kryer. Për më tepër, Gjykata nënvizon se deri në bërjen e një ekzaminimi të ri, kërkuesi vazhdonte të përfitonte pensionin e tij të mëparshëm.

23. Për rrjedhojë, Gjykata është e kënaqur që deri në datën e këtij vendimi, kërkuesi nuk ka pësuar ndonjë dëm material si pasojë e ndryshimit të legjislacionit në fjalë.

25. Në këto rrethana, Gjykata vëren se kërkuesi nuk mund të ankohet në kuadër të nenit 34, se është viktimë e shkeljeve të së drejtave të tij në kuadër të Konventës.

26. Për rrjedhojë, ankimi nuk përputhet *ratione personae* me parashikimet e Konventës në kuadër të nenit 35 par. 3 (a) dhe duhet rrëzuar në bazë të nenit 35, par. 4, të Konventës.

“

Kjartan Ásmundsson k. Islandës, 12.10.2004, Nr. 60669/00

Nëse ndërprerja e pagesës për aftësi të kufizuar të kërkuesit nga Fondi i Pensioneve, shkelte nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së për të drejtën e pronës, së bashku me nenin 14 të KEDNJ-së për mosdiskriminim.

”

**Faktet** – Kërkuesi, i cili punonte si marinar, pësoi një aksident të rëndë gjatë punës në bordin e një anije peshkimi. Pasi u vlerësua si 100% i paaftë për punë, ai u bë përfitues i pensionit të dhënë nga Fondi i Pensioneve Seamenis për personat me aftësi të kufizuara. Vlerësimi u bë në bazë të legjislacionit në fuqi, i cili i jepte çdo anëtar të Fondit një pension në rast se ai pësonte një aksident në punë, prej të cilit kishte humbur të paktën 35% të aftësive për të kryer punën që bënte përpara aksidentit. Disa kohë pas aksidentit, kërkuesi gjeti punë në një zyrë prej së cilës përfitonte disa të ardhura shtesë, përveç pensionit. Ndryshimet e bëra në ligj sollën një vlerësim të ri të aftësive të kërkuesit, bazuar në aftësinë e tij të përgjithshme për punë dhe jo në aftësinë për të kryer të njëjtën punë që kishte kryer më parë. Vlerësimi i ri arrinte në përfundimin se kërkuesi nuk e kishte nivelin minimal prej 35% të humbjes së aftësive dhe në vitin 1997, Fondi i Pensionit ia ndërpreu atij pagesën e pensionit si person me aftësi të kufizuar, si edhe përfitimet e tjera për fëmijët e tij, të cilat ai i kishte përfituar për gati 20 vjet. Padia e kërkuesit përpara gjykatës së shkallës së parë u rrëzua. Ndërkohë, Gjykata e Lartë në vendimin e saj u shpreh se ndryshimet në statut dhe masa e marrë nga Fondi i Pensionit përligjeshin edhe me situatën e vështirë financiare në të cilën ndodhej Fondi.

Përpara GJEDNJ-së, kërkuesi pretendoi se mospagimi nga Fondi i pagesës së paaftësisë shkelte nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së për të drejtën e pronës, së bashku me nenin 14 të KEDNJ-së për mosdiskriminim.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 1, të Protokollit 1 të Konventës marrë së bashku me nenin 14

**39.** Gjykata vëren se neni 1, i Protokollit 1, i cili garanton të drejtën e pronës, përfshin tre rregulla të ndryshme (shih *James dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1986, Seria A, nr. 98, f. 29-30, par. 37). Rregulli i parë, i cili është i shprehur në fjalinë e parë të par. 1, të nenit 1, garanton të drejtën për gëzim të qetë të pronës. Rregulli i dytë, parashikuar në fjalinë e dytë të të njëjtit paragraf, përcakton rastet kur mund të justifikohet privimi nga posedimi i pronës, duke radhitur kushte të caktuara që duhen përmbushur. Rregulli i tretë, që parashikohet në par. 2, u njeh të drejtën Shteteve Palë për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin publik. Rregulli i dytë dhe i tretë, të cilët vendosin kufizime në të drejtën për të gëzuar në mënyrë të qetë pronën private, duhen interpretuar nën dritën e parimeve të përgjithshme të parashikuara nga rregulli i parë. Në bazë të jurisprudencës së institucioneve të Konventës, **derdhja e kontributeve në një fond pensioni, në rrethana të caktuara mund të krijojë të drejta**

**pronësie, të cilat mund të ndikohen nga mënyra se si shpërndahet fondi** (shih *Bellet, Huertas dhe Vialatte k. Francës*, nr. 40832/98, 40833/98 dhe 40906/98, 27 prill 1999, dhe *Skorkiewicz k. Polonisë*, nr. 39860/98, 1 qershor 1999). Për më tepër, **të drejtat që rrjedhin nga pagesa e kontributeve të sistemeve të sigurimeve shoqërore janë të drejta materiale për qëllimet e nenit 1 të Protokollit 1** (shih *Gaygusuz k. Austrisë*, 16 shtator 1996, Raportet e gjykimeve dhe vendime 1996-IV, f. 1142, par. 39-41). Megjithatë, edhe duke supozuar se neni 1 i Protokollit 1 garanton përfitime për personat që kanë kontribuar në sistemin e sigurimeve shoqërore, kjo e drejtë nuk mund të interpretohet se u krijon individëve të drejtën për pension në një shumë të caktuar (shih *Müller k. Austrisë*, nr. 5849/72, Raportet e Komisionit të 1 tetorit 1975, Vendime dhe raporte 3, f. 25, dhe *Skorkiewicz*, cituar më lart). Një pikë e rëndësishme për vlerësimin në kuadër të kësaj dispozite është nëse e drejta e kërkuesit për të nxjerrë përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore në fjalë është shkelur në atë mënyrë që shpie në dëmtimin e thelbit të së drejtës së tij të pensionit (shih *Domalewski k. Polonisë*, nr. 34610/97, GJEDNJ, 1999-V).

**40.** Në çështjen objekt gjykimi, kërkuesi kishte kontribuar në Fondin e Pensionit nga viti 1969 deri në 1981, në bazë të një sistemi ku ai nuk kishte asnjë të drejtë ndaj aksioneve të fondit, por gëzonte vetëm të drejtën e përfitimit të pensionit, nëse përmbushte kushtet e caktuara [...].

Për sa i përket çështjes së ligjshmërisë së masës së ndërmarrë për përcaktimin e kriterëve të reja për vlerësimin e aftësive të kufizuara, Gjykata nuk do të ndalet për ta vlerësuar, sepse pretendimi i kërkuesit është refuzuar nga Gjykata e Lartë Islandeze. Respektimi ose jo i parimit të proporcionalitetit lë vend për interpretim në bazë të Konventës. Gjykata do të vlerësojë nëse është mbajtur një balancë e drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave themelore të një individ. Në këtë kuadër, do të kihet parasysh edhe fakti nëse në çështjen konkrete ka pasur një trajtim të diferencuar në mënyrë të pajustificuar [...].

**41.** [...] Gjykata nuk është e bindur nga argumentet e paraqitura nga qeveria, të cilat janë të pasigurta dhe të paqarta dhe, si rrjedhojë, ajo nuk do t'i marrë në konsideratë gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete [...].

**42.** Megjithëse vendimi i autoriteteve kombëtare për të mos i paguar më tej kërkuesit pensionin e invaliditetit është marrë duke mos llogaritur të ardhurat që ai përfitonte nga puna e re, Gjykata do ta marrë në konsideratë këtë pagesë për të vlerësuar çështjen e respektimit të parimit të proporcionalitetit, në kuadër të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës. Në këtë kuadër Gjykata vëren se hyrja në fuqi e rregullave të reja është bazuar në arsye legjitime, siç ishte zgjidhja e gjendjes të vështirë financiare të Fondit. Për më tepër, ndryshimet që u janë bërë kriterëve të aftësive të kufizuara, janë bazuar në kriterë objektive, konkretisht, një rivlerësim i detyrueshëm mjekësor për çdo person që përfiton një pension invaliditeti. Për të vlerësuar aftësinë e tij pas aksidentit për të kryer jo vetëm punën, që kryente përpara, por për të punuar në përgjithësi (shih *Bucheň k. Republikës Çeke*, nr. 36541/97, par. 75, 26 nëntor 2002), standard ky që aplikohet edhe në sektorë të tjerë në Islandë [...]. Gjykata ka gjithashtu parasysh argumentet e qeverisë se njëkohësisht me këto ndryshime, janë reduktuar në mënyrë të ndjeshme pensionet për të moshuarit nga Fondi i Pensioneve, sipas Aktit të vitit 1994.

**43.** Megjithatë, Gjykata vëren faktin se kërkuesi i përket një grupi të vogël personash me aftësi të kufizuara, pensionet e të cilëve, në ndryshim nga të gjithë grupimet e tjera, u ndërpreu në 1

korrik 1997. Argumenti legjitim i nevojës për të zgjidhur situatën financiare të Fondit, duket se nuk përputhet me faktin se pas 1 korrikut 1997, pjesa më e madhe e pensionistëve me aftësi të kufizuara - 689 prej tyre, vazhduan të merrnin përfitimet e tyre si pasojë e aksidenteve në punë në të njëjtën masë. Ndërkohë, vetëm një numër tepër i vogël pensionistësh u ballafaquan me masën ekstreme të humbjes së të drejtës së pensionit. Në vlerësimin e Gjykatës, megjithëse masat e marra për zgjidhjen e situatës së vështirë financiare të Fondit ishin legjitime, trajtimi i ndryshëm i përmendur më lart, nxjerr në pah se këto masa ishin të pajustificuara në kuadër të nenit 14 të Konventës, vlerësim i cili është tepër i rëndësishëm për shqyrtimin e respektimit të parimit të proporcionalitetit, në bazë të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

**44.** Karakteri diskriminues i ndërhyrjes u komplikua edhe nga fakti se ajo ndikoi tek kërkuesi në mënyrë konkrete dhe të rëndë, duke e privuar atë tërësisht nga e drejta për të përfituar pensionin e invaliditetit, të cilin zotit Kjartan Ásmundsson e kishte përfituar për afërsisht 20 vjet me radhë [...]. Sipas vlerësimit të Gjykatës, kërkuesi kishte një pritshmëri të ligjshme se aftësia e tij e kufizuar do të vazhdonte të vlerësohej në bazë të aftësive të tij për të kryer të njëjtën punë si përpara aksidentit. Duhet mbajtur parasysh edhe fakti se, në bazë të rregullave të mëparshme, fillimi i një pune të re nuk cenonte të drejtën e anëtarëve të Fondit për të përfituar një pension të plotë invaliditeti. Rrjedhimisht, duke mos qenë më i aftë të kryente punën e tij si marinar dhe i inkurajuar nga sistemi i pensionit ku ai kishte kontribuar për shumë vite, kërkuesi, sikurse edhe individë të tjerë që kishin pësuar aksidente në punë dhe përfitonin pension, gjeti ndërkohë një punë alternative, që të përfitonte dhe pensionin e invaliditetit. [...]

**45.** Në kuadër të rrethanave të çështjes, Gjykata vëren se kërkuesi ka qenë subjekt i një shkelje të rëndë dhe jo proporcionalë, e cila nuk mund të justifikohet si legjitime në përfitim të interesit publik, edhe nëse merret në konsideratë hapësira e gjerë e vlerësimit që shteti ka në fushën e legjislacionit social. Do të kishte qenë ndryshe në rast se kërkuesi do t'i ishte nënshtruar një rivlerësimi dhe pensioni i tij do të ishte ulur dhe ndërprerë fare (shih *Müller dhe Skorkiewicz*, cituar më lart, dhe *mutatis mutandis*, *James dhe të Tjerët*, cituar më lart, f.36, par. 54, dhe *Lithgow dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, Seria A, nr. 102, f. 44-45, par. 121).

Për rrjedhojë, ka pasur një shkelje të së drejtës së

garantuar nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës në dëm të kërkuarit.

### Shpërblimi i drejtë

**51.** Gjykata vlerësoi se kërkuari duhet të përfitojë si dëmshpërblim 60.000 euro në kuadër të fitimit të munguar, 15.000 euro si interes dhe 1.500 euro në kuadër të dëmit jo material.

“

**Koua Poirrez k. Francës, 30.09.2003, Nr. 40892/98**

*Nëse trajtimi i ndryshëm në lidhje me përfitimet sociale midis shtetasve francezë, ose shtetasve me vendbanim të përhershëm në Francë, shkelte të drejtën e pronësisë sipas nenit 1 të Protokollit 1, dhe parimin e mosdiskriminimit. sipas nenit 14 të Konventës.*

”

**Faktet** – Kërkuari, një shtetas nga Bregu i Fildishtë, vuan nga një aftësi e kufizuar fizike. Ai u birësua nga një shtetas francez në korrik 1987, por kërkesa e tij për të marrë shtetësinë franceze në dhjetor të po atij viti nuk u pranua, me argumentimin se në kohën që kishte bërë kërkesën zotit Poirrez kishte qenë në moshë madhore. Ai e apeloj këtë vendim. Atij iu dha një kartë e cila vërtetonte aftësinë e tij të kufizuar, por Zyra e Ndhmës Familjare refuzoi t`i jepte atij pagesën për persona madhorë me aftësi të kufizuara. Në qershor të vitit 1990, kërkuari e apeloj përsëri vendimin e mësipërm pranë Komisionit të Zgjidhjes së çështjeve me Pajtim, i cili rikonfirmoi vendimin e Zyrës së Ndhmës Familjare dhe u shpreh se ky vendim është marrë në bazë të Kodit francez të Mbrojtjes Sociale, sepse kërkuari nuk ishte shtetas francez dhe nuk kishte as shtetësinë e një shteti tjetër që të kishte marrëveshje dypalëshe me Francën. Pas këtij vendimi, kërkuari paraqiti një padi pranë Gjykatës së Mbrojtjes Sociale, e cila në qershor 1991, vendosi të ndalojë procesin dhe t`i drejtohej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në Luksemburg për një vendim të ndërmjetëm. Në dhjetor 1992, GJED-ja u shpreh se legjislacioni francez ishte në përputhje me parashikimet e të drejtës evropiane. Në mars 1993, Gjykata për Mbrojtjen Sociale e rrëzoi apelin e kërkuarit. Pas shterimit të shkallëve të tjera të ankimit, kërkuari iu drejtua GJEDNJ-së duke pretenduar shkelje të nenit 14 të Konventës marrës së bashku me nenin 1 të Protokollit 1 të saj.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### **Në lidhje me shkeljen e nenit 14, marrë së bashku me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës**

**46.** Në bazë të jurisprudencës së Gjykatës, një trajtim i ndryshëm është diskriminues sipas kuptimit të nenit 14, nëse ai nuk është ndërmarrë në bazë të një qëllimi dhe justifikimi të arsyeshëm, si edhe nëse nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm”, ose nuk ka “një raport të arsyeshëm proporcionaliteti” mes masës që është ndërmarrë dhe qëllimit që është dashur të realizohet. Për më tepër, Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të përcaktuar

nëse dhe për çfarë do të zbatohen trajtime të ndryshme në situata të ngjashme (shih *ndër të tjera, Gaygusuz k. Austrisë*, 16 shtator 1996, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV, f. 1142, par. 42; *Larkos k. Qipros* [DHOMA E MADHE], nr. 29515/95, par. 29, GJEDNJ, 1999-I; dhe *Thlimmenos k. Greqisë* [GHM], nr. 34369/97, par. 40, GJEDNJ, 2000-IV). Megjithatë, përpara Gjykatës duhet të paraqiten arsye shumë serioze me qëllim që një ndryshim në trajtim, i bazuar ekskluzivisht në shtetësi, të mund të konsiderohet në përputhje me Konventën (shih *Gaygusuz*, cituar më lart, f. 1142, par. 42).

**47.** Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuari ishte me vendbanim të ligjshëm në Francë, ku morri dhe një asistencë për jetesë minimale, përfitimi i të cilës nuk kushtëzohej nga kriteri i shtetësisë. Gjithashtu, Gjykata vëren se autoritetet i refuzuan kërkuarit pagesën në fjalë, duke u bazuar ekskluzivisht vetëm në kriterin e shtetësisë, i cili ishte një parakusht për këtë përfitim në bazë të nenit L. 821-1 të Kodit të Mbrojtjes Sociale, i cili ishte i zbatueshëm në kohën në fjalë.

**48.** Për më tepër, nuk është përcaktuar ose kundërshtuar që kërkuari nuk i plotësonte kushtet e tjera të parashikuara nga ligji për marrjen e këtij përfitimi social. Në lidhje me këtë çështje Gjykata vëren se kërkuari filloi të merrte përfitimin në fjalë vetëm pas 11 majit 1998, kohë në të cilën u shfuqizuan dispozitat që parashikonin shtetësinë si kusht përjashtues. Për rrjedhojë, vetëm në këtë kohë ai u vu në të njëjtën situatë me shtetasit francezë ose shtetasit e shteteve të treta, që kishin marrëveshje bilaterale me Francën për përfitime të tilla sociale. Gjykata vëren se edhe Gjykata franceze e Kasacionit është shprehur se trajtimi i ndryshëm i kërkuarit vetëm mbi bazën e shtetësisë së tij të ndryshme, ndërkohë që ai është me vendbanim të përhershëm në Francë, shkelte nenin 14 të Konventës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të saj (shih par. 26 të vendimit).

**49.** Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se argumentet e paraqitura nga qeveria nuk janë bindëse. Trajtimi i ndryshëm në lidhje me përfitimet sociale midis shtetasve francezë ose shtetasve të atyre shteteve që kanë marrëveshje bilaterale me Francën, dhe shtetasve nga vende të treta, nuk bazohet në asnjë “justifikim të arsyeshëm dhe objektiv” (shih *Moustaquim k. Belgjikës*, 18 shkurt 1991, Seria A, nr. 193, f. 20, par. 49). Megjithëse, në kohën në fjalë Franca nuk detyrohej nga asnjë marrëveshje bilaterale me Bregun e Fildishtë, me ratifikimin e Konventës, ajo është zotuar për të garantuar të drejtat dhe liritë e “të gjithë individëve brenda juridiksionit të saj” dhe padyshim kërkuari përfshihet në këtë kategori (shih *Gaygusuz*, cituar më lart, f. 1143, par. 51).

**50.** Në këtë rast, është shkelur e drejta e garantuar nga neni 14 i Konventës, marrë së bashku me nenin 1 të protokollit 1 të saj.

### Shpërblimi i drejtë

**70.** Gjykata vlerësoi se kërkuari duhet të përfitojë si dëmshpërblim 20.000 euro në kuadër të dëmit material dhe jo material, si edhe 3.000 euro dëmshpërblim për shpenzimet gjyqësore.

# VII. E DREJTA PËR TË VOTUAR

“

Alajos Kiss k. Hungarisë, 20.05.2010, Nr. 38832/06

Nëse kufizimi me vendim gjykate i zotësisë së kërkuesit për të vepruar, si pasojë e të cilit ai nuk kishte të drejtë për të votuar, shkelte Konventën.

”

**Faktet** – Kërkuesi, i cili disa vite më parë është diagnostikuar se vuan nga depresioni maniak, është vendosur në vitin 2005 nën kujdestari të pjesshme pasi gjykata vendase vlerësoi se ai ishte në gjendje të kujdesej për veten në mënyrë të përshtatshme, por shpesh herë ai ishte i papërgjegjshëm me përdorimin e parasë dhe në disa raste agresiv. Sipas seksionit 14 të Kodit Civil vendas, vendosja e kujdestarisë së pjesshme, e detyron gjykatën të kufizojë zotësinë të një individi me aftësi të kufizuara për të vepruar – veçanërisht në lidhje me çështje financiare. Megjithatë, nga parashikimi i nenit 70(5) të Kushtetutës Hungareze, një urdhër i tillë sjell humbjen e menjëhershme të së drejtës për të votuar. Për rrjedhojë, kërkuesit iu ndalua të votonte në zgjedhjet e përgjithshme në prill 2006.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës

**36.** Në zgjidhjen e kësaj çështjeje, Gjykata do t'i referohet jurisprudencës së saj të mëparshme, cituar në vendimin *Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) ([DHOMA E MADHE], par. 57-62).

**57.** Gjykata ka përcaktuar se neni 3 i Protokollit 1 garanton të drejta individuale, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur (shih *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt k. Belgjikës*, 2 mars 1987, Seria A, nr. 113, f. 22-23, par. 46-51). ...

**58.** Të drejtat e garantuara në kuadër të nenit 3 të Protokollit 1 janë thelbësore për vendosjen dhe qëndrueshmërinë e një demokracie efektive dhe të qenësishme, bazuar në shtetin e së drejtës [...].

**59.** [...] E drejta për të votuar nuk është një privilegj. Në shekullin e 21të, prezumimi se një shtet është demokratik duhet të anojë nga përfshirja [...]. E drejta universale e votës është bërë një parim bazë (shih *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, f. 23, par. 51, citon *X. k. Gjermanisë*, nr. 2728/66 vendim i Komisionit, 6 tetor 1967, Koleksioni 25, f. 38-41).

**60.** Megjithatë, të drejtat e garantuara nga neni 3 i Protokollit 1 nuk janë absolute. Në këtë fushë ka vend për kufizime dhe Shteteve Palë u lejohet një hapësirë vlerësimi në bazë të gjykimit të tyre.

**61.** ... Gjykata rithekson se hapësira në këtë fushë është e gjerë (shih *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, cituar më lart, f. 23, par. 52, dhe *Mathews k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 24833/94, par. 63, GJEDNJ, 1999-I; *Labita k. Italisë* [DHOMA E MADHE], nr. 26772/95, par. 201, GJEDNJ, 2000-IV, dhe *Podkolzina k. Letonisë*, nr. 46726/99, par. 33, GJEDNJ, 2002-II) [...].

**62.** Megjithatë, është detyrë e Gjykatës për të thënë fjalën e fundit nëse janë plotësuar kriteret e nenit 3 të Protokollit 1. Gjykata duhet të krijojë bindjen se kufizimet nuk cenojnë thelbin dhe efektivitetin e të drejtës në fjalë; se ato duhet të vendosen në kuadër të një qëllimi legjitim; dhe që masat e ndërmarra të mos jenë jo proporcionale (shih *Mathieu-Mohin dhe Clerfayt*, f. 23, par. 52)[...].

**37.** Në shqyrtim të çështjes konkrete, Gjykata do të përcaktojë nëse këto kritere janë përmbushur.

## (i) Qëllimi legjitim

**38.** Gjykata vëren se neni 3 i Protokollit 1 nuk përcakton në mënyrë të qartë kufizimet që mund t'i vendosen të drejtës së garantuar nga ky nen; si rrjedhojë, që ka një gamë të gjerë qëllimesh të cilat mund të jetë në përputhje me nenin 3. Palët e përfshira në proces ranë dakord me argumentin e qeverisë se vetëm ata individë që mund të mbajnë përgjegjësi për veprimet dhe zgjedhjet e tyre, lejohet të marrin pjesë në punët publike.

## (ii) Proporcionaliteti

**39.** Gjykata vëren se kufizimet në fjalë nuk bëjnë dallim ndërmjet personave me zotësi të kufizuara për të vepruar dhe atyre pa zotësi për të vepruar, dhe se ato pushojnë së vepruari në kohën kur kujdestaria mbaron [...].

**41.** Gjykata pranon se në këtë fushë, pushtetit legjislativ kombëtar i lihet një hapësirë e gjerë vlerësimi, për të caktuar se cilat kufizime të së drejtës së votës mund të justifikohen në kohët moderne dhe, nëse kjo ndodh, sa e drejtë është balanca. Veçanërisht i takon legjislativit të vendosë se cila procedurë duhet të hartohet për të përshtatur të drejtën e votës për personat me probleme të shëndetit mendor. **Gjykata vëren se nuk ka prova që të vërtetojnë se pushteti legjislativ hungarez i ka vlerësuar ndonjëherë interesat konkurruese, ose të vlerësojë proporcionalitetin e kufizimit në fjalë.**

**42.** Gjykata nuk mund të pranojë se pengimi absolut i personave me zotësi të pjesshme për të vepruar për të votuar, pa vlerësuar aftësitë e tyre aktuale, është brenda hapësirës së vlerësimit që gëzon shteti për kufizimin e kësaj të drejte. Megjithatë Gjykata thekson se kjo hapësirë është e gjerë, kjo nuk nënkupton se është një hapësirë gjithëpërfshirëse (shih *Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) [DHOMA E MADHE], cituar më lart, par. 82). Për më tepër, nëse një kufizim i të drejtave themelore zbatohet për një grup shoqëror, i cili ka qenë subjekt diskriminimi në të shkuarën, siç janë konkretisht personat që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, shteti do të ketë një hapësirë më të ngushtë vlerësimi për të kufizuar të drejtën në fjalë dhe, për ta bërë këtë, ai duhet të ketë arsye shumë serioze (shih për trajtimin e pabarabartë me bazë gjinore - *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali k. Mbretërisë së Bashkuar*, 28 maj 1985, par. 78, Seria A, nr. 94.; *D.H. dhe të Tjerët k. Republikës Çeke* [DHOMA E MADHE], nr. 57325/00, par. 182, GJEDNJ, 2007, mbi orientimin seksual *E.B. k. Francës* [DHOMA E MADHE], nr. 43546/02, par. 94, GJEDNJ 2008). Arsyja e kësaj qasjeje, e

cila vë në pikëpyetje këtë klasifikim, është se këto grupe të shoqërisë kanë qenë historikisht pjesë e paragjyqimeve që u kanë sjellë gjithmonë pasoja negative, duke rezultuar në përjashtimin e tyre social. Paragjyqime të tilla mund të sjellin stereotipa legjislativë, të cilat pengojnë vlerësimin individual të zotësisë për të vepruar dhe nevojave të këtyre individëve (shih *Shtukurov k. Rusisë*, nr. 44009/05, par. 95, 27 mars 2008).

**43.** Kërkuesi në çështjen konkrete humbi në mënyrë automatike të drejtën e tij për të votuar, si rezultat i vendosjes në kujdestari të pjesshme. Për rrjedhojë, ai mund të pretendojë se është viktimë e kësaj mase [...]. (shih *mutatis mutandis Hirst k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2), cituar më lart, par. 48 deri te 52).

**44.** Gjykata vlerëson më tej se trajtimi i njëjtë, sikur të jenë e njëjta kategori, i personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose mendore, është një klasifikim i diskutueshëm, ndërsa kufizimi i të drejtave të tyre duhet të jetë subjekt i shqyrtimit të rreptë [...]. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se **heqja e të drejtës së votës, pa bërë një vlerësim juridik individual dhe bazuar vetëm në ekzistencën e kujdestarisë së pjesshme të një individi, nuk mund të konsiderohet në përputhje me kufizimet legjitime të së drejtës së votës.** Pra, në rastin konkret ka pasur një shkelje të nenit 3 të Protokollit 1 të Konventës.

## Shpërblimi i drejtë

**87.** Gjykata i akordoi kërkuesit 3.000 euro në kuadër të shpërblimit të dëmit jo material.

“

**Molka k. Polonisë, 11.04.2006, Nr. 56550/00**

Nëse pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës së votës shkelte nenin 8 të Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

”

**Faktet** - Kërkuesi është një person me aftësi të kufizuar në masë të madhe. Në vitin 1998, atë e kishte ndihmuar nëna e tij për të shkuar në një qendër votimi, ku do të votonte në zgjedhjet për këshillat bashkiake dhe të qarkut, si dhe për asamblatë rajonale. Kryetari i Komisionit Zgjedhor Vendor e informoi nënën e kërkuesit se ai nuk mund të votonte, duke qenë se nuk lejohej marrja e fletës së votimit jashtë ambienteve të votimit dhe se ai nuk do të shkonte ta merrte kërkuesin për të votuar në ambientet e caktuara. Kërkuesi u kthye në shtëpi pa votuar. Ai pretendoi se atij i ishte privuar e drejta për të votuar pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar të tij. Gjykata Evropiane me mocionin e vet ngriti një kërkesë sipas nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës

Duke ardhur në përfundim se këshillat bashkiake, këshillat e qarkut dhe asamblatë rajonale nuk kishin asnjë kompetencë parësore lidhur me ligj bërjen dhe se nuk janë pjesë e legjislaturës së Republikës së Polonisë, referimi te neni 3 i Protokollit nr. 1 të Konventës nuk zbatohet për zgjedhjet në këto organe. Gjykata më tej vuri në dukje se kjo pjesë e zbatimit ishte e papajtueshme *ratione materiale* me dispozitat e Konventës.

### Pretendimi për shkelje të nenit 8 të Konventës

Duke vijuar më tej, për sa i përket nenit 8 të Konventës, Gjykata vërejti se në një sërë rastesh që i ishin referuar nenit 8, theksi ishte vënë tek fondet publike, për të lehtësuar lëvizshmërinë dhe cilësinë e jetës së kërkuesit me aftësi të kufizuara. Gjykata u shpreh në mënyrë më të përgjithshme, se gëzimi efektiv i shumë prej të drejtave të garantuara nga Konventa për personat me aftësi të kufizuara, mund të kërkojë miratimin e masave të ndryshme pozitive nga autoritetet kompetente shtetërore. Në këtë drejtim, **Gjykata u referohet akteve të ndryshme të miratuara nga Këshilli i Evropës, të cilat theksojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, veçanërisht në jetën politike dhe publike.**

Gjykata nuk përjashtoi faktin se, në rrethana të tilla, si ato në rastin në fjalë, do të duhej një ndërlikim

e mjaftueshme ndërmjet masave të kërkuara nga kërkuesi dhe jetës private të këtij të fundit, që të mund të zbatohet neni 8 i Konventës. Megjithatë, në përfundim Gjykata nuk e gjeti të arsyeshme të përcaktonte zbatueshmërinë e nenit 8 në rastin konkret, për sa kohë që kërkesa do të ishte në çdo rast e papranueshme për arsye të tjera (në veçanti, kërkuesi nuk kishte treguar se nuk e kishin ndihmuar persona të tjerë për të hyrë në ambientet e votimit, dhe situata në fjalë përbën një incident të izoluar, në krahasim me një sërë pengesash, arkitektonike ose tjera, duke u krijuar kërkuesve me aftësi të kufizuara fizike barriera për të pasur marrëdhënie me njerëz të tjerë dhe me botën e jashtme). Pra, kërkesa e ngritur në bazën e nenit 8 të Konventës ishte e pabazuar në nenin 35, par. 3 dhe 4, të Konventës. Gjykata e shpalli kërkesën të papranueshme.

## VIII. MOSDISKRIMINIMI

“

**Alajos Kiss k. Hungarisë, 20.05.2010, Nr. 38832/06**

Nëse kufizimi me vendim gjykatë i zotësisë së kërkuesit për të vepruar, si pasojë e të cilit ai nuk kishte të drejtë për të votuar, shkelte Konventën.

”

**Faktet** – Në vitin 1997, kërkuesi u diagnostikua nga një mjek si një njeri që nuk mund të kryente shërbimin ushtarak, sepse vuante nga diabeti. Në vitin 1999, ai u lirua edhe nga detyrimi për të shërbyer në Shërbimin e Mbrojtjes Civile. Në vitin 2000, ai u caktua në rezervat e mbrojtjes civile. Në vitin 2001, autoritetet i dërguan kërkuesit një urdhër pagesë për të paguar taksën e moskryerjes së ushtrisë për vitin 2000, me vlerë 477 euro. Kërkuesi e apeloj urdhër-pagesën, duke pretenduar se ishte viktimë e diskriminimit. Ai theksoi se kishte pasur gjithmonë dëshirë për të kryer shërbimin ushtarak. Në vitin 2001, Zyra Federale e Administrimit të Taksave e njoftoi kërkuesin se të gjithë meshkujt zviceranë të cilët nuk vuanin nga ndonjë aftësi e kufizuar “madhore”, duhet të paguanin taksën për moskryerjen e ushtrisë. Ndërkohë, njoftimi theksonte se në bazë të jurisprudencës së Gjykatës Federale zvicerane, kriteri i aftësisë së kufizuar fizike ose psikologjike duhet të përfshinte të paktën 40% të aftësive. Përmes një vendimi të korrikut 2003, autoritetet kompetente vlerësuan se, në bazë të një ekzaminimi mjekësor të bërë nga një mjek specialist, kërkuesi nuk mund të përjashtohet nga pagesa e taksës për aq kohë sa aftësitë e tij të kufizuara ishin më pak se 40%. Bordi i Apelit të Taksave Federale la në fuqi vendimin. Në vitin 2004, Gjykata Federale e rrëzoi apelin administrativ të kërkuesit. Zoti Glor u ankua në GJEDNJ për shkelje të nenit 14 të Konventës marrë së bashku me nenin 8 të saj.

## Vlerësimi i Gjykatës

### Në lidhje me shkeljen e nenit 14 marrë së bashku me nenin 8 të Konventës

**71.** Gjykata thekson se neni 14 i Konventës garanton mbrojtjen nga diskriminimi, me qëllim gëzimin e të gjithë të drejtave dhe lirive të garantuara nga parashikimet e tjera substanciale të Konventës dhe Protokolleve të saj. Megjithatë, jo çdo trajtim i ndryshëm sjell shkelje të këtij neni. Ai garanton që individë të ndryshëm, të cilët ndodhen në situata analoge ose të ngjashme, të mos gëzojnë trajtim preferencial, sepse kjo gjë është diskriminuese (shih *National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society k. Mbretërisë së Bashkuar*, 23 tetor 1997, par. 88, Raportet 1997VII, dhe *Zarb Adami k. Maltës*, nr. 17209/02, par. 71, GJEDNJ, 2006-VIII).

**72.** Në bazë të jurisprudencës së Gjykatës, një trajtim i ndryshëm është diskriminues sipas

kuptimit të nenit 14, nëse ai nuk është ndërmarrë në bazë të një objekti dhe justifikimi të arsyeshëm. Ekzistenca e një justifikimi duhet të shqyrtohet në lidhje me qëllimin dhe pasojat e masës së ndërmarrë dhe në kuadër të parimeve që mbizotërojnë normalisht në një shoqëri demokratike. Një trajtim i ndryshëm në lidhje me një të drejtë të garantuar nga Konventa, nuk duhet të mbështetet vetëm në një qëllim të ligjshëm: neni 14 shkelet edhe kur është qartësisht e dukshme se nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masës së ndërmarrë dhe qëllimit që kërkohet të realizohet (shih *Zarb Adami*, cituar me lart, par. 72; *Stec dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar* [DHOMA E MADHE], nr. 65731/01, par. 51, GJEDNJ, 2006-VI; *Petrovic*, cituar me lart, par. 30; dhe *Lithgow dhe të Tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1986, par. 177, Seria A, nr. 102).

**73.** Me fjalë të tjera, nocioni i diskriminimit përfshin, në përgjithësi, rastet kur një individ ose grup individësh trajtohen në mënyra

më pak të favorshme së të tjerët, pa një justifikim të vlefshëm, edhe pse një trajtim më i favorshëm nuk bëhet për shkak të Konventës (shih *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali*, cituar më lart, par. 82). Neni 14 nuk e ndalon trajtimin e ndryshëm, i cili vjen për shkak të rrethanave tërësisht të ndryshme, të cilat janë të bazuara në interesin publik, duke përfshirë edhe një balancë të drejtë mes mbrojtjes së interesit të komunitetit dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa (shih ndër të tjera *G.M.B. dhe K.M. k. Zvicrës*, nr. 36797/97, 27 shtator 2001, dhe *Zarb Adami*, cituar më lart, par. 73).

**74.** Shtetet Palë gëzojnë një hapësirë vlerësimi për të përligjur një trajtim të ndryshëm në situata të ngjashme. Fusha e veprimit të hapësirës së vlerësimit varet nga rrethanat e çështjes në fjalë... (shih *Fretté k.Francës*, nr. 36515/97, par. 40, GJEDNJ 2002I; *Stec dhe të Tjerët*, cituar më lart, par. 52; *Rasmussen k. Danimarkës*, 28 nëntor 1984, par. 40, Seria A, nr. 87; dhe *Inze k. Austrisë*, 28 tetor 1987, par. 41, Seria A, nr. 126).

**75.** Për sa kohë që Konventa është kryesisht një sistem për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Gjykata duhet të ketë parasysh kushtet e ndryshme në Shtetet Palë dhe duhet të mbajë parasysh, për shembull, çdo konsensus që shfaqet lidhur me standardet që duhet të arrihen. Një ndër faktorët më të rëndësishëm në përcaktimin e hapësirës së vlerësimit që u lejohet autoriteteve, mund të jetë ekzistenca ose mosekzistenca e një baze konsensusi apo marrëveshjeje mes ligjeve të Shteteve Palë (shih *Rasmussen*, cituar më lart, par. 40, dhe *mutatis mutandis*, *The Sunday Times k. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 1), 26 prill 1979, par. 59, Seria A, nr. 30).

**76.** Konventa dhe Protokollet e saj duhen interpretua në dritën e kushteve të tanishme (shih *Tyrrer k. Mbretërisë së Bashkuar*, 25 prill 1978, par. 31, Seria A, nr. 26; *Airey k. Irlandës*, 9 tetor 1979, par. 26, Seria A, nr. 32; dhe *Vo*, cituar më lart, par. 82). Së fundmi, Gjykata thekson se në bazë të jurisprudencës së saj të konsoliduar, Konventa nuk ka qëllim të garantojë vetëm të drejta teorike ose imagjinare, por edhe të drejtat praktike dhe efektive (shih për shembull, *Artico k. Italisë*, 13 maj 1980, par. 33, Seria A, nr. 37).

### **Nëse ka pasur një trajtim të ndryshëm të individëve që ndodhen në situata të ngjashme**

**80.** Gjykata vlerëson se, në çështjen konkrete, ekziston një shembull i trajtimit të ndryshëm të individëve që ndodhen në situata të ngjashme. Duke qenë se lista e ndryshimeve dhe “çdo status tjetër”, parashikuar në nenin 14, nuk

janë shteruese, (shih *Stec dhe të Tjerët*, cituar më lart, par. 50), nuk ka dyshim se ky parashikim përfshin diskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara. Mbetet për t’u vlerësuar nëse arsyet për të cilat është ndërmarrë një trajtim i ndryshëm kanë qenë objektive dhe të arsyeshme.

### **Nëse ekzistonte një justifikim objektiv dhe i arsyeshëm**

#### **(a) Justifikim objektiv**

**82.** Gjykata vëren se qëllimi i ligjit zviceran është të krijojë një formë barazie mes individëve që kryejnë shërbimin ushtarak, ose civil, dhe atyre që përjashtohen nga ky shërbim. Atëherë, duhet të vlerësohet nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis masave të ndërmarra dhe qëllimit që kërkohet të arrihet përmes tyre. Për këtë qëllim, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse autoritetet dhe gjykatat zvicerane kanë mbajtur një balancë të drejtë midis mbrojtjes së interesit të komunitetit, në tërësi, dhe të drejtave e lirive që kërkuesit i garantohen nga Konventa.

#### **(b) Justifikimi i arsyeshëm**

### **Hapësira e vlerësimit që u lejohet autoriteteve**

**83.** Gjykata thekson se Zvicra mbledh taksa nga të gjithë qytetarët meshkuj, të cilët për ndonjë arsye nuk kanë mundësi të kryejnë shërbimin ushtarak dhe nuk kryejnë as shërbimin zëvendësues civil, me përjashtim të atyre që kanë aftësi të kufizuara të mëdha. Megjithatë, ky fakt i marrë veçmas nuk është vendimtar për të vlerësuar një ankim në kuadër të nenit 14 të Konventës. Gjykata vëren se kjo lloj takse, e vendosur edhe për meshkujt që vuajnë nga ndonjë aftësi e kufizuar fizike dhe që nuk kanë mundësi të kryejnë shërbimin ushtarak, nuk duket se ekziston në vende të tjera, të paktën jo në Evropë [...].

**84.** Gjykata vlerëson se detyrimi i kërkuesit për të paguar një taksë, pasi ai është përjashtuar nga detyrimi për kryerjen e shërbimit ushtarak (ose civil), mund të jetë në kundërshtim me nevojën për të parandaluar diskriminimin ndaj individëve me aftësi të kufizuara, duke penguar pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre në shoqëri.

### **Interesat në fjalë**

#### **Interesi publik i shtetit të paditur**

**85.** Gjykata vëren se e vetmja arsye e paraqitur nga qeveria për legjislacionin në fjalë është ruajtja e barazisë mes individëve që kryejnë shërbimin ushtarak ose civil dhe atyre që nuk e

kryejnë atë. Në çështjen konkrete objekt gjykimi, individi në fjalë ishte diagnostikuar nga ana e autoriteteve me shëndet jo të përshtatshëm për kryerjen e këtij shërbimi. Në një situatë të tillë, Gjykata krijon bindjen se është në interes të komunitetit që ta detyrojë individin të paguajë një taksë kompensuese për moskryerjen e shërbimit ushtarak. Gjykata nuk e vlerëson të arsyeshme se kontributi financiar në fjalë i shërben një qëllimi të rëndësishëm kompensues (shih *mutatis mutandis*, *Karlheinz Schmidt k. Gjermanisë*, 18 korrik 1994, par. 28, Seria A, nr. 291B).

**87.** [...] Në bazë të të dhënave, rezulton se vitet e fundit, mbi 40% e të gjithë meshkujve eventualisht diagnostikohen si jo të shëndetshëm për shërbimin ushtarak. Në bazë të këtij informacioni që zotëron Gjykata, në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje, përqindja e individëve që marrin përfitime për aftësi të kufizuara është e ulët. Ndërkohë, një numër i madh individësh detyrohen të paguajnë taksën e kompensimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se të ardhurat e fituara nga pagimi i kësaj takse nuk mund të neglizhohen.

#### **Interesi personal i kërkuesit**

**89.** Gjykata vëren se taksa që ankuesit i është kërkuar të paguajë për vitin 2000 është rreth 477 euro. Është e vërtetë se kjo shumë përfaqëson vetëm 2% të rrogës së kërkuesit, por nuk mund të konsiderohet si e parëndësishme, nëse merret parasysh niveli modest i tatimit të të ardhurave të tij. Për më tepër, duhet mbajtur parasysh se kjo taksë duhet paguar çdo vit, për aq kohë sa zgjat edhe detyrimi ushtarak për individët e moshës 20 deri në 30 vjeç, ose edhe deri në 34 vjeç. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të çmojë se vlera financiare është simbolike.

#### **Si e kanë vlerësuar autoritetet nivelin e aftësive të kufizuara të kërkuesit dhe shumën e taksës përjashtuese**

**91.** Gjykata thekson se është detyrë kryesore e autoriteteve vendase, kryesisht e gjykatave, për të interpretuar dhe zbatuar ligjin vendas (shih *Winterwerp k. Holandës*, 24 tetor 1979, par. 46, Seria A, nr. 33). Megjithatë, Gjykata vlerëson se mënyra me të cilën vepruan autoritetet në çështjen në fjalë është e diskutueshme. Së pari, ata krahasuan vetëm sëmundjen e kërkuesit – e cila nuk e pengonte atë të punonte – me rastin e një individi që ka humbur këmbën për shkak të një aksidenti dhe arritën në përfundimin se aftësia e kufizuar e kërkuesit nuk prekte 40% të aftësive të tij të përgjithshme. Gjykata çmon se duke marrë në konsideratë vetëm një kriter

vlerësimi, bazuar në një rast tjetër me të cilin rasti i kërkuesit nuk mund të krahasohet, autoritetet zvicerane nuk arritën të shqyrtonin siç duhej situatën e kërkuesit.

**92.** [...] kërkuesi nuk mund të paraqiste ankimin se kishte të ardhura relativisht modeste dhe, si pasojë, në rastin e tij, detyrimi për të paguar taksën ishte jo proporcional.

**93.** Së fundmi, Gjykata vëren se personat e diagnostikuar me më pak se 40% aftësi të kufizuara dhe kanë të ardhura relativisht modeste, nuk mund të përjashtohen nga pagesa e kësaj takse[...].

#### **Mungesat e alternativave të tjera përveç taksës**

**94.** Gjykata vlerëson se që një masë të konsiderohet proporcionale dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike, nuk duhet të ketë mjete të tjera për të arritur të njëjtin rezultat, mjete të cilat do të ndërhyjnë më pak në të drejtat themelore që cenohen. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkuesi ka shprehur gjithmonë dëshirën për të kryer shërbimin ushtarak, por ai është cilësuar se nuk gëzon shëndet të plotë nga mjeku i ushtrisë [...].

**96.** Si përfundim, në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se në rastin e kërkuesit, i cili nuk u lejua të kryente shërbimin ushtarak ose civil, por iu kërkua të paguante një taksë përjashtuese, autoritetet shtetërore nuk kanë arritur të vendosin një balance të drejtë mes mbrojtjes së interesit të komunitetit dhe respektimit të të drejtave të kërkuesit, që mbrohen nga Konventa. Gjykata merr në konsideratë rrethanat e veçanta të çështjes në fjalë, duke përfshirë: shumën që duhet paguar – e cila nuk ishte e papërfillshme për kërkuesin – numrin e viteve për të cilën do të paguhej kjo shumë, faktin se kërkuesi kishte dëshirë të kryente shërbimin ushtarak ose civil, mungesën e parashikimeve në legjislacionin zviceran për lloje të tjera shërbimesh, që mund të kryejnë personat e ndodhur në situatë të njëjtë me kërkuesin, si edhe rolin minimal që luan taksa sot në drejtim të parandalimit apo kompensimit, për shmangien e shërbimit të detyrueshëm kombëtar.

**97.** Në dritën e qëllimit dhe të efekteve të taksës në fjalë, arsyet objektive të dhëna për të justifikuar trajtimin e ndryshëm të bërë nga autoritetet vendase, sidomos ndërmjet individëve të deklaruar me aftësi të kufizuara për kryerjen e shërbimit ushtarak, të përjashtuar nga pagesa e taksës, dhe atyre të deklaruar me aftësi të kufizuara, por që megjithatë janë të detyruar ta paguajnë atë,



nuk rezultojnë të arsyeshme në lidhje me parimet që mbizotërojnë në përgjithësi në shoqëritë demokratike.

**98.** Për rrjedhojë, kërkuesi ka qenë viktimë e një trajtimi diskriminues që solli shkelje të nenit 14 të Konventës, së bashku me nenin 8.

## INDEKSI ALFABETIK I ÇËSHTJEVE SIPAS NENEVE TË KONVENTËS

- *A.K. dhe L.K.*, neni 8
- *A.M.M.*, neni 8
- *Alajos Kiss*, neni 3 i Protokollit 1
- *Arutyunyan*, nenet 3 dhe 14
- *Asalya*, nenet 2, 3, 5, 13 dhe 8
- *Aswat*, neni 3
- *Botta*, neni 8
- *D.D.*, nenet 5 dhe 6
- *Dauti*, neni 6
- *Dmitriy*, neni 8
- *Dordević*, nenet 3, 8 dhe 14
- *Dybeku*, neni 3
- *Glass*, neni 8
- *Glor*, nenet 8 dhe 14
- *Grimailovs*, neni 3
- *Groni*, nenet 3, 5 dhe 34
- *Helhal*, neni 3
- *Hukić*, neni 3
- *Ivinović*, neni 8
- *Jasinskis*, neni 2
- *Katai*, neni 34 dhe neni 1 i Protokollit 1
- *Kjartan Ásmundsson*, neni 16 dhe neni 1 i Protokollit 1
- *Koua Poirrez*, neni 14 dhe neni 1 i Protokollit 1
- *Kutzner*, neni 8
- *Lambert*, neni 2
- *Lashin*, nenet 5 dhe 8
- *Mijailovs*, neni 5
- *Molka*, neni 8 dhe neni 3 i Protokollit 1
- *Nencheva*, neni 2
- *Pretty*, nenet 2, 3 dhe 8
- *Price*, neni 3
- *Qendra e Burimeve Juridike*, nenet 2 dhe 13
- *R.P. dhe të Tjerë*, nenet 8 dhe 6
- *S.H.H.*, neni 3
- *Salontaji-Drobnjak*, neni 6
- *Saviny*, neni 8
- *Shtukurov*, nenet 5, 6, 8 dhe 34
- *Spyra dhe Kranczkowski*, nenet 3 dhe 8
- *Stanev*, nenet 3, 5, 6 dhe 13
- *Vincent*, neni 3 dhe 14
- *X dhe Y*, neni 8
- *Zoti H.*, nenet 3 dhe 5
- *Zarzycki*, neni 3

# BURIME NË INTERNET PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Përmbledhje e çështjeve për aftësinë e kufizuar të GJEDNJ-së

[http://www.mdac.info/sites/mdac.info/files/English\\_Summaries%20of%20Mental%20Disability%20Cases%20Decided%20by%20the%20European%20Court%20of%20Human%20Rights.pdf](http://www.mdac.info/sites/mdac.info/files/English_Summaries%20of%20Mental%20Disability%20Cases%20Decided%20by%20the%20European%20Court%20of%20Human%20Rights.pdf)

Manuali për të Drejtën Evropiane për Mos-diskriminimin:

[http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/1510-FRA-CASE-LAW-HANDBOOK\\_EN.pdf](http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/1510-FRA-CASE-LAW-HANDBOOK_EN.pdf)

Personat me aftësi të kufizuara dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

[http://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Disabled\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/FS_Disabled_ENG.pdf)

Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Materiale Shpjeguese:

<http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=150>

Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara:

<http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/CRPD/Pages/GC.aspx>

